



Ismail
KADARE



S.P.I.R.I.T.U.S

Omnipress





Pjesa e parë

KAOSI

1

Ne u futëm në dheun e shqiptarëve nga ana lindore e tij. Ishte mesi i dimrit. Rrafshulta maqedonase që lamë pas, ishte e ngrirë. Pritësit vendës, kur panë se po fshinim qeljet e makinës për të shikuar më mirë, na thanë gjysmë duke qeshur se ishte i njëjti dimër. Së paku, gjer afër kryeqytetit.

Ne ishim të lodhur e pa shpresë.

Kishim muaj të tërë që endeshim në trevat e ish-perandorisë komuniste. Askush nuk e kuptonte ç'kërkonim. Lu shmangeshim sqarimeve, por, edhe po të donim të jepnim ndonjë sqarim, nuk do të mundnim. Kishte ditë të tëra që vetë ne nuk e kishim të qartë ç'donim.

Në arkat tonë kishim gjithfarë dosjesh e dëshmish. Tmerre, harta kampesh e burgjesh, letra të internuarish, vendime të fshehta e, natyrisht, copëza të prera gazetash. Të gjitha na kishin tërhequr aq shumë kur i kishim qëmtuar, por pak kohë më pas na ishin dukur, për çudi, të rëndomta e të përsëritura. Më në fund e kishim shprehur me fjalë

atë që kishim dyshuar historia e komunizmit, pavarësisht nga larmia e vendeve dhe e popujve që e kishin jetuar, ishte e gjithsejtë. Ashtu si ky dimër. Tani, që tisi i parë i harresës po binte mbi të, spikaste edhe më fort kjo njëtraftshmëri prej shkretëtire!

Ne kërkonim diçka tjetër. Diçka të veçantë, përmbledhëse, një ngjarje apo dukuri nga ato që kanë aftësinë të dendësojnë gjer në pamundësi një të vërtetë të shtrirë kaq fort. Kishim bindjen se një gjëmë e tillë e shkapërderdhur mbi gati gjysmën e rruzullit tokësor, nuk kishte si të mos jepte shfaqje të një cilësie të re, të paparë ndonjëherë, nga ato që quhen të mbikësojetshme.

Nganjëherë binim në dëshpërim, sidomos kur mendonim se përderisa trupat qiellorë, pa kurrfarë përkitejeje me njëri - tjetrin, ishin të përbërë pak a shumë nga e njëjta lëndë, si mund të shpresonim ne se brenda këtij planetthi mund të gjenim një lëndë të re, e aq më tepër, të krijuar në shekullin XX?

Tani, në mbarim të udhëtimit tonë, ne po e kuptionim se kishim vënë shumë shpresë te tmerrë. Kishim besuar se dendësia e tij mund të kapërcente të pamundurën e të pillte asosh ngjarjesh a dukurish, për të cilat ende s'kishte as emërtim në këtë botë. Ne rrakeshim t'i mendonim ato si bëma që s'duhej të ndodhnin, që për një gabim apo mosvëmendje i kishin shpëtuar pengesës fatale dhe, nga tryrsia e lemerishme, kishin dalë nga sgrofi i errët i përtejbotës, si Edipi që kishte dalë gabimisht nga barku i nënës, për t'u kthyer prapë në atë terr.

Shpesh na vinte të besonim se ndoshta të tilla shtrydhje kishte patur, por ato mund të ishin shfaqur vetëm një grimë kohe dhe aty pranë s'kishte qëlluar kurrikush për t'i parë. Apo, edhe në i paskësh parë, s'kishte kuptuar ç'ishin, tjetër nuk kishte dëshmuar dot.

Kishte ditë që na dukej se atë që kërkonim do ta gjenim më lehtë në viset e ftohta, atje ku bora e ndante për shumë muaj tokën nga qielli. Por vinin ditë të tjera

kur besonim të kundërtën. Rëra e shkretëtirës, e cila kishte nxjerrë qyshkur jetën prej barkut të saj, ishte më e përshtatshme, ndoshta. Nën diellin zhuritës pamjet dridheshin mbi të pabesisht, të gatshme për të pjellë mirazhe tashmë.

Në hapësirën ish-komuniste mund të gjeje të gjitha llojet e tokave e të ujërave. Përgjumjes së kënetave, me hënën sipër saj, na dukej se nuk do t'i duhej veçse pak gjë, për t'u bërë e aftë të dëshmonte. Një përzierje ndoshta me një pikëllim, me një krokamë korbi apo një stoli të humbur. Por as ato s'na kishin dhënë asgjë.

Nganjëherë mendonim se, mos ndoshta, e keqja që kërkonim, nuk duhej të shfaqeji, për arsyet që ne nuk mund t'i kapnim. Mbase, duhej të mbetej në këtë anë të rruzullit tokësor, për të mos prishur një drejtpeshim a një lëvizje të boshtit të tij.

Të gjitha këto s'kishte si të mos na vinin ndërmend ndërsa futeshim përherë e më thellë në tokën e shqiptarëve. E dinim që ishte një vend i vjetër legjendarë, megjithatë pas zhgënjamëve që kishim pësuar në ish - perandorinë e gjerë, caku i fundit i saj, Shqipëria, s'na këndellte dot shpresën.

Makina ngjitej ngadalshëm nëpër udhën malore. Nga të dy anët e saj, dëbora, për shkak të zgavrave e të çarave të zeza aty-këtu, dëbora ngjante si një maskë tragjike. Ne nuk i hiqnim sytë prej saj, ngaqë ndoshta na dukej se edhe asaj vetëm pak i duhej, që të kapërcente pengesën e të na fliste.

Në Shqipëri gjetëm, pak a shumë, atë që pritnim. Hotelet veç ishin më të mërzitshëm dhe kafenetë kishin më shumë tym.

Në çdo hap takonim ish-komunistë të brengosur, si të mbuluar nga pluhuri. Ish-të burgosurit tundnin thinjat edhe ata, por jo si më parë, me hakërrim. Shumica ishin të lodhur, madje edhe të marrët. Të lodhur ishin edhe pronarët prej ecejakeve pa fund në zyrat e bashkive, prej avokatëve e, sidomos, prej tapive të vjetra. Disa ishin me vula të shteteve që ishin përmbysur prej kohësh, madje me alfabetë të huaj që s'përdoreshin më kurrikund, ose që ishin të gjuhëve joindoevropiane.

Më tepër për të bërë ritin, ndoshta për të qetësuar ndërgjegjen tonë, në mënyrë të vetvetishme u përpoqëm t'u shpjegonim shoqëruesve vendës atë që kërkonim. I kishim përsëritur kaq herë fjalët, saqë nganjëherë na mërzitez vetja; një ndodhi e gjëmshme, e beftë si një çarje në murin ndarës të kësaj bote. Diçka që do të na lejonte një

grimë të shihnim ç'kishte përtej. Një gjë e matanshme, nga ato që quheshin të ëndërrta. E bërë kështu prej një krusme, prej një tkurrjeje të tmerrshme. E mosrrokshme për mendjen tonë. E tillë që thithë vetveten... dhe që ne... do të rrekeshim... t'i kthenim kahun..., domethënë ta tërhiqnim... këtej... për ta nxjerrë... nga terri.

Ata na dëgjonin gati me vuajtje, ngaqë donin vërtet që ne të shpëtonim nga ky mundim. Por pengesa në sytë e tyre ishte e ngjashme me atë që na ishte dukur se e kishim pikasur pas zgavrave të dëborës.

Pas disa ditësh diçka filluam të kapnim. Këtë e kuptuam nga njoftimet që na sillnin. S'kishin të bënин më me gjëra të njohura tashmë: dramat familjare të shkaktuara prej shtetit, krijimi i psikozës përparrë një fushate terrori, fazat e vetëndezjes së diktatorit. Ndodhitë sa vente e bëheshin më vetanake. Një njeri, i pandehur i vdekur qyshkur, ishte rishfaqur, krejt si në baladat e vjetra. Mirëpo të gjithë e kishin kuptuar se vdekja që e kishte marrë dhe e kishte nxjerrë prapë, nuk ish veç një sajesë e policisë së fshehtë. Për të mos u thyer zemrën, ne nuk u thoshim se ishte një histori e përsëritur nga të gjitha shërbimet e fshehta komuniste. Në Tobolsk të Rusicë, ku një nga torturat që përdorej shpesh ishte futja për disa orë në varr e një të gjalli përbri një të porsavdekuri, kishte ndodhur ngatërrimi i të torturuarit me të vdekurin, ndërrim që ishte marrë vesh vite më pas, pas hapjes së varrit, kur familja kishte marrë, më në fund, lejen për térheqjen e kufomës.

Ne vazhdonim të qëmtonim ngjarje të tilla, sidomos nga ato që të kujtonin mallkimet e stërmocojmë, që i ndiqnin brez pas brezi familjet dhe që ngjanin aq fort me luftën e klasave. Si në shumicën e vendeve të Lindjes, në Shqipëri nëma kishte vepruar gjer më tre breza. Ne e dinim ndërkaq se në Rusi dhe në Mongoli kishte mbërritur deri në pesë breza.

Ngjarjet ishin tronditëse, megjithatë diçka iu mungonte përherë për t'u kthyer në mite të vërteta. Enët e miteve të vjetra, të vetmet që mund ta përballonin gjithë atë zi e atë

natë, ishin aty përbri, krejt si vazot e porsanxjerra nga toka prej arkeologëve. Mirëpo ndodhitë e sotme dhe vazot qëndronin të ndara.

Kishim kohë që e kishim ndjerë se për të qenë ajo që e mendonim ne, një ndodhi duhej ta krijonte vetë zhguallin e saj. Veç kësaj, ato ishin ende të paarrira, siç thuhej, aguridhe, dhe do t'iu duhej së paku dyqind, ndoshta treqind vjet, për të fituar atë rreshkje e atë tkurrje të legjendës.

Ne i pyetëm disa herë shqiptarët lidhur me kinse të vdekurin, për të ditur nëse, qoftë edhe një pjesë e njerëzve mund ta kishin besuar se ai kishte ardhur vërtet nga bota tjetër. Por të gjitha herët atë kishin buzëqeshur: do të ishte tepër naivë të besohej kjo, ku'r dihej se në dosjet e Sigurimit bëheshin çudira edhe më të mëdha. Veç kësaj, ato dosje ishin tepër familjare për gjithkënd. Flitej për to si për ndryshimin e motit...

Ne buzëqeshnim gjithashtu, por me hidhërim. Ja ç'duhej të rrëzohej e para, të vyshkej si gjethet, në mënyrë që ngjarja të çlirohej nga barra e parë, dosja. Kur ajo të tretej, ngjarja vetë do të prodhonte cipën e parë të lëvozhgës mbrojtëse, pastaj të dytën, të tretën, gjersa të mbyllej në guackën misterioze të mitit.

Por ne nuk do ta arrinim dot këtë për arsyen e thjeshtë të jetës sonë të shkurtër njerëzore. Ndaj nguteshim e pas çdo ngutjeje dëshpëroheshim edhe më fort, ashtu si në fushat e Polonisë, si midis mërzisë së hungarezëve, apo në Çekinë e pahitur me qomyrguri. E vëtmja shpresëz e fundit na mbetej mrekullia që mund të bënte një tmerr i sipërjetshëm. Shembullin e viktimate që prej llahtarës, në vend të 30 ose 40 vjetësh, thinjeshin brenda një grime, e kujtonim përherë e më shpesh.

Një mbrëmje njërit prej nesh iu duk se dalloi në qiell një rrufé të ftohtë, të ngadaltë, dhe pastaj, në prag të dremitjes, i ishte dukur se faji rëndonte në anën e majtë të qytetit. E kishte pritur një copë herë të shfaqej, pastaj ia dha dënesës për një brengë të tij të vjetër.

Një ditë tjetër e gjetëm shefin tonë të zhytur në librin "Gjuha shqipe, njohuri për turistët". Kishte thënë disa herë se në gjuhën e një populli mund të gjesh kyçet për të zbërthyer misterin e tij, por ngaqë një mendim të tillë e kishte shfaqur në Shën Petërsburg, madje edhe në Budapest, pa e njohur as rusishten e aq më pak hungarishten, kurrsesi nuk na shkonte mendja se do të guxonte të përzihej me gjuhën e vështirë të shqiptarëve.

Në të vërtetë tortura që ndihej që larg në ngërthimin e vetullave dhe të atyre pak flokëve në kokën gjysmë të shogët, mezi ç'priste ardhjen e vendësve për t'i munduar edhe ata me ca pyetje të vështira. Një zot e dinte se ku i kishte gjetur ca shprehje të papërkthyeshme, si: "dita e moskurrit", "ngjarje e mosqoftshme", e sidomos një trajtë të foljes më të cilat ato lidheshin, një trajtë që quhej "dëshirore", e që qenkësh vetëm në gjuhën shqipe e ndoshta, disi në greqishten e vjetër. Sipas tij, kjo trajtë ishte vegla që gjithë foljeve të shqipes mund t'u jepte kahun e mbarë ose të prapë, me fjalë të tjera, një frymë të mirë ose të keqe.

Jo vetëm ne, por edhe vendasit mbetën disi të hutuar, ngaqë, siç e pohuan edhe vetë, e dinin pa dyshim këtë trajtë, madje e përdornin në të folurën e përditshme, por mendja nuk u kishte shkuar aq larg.

Shefi ynë i zhbironte me ca sy që herë ngjanin shpotitës e herë bëheshin të ligj, thua se fryma e mirë ose e keqe e gjuhës shqipe e kishte molepsur ndërkaq. Natyrish që s'u ka shkuar mendja, thoshte ai, sepse mendjes suaj aq ia pret. E përdorni atë trajtë, e nuk e dini se ajo është makina që prodhon të gjitha mallkimet e bekimet që janë tek ju si askund. M'i gaculloni sytë si të bufit, sepse nuk iu shkon mendja që sipas mendësisë së të parëve tuaj hyjnité e vogla, Orët, s'bëjnë gjë tjetër, veçse enden e përenden gjithkund për të mbledhur e për të çuar pastaj atje ku duhet qoftë mallkimet, qoftë bekimet që dëgjojnë andej-këndej. E kuptoni tani se ato hyjni i shërbijnë pikërisht kësaj makine? Dhe e kapni dot tani se, kur poetët tuaj të

vjetër e quanin gjuhën shqipe hyjnore, këtë e bënin jo se besonin në dokrra të tillë, por thjesht ngaqë e dinin se trajta dëshirore e foljes, ky thesar që e dallon atë nga gjuhët e tjera të botës, ka lidhje me Orët? Po ju as që doni t'ia dini për këto. Ju dini veç të ankoheni. Ndaj dhe e keni lënë vendin tuaj në këtë ditë të zezë. Ndaj dhe diktatori juaj, prifti apo hoxha, si e quanin, iu shëmtoi të gjithëve duke ju shtypur, dehur, e së fundi duke ju lëshuar mbi qafë si vezët e qyqes, gjysmë milioni bunkerë.

Sa më shumë fliste aq më fort nxehet, gjersa erdhi një çast që ne besuam se do të kapte ndokënd përfytë ose do të kapej ai vetë prej fytë nga vendësit e fyter. E pati edhe vetë siç duket atë droje, se në kulmin e pezmit u kthyesh befas mbrapsht përf t'u mbyllur në dhomën e vet.

3

Pas ftohjes së shoqëruesve vendës me shefin, atëherë kur ne prisnim që kjo të ndikonte për keq në marrëdhëniet tonë, ndodhi diçka në kah të kundërt. U bë shkak, ndoshta, vetë pezmatimi, ose ishte një përkim i rastit, por dy ditë më pas, ndërsa pinim kafenë e mëngjesit në barin e hotelit, njëri prej shoqëruesve tha se, me sa dukej, kishim rënë në gjurmë të asaj që kërkonim. Ishte fjala për një ngjarje që thuhej se kishte ndodhur në qytetin fqinj, një ngjarje tejet misterioze, si të thuash "e mosqoftshmë".

Shefi ynë i uli sytë dhe bëri sikur nuk e kapi shpotinë në zërin e tjetrit, çka tregonte se e kishte harruar ndërkaq acarimin e paradyditshëm dhe donte që edhe të tjerët ta harronin.

- T'i lemë mahitë, -ndërhyri shoqëruesi tjetër. -Ajo që tregohet është vërtet tejet e habitshme. -Ai gjerbi kupën e kafesë fare ngadalshëm. -Në qytetin fqinj, ose diku më larg, vite më parë policia e fshehtë shqiptare paska arritur të kapë një shpirt.

Ne qëndruam disa çaste në heshtje dhe, meqenëse shefi i mbante ende sytë mbi kupën e tij të kafesë, me aq sa ia njihnim huqet, na u duk se priste të bënim pyetjet, që në këtë rast duhej t'i bënte ai. Ç'do të thoshte "kapje e një shpirti"? Dhe kur kishte ndodhur kjo? Dhe në ç'rrethana? Dhe qysh?

Shoqëruesit ngritën supet për të thënë, me sa dukej, se a mund të bëheshin pyetje të tillë.

Dhe kishin të drejtë. Ishin pyetje të kota, të ngjashme me "ah, ashtu!?"-të, që njerëzit i përdornin vend e pa vend në bisedat e përditshme.

Pyetja e vërtetë u bë pas hutimit të parë. Kishte një bazë kjo ngjarje, apo ishte thjesht frut i një truri të ndezur?

Shoqëruesit na u përgjigjën se ata dinin tani aq gjëra për punën dhe qëllimin tonë, saqë të mos nguteshin për të na sjellë përralla ose tregime fantastiko - shkencore. Ishin të gjitha gjasat se rrëfimi mbështetej mbi një ngjarje të vërtetë, ndonëse ajo mbetej tani për tani krejt e errët. Madje ngjarja tre gohej në dy motërzime: kapja e shpirtit të dikujt prej Sigurimit, ose përgjimi i dikujt edhe pas vdekjes.

-Dy motërzime...O Zot, krejt si në lashtësi!
-ishte hera e parë që shefi ynë hapte gojën.

Biseda u çlirua më në fund krejtësisht dhe ne porositëm nga një kafe tjetër. Shqiptarët na thanë se diçka u kishte zënë veshi edhe më parë për këtë, por vetëm këtu, në qytetin B., ishin bindur se prapa asaj që dukej përrallë, fshihej diçka e një mendtë. Por gjithçka ishte mbuluar me kujdes. Me sa dukej, Sigurimi shqiptar kishte dashur ta mbante të fshehtë me çdo kusht mënyrën si kishte vepruar, ose mjetet e përdorura. E kishte fshehur, siç fshihet shpikja e çmuar, ose ngaqë donte ta përdorte përsëri...

Ne u kthyem e u rikthyem te kuptimi i fjalëve "kapja e një shpirti", ose "përgjimi pas vdekjes". "Kapje" a do të thoshte vërtet ndalimi i një shpirti, hedhja e prangave, si të thuash, apo në gjuhën shqipe kjo folje

kishte edhe ngjyrime të tjera? Vendësit na siguruan se folja ishte përdorur këtu në kuptimin e saj të parë, domethënë, kapje si në grackë, siç kapen zogjtë, fluturat. Kurse përgjimi pas vdekjes ishte më i mjegullt. Mund të kuptohej si përgjimi i kufomës së atij, ose e hijes, që iu shfaqej, ose më mirë që besohej se iu shfaqej njerëzve që kishin pasur punë me të.

Natyrisht shtresa e mjegullës ishte ende mjaft e dendur. Madje ata kishin shkuar gjer në qytetin fqinj për të sqaruar diçka, por më kot. E vetmja gjë që u bindën ishte se ngjarja nuk kishte ndodhur në të vërtetë atje, por larg, shumë larg. Qyteti fqinj besohej prej shumëkujt si vendngjarje nga që, pikërisht atje ishin bërë hetime për një pjesë teatrale, që duhej të shfaqej e ishte ndaluar pastaj. Një copë herë ata folën për dramën e ndaluar. Ishte një pjesë e Çehovit, "Pulëbardha" ose "Lumbardha", siç quhej në shqipen e vjetër.

Gjatë kohës që ata flisnin, shefi ynë kërciste gishtat nga padurimi. Më në fund s'e mbajti dot veten.

-Më çmendët me këtë pjesë teatrale. Bëni ç'bëni dhe vërtiteni rreth saj. Po ku e dini ju se kjo histori ka lidhje me të!?

Një grimë ata u hutuan nga kjo ndërhyrje, pastaj, pothuajse njëzëri, thanë se të gjithë njerëzit që kishin dëgjuar diçka për "shpirtkurthin" (ishte herë e parë që ata përdornin një fjalë të tillë), vinte një çast dhe e përmendnin dramën e ndaluar.

-Atëherë s'kemi ç'presim më, -tha shefi. -Të nisemi atje.

. 4

Ende sot, kur hap fletoren ku kam zbardhur bisedat me pjesëtarët e trupës së teatrit që ende kishin mbetur gjallë, ndiej një përqethje tmerri. S'kishte ende kurrfarë arsyё pér këtë. Madje, në pamje të parë, ngjante një histori e rëndomtë ndalimi, nga ato që mijëra herë ishin përsëritur në Lindjen e pafundme, që nga shfaqjet e amatorëve të kolkozeve ruse gjer në Operën e Berlinit. Megjithatë, një drithërim i shurdhër, si ato që vijnë nga nëntoka, u duk se na dha shenjën misterioze. Diku, thellë, shumë thellë, nën këmbët tonë, ishte ndoshta, në mos ajo që kërkonim, një hulli që çonte drejt saj.

Ishim ende lart, shumë lart, në sipërfaqe të tokës, kurse misteri ishte struktur poshtë zgafellave të frikshme, atje ku asgjë nuk depërtonte dot. Ishim, si të thuash, sipër lëvozhgës që mbështillte ngjarjen: shtresime të tëra balte, gurësh, gëlqereje e ndoshta qymyri të zi, na ndanin prej saj; megjithatë, edhe që larg, që poshtë zhguallit të saj të lemerishëm. ajo e tejçonte ankthin.

Ne ende s'dinim asgjë. Nuk dinim jo vetëm bërthamën e ngjarjes, por as imtësi që lidheshin me të, si për shembull, që ajo pjesë teatrale ishte ndërkaq e mallkuar.

Gjithkush që do të dëgjonte shprehjen "pjesë ose koncert i mallkuar", mendja do t'i shkonte së pari te fushatat e herëpashershme në jetën letraro-artistike. Por këtu ishte fjala për tjetër gjë, mallkimi ishte bërë prej një njeriu që nuk ia kishte dëgjuar as emrin Çehovit, madje që s'kishte qenë kurrë në kurrfarë shfaqje teatrale plakës Drane, tetëdhjetëedyvjecare, katolike, nga një katund pranë Lezhës... Por gjithçka do të merrej vesh më pas.

Mbërritëm po atë mbrëmje në B. Që larg, vezullimi i dritave të tij na u duk jomikpritës. Ndoshta ishim ne vetë të ngarkuar para kohe me do ndjesi të mbrapshta, ose ishte vërtet ashtu. Kur hymë në qytet, na u duk se kuptuam diçka më shumë. Si kudo në ish-Lindje, shumica e kafeneve dhe e bareve mbanin emërtime perëndimore. Veçse këtu gjithçka ishte çuar në skajshmëri. "Bevërli Hills", "Eva e St. Germain des Pres", "Roma", "Monte Carlo".

Harrimin që krejt kjo botë dëshironte prej kohësh, ndihej që ky qytet po e kërkonte me ngut. Ne na dukej vetja si lajmës ogurzinj, që sillnin kujtime të padëshëruara.

Përpara se të pyesnim për pjesëtarët e trupës, i ramë kryq e tërthor rrugës kryesore. Pastaj ndaluam përpara ndërtesës së teatrit. Afishet e shfaqjes së fundit ishin të shkalafitura nga era. Lajmërohej një premierë e re, por, ndërkaq, ndërtesa nxinte. Na thanë se të shtunave s'kishte prova, kështu që aktorët, po të donim mund t'i gjenim në klubin "As".

Në klub tymi i cigareve të zinte frymën. Kujtuan se ishim ndonjë firmë kinematografike që kërkonte aktorë vendës për role të dorës së tretë, ndaj na u afroan me gjëzim. Pastaj u zhgënjen, kur morën vesh se interesoheshim për shfaqjet e dikurshme. Ohu, thoshin duke i rënë ballit, me gjithë mend e keni!?

Iu dukej se ajo kohë s'kishte qenë kurrë. Disa as që e besonin që teatri kishte dhënë vërtet shfaqje. Me sa

55228

kishim dëgjuar, më tepër shërbente për mbledhje përkujtimore. Më rrallë, për ndonjë gjyq të hapur. Pastaj, kur ne këmbëngulëm se kishte pasur edhe shfaqje, diçka u kujtuan. Kishte patur, natyrisht, edhe shfaqje, por ato ishin drama..., si të thuash... me kooperativa. Të "socializmit realist", siç quhej në atë kohë. Të "realizmit socialist", -e qortonte tjetri. -Ah, ashtu, a s'është e njëjtë gjë?

Kur ne pyetëm për "Pulëbardhën" e Çehovit, ata ulën kryet. E kishin nxjerrë, me sa dukej, nga kujtesa, dhe përherë iu duhej një farë kohe sa të mësoheshin me përmendjen e saj.

"Pulëbardha" e Çehovit? Diçka kanë dëgjuar, natyrisht. Por ajo është tjetër gjë... Lidhej me diçka të errët që nuk u sqarua asnjëherë...

Me çfarë lidhej? Ç'nuk u sqarua?

Ata ngrinin supet dhe vështronin njëri-tjetrin. Ishte një gjë tepër, tepër e errët.

Nga që drama ishte e mallkuar, e keni dëgjuar ju që ajo dramë ishte e mallkuar nga një plakë?

Edhe këtë e kemi dëgjuar, por mjegulla nuk u shkaktua prej mallkimit. Ishte ndoshta e kundërtta.

Ç'domethënë e kundërtta? Që mjegulla shkaktoi mallkimin?

Ka mundësi. Por e gjitha kjo është një histori tepër e moçme. Dhe, ngaqë është e errët, ngjan dyfish e moçme.

Dhe këtë nuk e kuption më kurrikush?

Kurrikush, besoj. Njerëzit tërhiqen nga të tjera punë tani. Herën e fundit që u fol për të, në mos gaboj, ishte fill pas përbysjes së komunizmit. Një aktor e vranë mu në mes të rrugës me armë gjahu. Atëherë, në mos gaboj, u përmend dhe "Pulëbardha" e Çehovit. Pastaj, kurrë më.

-Një aktor i vrarë, dhe ne nuk na thanë asgjë... Oh, jo... -ia bëri shefi ynë dhe kapi ballin me të dyja duart, si të shmangente një shpërbërje në kafkën e tij.



Shumica kishin vdekur ose ishin shkulur këndej. Gjetëm vetëm drejtorin e teatrit, të shoqen e regjisoret dhe njëren nga aktoret kryesore, atë që lozta "Pulëbardhën". Të gjithë ruanin ende afishet e shfaqjes, të zverdhura tashmë, me një pulëbardhë të rrëzuar në breg të liqenit. Dhe natyrisht, fotografitë e premierës. Çasti i dhurimit të luleve. Rimeli që kishte rrjedhur pak te syri i djathtë, me siguri prej lotëve. Pjesë nga salla: fityra të ngazëlliyera, disa krejt të hutuara, si përpara një sfinksi.

Drejtori: S'kam kuptuar kur gjëherë asgjë. Ndalime shfaqjesh, madje në çastin e fundit, kur biletat ishin shitur krejt, kanë qenë një gjë e zakonshme. Por ajo që ndodhi me "Pulëbardhën" ishte tejet e pashpjegueshme. Urdhrat vinin nga drejtime të ndryshme kundërthënëse. Njëri e çnjihte tjetrin. Shfaqja u pezullua katër herë, dhe po aq herë u lejua, gjersa u ndalua përfundimisht. Dhe asnëherë nuk u sqarua asgjë. Enigma ishte e tillë, saqë një herë u

pëshpërit se kishte qenë Sigurimi vendës për shfaqjen dhe Komiteti i Partisë kundër. Kur e dëgjova në fillim m'u duk si një nga ato mahitë cinike, që i hapte vetë policia e fshehtë për t'u tallur, ose për dreqi e di çfarë. Më pas, kur u bënë sqarime në Sigurim, më kujtohet, një nga fajësimet ishte qëndrimi liberal ndaj "Pulëbardhës"! E merrni dot me mend një gjë të tillë? Gjithmonë mjegull, o Zot, ç'mjegull! Kanë kaluar kaq vite dhe kurrë s'kam mundur të kuptoj asgjë. Sa për atë punën e shpirtit të kapur, diçka më ka zënë veshi në atë kohë, por tepër turbull. Kishim kaq shumë ankth me vete, sa që s'na bënин përshtypje pëshpërimat e tillë.

Gruaja e regjisoret: Të gjithë vuajtën. Por pesha më e rëndë, kuptohet, i ra atij. Jam e bindur që edhe kanceri prej asaj iu shkaktua. Ditë të tëra mërzie, pastaj një shpresëz e zbehtë, diku në larginë. Ose e kundërtta, mu midis ngazëllimit të punës, një pëshpërimë e zezë e priste si me thikë, gjithçka. Natën qëllonte të fliste përqart. Më kapte dorën në gjumë, si të më kërkonte pulsin. "Shfaqja vazhon", - murmuriste. Pastaj befas, me zë të prerë, thoshte, "mbaroi"... Nuk po përmend vuajtjet e tjera: mbledhjet rraskapitëse, disa herë gjer më tre pas mesnate. Zhbirime, zhbirimë pafund. Pse ju shkoi mendja pikërisht tek kjo pjesë? Ç'mendim keni për dramat revolucionare të letërsisë së sotme? Ç'simbol gjetët te vrasja e pulëbardhës? A e dinit se shokët kinezë e kishin ndaluar këtë dramë? Për secilën pyetje kërkoheshin gjithmonë shkaqe të thella. Pastaj shkaqe edhe më të thella, pas të cilave vinin pyetje të tjera nga më të papriturat, p. sh. "pse nuk donit të merrnit në shfaqje ushtarini?".~~X~~ Ushtari, për të cilin pyetët edhe ju, ishte ai aktori që u vra pas shembjes së diktaturës. Në të vërtetë nuk ishte aktor, ishte thjesht një ushtar që kishte shërbyer në kufirin detar dhe, me sa dukej, kishte luajtur atje në grupin amator. Shpjegimet për të ishin nga më të vështirat. Më kuptoni ju lutem, përgjigjej im shoq. Ai mund të ishte një djalë i mrekullueshëm, një hero i kufirit,

por ai ishte amator dhe nuk mund të lozte në një dramë të tillë. Mos dredho, e ndërpriste sekretari i Partisë. Shkaku i vërtetë që nuk deshe ta merrje ishte sepse ai kishte shërbyer në kufi, në organet e diktaturës së proletariatit. Oh, edhe tani që e kujtoj, ndiej një zgavrinë këtu, në lukth.

Sekretari i Partisë së Rrethit për propagandën: Ç'keni me mua? Ç'hyj unë këtu? S'e ndalova unë pjesën. Urdhrat vinin nga lart dhe, urdhurat e Partisë, dihej që ishin të shenjta. Kush mund të dyshonte për to? Tani dalin ca trimoshë që ngrefosen. Hm, është lehtë të fryhesh tani. Në atë kohë ishte ndryshe. Mua, edhe tani, kur bie telefoni, më dridhet mishtë... Dega e Brendshme ishte për lejimin e mëtejshëm të shfaqjes? Hm, ç'më bëtë të qesh... ha, ha, ha,...! Mos më shikoni me ata sy ashtu... Këtë s'do ta merrni dot vesh kurrë. Kaq ta bëni dhëmbin, këtë s'do ta merrni vesh. Bota përmbyt të kthehet. Oh, lermëni t'i ngrys i qetë këto pesë ditë që më mbeten! Njeri jam edhe unë. Krijesë njerëzore jam.

Aktorja (Pulëbardha): Kur e mendoj gjithë atë histori, ende sot nuk e kam të qartë se ç'zotëronte në të: brenga apo lumturia. Ishin, pa dyshim, të dyja dhe ndonëse njerëzit kanë prirje që zezonat t'i kujtojnë më fort, unë s'mund të them se ngazëllimi që përjetova, ishte më i pakët se brenga. Isha si e dehur në atë kohë. E dija që lumturia ishte e përkohshme. Si ylberi, si rinia. Më falni që s'po i mbaj dot lotët. Kam kohë që s'kam qarë. Po të qash tani për këto gjëra ka rrezik të të tallin... Përpinqem të kujtoj kryesisht çastet e lumtura që më dha ajo shfaqje. Doja që gjithë jetën time ta tkurrja për ta futur në to. E ndieja që ky ishte rasti i vetëm. Një pulëbardhë e ardhur nga stepat ruse të shekullit të nëntëmbëdhjetë... Më falni, më duket se po flas marrëzira!? Mos ma merrni për keq. Doja, pra, ta përjetoja gjithçka në mënyrë të plotë. Sepse ishte një kohëz ylberi. Isha njëzetëkatër vjeç, kisha veç dy vjet që

kisha mbaruar shkollën e Lartë të Arteve në Tiranë dhe, ndonëse e doja burrin, pikërisht në atë kohë, midis dy provave pata një... flirt...e tradhëtova, siç thuhej atëhere. Më falni, ju lutem. Ngutesha t'i provoja të gjitha. Isha si ai që mbledh temotje për një dimër të gjatë. Dhe dimri, siç pritej, erdhi, por unë s'dua ta kujtoj... Si të mos mjaftonin mbledhjet për të dënuar shfaqjen, m'u shtuan edhe hetimet për flirtin. Por brengë kryesore mbeti "Pulëbardha"... Në ëndërr, nganjëherë më dukej se shfaqja u lejua prapë. Një zë na thërriste: shpejt, shpejt, salla është prapë plot. Ne vraponim për të dalë në skenë, por pengoheshim. Nuk gjenim dot petkat, këpucët... Veç kur mezi e arrinim skenën, e shihnim se ishim gjysmë lakuriq.

6

Pas darke qëndruam vonë në barin e hotelit. S'na hiqej nga mendja historia e "Pulëbardhës". Sidomos fati i "ushtarit". Jo, s'mund të ketë lidhje me atë që kërkojmë ne, tha befas shefi ynë. Ne e vështruam gjithë habi. Ndonëse e kishim menduar të gjithë, askush s'e kishte shprehur me fjalë. Shefi e kuptoi dhe buzëqeshi si_i zënë në faj. Gjithë kohën atë bluaja në kokë, tha. Pastaj shtoi: do të na çmendë ndonjë ditë ky mish-mash.

Ushtari e kishte kryer shërbimin në bregdetin e Jugut, në një nga zonat ku ndodhnin zakonisht arratisje. Ishulli grek i Korfuzit nuk ishte më larg se gjashtë milje, por natën dritat e tij dukeshin se do t'i kapje me dorë. Ai, siç duket, i ndillte arratisësit. Ikjet sa vinte bëheshin më të vështira. Bregu ruhej ditë e natë me gjithfarë mënyrash: ushtarë me qen, bashkëpunëtorë të policisë së fshehtë, të veshur si pushimtarë, si lypësa ose si lavire që kërkonin turistë të huaj. Ujërat përgjoheshin jo më pak. Natën dy projektorë ndriçonin frikshëm syprinën e detit. Urdhrat

nga qendra vinin përherë e më të rrepta: të ulet edhe më fort numri i arratisjeve. Në të gjitha mbledhjet e ushtarakëve pika e parë e rendit të ditës ishte e pandryshueshme, ikjet. Telegramet që dërgoheshin në kryeqytet me rastin e kongreseve të partisë ose të ditëlindjes së udhëheqësit nisin shpesh me to: "Ne, kolektivi i njësisë ushtarake X. të kufirit, i zotohem i udhëheqësit se në muajin tetor, në zonën që na ka besuar Partia, nuk do të ketë asnjë arratisje".

Zotimi nuk ishte i lehtë për t'u mbajtur. Pas shkeljes së tij vinin shkarkimet, dënimet e, pas tyre, ia mbërrinin oficerë të tjerë, zakonisht, më të ashpër se të parët, që parashtronin mënyra të reja përgjimi. Ishin ndërruar disa herë telat me gjemba në pikat e rrezikshme, ishin zëvendësuar projektorët, tejqyrat, barkat e ndjekjes, së fundi, ishin zëvendësuar kinse laviret me laviret të vërteta, të sjella nga kryeqyteti, të cilat ndryshten nga vajzat e Sigurimit, e kishin të lejueshme të bënин ç'të donin me viktimat, mjaftonte që t'ua zbulonin qëllimet. Ishin provuar pra të gjitha, gjer në verën e paharrueshme të fillimit të viteve tetëdhjetë, kur shefi i porsaemëruar i Sigurimit, e zgjoi në orën pesë të mëngjesit sekretarin e Partisë së rrethit për t'i dhënë një lajm të rrallë... Po atë fundjave, të lajmëruar s'dihej qysh, turma të banorëve të qytetit bregdetar, të përzier, me turistë vendës e të huaj, vështronin të llahtarisor që nga bregu barkën e policisë, në kicin e së cilës ishte shtrirë një kufomë. Trupi ishte plandosur përmbyss, me duart dhe trupin të varur poshtë, thua se ndiqte me sy çurkat e gjakut, që para pak kohe kishte qenë i tij.

S'kishte patur nevojë për kurrfarë shpjegimi që të merrej vesh ç'ishte ajo kufomë.

Në të vërtetë, tmerri që u mboll ishte i papërfytyrueshëm. Shumë njerëz i lanë pushimet përgjysmë duke gjetur gjithfarë shkaqesh, të tjerë u mbyllën në dhomat e hoteleve e nuk dilnin më. U duk se mënyra e re qenkësh më frytdhënëse se të gjithë telat me gjemba, projektorët, qentë, radarët e laviret të marra së bashku. Ikjet u ndërprenë vërtet, por kjo nuk vazhdoi gjatë. Pa mbaruar stina turistike dy motra,

studente nga Tirana, kishin arritur të kapërcenin kufirin me not. Egërsimi i shtetit ishte i pashebullt. Ajo cipëz e hollë zbutjeje, që dukej se mund të sajohej aty-këtu, cipëz pendimi që vinte zakonisht pas mbingopjes prej krimít, e që në të vërtetë s'ishte veçse frika bestyde prej mëkatit, u thye menjëherë.

"Ushtari" në atë kohë kryente shërbimin pikërisht përballë Korfuzit. Në postën e vogël kufitarejeta ishte e mërzitshme. Kështu që ata që kishin njëfarë dhuntie, që i binin kitarës për shembull, dalloheshin menjëherë. Pas leximit të një vjershe e, sidomos, pas një skeçi humoristik, që ai bashkë me një ushtar nga Shkodra sajuan për natën e Vtitit të Ri, të gjithë filluan ta quanin "artist".

Kështu e kishte quajtur dhe komisari i postës kur e kishte thirrur në zyrë: dëgjo, artist. Pas ca frazave të përgjithshme për atë se si arti duhej t'i shërbente popullit, ai ia shpjegoi ç'kërkonte prej tij. "Ushtarit", në fillim i kishte ngrirë gjaku. Kishte kujtuar se donin ta bënin spiun. Pastaj ishte lehtesar, ajo që i kërkonin ishte gjithsesi befasuese, por shumë më e lehtë. Ai duhet të lozta një rol... Ai duhet ta kuptonte mirë ç'kërkohet prej tij. Lufta e klasave sa vente ashperohej. Armiku përpinqej të cënonte revolucionin. Por revolucioni nuk sprapsej lehtë. Me dhunë do ta shtypte çdokënd. Siç mund ta kishte dëgjuar ai, pas një stepjeje të përkohshme, shkatuar prej tregimit të kufomës, arratisjet kishin nisur prapë. Siç dukej, frika po dilte. Ti mund të thuash pse nuk e ripërtërijmë frikën, kishte thënë komisari. Dhe ke të drejtë, ajo duhet bërë. Veç këtu na mungon diçka: s'kemi kufoma... Ai e kishte kapur për supesh ushtarin dhe, duke ia afruar fytyrën, i kishte thënë: ç'mi zgurdullon sytë ashtu? Kufomat janë, natyrisht, por hajde gjeji, në fund të detit... Kështu që armiqtë mund të zgërdhihen me ne. Mund të hapin fjalë se ne nuk i kapim dot... Këtu na kanë zënë ngushtë. Por, siç thotë fjala, qesh ai që qesh i fundit. Si përherë, ne do t'ua hedhim atyre. Ne do t'i gjejmë kufomat. Ai i kishte vënë gishtin mu në gjoks. Ti, artist, do të bëhesh ashtu...

Dhe kështu ai kishte nisur karrierën më të habitshme aktoreske në historinë e teatrit. I shtrirë, krejt i palëvizshëm sipër motobarkës së kufirit, i mbuluar më një rizë të bardhë plot njolla të kuqe që shëmbellën gjakun, ai lozta rolin e të vdekurit. Ëndrra e tij e dikurshme për t'u bërë aktor po njëmendësohej disi habitshëm... Ndërsa motobarka i afrohej bregut, dëgjonte murmurimën e njerëzve. Ishte më e gjerë se ajo e sallës së teatrit dhe, pa dyshim, më tronditëse. Dy herë kishte dëgjuar klithmën e një gruaje: bir, o bir qysh të kanë prerë...! Që poshtë rizës ai ndiente tmerrin, që ia kalonte me siguri atij të tragjedive të vjetra. Kush është? Cili është? dëgjoheshin pyetje aty-këtu. Nganjëherë i qëllonte të kapte emrin e të vrarit dhe prapë zemra i rrihte gufmueshëm. Me siguri vajzat e reja mezi mbytnin pshëretime. Mungonin vetëm lulet në premierë dhe vezullimet e bliceve të fotoreporterëve...

Kur mbaroi shërbimin dhe u kthyesh përfundimisht në B. e para gjë që bëri, ishte të paraqitej në teatër. Gjithë qyteti ishte në ethe për shkak të "Pulëbardhës". Ai kishte me vete një vërtetim nga drejtoria e kufirit për "veprimitari shembulllore në teatrin amator". Nuk kërkonte veç ndonjë rol të vogël të dorës së katërt, të cilin, pas shumë ndërhyrjeve, arriti ta merrte më në fund.

Ishin pikërisht ndërhyrjet për ta futur në teatër, që i krijuan hijen e njeriut të dyshimtë. Në krye e morën për spiun, ç'ka edhe pritej në një rast të tillë, por më pas e vërteta u mor vesh dalëngadalë. Ai vetë, me sa dukej, një mbrëmje, gjysmë i dehur, ua kishte rrëfyer shokëve "stinën e parë dhe të fundit teatrale të tij, kur kishte luajtur rolin kryesor".

Qysh atëherë njerëzit e shikonin me ca sy të mpirë, ku ishte e vështirë të ndaje ndjesitë. Disa e bënин fajtor e disa, ngaqë s'dinin ç'të thoshin, ngrinin supet. Edhe më vështirë e kishin të flisnin njerëzit që kishin pasur të afërm të vrarë në kufi. Kjo vazhdoi edhe pas përmbysjes së diktaturës, me të vetmin ndryshim se tanë, biseda për të bëhej me zë të lartë dhe haptas. Dhe, si më parë,

njerëzit ndaheshin më dysh, gjer ditën kur arma e gjahut, që e shtriu të vdekur mu në rrugën kryesore, e ndërpren gjithçka.

I mbështjellë me rizë të bardhë, sipër së cilës njollat e gjakut sa vinte zmadhoheshin, trupi i tij u dergj një copë herë të gjatë në pritje të mjekut ligjor. Rrotull tij ishte murmurima njerëzore, që pak ndryshonte nga ajo e bregut të detit dhe pyetjet: "Ç'është?", "Kush është ky?", përsëriteshin gjithkaj, njëlloj si atëherë.



Drojën e shefit, se do të çmendeshin një ditë nga gjithë ky lesh e li, po e provonim të gjithë. Jo vetëm atij, por secilit nga ne i shkoi mendja se mos kishte një lidhje midis historisë së ushtarit dhe asaj që midis nesh e quanim tani "kapja e shpirtit në kurth", ose shkurt "shpirtkurthi". Kishim arsyе për këtë. Ushtari i mbuluar më rizën plot njolla të kuqe, motrat dhe nënët nga bregu që ofshanin, i arratisuri që dergjej ndërkaq në fund të detit, ose kishte mundur të kapërcente matanë, të gjitha këto të afronin disi te mendimi se këtu bëhej fjalë për një shpirt të kapur, ose një shpirt që ishte shkëputur ndërkaq, nga trupi i vet.

Sa herë që shefi ynë, pasi tretej një copë herë në mendime, përmendej pastaj për të thënë një "jo" me krye, ne e dinim se përsë ishte fjala. Sipas tij, historia e ushtarit lidhej me tjetër gjë. Fundi i tij, më një rizë të përgjakur vërtet sipër trupit, tregonte se ai e kishte shestuar fatin e vet qysh kur kishte pranuar të lëzta rolin. Shefi, që kishte njojuri për teatrin e vjetër, thoshte se në tragjeditë greke

vizatimet ose gdhendjet mbi shqytet e personazheve qëllonte që merrnin pjesë të njëmendtë në ndeshje. Ishte një mënyrë e habitshme të përfytyruari, thoshte ai, kur sendi ose ngjarja, qysh në çastin kur ngjizej, e kishte vulosur sipër tij ditën, madje orën kur do të shfaqte thelbin e vet. Shefi e lidhte këtë me makinën e gjuhës shqipe, atë që i jepte foljes frymën e keqe. Sipas tij, mallkimi i ndonjë nëne, për shembull, atje te bregu i detit, "Kështu të pafsha, o Zot!", që ajo kujtonte se ia dërgonte oficerit të policisë që grahte barkën, i shkonte në të vërtetë ushtarit të mbuluar me rizë. Dhe më pas, kur e vërteta për të kaluarën e ushtarit kishte nisur të merrej vesh, shumë njerëz, kur e shihnin në rrugë, duhej ta kishin mallkuar: "Kështu të pafsha një ditë!".

• Ndërkaq, miqtë tanë shqiptarë, që kishin bërë çnuk e çmos të zhbironin diçka më shumë, na thanë se njerëzit e këtushëm ngulnin këmbë se ajo historia e shpirtit të kapur, ose e përgjimit të të vdekurit, kishte ndodhur gjekë. E kishin dëgjuar, pádyshim, madje edhe në një motërzim të tretë: një grumbull balte kishte folur, por përherë larg që këtej, diku në Shqipërinë Verilindore.

Kishim vënë re se çdo histori tronditëse njerëzit përpinqeshin ta lagonin sa më shumë vendbanimit të tyre. Qyteti B. shquhej për këtë. Kurse më parë ndodhе ndryshe, krahinat, madje katundhet e humbur grindeshin për të kundërtën.

Për ushtarin ndoshta s'do të mësonim asgjë, sikur historia e tij, në pjesën më të madhe të saj, të mos kishte ndodhur shumë larg që këtej, në breg të detit. Ishte kjo arsy, me sa dukej, që ditën tjetër, na u paraqit një njeri që na tha se dinte histori ngjethëse për arratisjen e dy motrave studente. Sipas tij, atë mbrëmje të paharrueshme, bashkë me to ishte dhe një i tretë, vëllai i tyre. Por gjatë ikjes me not, s'dihej qysh, midis shtjellës së ujërave të errëta, ai kishte humbur. Ndërsa i afroheshin bregut të Korfuzit, motrat e kërkuan më kot me sy sipër ujërave. Pastaj, ndaj të gdhirë, përgjatë ranishtes së shkretë, e

thërrisin rrokavajshëm: Vëlla, vëlla...!

-Askush nuk e mori vesh kurrë se ç'ndodhi, -tha njeriu. -U mbyt në det, u vra, apo u kap nga rojet... Ka mundësi që ajo legjenda e kapjes së një shpirti aty edhe e pati zanafillën e parë.

Ne dëgjonim krejt të ngurosur njeriun me flokë të kuq dhe sy të përqarë, nga ata që vazhdimisht zenë sklepa.

-Thonë se dy motrat ende e kërkojnë, -vazhdoi ai. -Kur dégjojnë zërin e qyqes në pranverë, fshatarët e atyre anëve thonë: Janë motrat që kërkojnë vëllanë. I thërresin prore "Gjon!", "Gjon!" e ai s'përgjigjet.

Të përpirë nga tregimi i tij, ne nuk e vumë re ngrysjen e shefit. Më në fund, ai s'duroi më. E kapi nga anët e palltos njeriun dhe, duke ia ngritur fytyrën, siç e kishte zakon kur zemërohej, iu gërmush:

-Si guxon të tallesh me gjëra të shenjta, or... horr... Vajtimin e qyqes që kërkon vëllanë duke klithur "Gjon!", "Gjon!", unë e lexova dje në një përbledhje legjendash tuaja të vjetra.

Tjetri qëndroi i ngrirë, thua se s'kishte dëgjuar asgjë. Veç ngadalë ia vuri dorën mbi dorën e tij për t'ia hequr nga qafëza.

-Edhe unë mund t'ju kap për fyti, -tha me zë të akullt. -Dhe t'ju fajësoj për të njëjtën gjë, duke ju quajtur "horr".

-Si? Mua... ju... të më fajësoni...

Shefi u ngrit dhe iku si i marrë për të kërkuar, me sa duket, librin e legjendave. Erdhi pas ca çastesh vërtet me të dhe, duke dihatur rëndshëm, gati sa s'po i griste fletët ndërsa e shfletonte.

-Ja ku është, -thirri, -ja, e zezë mbi të bardhë.

Tjetri, pa ia hedhur sytë librit, qeshi me shpoti.


-Askush s'mund ta dijë se çfarë është e vjetër dhe çfarë është e re në këtë botë, -tha. -Ju mund ta vërtetoni atë që thashë unë. Veç më vjen keq që desha t'ju ndihmoj e ju nuk e meritoni.

Ai u ngrit dhe, pa përshëndetur kurrikënd, u largua.

Të nesërmen morëm vesh se historia e vëllait të tretur në det ishte e vërtetë. Së paku, gjer te mëngjesi në ranishten e Korfuzit kur motrat e kërkuan për herë të fundit vëllanë. Shefi ynë s'dinte ç'të thoshte, veç herëherë përsëriste frazën e zakonshme: Do të çmendem nga ky mish-mash.

Ne ishim jo më pak të tronditur se ai. Historia ishte e vërtetë, me përjashtim të vajit të qyqes. Po a kishim të drejtë të thoshim se klithma e qyqes ndryshonte diçka në thelbin e ngjarjes?

Tani po na dukej se po e zbulonim shkakun e vërtetë se përse kishte kaq shumë mjegull mbi gjithçka që po rrëfehej në gjithësinë komuniste. Rrëfimet, me sa dukej, fironin thellë, si ujërat që thitheshin nga toka, për t'u bashkuar me ujanën e errët të përbashkët botërore. Ujana gjithashtu, nga ana e saj, dërgonte si lagështirë gjer lart në sipërfaqe ndërhyrjen e, ndoshta, qortimin e saj...



8

Sa më tepër që në B. mbahej një qëndrim mospërfillës, për të mos thënë i acartë ndaj nesh, aq më fort bindeshim se këtu kishin ndodhur ngjarje enigmatike, zbulimin e të cilave nuk e donte askush.

Pas një bisede të dytë me aktoren e "Pulëbardhës", bisedë e bërë me njëmijë kërkime ndjese e me shumë kujdes, ngaqë ishte fjala për një kujtim të plagosshëm, siç kishte qenë flirti i saj i dikurshëm, flirt që askush nuk guxonte t'ia përmendte, e aq më pak të zhbironët në të, sikur ajo vetë të mos e kishte përmendur në një ndërthurje dramatike, hetimet e Sigurimit, njëri prej nesh erdhi krejt i befasuar. A mund të na shkonte mendja se në këtë qytet, në periudhën më të egër të terrorit, ishte zbuluar një grup që bënte seanca spiritizmi!?

Ishte vërtet e papërfytyrueshme për ne, jo vetëm në rastin e Shqipërisë, por përgjithësisht të krejt ish-Lindjes. Mirëpo njeriu apo ishte ndarë nga aktorja, dhe ajo i kishte rrëfyer gjërë e gjatë se si thirrja e saj në zyrat

e Sigurimit ishte shkatuar pikërisht nga që i zgjedhuri i saj bënte pjesë në atë grup.

Seancë spiritizmi nën diktaturën e proletariatit... Ja një gjë që s'na e rrokte mendja, thoshte shefi ynë. Pastaj, si të fliste me vete, përsëriste emrin e të dashurit të aktoreve, një inxhinier elektrik, i zhdukur pa lënë gjurmë, sipas saj, shumë kohë përpara zbulimit të grupit, Shpend Guraziu, Shpend Guraziu. Nuk e di a ju bën përshtypje ju, por mua ky emër më shkakton përqethje. Kështu na thoshte. Ne e besonim, aq më tepër që ishte i vetmi që e kuptonte, ndonëse ende pak, gjuhën shqipe, kështu që, maniak siç ishte, e përkthente çdo gjë, madje edhe kuptimin e emrave.

Siç pritej, kërkoi vetë një takim me aktoren, por u kthye më i turbullt se ç'shkoi. Aktorja e kishte gjithçka të mjegullt në kujtesë. Njëfarësoj përligjej, ngaqë zhdukja e të dashurit kishte ndodhur po atë ditë kur "Pulëbardha" ishte ndaluar përfundimisht. Isha aq e trandur, saqë asgjë s'më bënte përshtypje, kishte thënë. Doja edhe vetë të vdisja. Më pas, kur ishte ftoetur disi, kishte dashur të mësonte hollësi për të, por përgjigjet kishin qenë të paqarta. Dikush i kishte thënë se ishte rrëzuar nga makina ndërsa shoqëronte një delegacion francez. Por një tjetër dyshonte për këtë. Ti e di, i kishte thënë, të shoqërosh të huajt duket gjë e këndshme, hotele, pije të shtrenjta, por qëllon që pastaj e paguan shtrenjtë.

Kur, pas disa vitesh e kishin thirrur befas në Sigurim, i kishin kujtar dyshimet e vjetra. Grupi s'ishte zbuluar ende, po, me sa dukej, përgjimi kishte nisur. E pyetën hollësisht për të zhdukurin. Meqënëse kishte kaluar mjaft kohë, kujtoi se mund ta mohonte lidhjen me të, por pas dy minutash kishte hequr dorë nga çdo kryeneçesi. Një kasetë magnetofoni kishte mjaftuar. Ishte një bisedë e tyre e regjistruar s'dihej qysh. E mbante mend edhe tanë, pas kaq vitesh: "Ajo: Atëherë do të vish sonte bashkë me francezët? Ai: Patjetër. Ajo: Kam kaq dëshirë të të shoh sonte në sallë. Ai: Unë gjithashtu, s'pres veç atë çast. Ajo: I shtrenjti im, do të shihemi ndoshta pas shfaqjes, shpirt.

Ai: Ndoshta...".

Ishte biseda e tyre e fundit. Mbasdite gjithçka ishte rrënuar: teatri, ai vetë.

Hetuesit e pyesnin për gjithçka, por sidomos kërkonin një xhup të tij. Një xhup ngjyrë kafe, prodhim austriak. E kërkonin si në ethe, dhe unë ende sot nuk e kuptoj përsë. Ua përsërita njëqind herë, nuk kishte lënë kurrfarë xhupi tek unë. Isha e martuar dhe ai s'mund të vinte natën. I vetmi takim që patëm kishte ndodhur në apartamentin e një shokut të tij një mbasdite, përparr provave. Por ata nuk hiqnin dorë. Ku mund ta ketë lënë?-pyesnin. Ishin të sigurtë se diku e kishte lënë atë xhup, e ata donin ta gjenin me çdo kusht.

Pastaj, befas e kishin lënë të qetë. Me sa duket, s'kishin më nevojë. E kishin gjetur, siç duket, atë që kërkonin, bashkë me krejt grupin. Njëri prej tyre, ai që shërbente si medium, thuhej se kishte vdekur nën torturë. Fati i të tjerëve s'dihej.

Gjithçka ishte mbështjellë nga një mjegull e dendur. Vetë varri i Shpend Guraziut ishte zhdukur ca kohë. Gjithë ajo pjesë e varrezës ishte rrrethuar për të bërë, me sa dukej, hetimet e duhura. Thua se ai ishte ngritur e kishte ikur nga varri i vet. Unë vetë ashtu besoj nganjëherë. Jam e bindur se është ende gjallë, diku.

9

U befasuam kur morëm vesh se historinë e grupit të vogël që merrej me spiritizëm e dinin shumë njerëz. Me sy të shqyer, ne i pyesnim "si është e mundur?" dhe aty për aty, të hutuar prej qetësisë së tyre, e harronim vazhdimin e asaj që donim të pyesnim. Në të vërtetë kishte çaste kur vetë ne nuk e kuptonim se ç'na habiste më fort: si ishte e mundur të kishte ndodhur një ngjarje e tillë, e pabesueshme, e jashtëkohshme, plot mister, midis festave e mitingjeve komuniste, midis ngazëllimit të 1 Majit, fjalimeve, duartrokitjeve e realizmit socialist, apo si ishte e mundur që ata, pasi e kishin dëgjuar një ndodhi të tillë, shkonin të qetë në kafenetë e tyre, qeshnin dhe pinin birrë, pa e ndier nevojën që, së paku, të shkarkoheshin prej saj.

Ata na dëgjuan me një buzëqeshje shpotitëse. Ne e kuptonim tani çdo të thoshte ajo buzëqeshje: këto ishin ndodhi të moçme, të kohës së... kinezëve. Shumë prej tyre flisnin për të si për kohën e Perandorisë Osmane, madje kishte nga ata që besonin se të dy kohët s'kishin qenë fort

larg, ashtu siç kishte të tjerë, për të cilët periudha e miqësisë me rusët ishte po aq e largët sa ajo e akullnajave.

Ishte koha e përgjimit të madh, tregonin ata që kishin një farë prirje t'i shtroheshin kuvendimit. Pas ardhjes së vaporit të zi, gjithë Shqipëria u vu nën dëgjim.

Vapori i zi ishte anija kineze që kishte sjellë sasinë e jashtëzakonshme të mikrofonëve të përgjimit. Porosia ishte bërë nga vetë diktatori shqiptar, me një letër të mallëngjyeshme drejtuar diktatorit kinez: vëlla i dashur, jam sëmurë, sytë po më lënë, ndihmomë!

Shefi ynë ishte i ndezur si asnjëherë tjetër. I dilte gjumi natën, na zgjonte edhe ne për të na thënë ato që i zienin në kokë. Ishte i bindur se po e kapnim fillin për t'iu afruar enigmës. Përgjim me anë të mikrofonave... Seancë spiritizmi... Kishte mundësi që në një nga ndjekjet e saj policia e fshehtë të kishte regjistruar përcartjen e mediumit..., domethënë, fjalët që shpirti i dikujt ia tejçonte mediumit gjatë seancës...

Arsyetimi ishte më se i besueshëm. Madje sa më fort që e mendonim, aq më tepër bindeshim se s'mund të ishte ndryshe. Nuk thoshim dot se kishim humbur kohën me "Pulëbardhën", ngaqë ishte teatri ai që na kishte çuar drejt hullisë së re.

Shefi u mbyll një ditë të tërë në dhomën e tij përpara se të shqiptonte fjalët që i prisnim të gjithë tashmë: Të kërkonim një dosje!

E ndienim se do të vinte kjo ditë. Sa më shumë i mbushnim mendjen vetes, madje sa më rëndshëm betoheshim se s'do të merreshim kurrë me dosjet, aq më fort dyshimi na gërryente se do të ndodhë e kundërtë.

Vendimin e kishim marrë bashkarisht, qysh në krye: në qoftë se nuk donim të humbisnim në natën e errët të dosjeve, s'duhej të merreshim me to. Ishim të bindur se kishim të drejtë. Ishte folur aq shumë për to në të gjithë ish -Lindjen e përbysur, saqë edhe dosjedashësit më të zjarritë duhet të ishin neveritur. Vite me radhë nuk kishte rreshtur zhurma skëterrore për to: të hapen, të mbyllen, të

digjen, të rihapen, të zhbëhen, të vihen në tempull, të çohen në djall. Dukej sikur ish-Lindja e madhe, e cytur nga mallkimi, po shtyhej drejt zbulimit të tmerrshëm, pas të cilit s'i mbetej veç të nxirrte sytë, si Edipi mbret.

Dosjet, ndërkaq, nuk kishin mbetur pa u dhunuar. Ishin vjedhur si piramidat, ishin shitur në treg të zi, njëlloj si ikonat, si copëzat e plutoniumit, u ishin shkëputur fletë ose ishin zëvendësuar me të rreme. Nganjëherë krejt perandoria e pafundme ngjante me pamjet që jepnin poetët e vjetër kinezë, kur mbi shkretinë e shtetit të përmbysur bishat e egra vërtiteshin andej-këndej, me lecka të përgjakura në dhëmbë, mbeturina petkash të zyrtarëve të vrarë. Në dhëmbët e bishave tanë mund të përfytyroheshin lehtë edhe fletë të shqyera dosjesh.

Asnjë prej nesh nuk guxoi të kujtonte asgjë nga ato, kur shefi, duke na ndjekur me ca sy zhbirues, me zë të akullt tha: "S'kemi ç'bëjmë, do të kërkojmë dosjen e mediumit".



10

E gjetëm më shpejt dhe duke paguar më pak se ç'shpresonim. Mungesa e tre fletëve të fundit në dosjen prej njëmbëdhjetë fletësh (siç qe shënuar në faqen e parë) në krye, nuk na u duk ndonjë fatkeqësi. Si çdo gjëje prej vitesh, iu kishte rënë vlera edhe dosjeve. Sidomos, atyre të hetimit, që quheshin të dorës së tretë. Madje ai që na e solli, si njeriu që dyshon se malli nuk do t'i çmohet sa duhet, na tha se përveç fletëve ku ishte regjistruar hetimi i tij, ishte fraza që viktima paskësh thënë midis torturave: "Dy vdekje nuk i nxjerr dot nga një trup", shënuar anash fletës së parë.

Për fat, dosja nuk ishte e rrëme, me përjashtim të frazës pér të dy vdekjet, që kuptohej menjëherë që ishte shtuar më pas, gjatë ndonjë përpjekjeje të mëparshme pér ta shitur. Regjistrimi ishte i përpiktë, me shumë pak gabime gjuhësore, me përjashtim të fjalëve latinishte, kryesisht fjalës "spiritus", që zbardhësi dy herë e kishte shkruar "shpirtium" e një herë "shpirtus".

Nuk ishte dëshmuar askund torturimi, por ai kuptohej qartë nga turbullimi i të folurës së viktimës, e sidomos naga kërkesat e shpeshta për të shkuar në WC.

Nga hetimi dilte se viktima kishte qenë nëpunës në bankën e vetme të rrethit. Pjetjet kryesore të hetuesve lidheshin me "qëllimin e grupit". Përgjigjet e mediumit se seancat e tyre të spiritizmit s'kishin kurrfarë synimi t'i kundërviheshin ideologjisë marksiste - leniniste, por lidheshin thjesht me brengat e tyre vetiakë, quheshin të pasinqerta prej hetuesve. Herë pas here ata i ktheheshin kërkimit të sqarimeve se cili ishte në të vërtetë roli i mediumit në një seancë spiritizmi, se çfarë i bënte shpirrat e afrohen, ose përkundrazi, çfarë i trembte e i pengonte si "në atë natën e tmerrshme, të paharrueshme..." Ata donin të dinin se ç'ndodhët kur shpirti kërkonte një trup tjetër për t'u futur, ngaqë nuk e gjente dot më trupin e vet, se sa ndikonte nata e dimrit ose era, ose drita e hënës në rrugëtimin e tyre etj. etj.

Në të gjitha pyetjet nuk harronin kurrë të shtonin frazat "sipas jush", madje nganjëherë "sipas marrëzisë suaj", si edhe fraza ku shpotia dukej haptaz, çka tregonte se dyshimi se dosja mund të lexohej prej shefave, nuk i linte asnjëherë. Megjithatë, megjithë përpjekjen për të fshehur joshjen e tyre prej kësaj "bëme të errët", ndihej se ajo i kishte thithur keq. Madje vrazhdësia gjatë pyetjeve të tjera ngjante nganjëherë se s'ishte gjë tjetër veç një padurim për t'u kthyer prapë në punët e shpirtit.

"Pohoje se qëllimi juaj i vërtetë ishte shpresa e çmendur që të hynit kinse në lidhje me shpirrat e ish anëtarëve të Byrosë Politike të pushkatuar. Si të lojtur që ishit, kujtonit se do të merrnit prej tyre kushedi ç'pohime, ç'të fshehta".

"As na ka shkuar mendja për një gjë të tillë, ju betohem, veç për këtë s'na ka shkuar mendja".

"Gënjen, rrrens plak. Ne dimë gjithçka. Ne dimë madje se në ç'ambasadë të huaj do t'i çonit të dhënat".

"Oh, jo".

"E rastit është që një anëtar i grupit shoqëronte delegacionin francez, të vetmen dërgatë perëndimore në atë kohë?"

"Oh, jo... Kam nevojë të shkoj në WC".

"Ngaqë mënyra e tradhtisë që kishit zgjedhur, ndërlidhje me shpirrat, magjira e dokrra të tilla qesharake, ju kujtoni se mund të trajtoheni si të përhënur dhe kështu të shpëtoni me pesë-gjashtë vjet burg, gaboheni, zotërinj. Vërtet mënyra që zgjodhët është e fantaksur, por qëllimi i tradhëtisë është i qartë. Prandaj hiq dorë nga kjo shpresë dhe poho si të tjerët".

"S'kam ç'të pohoj".

"Ç'shpresonit të dëgjonit nga shpirrat e ish-anëtarëve të Byrosë Politike? A? Ç'kuptim prisnit prej shpirtit të Shpend Guraziut? A?"

"S'di asgjë. S'jam mirë. Dua të shkoj në WC."

"Prapë s'do të flasësh? Atëherë ta them unë ç'prisnit prej shpirtit të Shpend Guraziut "atë natën e paharrueshme". Ju prisnit, ndonëse me vonesë, përgjigjen e Francës...".

"Oh, jo."

Emri i Shpend Guraziut përmendej më së shumti gjatë hetimit. Kërkoheshin gjithfarë të dhënash për të, për librat që lexonte, për rrëthanat e mësimit të frëngjishtes, e natyrisht, për lidhjen dashurore me aktoren e "Pulëbardhës". Por kryesorja mbetej përherë shoqërimi i delegacionit francez. Nga një rresht i hetimit ("ne dimë gjithçka, ti frëngjishten e kupton, dëgjoje!"), merrej me mend se ata i kishin vënë të dëgjonte një regjistrim, por kjo në vend të na ndihte, na ngatërroi më fort. Në qoftë se ata kishin pasur në duar bisedat me francezët, ç'kërkonin me aq këmbëngulje prej mediumit? Ç'ishte ajo përgjigje e Francës? Dhe përse duhej të jepej gjatë seancës së spiritizmit?

Gjatë hulumtimit rresht pas rreshti, mezi e davaritëm disi mjegullën. Në të vërtetë Shpend Guraziu kishte qenë dy trajtash në seancën e spiritizmit: më parë si dëgjues, bashkë me të tjerët, dhe herën e fundit si shpirt. Midis tyre shtrihej një periudhë trevjeçare. Tani ne kishim datat

e përpikta. Shoqërimi i delegacionit francez si dhe zhdukja e Shpend Guraziut kishin ndodhur në një kohë me ndalimin e "Pulëbardhës", hetimi i mediumit bëhej tre vjet më pas, vetëm disa ditë pas zbulimit të grupit. Pra ajo që quhej "përgjigje e Francës", duhej të sillej, ndonëse me vonesë, prej shpirtit të Shpend Guraziut.

-Më duket se po e kapim fillin, -kishte thënë i pari shefi, -por gjithçka është kaq e tymtë, gati-gati e ëndërrt, saqë kam frikë se do të na ikë përsëri.

Atë ndjesi e kishim të gjithë. Kishim droje se: ose filli do të na shkimej, ose mjaftonte një zbehje e lehtë e asaj përshkënditjeje që kishte fituar tashmë truri ynë, që gjithçka të errej prapë.

Ajo që druheshim, ndodhi fare shpejt në mëngjesin e së nesërmes. Nata dukej sikur na e kishte thithur rrezen e porsagjetur. Ndoshta s'duhej të flinim, tha shefi ynë, gjysmë me shpoti. Ai fill i brishtë ishte bashkuar për t'u arratisur me ondrrat, si me llojin e vet.

Aq sa ishte dukur e rrokshme në mbrëmje se "kapja e shpirtit" ose "përgjimi i dikujt pas vdekjes", me kurrgjë tjetër s'mund të lidhej se sa me një seancë spiritizmi, po aq na ngjante e pamundur në mëngjes, e kërkuar dhe e sajuar dhunshëm, si në filmat e këqinj. Pyetjet ishin të shumta, të pamëshirshme. Ishte e mundur që hetuesit komunistë, të stërvitur me zhbirime djallëzore, të shpresonin vërtet për të zbuluar diçka nga shenja që duhej të jepte një shpirt gjatë seancës së spiritizmit!? S'ishte vetëm logjika policore që e përjashtonte, por gjithë mendësia komuniste ishte kundër një dyshimi të tillë. Edhe sikur Sigurimi të donte të rrezatonte ndjenjën e fajit në trutë e viktimave, që më së shumti e bënte vetë diktatori i sëmurë i Shqipërisë,

ai do të kërkonte gjithfarë rrugësh, por kurrsesi ato që quheshin të çvlerësuara, të tallura pa mëshirë, madje të dëmshme: praktikat mistike.

Veç kësaj, ç'ishte ajo "përgjigje e Francës", që kërkohej me aq këmbëngulje? Kishte diçka që nuk shkonte në këtë histori. Kishte një ndërprerje e moskuptim midis dy palëve. Policia e fshehtë dinte diçka që viktimat nuk e dinin. Ndërkaq ajo dyshonte se viktimat, gjithashtu, dinin një tjetër gjë, që i kishte shpëtuar asaj. Keqardhjen për ato tri fletët e humbura të dosjes hetimore e ndiemë të dhjetëfishjtë tani. Një shpresëz na mbante se aty duhej të ishte strehuar enigma.

Kërkuan dosje të viktimateve të tjera, por nuk gjetëm asgjë. Një pjesë ishin tërhequr me kohë prej avokatëve të familjeve, në gjyqet e pafundme, që kishin vazhduar me vite pas përbysjes së komunizmit, kur gjithçka rigjykohej. Të tjerat, midis të cilave ajo e Shpend Guraziut, ishin zhdukur pa gjurmë.

Tani jo vetëm shefi, po të gjithë ne, e shqiptonim emrin e tij me një mënyrë të veçantë, ku kishte edhe nderim edhe frikë. Shpend Guraziu... Sapo dikush e përmendte, në mendjet tona sajohet aty për aty "ajo natë e tmerrshme, e paharrueshme", nëpër të cilën shpirti i tij kishte ngecur... Kishte qenë një natë me mot të keq, çka ishte bërë, ndoshta, shkak që ai të mos e sillte dot përgjigjen e Francës...

Shefit i shkoi ndërmend të shkonim, sidoqoftë, në varrezën e qytetit. Aktorja kishte thënë se e kishin nxjerrë një herë nga varri, por ne s'i kishim dhënë fort rëndësi kësaj, ngaqë historitë e zhvarrimeve kishin qenë në Shqipëri më të rëndomta se gjithkund. Gabimi ynë në këtë rast ishte se nuk kishim pasur parasysh dy epokat. Stuhia e zhvarrimeve kishte ndodhur fill pas rrëzimit të diktaturës, kur gjithçka rishikohej e rivlerësohej. Atëherë ishte një pamje e zakonshme të shihje njerëz që rrugëtonin nga jugu i vendit në veri, ose e kundërtat, me arkëmorte, arka, disa herë thasë me eshtra, që pasi i kishin nxjerrë nga toka, i bartnin nëpër trena, në taksi ose mbi shpinë për t'i

çuar atje ku duhej. Hiqeshin shpesh nga "varrezat e dëshmorëve" ata që ishin quajtur heronj, e vendoseshin në vend të tyre kundërshtarët politikë, të vrarë disa herë mes veti. Dukej sikur të gjithë shpejtonin të vendosnin rendin e ri nën tokë, përpara se të merreshin me botën e sipërme. Të gjitha fushatat politike, zgjedhjet, programet e reja të partive, shoqëroheshin nga hapja e tokës dhe nxjerrja ose futja e dikujt.

Ndonëse kishin shkuan aq vite, pamja e varrezës së qytetit ende i kishte gjurmët e asaj furtune nëntokësore. Zhvarrimi i Shpend Guraziut, pikërisht, nga që kishte ndodhur vite më parë, ngjante për njerëzit i pakuptimit. Aha, s'paska qenë as ndjekës i mbretit, as murg franceskan, as kundërshtar i regjimit. Aha, qenka zhvarrosur në kohën komuniste. Atëherë duhet të ketë qenë ndonjë arsy e rëndomtë, zhvendosje e trupit nga familjarët, të tilla gjëra ndodhni nganjëherë edhe në atë kohë.

Më në fund arritëm të gjenim një nga varrmihësit, që thoshte se kishte marrë pjesë në nxjerrjen e Shpend Guraziut nga toka.

"Qyshse na thirrën natën me ngut, e kuptuam se këtu kishte një gjë të pazakonshme. Nata ishte e keqe, me shi. Varri që do të rrëmihnim ndriçohej nga dritat e dy makinave të Sigurimit. Urdhri ishte që jo vetëm eshtrat, por krejt balta e gërmuar të ngarkohej në një kamion. Dukej një punë prej të çmendurish, por shefi i Sigurimit ishte aty. Ishte ai vetë që jepte urdhurat dhe ndiqte gjithçka. Ju do të mbyllni gojën për këtë punë që bëni sonte, ndryshtë e dini ç'ju pret. Këto ishin të vetmet fjalë që na drejtoi, para se të hynte në makinën e tij për të ndjekur kamionin. As që na shkonte mendja të flisnim. Po mendjen s'e ndaloje dot të shkonte në gjithfarë hamendjesh. Dukej që diçka kërkonin, por s'mund të them dot nëse e gjetën apo jo. Më pas, fare rastësisht, më zuri veshi se e kishin shkoqitur atë farë dheu grusht më grusht. Disa thoshnin se i ndjeri kishte vdekur nga një sëmundje e panjohur, që dijetarët donin ta zbulonin se s'bën. Por unë s'i besoj kësi dokrrash.

Mbajnë erë shpifje prej Sigurimi që larg. Për ta bërë të besueshme këtë na dhanë të gjithëve doreza llastiku. Mendoj se shkaku i vërtetë që e trazuan të vdekurin, ishte se ata dyshonin që nuk ishte ai. Me fjalë të tjera, dyshuan se në vend të tij ishte varrosur një tjetër.

Fjalët e varrmihësit na dhanë një pamje të re të gjërave. Aktorja gjithashtu kishte pohuar se parandjenja i thoshte se Shpend Guraziu ishte ende gjallë. Në këtë rast, regjistrimi i zërit të tij "atje matanë" nuk ishte fort i përrallshëm.

Po atë ditë shefi na tha se ishim që ishim në botën mortore, të shkonim njëherë nga varreza e burgut të vjetër. Kishte dëgjuar ca kureshti të mëdha për të.

Varreza e burgut, siç merrej me mend, ishte edhe më e shpërbërë. Sipas ligjit të atëhershëm, në qoftë se i burgosuri vdiste gjatë shlyerjes së dënimit, trupi i tij duhet të vazhdonte burgimin gjersa të plotësohej afati. Vetëm atëherë mund t'i dorëzohej familjes.

Në këtë kënd ishin të përjetshmit, ata që s'kishin kurrfarë shprese të dilnin, veç në rast të ndonjë faljeje të madhe, na shpjegonte një nga mbikqyrësit që kishim mundur më në fund ta gjenim. Nga e djathta, ata që nuk iu mbetej edhe shumë kohë, zakonisht dy deri më pesë vjet. Politikët, ashtu si edhe në burg, edhe këtu ishin veçmas, në mes.

Dhe ju kishit listat, njëloj si për të gjallët, me emrat, me afatet e secilit?

Sigurisht. Kishim lista të rregullta me gjithë të dhënët. Ndihmësi im, ndjesë pastë, më kujtohet, kishte dëshirë t'u fliste gjatë mbikqyrjes. Të paska mbirë bari i parë, Martin? Ose: duro edhe këtë dimër Rrok, në mars do të kthehesht tek të tutë!

Dhe të afërmit vinin gjithmonë t'i merrnin në mbarim të afatit?

Zakonisht vinin. Veç kur ishin faruar krejt. Nganjëherë sillnin dhe arkëmortin e ngarkuar në qerre ose në taksi. Kur ishin të varfër, s'kishin veç një thes prej plastike, zakonisht nga ato të çimentos.

Në rast faljeje përfitonin edhe këta?

Patjetër. Njëlloj si të gjallët. Që të rrimë shtrembër e të flasim drejt, rregullat ndiqeshin në këtë burg. Tani secili mund të flasë si të dojë, por unë s'dua ta rëndoja veten me mëkate në prag të vdekjes. Madje mund t'ju them se në kishte një vend ku falja zbatohej më përpikta, ishte pikërisht varreza e burgut. Këtu s'kishte as rrethana rënduese, as lehtësuese. Se trupat, siç e dini vetë...

Po ridënimë a kishte?

Ridënimë në varrezë? Hm, kjo është një tjetër histori. Natyrisht që kishte... Ju e kuptioni, të burgosurit kishin lidhje më njëri-tjetrin, sidomos politikët. Kur qëllonte që në burg zbulohej ndonjë grup armiqësor, ose përpjekje përrarratisje, ridëni i kapte dhe të vdekurit, po të ishin përzier. Më kujtohet, kishim një Sheme Alarupi. Tri herë u ridënuai i vdekur. Ndihmësi im, ndjesë pastë, i pëlqente t'ia thoshte i pari, te guri i varrit; s' paskësh qenë e thënë të dilje as këtë vjeshtë, o Sheme. E more vesh? T'u shtua edhe një dhjetëshe. S'qëndroke urtë as aty ku je.

A bëhej ndonjë farë njoftimi zyrtar me këtë rast? Si të thuash ndonjë farë leximi i dënimtit të ri te koka e varrit?

Oh, jo, komedi të tillë s'bëheshin këtu. Tani mund të përrallo森en gjithfarë dokrrash, por ky këtu ishte një burg serioz.

Edhe një pyetje të fundit: kur zbulohej me vonesë ndonjë armik, ndokush që kishte vdekur ndërkaq e që dergjej si gjithë bota në varrezën e lirë të qytetit, a e kërkonin rregullat që të nxirrej nga varreza trupi i tij, të kryente dënimin?

Jo, s'më ka zënë veshi ndonjë herë një gjë të tillë. Ua thashë, zotërinj, ky ishte një burg serioz.

12

Moti, pas një zbutjeje të disaditshme, u acarua përsëri. Një akullimë e pabesë e kishte ngrirë gjithçka. Por neve as që na shkonte mendja ta linim Shqipërinë. Një zë i brendshëm na thoshte se, pikërisht tani, s'duhej të iknim.

) Varreza e burgut kishte qenë shpresa e fundit për të rënë në gjurmë të Shpend Guraziut. Tani s'mbetej veç rastësia. Oqeani i dosjeve me murmurimën e valëve të tij ndihej gjithmonë përbri-nesh. Në ranishten e tij të pafundme, si ata që duke klithur në gjysmë terr verbtazi kërkojnë njëri-tjetrin, ne mund të ndeshnim atë që kërkonim. E, ndonëse shpresa ishte e paktë, joshja e atij oqeani nuk na ndahej.)

E kishim shlyer disi kureshtinë me dosjen e mediumit, por ajo kishte qenë hetimore. Bënte pjesë ende në rrethinat. Kurse zona e natës fillonte më tej. Joshja ishte e papërballueshme dhe ne bëmë ç'bëmë e iu nënshtruam asaj. Dosja, që na u dha rasti të blejmë, në pamje të parë, dukej e thjeshtë,

por ndihej menjëherë se e kishte krejt vlerën dhe peshën e gjérave të mirëfillta.¹ Madje pikërisht ajo që ngjante si varfëri e saj, një lloj mungese, një farë rrallimi prej gërmadhe, i jepte asaj peshën e rëndë të ngrehinave mortore. \

Lënda ishte e paktë. Miratimi i kërkesës për hapjen e dosjes për "përpunim të qytetares K.M.", mjeke e syve në spitalin e qytetit. Miratimi bazohej në kallëzimin e infermieres C.T., dhënë operativit 309F. Në një fletë të veçantë riprodhohej kallëzimi. Në datën 23 të muajit dhjetor, mbesa e K.M., e cila kryente studimet për mjekësi në Universitetin e Tiranës, e ardhur për pushimet e fundit të vitit (për Krishtlindje?) te emta e saj, i ka thënë kësaj të fundit se gjatë hapjes së trupave të sjella nga morgu, asaj i ka qëlluar të shohë gjurmë plumbash, madje në një rast edhe plumbin vetë. Kjo vërtetonte, sipas mbesës, pëshpërimat se trupat e sjella nga morgu ishin të njerëzve të pushkatuar.

Lënda e dytë mbante datën 2 mars të vitit tjetër, kohë në të cilën K.M. ishte vënë ndërkaq në "përpunim". Ishte një e thënme e moçme, e nënvizuar me të kuqe: "Korbit kur i verbohen sytë, nxihet edhe më fort"\ Në shqiptuar gjatë vizitës mjekësore prej pacientit Xhemal V., ish-mësues i latinishtes në liceun e qytetit, në atë kohë nëpunës në Arkën e Kursimit.

Të qeshurat e mjekes e të pacientit, fjalët: "Të jetë e vërtetë?", "Do Zoti të jetë e vërtetë!", linin të kuptohej, sipas përpiluesit të tekstit, se ishte fjala për një nënkuptim djallëzor.

Përpiluesi, për çudi, nuk jepte kurrfarë shpjegimi se ç'mund të ishte "nënkuptimi djallëzor".

Nga lënda e tretë, një kumtesë e dërguar prej Institutit të Kulturës Popullore në Tiranë, që mbante datën 29 mars, merrej me mend se përpiluesi i dosjes duke këmbëngulur që të mos jepte zberthimin vetiak të proverbit, i ishte drejtuar Institutit: Sipas kërkesës suaj po iu dërgojmë të gjitha motërzimet, si edhe kuptimet që në zonë të ndryshme i jepen proverbit "Korbit, kur i verbohen sytë, nxihet më fort".

Në një fletë të veçantë, dikush që ndiqte, me sa dukej, fatin e dosjes, kishte shënuar me ngjyrë të kuqe: "Tani për tani t'i jepet përparësi çështjes së proverbit të korbit. E përsëris: të veprohet me ngut. Të mos kursehen zëthat. Po të jetë nevoja të dërgohet një mi, mundësishët i verbër. Me sa di unë kemi ende të tillë. Në rast se s'gjendet, të përdoret një mi me sy të sëmurë vërtet, që të mos zgjojë kurrfarë dyshimi te K.M. gjatë vizitës mjekësore. (A.V.)"

Ne e hetuan dosjen fjalë përfjalë dhe shkronjë për shkronjë. Nganjëherë na dukej e varfër dhe e paktë, por kishte ditë kur në kryet tonë krijohej një tymnajë e tillë që gjithçkaje i jepte kuptime të shumëfishta, sa që dosja na dukej si një botë e tërë. Pastaj, prapë mpakej.

E para gjë dhe natyrisht, më e lehta, ishte kuptimi i fjalëve "mi" dhe "zëtha", që ashtu siç dyshuam, donin të thoshin "spiun - provokator" dhe "mikrofonë përgjimi". Po ashtu A.V. nuk e patëm të vështirë ta gjenim. Ishte Arian Vogli, shëf në atë kohë i Sigurimit të rrethit.

Më kot u përpoqëm të gjenim një lidhje midis "korbit" dhe "pulëbardhës". Sa përfatin e mëtejshëm të disa prej vetëve të dramës, e mësuam më pas. Mjekja K.M., bashkë me të shoqin dhe fëmijët, ishin internuar në një katund fushor të Shqipërisë Qendrore. Infermierja C.T. kishte arritur më në fund të emërohej në "Shtëpinë e pritjes", siç quheshin shtëpitë ku bujtnin anëtarët e udhëheqjes së lartë, kur vinin në rrethe. Si e tillë, kishte shkuar dy herë në Vienë, përfi të shoqëruar sekretarin e parë të rrethit përfi një pezmatim veshkash dhe, herën e dytë, muzikantin e vjetër G.K., i cili vuante nga dhjamthi.

Mbesa e saj, studentja e mjekësisë, gjithashtu, pas futjes në ambasadën më 1990, kishte ikur me vaporin e parë në Perëndim. Më pas, s'dihet qysh, kishte qenë disa vite lavire në një shtëpi publike të Athinës. Tani ishte padrone e një salloni bukurie në Tiranë.

Rrëfimi i saj përfi shenjat e plumbave në trupat që vinin nga morgu, rrëfim që u bë shkak përfi aq shumë

fatkeqësi, na bëri të dyshonim ca kohë se mos vallë Shpend Guraziun e kishin nxjerrë nga varri pér t'i zhdukur shenjën e ndonjë plumbi pas qafe.

Pér këtë s'kishim kurrfarë dëshmie.

Tani që e kishim shuar kureshtjen e dosjeve kujtonim se do të ishim më të qetë. Mirëpo po ndodhete e kundërta. Ishim bërë të gjithë si me gjemba. Nga një anë, trembeshim se do të mësoheshim me to, si rishtarët kur provojnë drogën, nga ana tjetër, e ndienim se nuk shqiteshim dot lehtë nga ky tundim.

Nga ravgimi na shpëtuan shoqëruesit shqiptarë. Gati-gati, me një ndjesi faji, na thanë se dikush kishte në zotërim një gjë tejet të çuditshme, diçka që s'mund të thuhej se ishte dosje e, megjithatë, ishte ndoshta, më e rrallë...si të thuash, më djallëzore se ato, madje s'përjashtohej që të ishte në mos ajo që kërkonim, diçka që conte drejt saj.

Mbrëmja ishte e lagësht, plot dritëza të shqetësuara makinash, të cilat nga asfalti i qullur arratiseshin drejt qiellit, ose e kundërta. Dhe, si të mos mjaftonte kjo, hoteli ishte plot me idhtarë të një sekti, që kishin ardhur ngado për të bërë tubimin e tyre këtu në B. Shkurt, ishte

një mbrëmje që kërkonte mbështetje, krejt si ngrehina e vjetër në prag të rrënimit. Pa e zgjatur, shefi nxorri nga çanta dy mijë dollarët dhe paketa e vogël u bë e jona.

Ishin tre kasetëza me regjistrime. Në dhomën e shefit, midis tymit të cigares së tij, që s'di se si e mbushi krejt dhomën, i dëgjuam njëra pas tjetrës.

Do të mjaftonte e para për të na lënë gojëhapur. Ishte regjistrimi i belbëzimës së mundimshme të një memeci, ose një idioti. Asnjë fjalë e kuptueshme, vetëm mce-mce dhe blla-blla. Belbëzimi ndërpritej katër herë nga një zë i qartë, që thoshte datën e regjistrimit, krejt si spikeri që përcjell një ngjarje në TV. Datë 19 tetor. Datë 20 tetor. Datë 1 nëntor, e hënë.

Pas dëgjimit të dytë, shefi ngriti supet. S'merrej vesh asgjë. Zotërueshit e kasetave s'kishin dhënë kurrfarë sqarimi. Thanë se as vetë nuk e dinin se ç'ishte. Në fillim kishin kujtar se ishte zëri i mbinatyrshtëm që kërkonim ne.

Pandehma e parë që na erdhi ndërmend ishte një provë me viktimin. Përgatitje për dëshmimin. Ose e kundërtë, frikë nga dëshmimi. Kjo e dyta kishte gjasë më fort.

Kaseta e dytë ishte regjistrimi i një gruaje gjatë dashurisë, me pakëz bisedë në krye e në fund. Nga që në të përmendej "Pulëbardha", kujtuam se ishin zërat e aktoreve e të Shpend Guraziut, por pas dëgjimit tjetër, e kuptuam se ishte tjetërkush. Gruaja, siç dilte nga pëshpërima e mashkullit, e kishte emrin Edlira. Veç kësaj, nga bisedëza e fillimit, dukej që sapo ishte kthyer nga premiera e "Pulëbardhës", ku gruaja e kishte ndier veten tepër, tepër të lumtur, çka shpjegonte, sipas asaj vetë, edhe dëshirën e pamasë të saj në atë natë dashurie.

-E pabesueshme, - tha shefi, si të fliste me vete.
-Nga çdo anë që vërtitemi del përpëra kjo premierë.

Kaseta e tretë kishte regjistrome telefonatash. Atë, që në krye na u duk më e rëndomta e të gjithave, atë e dëgjuam më shumë se të tjerat. Ndryshtë nga ç'pritej, qysh në frazat e para kuptohej se njeriu i përgjuar nuk e kishte

aspak zërin e drojtur, përkundrazi kishte një zë zyrtari, tepër të sigurtë. Më tutje dilte që jo vetëm ishte zyrtar, por punonte në policinë e fshehtë, madje jepte urdhra. Bisedat kishin lidhje kryesisht me një mikrofon të humbur. Një "princ". Kështu cilësohej. Unë do ta gjej atë se s'bën, thoshte i përgjuari. Qiell e tokë do të përmbyt.

-Mjaft, -tha më në fund shefi, pas dëgjimit të katërt apo të pestë. -Ai kishte zënë kryet me duar. -Përgjimi i përgjimeve... Edhe kjo na duhej tani. E kam thënë qysh në krye: do të çmendemi po u futëm te dosjet...

Kishte të drejtë. Në kokat tona kishte një pështjellim të tillë, që asgjë nuk mund ta davariste. Përgjim i përgjuesve... E sikur ata gjithashtu të përgjoheshin dhe gjithçka të zgjerohej kështu, pa fund, si rrathët në ujërat e errëta?

Por nata mezi shtyhej dhe ne, sikur ta dinim se ajo na ruante një befasi të fundit, pasi i thamë "natën e mirë" shefit, zbritëm në bar. Aty, njeriu me flokë të kuq dhe sytë e përqarë na priste, siç dukej prej kohësh. Nuk kërkoi të përgjigjej a të gjente së paku një shpjegim sado të pabesueshëm për ato tre fletë të dosjes hetimore të mediumit, që nuk na i kishte dhënë herën tjeter. Na tha vetëm çmimin dhe kërkoi përgjigjen tonë aty për aty. Kur vuri re mospërfilljen tonë, buzëqeshi fare lehtë. Do të pendoheni, tha, por do të jetë tepër vonë. Dhe u ngrit të ikte.

Ende sot nuk e shpjegojmë dot se ç'na bëri të besonim se do të pendoheshim vërtet dhe se do të ishte vonë pastaj. Bëmë ç'bëmë, u çliruam nga stepja dhe vendosëm të paguanim nga kursimet tona.

Ishte hera e parë që patëm ndjesinë se po na dridheshin duart, kur nisëm leximin. Në orën dy pas mesnate, vendosëm të zgjonim shefin. Qëndruam në dhomën e tij gjer ndaj të gdhirë. Sa herë që ndonjëri prej nesh thoshte "do të shkoj në WC", ne të tjerët shikonim duart tona, thua se kërkonim në to veglat e torturës.

14

Gjumë më të turbullt s'kishim bërë ndonjëherë. Sapo na kaplonte pak, na dukej se hetuesi thoshte "trego" dhe aty për aty donim të shkonim në WC.

Fleta e fundit e dosjes ishte veçanërisht dramatike.

"Trego, veç të mira do të kesh nga kjo. Vajza do të marrë të drejtën e studimit, madje në fakultetin që ëndërron: në mjekësi në mos gaboj.

S'di asgjë. S'kam ç'të them. Më lini të shkoj në WC.

S'ditke asgjë, kërmë? Po këtë zë a e njeh? Më shiko në sy, e njeh këtë zë? Na, dëgjoje edhe një herë. E njeh?

Po. E njoh.

Është i Shpend Guraziut?

Ai është.

Dhe tani, zoti medium, do bëjmë një befasim. Tani dëgjoje këtë zë... E njeh?

O Zot!

E njeh? Fol!

Ky është zë si prej të vdekuri.

Fol, coftinë. E njeh?

Është prapë ai...Tmerr.

E kupton tani se ne jemi më të fortë se ju?

Mjerë ne.

Mjerë ju, vërtet.

Mjerë ne të gjithë.

E kuptove, coftinë, se ne jemi më të fortë se vdekja?

Atëhere, ç'pret?

C'kërkoni nga unë? Dua të shkoj në WC.

Trego!

Ju i dini të gjitha, ç'doni nga unë?

Përgjigjen e Francës...përgjigjen e Perëndimit.

S'di asgjë. Dua të shkoj në WC.

Dëgjoje, coftinë. Dëgjoje edhe një herë zërin e ferrit.

S'ka përgjigjet... Ka pasur heshtje... O Zonja Shën Mëri... heshtje gjithkund..."

Këtu mbaronte hetimi. Në kopjen e tij, në fund të tekstit, shefi kishte shënuar me ngjyrë të kuqe një kryq.

Me sa duket, mediumi kishte vdekur pas fjalës "gjithkund".

Ne u mblozhëm në mesditë për të parë se ç'qortim mund të kishte bërë nata në mendimet tonas. Një erë e shqetësuar i trandte qelqet e dritarëve. Herë pas here ne kthenim kryet andej, si të kapur në faj,

Flisnim ngadalë, pa e ndërprerë njëri - tjetrin, një gjë fort e rrallë kjo midis nesh.

Që në këtë fletë ishte ndtryrë, me sa dukej, zanafilla e legjendës, ishte më se e besueshme. Por kjo nuk mjaftonte për shpjegimin e saj.

Ishim në një mendje për pandehmën e parë: mundësinë e lojës me anë të zërit. Për një polici të fshehtë, si ajo e shqiptarëve, s'ishte e vështirë të regjistrohej Shpend Guraziu i sëmurë, i torturuar, madje në grahmat e fundit, përparrë se të jepte shpirt. E besonim këtë, megjithatë

nguteshim të ndaheshim prej saj për të kaluar në shkoqitjen e mëtejshme.

Pengesa kryesore ishte se ne nuk e dinim ç'fjalë të Shpend Guraziut kishte dëgjuar mediumi gjatë hetimit të fundit. I mësuar prej vitesh me spiritizëm, mediumi nuk ishte dikush që mund të lemeritej lehtë nga një lojë me zërat. Atëherë, ç'paska dëgjuar që ia ka ngjethur mishtë, e që, me sa dukej, i ka shpejtuar vdekjen?

Nisur nga këto fjalë, hetuesit kërkonin të dinin përgjigjen e Francës. Pra diçka u ka kërkuar Shpend Guraziu francezëve. Këtë hetuesit e dinin. Ajo që ata s'dinin ishte përgjigjja, të cilën anëtarët e dërgatës franceze, me sa dukej, nuk e kishin dhënë aty për aty, për shkaqe që merreshin me mend: s'kishin plotfuqishmëri, duhej të këshilloheshin me qeverinë e tyre etj. Pra ishte fjala për diçka tejet të rëndësishme, themelore. Diçka që hetuesit dyshonin se mund të kishte mbërritur më vonë.

Një nga kyçet e enigmës qëndronte tek këmbëngulja e hetuesve për të ditur ç'ka ndodhur atë natë me shi dhe erë, kur shpirti i Shpend Guraziut nuk jepte dot kumtin e tij. Që ata nuk e besonin aspak që zëri i të vdekurit të mund të zbulonte përgjigjen e Francës, kjo ishte jashtë çdo dyshimi. Atëherë përsë ngulnin këmbë?

Shpjegimi ynë i vetëm ishte se hetuesit bënin kinse besonin në ardhjen e kumtit francez nëpërmjet një shpirti, me shpresë se mediumi, i çoroditur nga torturat dhe lodhja, do të tregonte më në fund një të vërtetë tjetër, atë të njëmendtën. Do të thoshte ta zemë: atë natë ne s'prisnim kurrfarë kumti, sepse ne e dinim ndërkaq atë. Kishte ardhur, ta zemë, nëpërmjet një dërgate tjetër, një zbuluesi, ose një punonjësi të një ambasade perëndimore. Me fjalë të tjera, hetuesit, të bindur se një përgjigje kishte mbërritur ndërkaq në Shqipëri, kishin shpresë se me anë të ngucjeve, zhbirimeve, duke kërkuar disa herë symbyllurazi, në tymt, do të ndeshnin në të.

Ne rrnim përparrë dosjes hetimore, si përparrë një gërmadhe që heshtte. Herë - herë, në atë hirnosje na dukej

se kapnim një përshkënditje të zbehtë. Por ajo tërhiqej prapë në thellësi, bashkë me të fshehtën.

E ndjenim që na mungonte diçka për të gjetur të çarën nëpërmjet të cilës do të mund të depërtonim poshtë zhguallit. Ishte ndoshta diçka e ngjashme me dhuntinë që kishin kuajt për të ndjerë vdekjen e mbuluar nën dhë, ose minjtë tërmetet, dhundi të cilën krijuesi nuk ua kishte dhënë njerëzve, për një arsy që e dinte veç ai.

| Era e shqetësuar, si me thonj të padukshëm, gërvishjtë qeljet.

Një rrufe sferike, e ngadaltë, e çliruar nga vargorët e tërheqjes së gjithnjës, pluskonte në përfytyrimin tonë si e mbetur.

| S'kishte përgjigje, kishte thënë mediumi disa çaste para vdekjes. Kishte vetëm heshtje, gjithkund...

| Përgjigja s'kishte qenë veçse një èndërr e shumëpritur vite me radhë prej gjithë Lindjes. Miliona sy të nxirë nga pritja kishin përgjuar kështu retë e turbullta të qiellnjës komuniste. Për të pikasur në të rrufenë e vdekur, vetanake, të arratisur jashtë ligjeve të gjithësisë.) +



15

Një gjumësim i shurdhër na kaplloi befas ato ditëp Edhe kur zgjoheshim, ai s'ishte veç zgjim i thënçin, sepse kurrsesi s'dilnim dot nga zotërimi i tij.

Ditët po shtrajtoheshin me shpejtësi. Koha vetë, madje hapësira, nisën herë të bymehen, herë të tkurren. Gjymtyrët tonë gjithashtu. Diçka ndodhë brenda 'nesh. Qenia jonë po përgatitej, ndoshta, për diçka.

Kishim kureshtje se ç'do të ndodhët. Kishim edhe frikë. Por të dyja ishin pa peshë, si të një tjetër bote.

Herë-herë, në çaste kthjellimi, si sfera qellore të një gjithësie të vogël, na vërtiteshim ato ç'kishim dëgjuar: një seancë spiritizmi në qytetin B., shfaqja e pastaj ndalimi i "Pulëbardhës", kërkimi i një mikrofoni, torturimi i mediumit, zhvarrimi i Shpend Guraziut, një korbi që nxihej me shpejtësi nga verbëria... Të gjitha ato dukej sikur lidheshin me njëra-tjetrën, por ne nuk gjenim dot fillin. Nyjet lidhëse ishin prerë. Ndodhi të tjera, në dukje më të vogla, ose më të mëdha, vërtiteshin rrëth tyre: mallkimi i dramës së

Çehovit nga një plakë që s'kishte qenë kurrë në teatër, rënkim i një gruaje të panjohur në prag të orgazmës, pas premierës, një njeri me gjuhë të prerë që kërkonte të thoshte diçka... ishin si copëza jete, që ashtu si pluhuri i gjithësisë që krijonte trupat qiellorë, kishin synuar, me sa dukej, drejt njëra-tjetrës për t'u ngjeshur si lënda e yjeve të dendur, përpara se të jepnin një trajtë përfundimtare: ishte kapur një shpirt, ose kishtë folur balta e dheut.

Si kishte ndodhur kjo? Si ishin thithur e përqafuar vdekshëm midis hapësirës së errët? Përse pikërisht këto e jo të tjera, mijëra e mijëra ndodhi njerëzore, që vërtiteshin në erë, nëpër kaos?

E kërkonim, natyrisht, të vërtetën e gjithaq trembeshim prej saj. I afroheshim e i largoheshim prapë luhatshëm, si hije. Kishim frikë nga një shpjegim zhgënjes. Kishte ditë që nuk e kuptionim as vetë: ishte ngjarja që rrekej të largohej prej nesh, apo ishim ne që i vidheshim asaj. Kjo duhej të ishte një ndodhi që të kishte pësuar një plakje, së paku, treqindvjeçare. Ne kërkonim jetën dyfishe të saj: atë natyralen, dhe tjetren, fosilen, çmërsin e saj... Por ne donim që të dy trajtat të mos e cënonin njëra - tjetren.

Ne donim ta zbërthenim gjer në fund dosjen e ngjarjes, për ne ajo ishte mitra e përgjakur që e kishte pjellë. Por si çdo mitër, ajo duhej të mos shfaqej kurrë.

Nganjëherë e kuptionim dhe vetë që po kërkonim diçka të pamundur. Ne kërkonim ngjarjen që ishte në kufirin e dy botëve. Ajo s'mund të kishte tjetër shfaqje veç atë të shtrajtuarën, të rrezatuar turbull nga një pasqyrë e përtejme. Shkurt, ne kërkonim atë që në gjuhën shqipe quhej "e mosqoftshme".

16

Si skizofrenët që shohin dyzimin e tyre në rrugë, ne na dukej se arrinim të shihnim nganjëherë veten tonë, larg, shumë larg, në tokën e shqiptarëve, duke u endur në kërkim të ca shëmbellimeve si prej ëndrrre.

Në çaste të tilla edhe ajo çka përjetonim në jetën e përditishme, në qytetin e mërzitshëm B., merrte trajtat e rrëfimeve të kryehershme epike të kohërave të shkuara... Në vitin e tridhjetepestë të komunizmit në Shqipëri, në qytetin B. ndodhën ngjarje tronditëse, imtësitë e të cilave balada i ka tretur brenda vetes, duke lënë jashtë veç thelbin, si të thuash, ashtin e saj. Dhe thelbi ishte ky: krusma ishte aq e madhe atë vit, -po afronte fundi i mijëvjeçarit të dytë, -dhe aq paspresshëm nxinte gjithçka, saqë dukej se mijëvjeçar të tretë s'do të kishte, -pra, zezona ishte e tillë saqë, një i vdekur, pas tre vjetësh pasi ishte kallur në dhë, kishte arritur të dërgonte një kumt mbi tokë. Kumti, krejtësisht i pakuptueshëm, kishte ngjethur për shumë netë banorët e B., në atë dimër që edhe pa atë

ngjarje, kishte qëlluar i ftohtë.

Vite më pas, duke rrëmihur zghuallin e ngrirë të epokës, shumë kronistë, historianë, gazetarë të TV dhe, natyrisht, studiues të psikikave kombëtare, u përpoqën të sqaronin diçka më shumë, por ngjarja ishte e tillë që largohej ose ndërronte trajtë sa më fort i afroheshe.

Megjithatë, pas mjaft përpjekjesh u zbulua se çështja ishte shumë më e ndërlikuar se ç'e tregonte balada, kryesisht dy rreshtat e saj, ku tregohej se terrori ishte aq i egër e etja për të dëshmuar aq e fortë, saqë "balta u bë me gojë". U hulumtuan arkiva e dosje të pafundme, të vërteta e të rreme (nganjëherë të rremet zbulonin të vërteta të tjera edhe më ngjethëse), u pyetën e u zhbiruan qindra dëshmitarë dhe gjithçka çonte në të njëtin përfundim: pavarësisht nga zbulimet e çelësave të humbur, e rivendosjes së nyjeve të këputura, thelbi i ndodhisë mbetej i pandryshueshëm: një zë ishte ngjitur që poshtë dheut për herë ta parë në historinë e këtij vendi e, ndoshta të krejt kësaj bote.

Edhe më pas, kur pas trazimit të mëtejshëm të arkivave u krijuat një shtjellë e marrë, si në stuhitë e yjeshtës së parë, si gurgjaku i një unaze, rrezëllonte midis kaosit zëri i përtejmë.

Ai kumt, i kapur nga policia e fshehtë shqiptare dhe i regjistruar në një kasetë, i ishte dërguar si dhuratë për ditëlindje, diktatorit të Shqipërisë, në mbrëmjen e 16 tetorit të atij viti të paharrueshëm...

Natyrisht që hulumtuesit ishim ne. Ngadalë përparonim nëpër kthinan e labirinthit. Zbuloheshin njëra pas tjetrës shkallët e mbuluara nga dheu. Lëviznin gurët e rëndë, dhe çmërsi, dhe balta. Nganjëherë truri ynë fitonte një aftesi të çuditshme, saqë na dukej se mund të shquanim gjëra të parrokshme: si ankthin e gjuhës shqipe, që përpiquej të mbrohej nga lëngata. Gati-gati e shquanim vegjën e saj të vjetër, të lodhur, që mezi përballonte zëvendësimin e veglave, për të krijuar një të folur të ri.

Ishë më e lehtë, natyrisht, të përfytyronim njerëzit, që me mikrofona përgjimi, të futura nëpër veshje ose që

kujtonin se i kishin në to, iknin të çmeritur, si të ndjekur nga erinitë e moçme...

Kjo përshkëndritje e trurit, natyrisht, nuk vazhdonte gjatë dhe atëherë ne ndiqnim punën tonë të përditshme prej thnadle pér zbulimin aty pér aty të së vërtetës. Rrëfime nga më befasueset, shkresa, proces-verbale të mbledhjeve të Byrosë Politike, urdhra të fshehtë, të stërfshehtë, filmime ngjethëse, pohime, ditarë të diktatorit të mbajtura në gjendje pérçartjeje, plot zbrazëti midis, skajoheshin në ndërgjegjen tonë.

E ndienim se ajo lëndë e ngrirë shumëvjeçare po ngjallej ngadalshëm. Në dejet e saj, lëngu depërtonte me mundim.

Të magjepsur dhe po aq gjithë droje, ne pritnim shfaqjen e saj të plotë. Nganjëherë na dukej se në çastin e saj të fundit do të tretej mu në sytë tanë. Do të rridhte prapë nëpër të çarat e dheut, andej nga besohej se kishte dalë. Kishte ditë të tjera kur i druheshim gjymtimit të saj. Mund ta nxirrnim nga zgfella, por të dëmtuar rëndë, pa ia ruajtur dot trajtën e dyjetshme.

Kishte kohë që qytetarët e B. na shihnin me ftohtësi. E ndienin se dinim ndërkaq gjëra që nuk duhej t'i dinim. Ata ishin përpjekur, me sa dukej, t'i harronin, ose ndoshta i kishin shkulur vërtet nga kujtesa. Blla-blla-ja e asaj gjuhe të gjymtar, që donte të thoshte diçka e kurrsesi s'mundej, kishte lidhje ndoshta me krejt qytetin.

Ndërkaq ne vazhdonim hulumtimin. Shtjella kaotike përpara nesh herë dukej se do të nënshtrohej e, aty për

aty, kreshpërohej e fryhej si më parë. Në ato çaste ne na dukej se vargorët e litarët me të cilat ne shpresonim ta lidhnim, bashkë me kllapat, me pejëzat e gremçat kapëse, ishin krejtësisht të pafuqishme për ta vënë në fre atë stihi.

Ne jemi pak a shumë në gjendjen e tragjikëve të parë përpara kaosit mitologjik, tha një ditë shefi ynë.

Ndonëse ai i tha këto fjalë gjysmë me mahi, ne e ndienim se, ashtu siç thuhej se në një pikë ujë mund të pasqyrohej krejt bota, krejt ravgimi botëror, mund të përsëritej në rrëfimin e një ndodhie.

Ne vazhdonim hulumtimin. Perdja e ngjarjes po ngrihej dalëngadalë. Mjegulla davaritej sipër pllajave e gropave të saj. Me syze të errëta mbrojtëse, si ata që kishin pritur shpërthimin atomik apo apokalipsin, ne pritnim zbulimin e saj.

Pjesa e dytë

ZBULESA

1

Diktatori po verbohej. Ajo që për muaj me radhë s'kishte qenë veç një pandehmë, ishte shqiptuar para ca çastesh me fjalë të përpikta. Nuk e kishte menduar se dënimin e syve të tij do ta dëgjonte në një frëngjishtë të shqepët, me theks japonez. Grupi i mjekëve francezë i kishte lënë ende një farë shpresë para një javë. Kurse japonezët e porsambërritur kishin qenë të pamëshirshëm. Shikimi do të tretej përherë e më me shpejtësi gjë sa të fikej krejt pas dy vitesh. Mundësia e operimit të cipës, pas "pjekjes" së saj, siç kishin hamendësuar francezët, mbetej më fort një dëshirë, për të mos thënë një mirësjellje diplomatike. Kishte qenë dyshimi për këtë të fundit që e kishte shtyrë të kërkonte me ngut dërgatën e largët.

Kështu pra, sytë po e linin. E mendoi këtë qetësisht, me më pak trishtim se ç'e kishte përfytyruar. Me sa dukej, në orët e dyshimeve, brenga ishte shpenzuar, madje me tepri.

Në këmbë, te dritarja e madhe dëgjoi zhurmën e

lehtë të makinave që do të merrnin mjekët, por ata vetë iu dukën veç si njolla të zeza që u zhvendosën turbull, si të shtyra nga era.

Dita po thyhej. Ai merrte me mend se si, në lagjen e ndaluar, lajmi po shpérndahej drojtur nëpër shtëpitë e anëtarëve të Byrosë Politike. Nuk ka nevojë për aq shumë fshehtësi, i kishte thënë së shoqes, kur ajo, e çmeritur, jepte e merrte në telefon me ministrin e brendshëm se si do të mbulohej ardhja e mjekëve, duke i paraqitur si arkeologë apo si kërkues vajguri. Ishte diçka që do të merrej vesh një ditë.

Për çudi, s'kishte drojë nga dalja e kësaj të fshehte. Madje fshehirazë e dëshironte. Në krahasim me të tjerat, i dukej fisnikëruese dhe ç'ishte kryesorja, e tillë që nuk ia cënonte hijen e rëndë.

Prej vitesh i ishte krijuar besimi te gjithçka, madje edhe ato rrethana që ishin kundër tij, vinte një ditë që i kthehet e përtëmirë.

Që vdekja përpëra se të vinte vetë po i dërgonte pajimet e saj, e merrte si një shenjë mirëkuptimi me të. Po e mësonte qysh më parë me mbretërinë e saj: me terrin, në radhë të parë, e, pa dyshim, me ndarjen me të vetët.

*S. N. Yelef
Follefemane*

As varri s'ka frikë nga i vdekuri e as i vdekuri nga varri. Këtë fjalë të moçme ia kishte thënë e ëma, atë ditë kur e kishte gjetur para arkës së çuditshme, ndërsa skajonte për herë të fundit pajisjet për ditën e mortit: fustanin me të cilin do ta vishnin, këmishën, këpucët, mbulesën prej atllasi e gjer te riza e nëpërdukshme, me të cilën do t'i mbulonin ftyrën. Po ç'bën kështu, moj nënë, i kishte thënë ai. Ç'është nevoja të lodhesh ti vetë, kur kemi kaq njerëz që na shërbijnë? Ajo i kishte shpjeguar se nuk ishte e kotë që gjithë plakat e Gjirokastrës i kryenin vetë, pa ndërmjetësinë e të tjerëve, gjithë punët e vdekjes. Me mortjen duhet marrë vesh drejtëpërdrejt, i kishte thënë. Kështu ajo të vjen e lehtë ditën e caktuar, dhe, lehtshëm, të shpie atje ku e ka vendin gjithkush.

Diktatori pshërëtiu. Për një fjalë të nënës do të kishte nevojë tani më shumë se për gjithë përgjërimet e anëtarëve të Byrosë Politike.

I përfytyroi megjithatë një nga një, ndërsa po merrnin vesh lajmin e verbimit të tij. Në krye iu ndërmendësan më besnikët, ata që me fytyra të llahtarisura, zinin kryet me duar dhe gati sa s'po ia krisnin vajit, bashkë me gratë. Daleni, daleni, mendoi. S'është nevoja të ligështoheni ashtu. Dhe as të thoni "ç'është kjo gjëmë!", sikur të kishte behur fundi i botës. Dhe sa për sytë që jeni gati të m'i dhuron, ju faleminderit, por s'është nevoja... Ky ishte fati im dhe unë do t'i nënshtrohem.

Një valë mallëngjimi e kaploj krejt. Mendimi se po flajohej ai vetë, s'i ndahej. Po e thithë terrin dhe natën vetë, këtë herë me gjakftohtësi. Mendja i kishte shkuar te pjesa tjeter e Byrosë Politike, ata për të cilët, zemrën e kishte të ftohtë. Me fytyra të bardha, pa shprehje, po e merrnin vesh zezonën. U mpitë, hë!? S'dini ç'të thoni!?

Nuk kishte kurrfarë shkaku të ishte mosbesues ndaj tyre, por kjo nuk e lehtësonte aspak. Përkundrazi, sa më shumë që s'gjente arsyen, aq më fort acarohej me ta. Madje nganjëherë i dukej se enkas nuk shfaqeshin hapur, dhe nuk i jepnin një shkas të qartë, për ta munduar më keq.

Daleni, po do të më shihni, tha gjithë mllef. Tani që ishte i verbër, s'kishin pse të kërkonin mëshirë si më parë. Tani kishte arsyen më fort se kurrë të godiste kur ta mbushnin kupën.

Vala e pezmit ia çoi mendjen te një grup i tretë, gjysmë i mjegullt. Ishin anëtarë të mundshëm të Byrosë Politike që, nga pritja e gjatë për t'u zgjedhur, ishin plakur dyfish, të tjerë, të përjashtur prej kohësh, një pjesë të vdekur. Me ta përziheshin të dënuarit, shumica e të cilëve treteshin prej kohësh në dhë, por që për atë ishin ende gjallë. U gëzuat, hë? tha me vete. Natyrishq që u gëzuat, kishit vite që më përgjonit.

Thashethemnaja për verbimin e tij ishte ende e re. Dy muaj më parë, kur pas kthimit nga udhëtimi në jug të

vendit, e shoqja, me atë humbje qartësie, që i krijohej në të folur gjithsaherë i kumtonte ndonjë gjë tejet plagosëse, i kishte thënë që të përpiquej herë tjetër, kur të gjendej përpara ndonjë basorelievi ose pllake përkujtimore, ta shmangete prekjen me dorë të mermerit, siç kishte bërë te grupi skulptural i vellezërve Frashëri. Ai e kishte kapur në çast shqetësimin. Do të thuash se është një lëvizje prej të verbëri? e kishte ndërprerë, pa ia shqitur sytë. S'ka nevojë të belbëzosh më gjatë, e di se ç'ke menduar ti bashkë me ministrin e brendshëm dhe gjithë kokëtrashët e tjerë të tij. Se asnjë nga ju nuk e di që një përkitje e tillë e shtatores, ose e gurit të varrit është një mënyrë nderimi e moçme.

E shoqja kishte dashur ta sqaronte se ishte fjala për shmangien e keqkuptimeve, sidomos kur kjo ndodhë para kamerave të TV, por ai s'kishte dashur ta dëgjonte. Në fund të fundit le ta merrnin vesh, kishte thënë me përcëmim. Kurse me vete kishte menduar: a s'kishin thënë kaq vite se ishte i çmendur... se ishte... ç'nuk ishte...

} Si përherë në çaste zemërimi, mendimi nuk i shqitej nga pjesa e pabesë e Byrosë Politike. Do t'i shtypte këtej e tutje, pikërisht, me atë që ata e kishin marrë si fatkeqësi të tij e që në të vërtetë kishte qenë e tyrra. Do t'i torturonte me pandehmën franceze: heqjen e cipës së syve pas një viti, e shumta dy vitesh.

Me sy të përtërirë do të vinte tek tryesa e gjatë, ku ata do të prisnin gjithë ankth. Ja pra, u pamë përsëri. Mirë se ju gjej, mirë se ju gjej... E shoh se disa nga ju janë shëndoshur, janë rinuar. Siç duket, mungesa ime i ka këndellur. E po, natyrisht, plaku dhe guri e kanë hijen e rëndë. Po ç'ti bësh, do të më duroni dhe ca kohë. S'mund të iki nga kjo botë me këmbët e mia.

Pastaj do t'i kthehej pjesës tjetër, atyre që do t'i dukeshin të ligur dhe të verdhë. Po ju, ç'paskeni pësuar kështu? Ç'janë këto rrudha që s'ua kam parë? Jeni brengosur për mua, e di, si atëherë kur vuaja nga zemra. Keni qëndruar pa gjumë, me siguri. Ju faleminderit..., ju faleminderit...! Apo ju ka tretur tjetër gjë? U ka dalë

gjumi si të më zini vendin, keni nisur kacafytjen me njëritjetrin, si atëherë kur dergjesha pa ndjenja, e ju s'mendonit veç për postet? Ajme, ajme.

Kështu do t'u kallte datën, t'i pluhuronte, t'i aspaktte, gjersa të mallkonin qumështin e nënës, siç thuhej.

Iu duk se në dhomat matanë dëgjoi zhurma të lehta. Kishte kohë që kishte përshtypjen se veshët i kapnin zëra dhe pëshpërima që më parë s'i ndiente. Dhe kjo ishte e natyrshme. Gjëja e parë që kishte mësuar kur kishte lexuar një libër për verbimin, ishte se me dobësimin e syve, dëgjimi mprihej.

U gëzuat para kohe, tha me vete i lodhur, duke menduar turma të tëra ndërkaq. Më keq do ta kishin tanë. Syri i tij nuk i përgjonte dot kudo, kurse veshi do t'i ndiqte atje, ku nuk ua priste mendja.

Dy ditë më parë ministri i brendshëm, në emër të tij, i kishte kërkuar zëvendëskryeministrin kinez, që kryesonte dërgatën zyrtare për Festën e Çlirimit, një sasi mikrofonash përgjimi tepër të stërholluar. Sonte, në pritje në Pallatin e Brigadave, kinezi do të jepte me siguri përgjigjen.

Jam vesh i gjithi e të dëgjoj. tha me zë një varg që kushedi se ku e kishte lexuar.

Mendimi se në jetën e tij gjërat i kishin ardhur në kohën e rendin që duhej, e përshkoi qetësisht. Kaq kohë e kishte shmagur me vështirësi dëshirën për të shkruar. Dukej sikur fati po ia dërgonte verbimin për ta çliruar nga mëdyshjet. Në terr thureshin më lehtë përfytyrimet e sidomos motërzimet e dyshimeve. Kishte aq shumë asosh në trurin e tij. Gjithë përbetimet kundër tij ishin aty. Netët e zeza kur kishte pritur pa gjumë fundin e kundërshtarëve. Lajmëtarët që i kumtonin vetvrasjet e papritura. Pastaj vetëvrasjet që vononin. Të gjitha këto përziheshin në kokën e tij me ngjarje që ende s'kishin ndodhur. Po për të s'kishte kurrfarë rëndësie kjo. Ishte gjithsesi i njëjti brumë. Si shtëllunga e lesshit të patjerrur në furkë, mund t'i jepje fije herë së shkuarës e herë së ardhmes e herë të dyjave njëkohësisht. Dallimin midis tyre po e humbte lumturisht tanë.

I erdhi të qeshte kur mendoi vajtimin e tyre për sytë e tij. Merruni më mirë me sytë tuaj të vegjël, tha me zë. Do të shkruante, pa dyshim, kujtimet e fëminisë dhe ato të rinisë në Francë. Dhe ndoshta një dramë për dimrin e vitit 1960 në Moskë. Dhe një tjetër për një ngjarje që ende s'kishte ndodhur...

Një copë mermeri me dy zgavra, që herë merrte trajtën e fytyrës së Vehip Qorrit, bejteturësit vegjëlisë së tij, e herë atë të Homerit, i valëvitej në përfytyrim.

Kinezi do ta jepte përgjigjen me siguri që sonte. Mijëra mikrofonë të rindj do të vendoseshin kudo. Në qoftë se Shqipërisë do t'i dobësoheshin sytë, veshët do t'i mpriheshin si asnijëherë. Në fund të fundit kjo ishte në logjikën e gjëra. Shqipëria do të kthehej në rrënjët parake, atëherë kur ishte veshi që sundonte e jo syri.

Le të mahniteshin me të, siç kishin bërë pérherë: Shqipëria rapsodike, gojore.

Pas qelqeve të dritäres dritëzat e kryqytetit, të zbukuruar për festë, rrëzëllonin turbull.

Në mendjen e tij u bë befas zbrazëti. Pastaj, mendimi i parë që i erdhi, u lidh me rrënjët e thella të gjithë kësaj që po ndodhë. Ashtu është, mendoi ai duke marrë frymë thellë. I shkonte Shqipërisë, si asnje tjetre, verbëria e tij.

Kur ai hyri në Pallatin e Brigadave, duartrokositjet në fillim, pastaj heshtja, e pas saj gjallërimi i gjithçkaje, dukeshin njëlloj si një vit, si katër, si shtatë vite më parë. Por ujqërit e vjetër të pritjeve, si dhe diplomatët që kishin kohë në Tiranë, e kapën në çast atë hije të veçantë që zia e jepte edhe midis ngazëllimit. Ishin së paku dy duzina njerëzish që e dinin, ndërkaq, fillimin e verbimit të tij, dhe ata mjaftonin për të rrëzatuar hijen.

Të ulur në tryezën kryesore, anëtarët e Byrosë Politike nuk ia ndanin shikimin. Ai vezullim i pazakontë i shfaqur muajt e fundit në sytë e tij, atë mbrëmje ishte i papërballueshëm.

Ç'i kanë bërë, o qiel, mendonte secili prej tyre. Dukej sikur poshtë rrjetëzës së syve i kishin futur diamante.

Mjekët e ardhur nga larg duhej të ishin diku në sallë, por askush nuk i njihte. Të lumtur që tryesa ishte tepër e gjërë dhe ai s'mund të këmbente fjalë veç me ata që kishte përbri, anëtarët e Byrosë Politike mendonin ndërkaq mbledhjet e ardhshme, kur ai do t'i gjykonte kryesisht nëpërmjet dëgjimit. Gjer atëherë ishin tortuar në zgjedhjet e këmishave e sidomos të kravatave, të cilat ai, kushedi pse, i pëlqente t'i vinte re, gjysmë me mahi. Veshjen dhe qimet në fytyrë, gjithashtu ua vinte re. Gjëja e parë që mësonin të porsazgjedhurit në Byronë Politike, ishte se ai nuk i duronte dot fytyrat e parruara ose të rruara keq. Ripeshin pa mëshirë pak kohë përpëra çdo mbledhjeje, madje iu dukej se me krenari mund t'i tregonin prerjet në mollëza e nën mjekër, gjersa një ditë ai u kishte thënë se këtu nuk ishte ambulance ~~por~~ Byro Politike.

Ndërkaq kjo ishte ende e thjeshtë në krahasim me torturën e syve. Prej vitesh qarkullonte mendimi se nga sytë ai kishte pikasur së pari pabesinë e ndihmësve të vet. Përpëra shikimit të tij ata s'dinin ç'të bënin. E dinin se po t'i ulnin sytë, kjo do të ishte baraz me vetëvrasjen, por edhe t'ia përballonin shikimin s'ishte e lehtë. Mund të merrej si krenari e kotë, si shenjë barazie, për të mos kujtuar shprehjen e mallkuar "s'ia bënte syri tërr", të cilin një hap e ndante nga kundërvënia. As syze me qelqe të tymta s'mbanin dot, sepse ai ishte në dijeni për të gjitha cenet e shëndetit të tyre. Flitej se një herë në javë mbyllej me një mjek plak, shok i tij i vjetër, në një nga dhomat e shtëpisë, natën vonë. Atje, nën dritën e një llambe, shqyheshin gazit të dy me hijet e nofullave të tyre, të mushkërive e sidomos të kafkës. Shikoje mëlçinë e këtij, i thoshte për ndonjërin, a i dallohet millefi, hë? Më duket se ka nisur t'i nxijë, përgjigjej tjetri, dhe prapë ia krisnin të qeshurës. Si thua, t'ia bëjmë gropën? pyeste ai. Mjeku plak mëdyshej pak. Të presim edhe një grafi tjetër, përgjigjej hijerëndë, pastaj... Dhe prapë shqyheshin gazit.

Tani të gjitha këto kishin marrë fund. Tani mund t'i zgjidhnin si të donin kravatat, veç me zërat duhej të merreshin më shumë. T'i zbutnin, nëse tingëllonin të mprehtë, t'i ngrohnin në ato raste kur ashtu duhej e, përkundrazi, t'i egërsonin edhe më në mbledhjet ku kërkohet ashpërsi.

Sipas zakonit, kur nisi servirja e kafesë, një pjesë e të ftuarve i lanë tryezat dhe nisën të vërtiten njëloj si përpara darkës, në mjediset e pallatit.

Zëvendëskryeministri kinez i bëri një shenjë që larg ministrit të brendshëm.

-Fola me kryeministrin Çu, -i tha, kur tjetri u afrua. -Më tha se për të do të ishte një kënaqësi të merrej vetë me sigurimin e lëndës, aq më tepër që kërkesa vjen drejtpërdrejt nga udhëheqësi juaj.

-Ju faleminderit, -u përgjigj ministri. -Jam i sigurtë se ai do ta çmojë shumë këtë kujdes të shokut Çu En Lai.

Diplomatët e huaj të cilët, qyshse ishte pëshpëritur për ftohjen e marrdhënieve shqiptaro-kineze ndiqnin me vëmendje gjithçka ndodhte në pritjet zyrtare, nuk ua ndanin sytë dy zyrtarëve të lartë.

-Kryeministri Çu më tha se një sasi e parë mund të mbërrijë me ngut me avion, që javën e ardhshme. Kinezi afroi kryet dhe duke mbledhur gishtat te buzët, sikur t'i puthte, siç bëhej për të rrëfyer përkryerjen e diçkaje, vazhdoi: -Ju do ta shihni vetë, shoku ministër, se ç'mrekulli janë ato. Lulja, ajka e teknikës kineze, ha, ha, ha!

Ca çaste më pas, ministri i brendshëm arriti të takonte, midis grumbullit të të ftuarve, gruan e Udhëheqësit.

-Ajo kërkesa do të kryhet, madje shumë shpejt.

-Ashtu? -ia bëri ajo. -Shumë mirë, shumë mirë, -shtoi, por dukej që mendja i punonte gjetkë. -Dëgjo, -tha duke iu drejtuar me emër. -Ka patur prapë përfolje lidhur me...

-Hëm, si të them. Diçka ka patur. Kemi kapur dy

raste të tjera.

-Prapë ai proverbi për korbin e verbër?

Ministri bëri "po" me krye.

Tiparet e gruas u bënë të akullta. Ndihej se egërsisë do t'i duhej shumë mund për t'u shfaqur në atë fytyrë të hijshme.

-Ti, besoj, se e ke kujdes vetë. Në raste të tilla... asnje mëshirë s'duhet pasur për askënd...

-Natyrisht, -tha ministri.

-Kurse ai vetë s'duhet kurrsesi ta marrë vesh. S'kemi përsë ta mërzisim.

-Natyrisht, -tha prapë ministri.

Zhurmëria e pasdarkës ndihej përherë e më shkujdeshëm përreth. Pasi kërkonin ndonjë tryezë ku të linin kupat e kafesë, të ftuarit bënin ç'bënin kthenin kryet nga tryza kryesore.

Sytë e gruas ndoqën një copë herë grupin e vogël të mjekëve japonezë, që përendeshin krejtësisht të huaj në atë pështjellim.

-Besoj se ata do të janë gojëkyçur, -tha ajo.

-Ashtu them, -u përgjigj ministri.

Ndërkaq, pas shpinës së tij një tjetër njeri po i hante me ca sy të dergjur të ftuarit e largët: ambasadori francez.

20. Maj. 2008.

Mos ji kaq i trishtuar e
i menduar o njeri, kujtohu
se jeta është si pasqyra,
të buzëgash, kur ti
just i buzëgash asaj.

**Smile!
e
Sorridi!**

13. MAJ. 2001
?

LA MIA VITA È UNA
VERA MERDA

È ANCHE DI PIU'

23. MARS. 2005

'Why are you
so pessimist?
I'm sorry for
you.
You shouldn't speak
like this. Life is
the most
beautiful
gift.'

Zhurma e makinës që po hynte në oborrin e brendshëm u duk se i drodhi qelqet e dritäres. Mbërritën, tha ai me vete dhe u ngrit nga tryesa. Gjunjët i ndiente të mpirë, kurse nga lukthi e lart kishte drithëtirë. Dërrasat e shkallëve po kërcisin nën hapat e ndihmësit. Ngadalë, tha ai, e mora vesh.

Në oborr të porsaardhurit po çmpinin këmbët.

-Arian Vogli, shefi i Sigurimit, -tha ai duke iu zgjatur dorën. -Kemi gjithë ditën që ju presim. Mirëseardhët!

Vështrimi i tij ndaloi mbi mbulesën e makinës që zbardhë vende-vende.

-Në male binte dëborë, -tha njëri nga të ardhurit.
-Ndaj dhe u vonuam.

Ndërsa shkarkoheshin arkat, ata u ulën në kthinën e pritjes, për të pirë kafe. Arkat ishin të ftohta akull dhe hieroglifet kineze mbi to nxinin si gjallesa të ngrira.

-Përpara se të nënshkruajmë dëftesat e dorëzimit do të ishte mirë të bënim një mbledhje të shkurtër, -tha

njëri nga ardhësit.

-Natyrisht, -u përgjigj Arian Vogli. -Ju jeni me ngut?

-Fatkeqësish po. Na duhet që sonte të bëjmë dorëzimin edhe në qytetin fqinjë. Besoj se do të flemë atje.

-Mbledhjen mund ta bëjmë këtu, apo jo? -tha shefi i Sigurimit. -Le të vijnë dhe të tjerët, -iu drejtua ndihmësit.

E dinte pak a shumë se ç'do të thoshin të ardhurit. Trysnia kundër Shqipërisë nga armiqtë e jashtëm e të brendshëm po rritej.

Lufta e klasave do të forcohej. Këta përgjues që ishin fjala e fundit e teknikës, do të ishin këndeja e tutje veshët e përtërirë të diktaturës së proletariatit. Sa të dëgjonin këta veshë, asgjë s'e gjente Shqipërinë. Po të shtupoheshin ata, na mori lumi të gjithëve.

Ai që foli i pari, tha pak a shumë ato fjalë. E vetmja gjë e veçantë ishte theksimi se përgjuesit i kishin kërkuar Kinës me porosi të veçantë të Udhëheqësit dhe se për gjithçka që lidhej me to, do të njoftohej njëherazi Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Komitetit Qendror.

Ndërsa tjetri fliste, vështrimi i Arian Voglit shkonte herë pas here te pllakati i porsadalë për festimin e përvjetorit të shërbimit të fshehtë: një sy njeriu dhe një tjetër prej shqiponje që gati-gati përkiteshin. Vitin e ardhshëm do të duhej të shtohej ndoshta një vesh, mendoi.

-Besoj se ju ndërkaq keni punuar për përpilimin e listave, -vazhdoi tjetri. -Megjithatë, ndoshta do t'ju duhet të bëni ndonjë qortim në to, pasi të dëgjoni sqarimet që do t'ju japë ky shoku këtu, që është inxhinier.

Ata porositën edhe një kafe të dytë përpëra se të dëgjonin shpjegimet e inxhinierit. Ndoshta për shkak të mjeshtërisë, zërin e kishte fare të ulët, gati-gati nanuritës. Ai tha se kjo që po ndodhte ishte një gjë e re në historinë e përgjimit shqiptar. Mikropërgjimi kishte qenë gjer më sot diçka tepër e rrallë, që kapte vetëm gjashtë përqind të dëgjimit të fshehtë, dëgjim që përballohej kryesisht me

anë të veshit. Tani gjithçka do të kthehej kryengulthi. Me fjalë të tjera, nga një përgjim i zgjedhur, të thoshje sqimatar, mikropërgjimi do të kthehej në të gjithunjishëm, total, siç quhej sot.

Ky përfthim i krejtrrokshëm duhej kuptuar dy mënyrash, kishte vazhduar inxhinieri. Që ato do të vendoseshin gjithkund. Që s'do të kurserin kurrkënd.

Përpara se të shpjegonte llojet e "zëthave", siç nisi t'i emërtonte, inxhinieri foli shkurt për cilësitë e tyre. Ndryshe nga të gjertanishmet ato ishin fjala e fundit e teknikës, me ndjeshmëri të lartë, të vegjël, të vendosshëm e të çvendosshëm lehtë, me fjalë të tjera të tillë që mund "të mbilleshin" e pastaj "të korreshin" kurdo. Ju e dini më mirë se unë, shokë, se ç'kemi hequr me gërdallat e vjetra, ato që më shumë se zëra njerëzish mblidhnin zhurma dhe erë. Sa herë desh kemi thyer kokën duke u kacavjerur për t'i ngjitur ose shqitur nga llambadarët.

Tani po i themi lamtumirën kësaj kohe, tha inxhinieri.

Duke kthyer kryet nga arkat ai tha pastaj se zëthat e tanishëm ishin tre llojesh. Të përhershmit, ata të përgjimit të gjertanishëm klasik, do të vazhdonin të vendoseshin në hotele, zyra, kafene, e vende të tjera që ata i dinin fort mirë. Gjëja e re në këtë rast ishte se do të zgjerohej lista e mjediseve. Kështu, falë cilësive të tyre, do të futeshin në stola parqesh, pas tablove të piktureve në muzeume, madje pas afisheve të filmave, atje ku njerëzit ishim më të shkujdesur.

Grupi i dytë, ai i zëthave të përkohshëm, gjithashtu ishte i njojur prej gjithkujt. Por në qoftë se gjer tani përdorimi i tyre ka qenë i kufizuar për shkak të vështirësive që u përmendën më lart, mbjellja e tyre tani, në dorëzat e telefonit, WC-të, madje në krevatët bashkëshortorë, lehtësohej dukshëm.

Inxhinieri ktheu kryet prapë nga arkat, duke kërkuar, me sa dukej me sy, njërën prej tyre, atë që veç hieroglifeve të zakonshme kishte një shenjë të kuqe. Pa fshehur një buzëqeshje të mekur, ai tha se e kishte ruajtur për në fund

befasimin e këndshëm, grupin e tretë. Këta ishin dëgjues të panjohur gjer më sot. Mund të thuhej se ishin perlat e përgjimit bashkëkohor, ndaj me të drejtë quheshin "princat e dëgjimit".

Ai foli gjatë dhe me afsh për ta.

-Ca vite më parë ju, e bashkë me ju, edhe ne, jemi mahnitur me zëthat e pavarur, ata që punonin me pilë e që mund ta ndiqnin pas viktimin, -vazhdoi inxhinieri. - Dhe kishim të drejtë të mrekulloheshim. Në atë kohë ata ishin për ne kulmi i përkryerjes. E ndiqnin viktimin vërtet hap pas hapi, si qeni, por ama, si qeni që e ka një vargor në qafë edhe ata ishin të lidhura me qendrën komanduese. Kështu që, sado të zgjerohej rrethi i veprimit të valëve, vinte një çast që viktima dilte nga rrezja e tyre. Dhe për ne kjo ishte vdekje.

Inxhinieri buzëqeshi. Ai tha se viktimat, si gjithë fajtorët, ishin përgjithësisht natyra të shqetësuara, kështu që bënин ç'bënин, i iknin përgjimit. Me "princat" ky shteg mbyllej përgjithmonë. Ata kishin pavarësi të paskajshme, s'kishin nevojë për kurrrfarë lidhje e komandim. Ushqeheshin vetë nga pila, vetë bënин regjistrimin, vetë e ruanin kasetëzën e vogël në trupthin e tyre. Të vendosur në çantën a në veshjen e viktimës, e ndiqnin atë hap pas hapi, qindra, mijëra kilometra larg, gjer në fund të dheut, po të qe nevoja.

Ja kështu ishin "princat". Mallëngjimi i folësit po i mekte të gjithë. Me këta bablokë merrte fund epoka kur armiqqtë, pasi rrinin të heshtur si korbi në zyrë ose në shtëpi, i bënин shenjë njëri-tjetrit "dalim një çikë?". Dhe në rrugë ose në park niste, pastaj, tërbimi kundër shtetit.

Ndjenja e mirënjoyjes përzuhej me një farë keqardhjeje, por krejt të turbullt, që vinte ndoshta ngaqë ishin të vegjëlth, që të vetmuar krejt punonin ku t'i binte hera: në peliqen me erë të mirë të gruas së bukur, apo në gropën e minierës. Dhe për helmin e së folurës, që pasi e mblidhnin të gjorthit me aq mund, e skajonin në trupthin e imët, si në sarkofagth, në pritje të hapjes.

Shkrehja po i zbuste zërat e tyre. Dhe frysëmarrja diçka iu kishte pësuar. Ndërsa tjetri fliste, ndër mend iu vetonin njerëz që i urrenin, e që tani, ashtu siç do t'i përfytyronin me gjymtime ose puçrra të frikshme, i mendonin me "princat" në trup. Disa kujtonin gratë që nuk i kishin shtirë dot në dorë e që flitej se ishin të ftohta ose të nxehta jashtë mase. Të tjerë ëndërronin zbulime përbetimesh, si katër vjet më parë, dhe veten e tyre në sallat e kryeqytetit ndërsa merrnin medaljet.

I lodhur, siç duket, inxhinieri heshti një copë herë. Sytë, bënte ç'bënte, i çonte nga arka me shenjë të kuqe. Tjetri, që ishte përpjekur ta mbante veten, përfitoi nga rasti për t'iu kujtar porositë e shefit të Drejtorisë së Përgjithshme. Të gjithë përgjuesit ishin të shenjtë, por "princat", sidomos, duhej të qeveriseshin e të ruheshin me kujdes. Për vendosjen e secilit prej tyre kërkohej një proces-verbal i veçantë. Po ashtu për rimarrjen.

I pari, që kuptohej se ishte kryesor, ngaqë përvèç se fliste më pak, thoshte gjëra më madhore, tha se me ndarjen e sasisë së "princave" për çdo rrëth të Shqipërisë ishte marrë vetë Udhëheqësi.

-Ju, siç do të shihni kur të hapni arkat, keni tridhjetënëtë copë, çka mendoj se duhet ta merrni si një nder që i është bërë krejt krahinës suaj të shquar përherë për atthesi dhe besnikëri ndaj shtetit.

Një murmurimë mirënjojjeje u shqiptua njëkohësisht nga shumë gojë.

-Na vjen keq që s'rrini për darkë sonte, -tha Arian Vogli.

-Vërtet e keni të pamundur?!

-Ashtu e kemi, i dashur, - u përgjigjën ata njëri pas tjetrit. -Ju e kuptoni, na presin, madje jemi vonë. Nata ka rënë qyshkur.

Kur erdhi çasti të hapnin arkat, mallëngjimin që gjer atëherë e kishin përballuar zërat, duart e shfaqën-në trajtë edhe më lakuriqe. Ata po kridheshin, madje një çast Arian Voglit iu duk se dëgjoi një gulç, nga ato që iu

shpëtojnë njerëzve në një mort.

Si të gjithë, ai digjej nga kureshtja të shikonte "princat".

Të vendosur rresht, në arkëza veshur me kadife të kuqe të myllët, ata kishin vërtet diçka prej stolie e sarkofagu njëkohësisht.

Nënshkrimi i dëftesave të dorëzimit u bë drejt e mbi arkat e zbrazëta.

-E po do të na falni tani, -tha njëri prej kryeqytetasve.
-Ju, me siguri, do të keni punë sonte.

-O, natyrisht, -u përgjigj Arian Vogli. -Do të shikojmë edhe një herë letrat një për një. Do të zgjedhim ndoshta kandidaturën, si të thuash, "dhëndrin" për të përvuuar "princip" e parë, -shtoi pas pak duke buzëqeshur.

-Ju urojmë gjithë të mirat, vëllezër, -thanë ata duke u ndarë me të gjithë. -Daltë mbarë kjo punë!

Arian Vogli i shoqëroi gjer te oborri. Duke u ndarë, ai ndjeu prapë një zbutje në gjoks, dhe gulçin që i ishte dukur se e kishte dëgjuar prej dikujt, e kuptoi se e kishte patur brenda vetes.

Ndërsa zgjaste dorën, një shtysë e padukshme e bëri ta përqafonte befas njërin prej tyre, atë që kishte folur më pak.

Tjetri gjithashtu e përqafoi, madje me të njëjtin hov.

Lamtumirë, i dashur. Këto fjalë, Arian Vogli nuk ishte i sigurt nëse i kishte dëgjuar vërtet prej tij, apo i kishte menduar.

Ai u kthye kryeulur te salloni ku ndihmësit e tij e prisnin.

Vonë, në dy pas mesnate, ata dolën njëri pas tjetrit. Unë do të rri edhe pak, tha Arian Vogli.

I ndoqi me sy tek dolën nga porta kryesore, pastaj një copë herë vështrimi i mbeti mbi kapotat e zeza të

rojeve në oborr.

Mbi tryesa ishin listat plot me shenja të kuqe, pikëpyetje e pikëçuditëse përbri emrave. I kishin shkoqitur për tre orë rresht, një për një. Secili nga zëvendësshefat kishte paraqitur të vetët, bashkë me pse-hin e përgjimit. Dy- tri herë kishte patur acarime, të pashmangshme në kësi rastesh, kryesisht për sasinë e përgjuesve që do të merrte çdo zëvendësshef. Fshatarët e mi gjithnjë të fundit, kishte thënë ai që mbulonte katundet. Na mbeti mendja te artistët e te intelektualët. Por gjuha e fshatarit është me e hidhura e të gjithëve. Dhe dijeni se me këtë shpërfillje që tregojmë, nga katundet do të na vijë ndonjë ditë ndonjë e pabërë.

Arian Voglit iu kujtuan përgjigjet dhe kundërpërgjigjet dhe qeshi me vete. Merri, merri, që të na sjellësh edhe ca blegërima të tjera delesh. Jo, po ato ofshamat e lavireve hollandaze të Hotel Turizmit tënd, na ndritën. Që mos të të përmend bythecët.

Për zgjedhjen e njeriut mbi cilin do të provohej "princi" i parë, gjithashtu kishin folur një copë herë. Midis "dhëndurëve" të mundshëm, ia kishin lënë atij të vendoste. Ishin katër në listë: regjisori i teatrit, që për shkak të pjesës së re që po vinte, kishte bërë shumë udhëtime në Tiranë dhe ishte vazhdimisht i pezmatuar me Ministrinë e Kulturës. Një oficer i liruar, që dyshohej se shfrynte në familje. Një prift katolik, që pas mbarimit të internimit e kishte të ndaluar të kthehej në Shkodër dhe që dyshohej se para një muaji kishte pagëzuar një fëmijë në B. Doktoresha e syve e Spitalit Qendor.

E përfytyroi veshjen dimërore të secilit, (stina është e përshtatshme për vendosjen e "princave" kishin thënë kryqytetasit), dhe dorën që fuste me ngut përgjuesin midis pambukut të supeve. Meqenëse vendosja e "princave", si një përvojë krejtësisht e re, kishte nxjerrë mjaft të papritura, kishin menduar ta shqyrtonin në një mbledhje të veçantë.

Stina është e përshtatshme, përsëriti me vete fjalët e të ardhurve, por në këtë qytet ishin tepër të rralla vendet

ku njerëzit i hiqnin veshjet dimërore. Gjithkund bënte ftohtë: në kinema, në zyrat, në sallat e mbledhjeve.

E ndërpree ecejaken për t'u afruar te tryesa. Mbi një fletë të bardhë shënoi Spital. Mundësi të gjera. Dhomat e vizitorëve. Sidomos Radiografia."

Gjithçkaje i gjendej rrugëzgjidhja po të vritej mendja. Duhet të kemi, ndërkaq, njerëzit tanë midis rrobaruajtësve, tha me vete.

Ndër mend iu rreshtuan prapë "princat" midis kadifësë së kuqe, si në një kremitim ziplot. S'kishte qenë e kotë ajo pamje arkëmorti. Do të bënин mort, me sa dukej.

Me siguri, shtoi me vete. Ndryshe e gjitha kjo s'do të kishte kuptim. Dhe as peshë.

Përndeza iu ripërtërit. Një ndjesi rrënqethjeje futej midis saj. Do të kishte kokëçarje, pa dyshim. Smirë e verbër, hakmarrje ndoshta, andej nga s'e priste. Në mendje iu renditën drejtuesit e qytetit, bashkë me gratë e tyre, ashtu siç i shihte përherë në tremen kryesore të stadiumit, në Festën e Çlirimt. Do të dyshonin se i dëgjonte. Do t'i merrnin vesh ndoshta ato dy fjalët e tmerrshme: "gjithkund" dhe "gjithkënd".

Kishin të drejtë të mos e donin. Dhe të hakmerreshin po t'u binte rasti. Natyrisht, mendoi, s'kishte si të ndodhë ndryshe. Megjithatë e ndiente se ajo përqethje tmerri nuk i vinte prej tyre. Një tjeter frikë po e pushtonte. Do të zbriste në humnerat e botës. Atje ku ishte ftohtë dhe terr. Do të dëgjonte të mosdëgjueshmen: turpet, rënkimet e dashurisë, lutjet e fshehta me emra shenjtorësh, të ndaluar qyshkur.

U përpoq ta hiqte mendjen andej. Brenda tij, ca çaste gjithçka u bë fir. Pastaj midis zbrazëtisë u shfaq një emër: Edlira. Kishte kujtar se e kishte shkulur nga kujtesa. Por ja, kishte mbërritur kjo vjeshtë me përgjuesa të rinj dhe gjithçka kishte ndryshuar. Mendimi se mund ta dëgjonte, kishte netë që e ngucut tinëzisht. Madje arsyaja e vërtetë që kishte mbetur vetëm në zyrë, kishte qenë ndoshta ajo.

Ishë e lumtur, me sa dukej, në muajin e parë të

martesës. Dhe as i shkonte mendja se ai nuk do t'i ndahej. Ashtu siç e kishte kërcënuar në takimin e tyre të fundit: unë nuk të ndahem, ta dish. Ashtu?, ishte përgjigjur ajo me shpoti. Kaq i fuqishëm të duket vetja? Gabohesh.

Në të vërtetë, ndonëse sekretar i parë i rinisë, atij i dukej vetja më i pafuqishëm se kurrë. Ishte kohë fushate kundër zvetënimit të kuadrove. Parrullat "Zvetënimi moral" është pararendës i zvetënimit politik" shquanin e nxinin kudo. Ndiqeshin historitë e dashurisë gjithaq sa krimet. Gojët e liga thoshnin se kjo lidhej me gjendjen hormonale të anëtarëve të Byrosë Politike, kryesisht të diktatorit. Çdo grykësi seksuale merrej si tallje, për të mos thënë kundërvenie ndaj tij. Mosepshi bënte rrënim kudo. Një mburje e re, e shfaqur, me sa dukej, për herë të parë në botë, dëgjohej gjithandej midis kuadrove: pafuqia seksuale.

E kishte ndjerë dhe vetë sesa i mjerë paskësh qenë ai kërcënim. Do të jepte çnuk e çmos për ta ndrequr atë takim të fundit të shëmtuar. Por ajo s'i kishte dhënë kurrfarë rasti.

Dhe ja tani koha e solli që ta çonte në vend kanosjen e dikurshme. Do t'i ndodhej vërtet pranë, kur asaj s'ia merrte mendja. Në çastet e shenjta, kur kujtonte se ishte mbyllur në çerdhen bashkëshortore. Të merrte vesh në ishte vërtet e lumtur, siç hiqej.

Nuk kishte kurrfarë urrejtje. As ndjenjë hakmarrje. Kishte veç një hidhësi, që s'dinte si ta shkulte nga zgavra e gjoksit.

Muzika e së shtunës, pesë vjet më parë, në sheshin e vallëzimit, midis tendave të vullnetarëve për hapjen e tokave të reja, i kumbonte herë pas here në vesh. Nën atë muzikë, ndërsa vallëzonin, ishin përqafuar e pastaj puthur një copë herë në gjysmë hije, ajo, studente e vitit të parë të fakultetit ekonomik, me flokët që i mbanin erë sapun, si gjithë vajzave, të shtunave, dhe ai, sekretar i parë i rinisë së krejt Universitetit, i ardhur për mbikqyrje nga Tirana, me këmishë ngjyrë qielli, i adhuruar nga një pjesë e studenteshave, të dy të bronzuar, mishërimi i lumturisë

që jepte socializmi. Dhe një javë më pas, në një tjetër të shtunë, nën të njëjtën muzikë, që vinte këtë herë nga larg, ajo, pasi i kishte thënë "jam e virgjër", e ndezur nga ai fund vere, i ishte dorëzuar lehtësisht në lëndinë.

Arian Vogli s'donte të pshëretinte. Megjithatë ai lëshim ajri i zgjatur s'kishte emërtim tjetër.

Ku ishte hapur për herë të parë e çara që i kishte ftohur? Ai, që zbulimin e të fshehtave e kishte mjeshtëri, i shmangej përherë kësaj pyetjeje. Po të mos kishte ndodhur përpëra emërimit të tij si shef i Sigurimit në B., gjithë jetën do të kishte kujtuar se ishte ai emërim që e kishte larguar Edlirën.

Befasimi për atë emërim kishte qenë i fortë për krejt të njohurit e tij. Në sytë e të gjithëve ngrinte një pyetje: domethënë... ti ... qysh më parë... paske punuar atje?

Në të vërtetë s'kishte qenë kurrë bashkëpunëtor i fshehtë, ndaj ai vetë ishte habitur në krye. Ç'hynte ai në këtë punë? Me fakultet gjuhë-letërsie, pa kurrfarë përvoje të tillë... Por shumë shpejt, në Komitetin Qendror, në një mbledhje me kuadrot e rinj që do të emëroheshin në Sigurim, gjithçka ishte sqaruar. Partia, Udhëheqësi vetë kishin menduar ta rrisnin Sigurimin me gjak të ri. Ai duhej t'i përshtatej kohës. Ai mbetej shpata e dashur e Partisë. Por shpata, që të priste mirë, duhej të mprihej.

Në Ministrinë e Brendshme i kishin pritur ftohtë "ilirët", siç i quanin me tallje të rintjtë, për shkak të emrave ilirë, që të hyrë prej kohësh në modë, po jepnin brezat e parë të kuadrore: Gent, Altin, Arian e që po zëvendësonin ujqit e vjetër të ministrive: Sefedinët, Koçët, ose Zylot. S'ishin vetëm shkollat e larta që kishin mbaruar, gjuhët anglisht e frëngjisht (të vjetrit dinin tek-tuk rusisht, edhe më rrallë ndonjë gjysmë serbo-kroatishtë ose greqishtë, të fituar gjatë shërbimeve të gjata atje), dhe as mënyra e veshjes, por një frymë e tërë që pritej të sillej prej tyre.

Gjashtë muajt e parë në ministri kishin qenë më të rënda se ç'e kishte menduar. Diçka nuk ecte në "bashkëpunimin

midis brezave" dhe, ditën që i erdhi emërimi në B., ai kishte marrë frysme i lehtesar. Mendimi i dytë kishte qenë: atje ishte Edlira. Por ai mendim kishte qenë i qetë, si për një stoli që kishte qenë e thënë të humbte.

 Ai përfytyroi ditën kur do t'i thoshte ndihmësit të vet: "vendos një zëth në apartamentin e inxhinier Gjikondit. Në krevatin bashkëshortor... Thuhet se e shoqja e tij... gjatë dashurisë... nxjerr të fshehta të rëndësishme".

Iu duk se në fytyrë kishte një buzëqeshje të hidhur. Nga ato që ti i ndien vetë, kurse tjetri, përballë teje, jo vetëm nuk i vëren, por spikat të kundërtën. Ishte i bindur se nuk do ta jepte kurrë atë urdhër. Megjithatë, kjo nuk e pengonte ta vërtiste nëpër mend, siç ndodh me hakmarrjet e pakryera.

Kaq i fuqishëm të duket vetja ?

Ftohtësia, ndërsa ia egërsonte sytë e saj, u jepte një bukuri të huaj.

Po, Edlirë, tha me vete. Megjithatë as vetë s'e besonte. Do të ishte i fuqishëm, pa dyshim, si cilido që zbriste në ferr, atje ku gjithçka ishte ndryshe. Trajtat, tingujt, madje gjuha atje shpaloseshin të tjetërfarshme. Si demon do t'i binte pash më pash atyre trojeve.

Tmerri i verbër i pashkak, i ardhur nga një kah i pamundur, e rrënqethi prapë. Ishte zona e palejueshme që e jepte.

Kur ajo doli në rrugë, ndriçimi i ditës të lëbyrte sytë. Qielli, si i rinuar pas çlirimit të dëborës, ndehej dehshëm me ca fasha e çarje të kaltërta, që e tregonin më të madh e trillan.

Edlira ndjeu mbi flokët një si prekje dëbore. Ngriti kryet, por në atë pjesë të trotuarit s'kishte as drurë, as pullaze shtëpish prej nga mund të binin kristalet. Ndoshata ishin shkundur prej krahëve të ndonjë zogu në fluturim, mendoi.

Ishte vonë, megjithatë, kur po kalonte përpara teatrit të qytetit, ndali hapat përpara katorrit të afisheve. Përsëri asnjë gjurmë e "Pulëbardhës". Drama "Cuca e maleve" i zinte të katër netët e javës. Një natë më parë, te Vorpsët, fill pas darke ishte hapur biseda përfatim e shfaqjes. Shumica mendonin se nuk do të lejohej. Të zotët e shtëpisë, përkundrazi, kishin shpresë. Madje kur i përcollën te dera dhe panë dëborën që po binte, gruaja i tha Edlirës: Kjo borë është shenjë e mirë. Gjithçkaje që vjen prej qiellit

unë i besoj.

Dikush tjetër përbri saj, po hetonte afishet. Nga që, siç duket, nuk shihte mirë, pothuajse e ngjishte ballin te oraret. Deshi t'i thoshte: është "Cuca e maleve" gjithë javën, por aty për aty iu kujtua se e kishte parë atë njeri dy javë më parë në zyrat e tyre. Ishte një prift katolik që sapo kishte kryer internimin dhe kërkonte meremetimin e pullazit të shtëpizës ku ishte vendosur.

Me siguri ende e përgjojnë, mendoi dhe iku më tutje.

Kur iu afrua ndërtesës së Komunales, i shpejtoi hapat edhe më.

-Mirëmëngjes, jam vonë, ë? -i tha portjerit.

Ai u zgjat që pas katrores prej qelqi.

-Vonë, shoqja Edlirë, sigurisht... Besoj se mbrëmë ia ke kaluar mirë...

Ajo ngjiti shkallët me shpejtësi që ai të mos ia kapte ngërdheshjen përcmuese. Në ndërtesë ndihej era e qymyrgurit.

-Mirëmëngjes, -tha gjëzueshëm, duke mbyllur pas vetes derën.

Shoku i zyrës, Skënderi, seç po fliste pranë dritares me Nikollën nga zyra fqinjë.

-U vonova pak, -tha ajo.

-Është e kuptueshme, Edlirë, -u përgjigj Skënderi.

-Madje do të thoshja se pas tre javë martese ti po vendos një rekord të vërtetë... të... s'di si ta quaj... të ardhjes herët në zyrë.

-Edhe ti do më ngacmosh tanë?

Ajo lëvizi ndenjësen, pastaj hapi syzen e tryezës me zhurmë.

-Më fal, s'e kam me ty, -tha Edlira ndërsa nxirrte dosjet nga syza. -Por, të them të drejtën, po më ndodh diçka e bezdissħme. S'guxoj të kaloj nëpër mesoret dhe njerëzit më shikojnë gjithë nënkopim, thua se është ndonjë gjë e rrallë të jesh e porsamartuar. Madje, sot, edhe portieri e quajti të drejtë të tij të më ngacmonte.

-Mos ia merr për keq, Edlirë, -tha Skënderi. -Ditët janë të mërzitshme në ndërmarrjen tonë dhe për të si portier janë dyfish të tilla. Ndaj kur ti kalon përpëra tij, për të është njëlloj si të shikojë vazhdimin e filmit erotik të së dielës në TV italian.

Edlira u përpoq të buzëqeshte.

-E kuptoj edhe këtë. Natyrisht që mund të bëhet mahi me shumë gjëra, por kur taprohet bëhet e padurueshme. Aq sa të vjen të ngrihesh në mbledhjen e parë e të thuash: unë si e porsamartuar fle çdo natë me burrin, domethënë bëj çdo natë dashuri me të. Edhe mbrëmë kam bërë të njëjtën gjë. E mblodhët mendjen tani ?

Ata e vështruan gjithë mirësi.

-Ja e mësuam edhe një të fshehtë, -tha Skënderi duke qeshur. -Dhe natyrisht, e mblodhëm mendjen.

Edlira ndjeu se u skuq krejt.

-Unë po shkoj, -tha tjetri. Te dera mbajti këmbët dhe i bëri shenjën e zakonshme me vetulla, sa herë që ajo nxehet. -Mos u mërzit, vogëlushe.

Skënderi vazhdoi të qëndronte te dritarja.

-Skënder, më fal, -tha gruaja e re. -Më vjen keq për Nikollën. Ju e dini se ju çmoj të dyve. Por s'jam fare në vete.

-Asgjë, Edlirë. Ti e di se nuk ta marrim kurrë për keq. Në të vërtetë ne po flisnim për gjëra të trishtuara.

Ajo e hetoi një copë herë me sy.

-Ti e bëre radiografinë? Si dole?

Ai bëri "po" me krye, pastaj shtoi "jo keq".

-Të lutem edhe një herë, më fal. Jam vërtet nervoze sot. Dhe ndoshta jo për shkak të ngacmimeve të njerëzve, sesa për tjetër gjë. Mbrëmë gjatë një darke, fare rastësisht kam marrë vesh se në qytetin tonë ka mbërritur diçka ...

-Çfarë? -pyeti ai. -Shumë gjëra mund të mbërrijnë në një qytet.

-E di. S'jam aq naive sa të shqetësohem për gjepura. Por mënyra si u tha kjo gjë, nënkuqntone diçka të keqe, madje tepër të keqe.

-Ishte fjala për njerëz të këqinj apo për tjetër gjë, për udhëzime për shembull?

-S'e kapa dot mirë. Por që ishte diçka e keqe, kjo nënkuptohej.

-Shumica e gjérave që mbërrijnë ashtu janë, me përjashtime të rralla.

Edlira tundi kryet.

-S'di ç'të them ...

U përpoq të përqendrohej në dosjen e porsahapur, por s'mundej. Me bisht të syrit shikonte herë pas here spikamën e fytyrës së tjetrit. Ndriçimi i ditës i binte nga pas duke ia bërë edhe më të tejdukshëm flokët e çelët. I çmonte vërtet të dy, madje ua kishte lakmi shoqërinë e ngushtë, qysh nga bankat e gjimnazit. Kishin qenë bashkë në Universitet, e pastaj në të njejtën drejtori në Ministri, gjersa pas qarkullimit, kishin përfunduar të dy në B.

-Shpendi duhet të kthehet sot, -tha Skënderi. -Autobusi nga Tirana vjen në mesditë.

-Ah, po.

-Do të na sjellë ndoshta lajme. I ke marrë vesh ndryshimet e fundit?

-Diçka u fol mbrëmë... -Tingulli i telefonit ia ndërpren të folurën. -Po më thërrasin në drejtori, -tha ajo, dhe ungrit.

Kur dera u mbyll, Skënderi nxori nga syza e tryezës së tij radiografinë dhe e vuri kundër dritës. Një si buzëqeshje shpotitëse s'i ndahej nga fytyra.

Shpend Guraziu erdhi vërtet në mesditë. Fytyra i nxinte që larg. Ka kaluar me siguri përpara afisheve të teatrit, mendoi Skënderi.

Sikur të ishte në mendjen e tij, tjetri pa e hequr shallin nxori nga xhepi i palltos një çelës.

-Faleminderit, -i tha duke ia zgjatur. -S'besoj se do të më duhet.

-Ti mund ta mbash, me gjithatë.

-Jo, -gati sa s'thirri tjetri. -Kalova nga afishet e teatrit.

-E di.

Shpendi kishte zënë kryet me duar.

-Asgjë, -tha si të fliste me vete. -Shkretëtirë.

-Megjithatë ...

-Kurrë, -ndërpreu Shpendi. -Ajo s'do të vijë me mua kurrë, në qoftë se drama s'lejohet... Më kupton, Skënder, s'është fjala vetëm për lidhjen tonë. Hm, në qoftë se mund të quhen lidhje disa të puthura në shkallët e banesës. Por s'është vetëm ajo... Për Suzanën, moslejimi i pjesës është si fundi i botës.

-Megjithatë, me sa di unë, ka ende një farë shprese. Shpend Guraziu tundi kryet në shenjë mohuese.

-Me ç'pashë klimën në Tiranë, asnjë shpresë s'ka.

-Ashtu? S'më ke thënë ende asgjë.

-Skënder, më fal, po s'kam kurrfarë vullneti të tregoj.

Do të flasim më vonë.

Celësin, që gjer atëherë e kishte mbajtur në dorë e lëshoi më në fund në tryezën e tjetrit.

-Sa e ëndërrrova takimin me të në apartamentin tënd, -tha me zë të zbutur. -O Zot, asnjëherë s'kam ëndërruar aq fort. Kishte një shije tjeter gjithçka, si në vitet studenteske. Ti me siguri thua ç'është ky karafil sentimental, si nga shekulli tjeter.

-Jo, Shpend, si mund ta mendosh këtë?

-Unë vetë habitem me veten time. E shaj veten, e vë në lojë dhe prapë asgjë nuk ndryshon.

-Unë të kuptoj fare mirë.

-S'e besoj. Asnjë s'mund ta kuptojë atë..., s'di si ta quaj..., atë ëndërr ndoshta..., marrëzi ndoshta ...

Ai ia nguli sytë shokut si për ta hetuar përpara se t'i tregonte për të kushedisatën herë historinë e tij.

Skënderi e dinte gjithçka qysh nga ajo mbasdite e vonë kur, Shpend Guraziu, që kishte shkuar në ndërtësën e teatrit për një kontroll të rrjetit elektrik, fare rastësisht

ishte ndodhur në një nga provat e dramës. Kryqëzimin e parë të syve, dehjen dhe shpërqendrimin e aktoreve dhe fjalët e para që këmbyen tek merrnin së bashku një kafe në pushim. Pastaj fjalët e saj, "do të më përcillni", dhe kapelen që ende e mbante kur dolën. Kapelen e fundit të shekullit, nën të cilën qafa e gruas, me drethkat e buta të flokëve, dukej përherë më e ëmbël. Ishte përherë e dashur, por disi e largët, madje edhe te shkallët e errëta të banesës, kur ai me drojtje në fillim, sikur do ta thyente, ia kapi kryet, aty te drethkat e çelëta, për ta puthur. Dhe ajo, jo vetëm e la ta puthte, por e puthi edhe vetë, madje me afsh, duke ia lidhur duart rrëth qafës. Nuk më besohej, më kuption, Skënder? Aq sa desha t'i them, a e di që unë jam inxhinieri elektrik Shpend Guraziu, që punoj në komunale? Kështu desha t'i them e megjithatë kisha frikë ta zgjoja nga ajo gjendje prej somnambuli. A do të takohemi? i thashë, dhe ajo prapë ashtu e shpërqendruar m'u përgjigj "po, natyrisht". Madje më tregoi dhe orën e përshtatshme, mbasdite midis katrës dhe gjashtës, përpara provave. U puthëm prapë dhe megjithatë mua s'më besohej. Si të kisha në krah një ylber. Dhe parandjenja s'më gaboi.

Ashtu si ylberi ajo i ishte tretur disa ditë më pas, pikërisht kur ai kishte çelësin e apartamentit ku do të takoheshin midis katrës dhe gjashtës. Me një urdhër të papritur nga Ministria e Kulturës shfaqja ishte pezulluar. E murrëtyer, krejt me sy të fryrë nga dënesa, e kishte vështruar gati armiqësisht dhe atij i ishte dukur vetja si njeriu që midis zisë kërkon të zbavitet...

E kuptova dhe nuk i dola më përpara, as në telefon s'e kërkova. Veç çdo ditë kaloj nga afishet e teatrit. Dhe atje përherë shkretëtirë.

Ia kishte thënë të gjitha këto, megjithatë pas çdo rrëfimi ndihej i lehtësuar. E hoqi më në fund shallin dhe një copë herë qëndroi me ballin në duar, i lodhur.

-Më fal që të mërzis me punët e mia. Ti si ke genë? I more radiografitë? Si dole?

-Jo keq, -u përgjigj Skënderi. -Do të bëj ndoshta

edhe një tjetër.

-Edlira ku është ?

-E kanë thirrur në drejtori. Po hartohet, me sa duket, plani i ardhshëm.

-Ti më pyete ç'ka nga Tirana? Hm. Gjëra të trishtueshme, si pérherë. Flitet se nga Kina kanë mbërritur mikrofona të rinj përgjimi, zëtha, siç i quajnë tani.

-Ashtu? Edhe ato mungonin. Megjithëse s'është ndonjë gjë e re.

-Unë mendoj të kundërtën, -tha Shpendi. -Ishim mësuar me frikën nga mikrofonët e vjetër, ata që duhej katër orë të vendoseshin në zyrën ku do të bëhej përgjimi dhe dy orë të hiqeshin, dhe ndërkaq e kishte marrë vesh gjysma e ndërmarrjes. Tani është tjetër gjë. Fjala e fundit e teknikës.

-Më duket se Edlira diçka dinte, por s'guxonte ta thoshte, -tha Skënderi. -Ishte shumë nervoze sot. Ajo që më habit është se si qenka e mundur përhapja e pëshpërimës.

Shpend Guraziu e vështroi një çast hutueshëm. Dukej që mezi përqendrohej në bisedë.

-Pëshpërima? Edhe mua më bëri përshtypje. Por ndofta e kanë lënë vetë të pikojë aty-këtu. Për të shtuar frikën nga e folura.

-Ke të drejtë. Në fund të fundit, mbyllja e gojës është një nga qëllimet kryesore në kësi rastesh.

Shpend Guraziu murmuriti diçka nëpër dhëmbë.

-Frikë e mallkuar. Gjer ku kërkojnë ta çojnë?

-Gjersa të na rrënojnë të gjithëve.

E hapi syzen e tryezës dhe nxori radiografitë. Shpend Guraziu i habitur, po ndiqte me sy sesi tjetri e vuri radiografinë kundër dritës dhe po e këqyrte.

-Skënder, -i tha me zë të ulët- ...Më fal që të dërdëllisa kaq kohë... Po ti më the se kishe dalë mirë.

-Ëhë, -ia bëri tjetri, pa kthyer kryet. E vështronte fletëzën e errët, sikur Shpendi të mos ishte aty. -Kush tha se më ka dalë ke?, -shtoi pa e hequr shikimin prej saj.

S'është nevoja ta thuash. Ndihet që je i shqetësuar.

-Aspak, -u përgjigj Skënderi. -Aspak, Shpend. E shikoj kështu herë pas here për një arsy që ty mund të të duket e çuditshme. Madje e parrokshme... Është mënyra ime për të luftuar frikën.

Shpend Guraziu kishte në fytyrë atë buzëqeshje të ngrirë që shkaktohet prej moskuptimit të gjërave.

-S'të marr vesh, -i tha.

Skënderi ia bëri me dorë të afrohet.

-Eja të shikosh dhe do ta marrësh vesh... E shikon kafkën time? Dhëmbët, zgavrinat e syve, gjithçka të mbështjellë me hijen e vdekjes... Ty mund të të duket çmenduri, por pamja e saj më jep më shumë guxim se radioja e Vatikanit ose BBC-ja në gjuhën shqipe.

Shpend Guraziu tundi kryet një copë herë.

-Ku të paska shkuar mendja, -tha.

Skënderi e tundi fletën e errët gati me zemërim.

-Kjo më bën që sekretari ynë i partisë, mikrofonat apo zëthat, siç i quajti kongresi i tetë apo i nëntë, vetë Sigurimi të më duken si ca pupacë. Natyrisht për aq kohë sa vazhdon ndikimi i saj. Pastaj gjithçka duhet përtëritur.

-Ti je i çuditshëm.

Hyri Edlira dhe si u përshëndet me Shpendin, trazoi një copë herë syzet e tryezës. E gjeti, siç duket, atë që kërkonte dhe doli prapë me ngut.

-Ti je vërtet i çuditshëm, -tha prapë Shpendi.

Sytë e tjetrit e vështruan në atë mënyrë si të bëhej gati t'i thoshte një të fshehtë. Fol, tha me vete, Shpend Guraziu. Por tjetri mëdyshej. Pastaj e uli shikimin te radiografia, që e kishte lënë mbi syprinën e tryezës dhe, si të merrte lejë prej kafkës së vet, e hapi gojën.

Ajo që tha ishte tejet befasuese. Shpend Guraziut iu desh të përqendrohej mundimshëm për ta ndjekur. Tjetri e sillte të folurën për një bisedë që kishin bërë më parë lidhur me ndryshimin midis dy tmerreve: frikës prej shtetit dhe asaj tjetrës, frikës së moçme, parake, prej fantazmave, ferrit dhe vdekjes. Kishin qenë të dy në një mendje se më e shëmtuara e të gjithave ishte frika e shtetit, madje Shpend

Guraziu kishte thënë: Na ka marrë malli për frikën e vjetër, të mirë, atë të fëminisë, kur të ngjethet mishtë nga magjistarët e nga pasqyrat. Kurse Skënderi kishte shtuar se ndoshta kthimi i asaj frike të lashtë do të ishte i dobishëm, ngaqë po të ndesheshin të dyja, si dy shemra, parakja dhe shtetërorja, do ta zbehnin ndoshta njëra-tjetren. Ishte kjo, me sa dukej, arsyeva që shteti përgjonte çdo shteg nga mund të shfaqeji frika e lashtë. Nuk e sheh si bërtasin në çdo mbledhje: misticizëm, dekadentizëm.

Skënderi i rikujtoi në një farë mënyre të gjitha këto, por Shpend Guraziu ende s'e kapte dot se ku donte të dilte. Kishte një pengesë midis të folurës, pastaj ajo u ngjit në sytë dhe aty u bë e padurueshme. Ia kishin ngulur vështrimin njëri-tjetrit dhe Shpendit iu duk se balli i tjetrit po djersitej nga mundimi.

-Shpend, -tha Skënderi, duke vështruar prapë kafkën e vet mbi tryezë, -deshë të të besoja diçka... Ti e di sa tē çmoj, aq më tepër tanë që ti je i dashuruar, si tē thuash i shenjtë... Ti më përmende pak më parë shekullin e XIX... Dhe mallin për frikërat vogëlisë... Ka një mundësi që tē vish në një vend ku ne takohemi me to... ushqehemi... si tē thuash... shërohemë prej tyre...

E folura e tij sa vente bëhej më e turbullt dhe Shpendi, ndonëse nuk donte ta ndërpriste, i tha:

-Nuk tē kuptoj.

Skënderi e vështroi prapë në sy, gjatë dhe mundimshëm. Djersa që Shpendi e kishte pritur te balli i tij, i kishte avulluar vështrimin.

-Po ta besoj, siç tē thashë, një tē fshehtë. Ne, një grup i vogël miqsh, mblidhemi dy ose tri herë në vit në një seancë spiritizmi.

Trandja e Shpend Guraziut ishte më e madhe se ç'e prisnin tē dy.

-Seancë spiritizmi... Është e mundur tē gjendet një stoli e tillë e harruar, këtu ?

Skënderi tundi kryet me gëzim e trishtim përzier. Është e mundur, vëlla, është e mundur, thoshin sytë e tij.

-Seancë spiritizmi mu midis diktaturës së proletariatit. -Zëri i Shpendit ishte i ulët, si të fliste me vete. -Është më se e pabesueshme. Krejt e parrokshme. Dhe unë mund të vij atje?

-Besoj se ata do të pranojnë, -tha Skënderi. -Dhe nuk është larg. Ndoshta në fund të kësaj javë.

-Dhe është me medium, me gjithçka që duhet?

-Me medium, me gjithçka që duhet, -u përgjigj tjetri.

Shpend Guraziut i erdhi t'i binte në gjunjë.

Tjetri, i lodhur vështronte shqyerjet në qiell. Dy vjet më parë, në një ditë të tillë, kishte provuar të njëjtën tronditje kur Nikolla, me të cilin kishin shkuar së bashku në bankën e qytetit për një punë të ndërmarrjes, i kishte pëshpëritur: e shikon atë njeri me kostum të errët, në të majtë të dritarezës? Është një medium.

Nuk kishte dashur të dinte se në ç'rrethana Nikolla e kishte mësuar atë kureshti. Veç dëshira për t'u njojur me mediumin i kishte rënë në kokë në çast, plot ngut, si në dashuri.

Nikolla vetë nuk kishte veç një përshëndetje me tjetrin, ndaj me ditë të tëra kishin vrarë mendjen si ta sillnin punën që të afroheshin me të. Riparimi i ngrohtores së dushit në apartamentin e mediumit e, sidomos, ndërhyrjet për të drejtën e studimit të vajzës i kishin afruar më në fund, gjer atë darkën e paharuar të ditëlindjes së Nikollës, kur Skënderi i kishte pëshpëritur: Zoti Veniamin. Tjetri e kishte vështruar me atë lloj habie që mund të merrej lehtë për përcëmim. Ju më thirrët Zoti Veniamin, apo më bënë veshët? Skënderi kishte zënë ballin me dorë. Mos kujtoni se goja ime e pati lehtë të shqiptonte fjalën e vjetër, të varrosur prej kohësh "zotni"? Nuk ju kuptoj, kishte thënë tjetri ftohtas. Nuk jam provokator, gati sa nuk kishte rënkuar Skënderi. Sikur ta dinit ju se ç'mendim të lartë kemi ne për ju... Fytyra e tjetrit sa vente ngrysej. Kush jeni ju dhe përsë keni një mendim kaq të lartë për mua? Unë s'jam veçse një nëpunës banke.

Ishin në një kënd të apartamentit, përreth ishte zhurmëria e zakonshme e ditëlindjes, çka e bënte të lehtë bisedën. Ju jeni një njeri tepër, tepër i lartë, kishte vazduar Skënderi. Ju drejtova me fjalën "zotni", por do të doja t'ju thërrisja me një cilësim shumë më të epërm, sikur mos m'a merrnit për keq... Imzot... Ah, tani e kuptoja, e kishte ndërprerë tjetri... Ju, me sa kuptoja, jeni në dijeni që unë... Nuk jam shtijekeq, kishte thënë prapë Skënderi. Vëllanë tim do të flijoja për t'ju ruajtur ju.

Gjer pas mesnate, të mënjanuar prej të tjerëve, ata vazduan bisedën, që për një vesh të rastësishëm do të ngjante si çarturi. Skënderi i thoshte se duke qenë një medium, që jepet e merrte me shpirrat, ai ishte këtu, midis kësaj shkretie, i dërguari i një bote tjetër, të epërme. Ai mund t'i ndihmonte ata të njiheshin me frikën e madhe të qiejve. Ata vinin te ai si te shpëtimtari i tyre. Ju lutem, mos na përbuzni, i thoshte pa pushim. Na ndihmoni të çlirohemi nga ankthi i këtushëm. Na lidhni edhe ne me qiejt që i kemi humbur. Mos na braktisni, Imzot.

Tjetri i kujtonte se sa e rrezikshme ishte kjo, jo vetëm për të, por edhe për ta. Një medium mund të zbulonte enigma, që shteti i kishte fshehur me kujdes. Ai kishte thënë se kishte përdorur fjalën "enigma" në vend të fjalës "krime", sepse edhe ai, ndonëse medium, s'ishte i pandjeshëm ndaj frikës shtetërore dhe, ashtu si ata rrekej ta luftonte atë. Ai, pra, mund të zbulonte pa dashur llahtara që s'duheshin dëgjuar nga askush.

Ne e pranojmë flijimin që mund të na kërkohet, kishte thënë Skënderi, duke ngritur dorën lart, drejt qiejve.

Pas një gote tjetër konjaku, mediumi me një zë të butë, krejt të ndryshëm nga i mëparshmi, i kishte rrëfyer se kërkimi i së vërtetës përfatim e dikujt, që e kishte dashur shumë në këtë jetë, ishte fjalë për një grua që nuk rronte më, ishte bërë shkak që një ditë të zbulonte brenda tij prirjen e mediumit. Kishte arritur pra të vihej në lidhje me shpirtin e saj për të mësuar gjëra që do t'ia tregonte veç varrit...

Zëri i Shpend Guraziut e solli në vete.

-Natyrisht, -tha si nëpër gjumë... -Ti e kupton se duhet t'u marr leje të gjithëve, e në radhë të parë atij vetë, mediumit.

-Të kuptoj, -tha Shpendi.

Hyri Edlira me tufën e dosjeve në duar. Te mollëzat kishte një kuqëlim të lehtë.

-Të ngacmuani prapë? -pyeti Skënderi.

Ajo ngriti supet, si për t'i thënë: ç't'i bësh.

4

Me fytyrë të ngrysur Arian Vogli dëgjonte kumtimet e tyre. Ishin vendosur gjer tani njëmbëdhjetë mikrofonë të rinj. Ishin zëvendësuar krejt të vjetërit në Hotel Turizmi, te "vila e pritjes", si dhe në kafenenë ku mblidheshin artistët.

-Këto i di, -e ndërpren shefi ndihmësin. Qenkeni munduar shumë atje te "vila e pritjes", që ka tre muaj ku nuk shkel kush? Dhe në Hotel Turizmi, ku të gjithë punonjësit janë tanët. Pa le pastaj te kafeneja e artistëve, ju e dini ç'keni hequr, nga ora dy e mesnatës gjer më gjashtë të mëngjesit, ku ishit vetë zot e vetë shkëp. Ankth i madh, s'ke ç'i thua.

-S'them se ishte vështirë, -tha ndihmësi. -Por dhe fushë me lule s'mund të thuash. Pastaj a nuk vendosëm bashkarisht që do të fillonim nga më të lehtat, për t'i mësuar disi njerëzit tanë? Vëç kësaj te "vila e pritjes" s'ka pasur edhe aq qetësi. Ju e dini se një dërgatë kanadeze qëndroi dy netë.

-E pastaj?

-Dëgjimi ka qenë i shkëlqyer. Pavarësisht se vjelja ka qenë, si të thuash, pa bukë.

-Vetëm lavdërimë për Shqipërinë?

Tjetri bëri "po" me krye.

-Ju e kuptioni... janë miq marksistë-leninistë.

-Edhe kjo na duhet tani. Të përgjojmë lavdërimet. Ai thartoi fytyrën si të dëgjonte të flitej për prapësinë më të madhe. Ishte njëlloj si të këndoje në varrim e të klithje në dasmë.

-Tjetër, -tha.

Ai e mbajti po atë shprehje të pakënaqur në fytyrë, ndonëse e dinte se ata s'kishin ndonjë faj kushedi çfarë. "Vila e pritjes" vërtet ishte e mërzitshme dhe muaj me radhë jepte veç heshtje dhe egjér, por vinte befas një ditë, që viente sa një mijë, kur ajo jepte flori. Një vit më parë, shi përpura rënies përfundimtare, atje kishte kaluar dy netë, me dreka e darka njëri nga dy zëvendëskryeministrat.

Njëri nga ndihmësit kumtonte për vendosjen e "zëthave" në katër apartamente ndërkaq. Ndërlikim kishte pasur veç në të fundit, kur vendosësit desh ishin kapur me presh në duar, ngaqë e zonja e shtëpisë ishte kthyer befas gjatë orarit zyrtar. Por, sipas udhëzimeve, ata ishin hequr si keqbërës të rëndomtë dhe kishin mundur t'ia mbathnin. Te afishet e teatrit gjithashtu, për herë të parë, ishte vendosur një dëgjues. Dhe vjelja qysh tani ishte më e mirë se ç'pritej. E kishin thënë edhe më parë, përpura afisheve veçanërisht, njerëzit ndjenin nevojë të llëpnin.

Arian Vogli dëgjonte disi i shpërqendruar. Nga një udhëzim që kishte marrë një ditë më parë, ai e dinte se Drejtoria e Përgjithshme nuk do të kënaqej me kësi vogëlimash. Kërkohet ngut.

-Na ka dalë edhe një pengesë e paparashikuar, -tha zëvendësi i tij i parë, Naumi. -Përgjuesit tanë me vesh, kanë nisur të jenë të pakënaqur. E ndiejnë veten të fyter, si të thuash të lënë jashtë vëmendjes. Madje unë mendoj se hapja më shpejt se ç'pritej e së fshehtës së zëthave në

qytet, shpjegohet në radhë të parë prej pakënaqësisë së tyre. Ishin ata që nisën të vjellin vrer të parët.

-Janë të pagdhendur, -ndërhyri oficeri që merrej me ta. -Kam thirrur disa prej tyre për t'ua shpjeguar se s'kishin pse të ndienin smirë për ato vegla, se veshët e tyre do të çmoheshin si pérherë etj.etj., por me ta, ju e dini se sa e vështirë është të kuptohesh.

-Me sa di unë është një çështje që ka dalë gjithandej, -tha Arian Vogli, -kështu që besoj se qendra do të gjejë vetë një zgjidhje. Të kthehemë më mirë te gjërat që varen prej nesh. Qendra është e pakënaqur me ngadalësimin tonë. Nuk dëgjova asgjë për "princat". Qendra kërkonte veçanërisht njoftime për ta. Ai iu drejtua zëvendësit.

-Gjer tani asgjë, -u përgjigj tjetri. -Madje as fratit Nik Prela, me të cilin ramë në një mendje të fillonim, nuk kemi arritur dot t'ia ngjitim.

-Kjo është dëshpëruese, -tha shefi. -Me një shpeshti të tillë neve do na duhen gjashtë muaj, në mos më tepër, për të vënë në veprim gjysmën e tyre. Kurse qendra kërkon që brenda stinës së ftohtë, ata të jenë të gjithë në veprim. Ju e dini, dimri është koha e tyre.

Dalëngadalë, ashtu si në mbledhjen e mëparshme, ata u zhytën prapë në çështjen e "princave". I kishin shkoqitur një për një mundësitë e prapë s'kishin ardhur në kurrrfarë zgjidhje. Ishin trillanë "princat". S'quheshin më kot ashtu. Më lehtë do ta kisha të viaj njëqind zëtha se një princ, kishte thënë në mbledhjen e fundit oficeri që merrej me ta. Dale, dale, e kishin ndërprerë të tjerët. Mos na i përcmo kështu "zëthat" tona. Nganjëherë edhe ato bëjnë mjaltë.

Mirëpo më pas, kur e kishin shqyrtuar bashkërisht çështjen, disa herë kishin thënë: ke të drejtë, për besë, qënka vërtet një punë dreqi.

Sado me rreziqe të dukej venia e zëthave mu në sytë e të zotërve të shtëpisë prej teknikëve të veshur si pastrues tymtarësh, ose hidraulikë, në krahasim me atë të "princave", dukej si lodër fëmijësh. Ata e përsëritnin dhe

e përsëritnin pa pushim parimin kryesor: "princat", për ta kryer rolin e tyre, ndjekjen e viktims hap pas hapi, duhet të ishin në trupin e tij. E meqenëse, me ndonjë përjashtim tepër të rrallë s'mund t'i kallnin në trup, (thuhej se gjermanët kishin mundur t'i futnin brenda dhëmballëve), e vëtmja mundësi mbetej veshja e viktims, kryesisht pambukët e supeve e të gjoksit. Për këtë duhej një kohë e caktuar për të bërë shqepjen, e pastaj mbylljen, qepjen. Këtu kishte një kundërti, sa më e thellë, pra e përsosur të ishte ndërhyrja, aq më e vështirë do të ishte nxjerra e "principit" pas dy javësh. Dilte nevoja që teknikët ose t'i nënshtroheshin një kursi rrobaqepësie, ose të shoqëroheshin prej rrobaqepësve të besuar. Përndryshe kishte rrezik që ta shkalafitnin pallton ose pelicen aq sa të dukej se e kishin shqyer qentë.

E gjithë kjo kërkonte një kusht të domosdoshëm, trupi të mos ishte aty.

Në krye kjo nuk iu ishte dukur ndonjë pengesë kushedi se çfarë. Por kur i panë rastet e mundshme një për një, dilte se s'ishte ashtu.

Mundësia e parë që të kallej "princi" ndërsa viktima flinte, ishte gati e pamundur. Apartamentet ishin të vogla dhe palltoja ose pelicja ndodhej zakonisht dy hapa larg të fjeturit. Darkat apo ditëlindjet, kur palltot hidheshin shuk mbi njëra-tjetrën, krijonin njëfarë rasti, por tepër të rrallë. Sa për mundësinë tjetër, "princëzimin" e palltos a peliqes, në kohën kur ajo qëndronte e varur në shtëpi e viktima kishte dalë, kjo ishte njëlloj si të mihje një vrimë në ujë. Në qoftë se viktima kishte dalë pa të, do të thoshte se moti po ngrohej, dhe të prisje sa të shtrëngonte prapë e ftohta, ose, dhe më keq, të prisje stinën tjetër, kjo do të thoshte që kur ta kërkoje "principi", s'do të gjeje veç një lëvozhgë me pilën e shpenzuar qyshkur, ku shumëshumë do të qenë mbledhur ca gërvima krimbash e ca gërhimanate.

Ata kishin ardhur në një mendje se e vëtmja mënyrë ishte të përfitonin nga koha kur veshjet ishin të hequra përkohësisht. I kishin shqyrtauar një nga një të gjitha rastet:

vizitat mjekësore në spitale ose poliklinika, zyrat ku mund të thirrej viktima për kinse një punë, restorantet, mbledhjet solemne, teatri, koncertet e gjer te banjat publike.

Në krye iu qe dukur se gjithë kjo mizëri, mundësisht, i përfshinte në mos krejt, së paku gjysmën e viktimave. Madje kishin nisur të sajonin listat e përgjithshme të të sëmurëve kronikë: ata që vuanin nga verdhëza, nga mushkëritë, ose që bënин dializën e veshkave. Mirëpo pikërisht aty edhe e kishin patur zhgënjimin e parë. Për habinë e tyre dilte se shumica e viktimave s'kishin kurrrfarë sëmundje. Meqenëse, siç duket, edhe në qytete të tjera paskësh lindur kjo shpresë, në një nga udhëzimet thuhej shprehimi që të mos kërkonin rrugë më të lehta, domethënë, caktimi i viktimave me sëmundje.

Zhgënjimet nga mundësitë e tjera do të ishin edhe më të hidhura. Ishte dukur e lehtë thirrja e viktimës në një zyrë, por shumica e zyrave, me përjashtime të rralla, ishin akull të ftohta, kështu as që mendohej heqja e veshjes së trashë.

-Të gjitha këto ne i kemi biseduar edhe herën tjetër, -tha Arian Vogli me zë të lodhur. -Ashtu siç kemi folur përmundësitë e fundit që mbeten: restorantet, teatri, koncertet. Për të gjitha këto, pengesë kryesore del gjithmonë ftohtësia e mqediseve. Në restorante askush nuk e lë pallton te rrobaroja, e aq më pak në teatër, ku gjysma e fjalëve s'dëgjohen për shkak të teshtimave. Atëherë ç'të bëjmë?

Ata folën prapë njëri pas tjetrit dhe, sa më shumë përpinqeshin të thoshnin diçka të re, aq më fort përsëritnin ato që kishin folur në mbledhjet e mëparshme.

-Atëherë ç'na mbetet të bëjmë? -tha prapë Arian Vogli. -Të lidhim duart?

Ai qëndroi një copë herë me ballin të mbështetur te njëra dorë. Sytë i kishte të kuq nga pagjumësia. -Ju e dini më mirë se unë se s'mund të lidhim duart. Unë e kam vrarë mendjen gjatë dhe kam ardhur në përfundim se e vetmja mundësi e njëmëndtë është teatri. E di se ç'do të më thoni lidhur me ftohtësinë e sallës, por prisni, mos u

ngutni. Përpara se të kthehem te salla e akullt, por rikujoj të tjerat. Nga çdo mjedis tjetër, teatri është më i përsosuri për vendosjen e "princave". E para, se ti e di kohën sa do të vazhdojë shfaqja, kështu që fare gjakftohtësish mund t'i shqepësh, e pastaj t'i qepësh palltot e pelicet, madje ke aq kohë sa të rregullosh edhe ndonjë cen të rrobaqepësit. E dyta, dhe kjo ka shumë rëndësi, viktimat tonë shkojnë zakonisht në teatër. Ju e dini, po aq mirë sa unë, se si shfryjnë ata kur stina teatrale vonon të hapet dhe si vrapojnë pastaj në premierë për të nuhatur prej shfaqjes ndonjë shenjë zbutjeje apo shtrëngimi të shtetit. E treta, se rrobaruajtësit, edhe në qoftë se nuk i kemi të gjithë bashkëpunëtorët tanë, mund ta rregullojmë fare lehtë që të jenë të tillë.

Shefi e ndërprenë të folurën dhe i vështroi të gjithë me radhë, me atë buzëqeshje të veçantë, që ata ia pëlqenin, dhe që kishte në thellësi të saj një pyetje ose një befasim.

-Dhe tani ju mund të më thoni se prapë po kërkojmë kallëza në dëborë? Po akullsira e sallës, po teshtimat, me një fjalë, po ngrohja? E pra, s'ju thashë kot mos u ngutni. E kam menduar edhe këtë. Ngrohjen ne mund ta rregullojmë.

Ai heshti si për t'ju lënë kohë që të shikonin njëritjetrin gjithë habi. Vërtet, si nuk na paska shkuar mendja? Paskësh qenë si veza e Kolombit. Vetëm zëvendësi, Naumi, qëndroi i ngrysur.

-Ti ke diçka, -pyeti shefi.

-Po, -u përgjigj tjetri. -Jam në një mendje me ju për gjithçka parashtuat këtu. Jam, gjithashtu, në një mendje se ngrohja e teatrit mund të rregullohet, aq më tepër që gjithë ngrohtoret e pajisjet janë në vend. Por ju e dini se, kohët e fundit, në teatrin e qytetit ka pasur ndërlikime.

-E di fare mirë, -u përgjigj Arian Vogli. -Ashtu siç e di që një pjesë e shfryrjeve na vijnë nga aktorët për shkak të pezullimit të premierës së fundit.

Zëvendësi hapi krahët si për të thënë: e po, atëherë?

-Megjithatë s'më duket dramatike, -tha shefi. Një copë herë i ra me gishta tryezës, pastaj zgjati dorën te telefoni. -Alo, drejtoria e teatrit?

Të tjerët shikonin njëri-tjetrit. Nganjëherë shefit i zgjоhej delli i lojës dhe këtë herë trilli ishte krejt i përligjur, përderisa kishte të bënte me teatrin. Keni kokëçarje të mëdha? E marr me mend. Kam dëgjuar se teatrin e keni akull të ftohtë. Si? Paskeni probleme më të rënda se e ftohta? E ku mund të ketë më keq se një teatër i ngrirë? Ah, ashtu? Si? Jua paskan pezulluar pjesën? Kurse unë sapo doja t'ju pyesja se me ç'premierë do na gjëzoni këtë stinë. Po kur, kështu? Ah, paska një javë. Si? Nga Ministria e Kulturës? Më vjen keq vërtet. Mbrëmë gruaja më tha: ka kaq kohë që s'kemi qenë në teatër. Por, siç i thonë fjalës: kur gjen miell i varfëri, djalli i merr thesin. Po nesje, ndoshta s'është një gjë e prerë. Ju thatë pezullim, apo jo? Le të shpresojmë për më të mirën.

Ai e vuri dorezën në vend dhe të gjithë pritën që t'ia shkrepte të qeshurës. Por ai qëndroi mendueshëm.

-Mund të bëhet diçka për ta lejuar pjesën? -pyeti zëvendësi.

-Atë po vrash mendjen, -u përgjigj shefi. -Nga udhëzimi i djeshëm kuptova se rëndësia që i jepet kësaj pune, sidomos vendosja e "princave" është shumë më e madhe se ajo që mendojmë ne. Kështu që kam shpresë që...

Ai e ngriti prapë dëgjuesen. Alo? Unë jam prapë. Desha të di e kujt është ajo drama që u pezullua? Klasike? Ah, kujtova se është e sotme. Hm. Edhe unë ashtu mendoj: kokëçarjet vijnë zakonisht nga të sotmet. Po, po...

Nga ana tjetër e fillit ndihej që bashkëbiseduesi fliste pa pushim. Arian Vogli nuk thoshte veçse "po, ju kuptoj", ose "ju kuptoj fare mirë". Ai i përmbyllte herë pas here sytë nga lodhja. Në këtë pikë mendoj si ju, shoku drejtor. Ne? Ju e dini se nuk përzihemi në kësi punësh. E vetmja gjë që hyn në punën tonë është shhangia e pakënaqësisë. Pikërisht, pikërisht. Mërzi të panevojshme. Që e zymtojnë jetën. Jam plotësisht në një mendje me ju. Në fund të fundit, të gjithë punojmë për të njëjtin qëllim.

Ai buzëqeshi vetëm kur e vuri dëgjuesen në vend.

-Drama qenka "Pulëbardha" e Çehovit, - tha me zë

të ulët. Një dramë dashurie, me sa më kujtohet nga fakulteti. Asnjë ngjasim me kohën. Veç në qoftë se pengesa ka lindur nga që autori është rus. Me sa di unë, klasikët rusë vazhdojnë të botohen. Ai mori frymë thellë: -Mendoj të nisem vetë në Tiranë. Kjo punë duhet biseduar me ministrin. Desha të them, ministrin tonë, jo të kulturës. Katër-pesë shfaqje na mjaftojnë për të mbaruar punë. Pastaj, e ndalojmë përsëri. Kohë për të ndaluar një dramë ka gjithmonë.

Ai i vështroi me radhë për të kuptuar ç'mendonin. Por fytyrat e tyre iu dukën të mekura. Katër-pesë shfaqje... dhe të gjithë pëllumbat bien në grackë, mendoi.

-Si thoni? -pyeti më në fund.

Përgjigjet e tyre ishin të drojtura, siç ndodhët sa herë që binte fjala për punë arti.

-Unë kam besim se kjo punë rregullohet, -tha Arian Vogli. -Aq më tepër që s'kenka veç një dramë dashurie. Për një pulëbardhë, domethënë femër të plagosur në shpirt...

Ai u ngrit nga vendi dhe nisi të vërtitej në dhomë, siç bënte sa herë që ndizej nga diçka.

-Na duhet kjo dramë, pa tjetër, më kuptioni? Hamleti e ka thënë mirë: drama është gracka ku krejt qyteti kapet si laraska.

Si përherë kur përmendte thënie të tilla, ai spikati te një pjesë adhurimin e te tjetra smirën.

Ishte vonë kur e mbylli mbledhjen. Dolën të gjithë veç ndihmësit që, si zakonisht, ikte i fundit.

-Dëgjo, -i tha Arian Vogli, ndërsa mbyllte syzet e tryezës. -Pas një javë, e shumta dy, vjen këtu një dërgatë franceze për një vizitë dyditore. Merr masat që në pallton e shoqërueshit të vendosësh një "princ". Është një rast i rrallë që s'duhet humbur.

-Po francezët?

-Me ta merret qendra. Ne na përket shoqëruesi i këtushëm, i yni. Mësoje sa më parë kush do të jetë dhe pastaj vepro.

-Si urdhëron.

-Edhe diçka tjetër... Sapo të krijohet rasti, mos

A

harro të vendosësh një zëth në apartamentin e inxhinier Bardh Gjikondit... Në krevatin bashkëshortor... Flitet se e shoqja e tij, në çastet e ndezjes, thotë gjëra befasuese.

-Si urdhëron, shef.

-E pra, natën e mirë atëherë. Thuaji shoferit tim të mos më presë. Do të kthehem më këmbë.

-Është kohë e keqe, -tha ndihmësi.

Tjetri bëri sikur nuk e dëgjoi.

Spirukus

5

Si pérherë, në sheshin e Republikës era të priste. Ndriçuesit e rrallë, pér shkak të pjalmit, dukeshin sikur lëkundeshin pikëllueshëm.

Shpend Guraziu ngriti qafëzën e palltos, ndonëse e dinte se drithërima i vinte nga tjetër gjë.

Në trotuarin tjetër dalloi një njeri me pallto të zezë. Ekte vetmueshëm në shi, me qafëzën e ngritur, njëlloj si ai. Kështu ikim të gjithë, secili në fat të vet, mendoi. Një zhurmë e butë rrotash e bëri të kthejë kryet. Një "Gaz 69", me drita gjysmë të fikura lëvizte ngadalë në rrugë. Nën ndriçimin e kuq të llampave të sprasme, pjalmi ngjante si në ethe.

Shpend Guraziut iu duk se "Gazi" po ndiqte njeriun e trotuarit. Që kur kishin filluar të përgjonin kaq haptas?

Për çudi, nuk e ndjeu ankthin e zakonshëm në kësi rastesh. Me sa dukej, seanca e spiritizmit ku po shkonte, rrezatonte ndërkaq mbrojtjen e saj.

Te udhëkryqi tjetër "Gazi" iu afroa edhe më shumë

të panjohurit. Madje ca çaste eci përbri tij. Zot i madh, mendoi Shpendi. Mos do të shikonte me sy ndonjë arrestim? S'i kishte qëlluar kurrë.

Ngadalësoi hapat për të parë ç'do të ndodhët. U duk se njeriu me pallto të zezë, e ndjeu më në fund praninë e makinës. Por as rendi me vrap, siç mendoi Shpendi, as bëri ndonjë lëvizje tjetër.

Pa shih, pa shih, tha me vete, kur pa se i panjohuri, jo vetëm s'u tremb, por i bëri një shenjë makinës. Me sa dukej, të dy bashkë, njeriu dhe makina ndiqnin një të tretë.

Ai ktheu kryet pas. Pastaj anash. Rruga, si më parë, ishte e shkretë. Veç në qoftëse më ndjekin mua, mendoi. Por pa kurrfarë tmerri. Mendimi se ai po shkonte në takimin me një shpirt, i dha prapë qetësi. Sidoqoftë atë s'e ndiqnin dot kurrë, mendoi me vete.

Shpejtoi prapë hapat, pa e ditur as vetë përse. "Gazi" u shkëput befas nga njeriu dhe u largua me shpejtësi.

Shpendi ndoqi një copë herë me sy dritëzat e kuqe të sprasme, që pjalmi, duke i shtrajtuar, i bënte të dukeshin sikur kullonin përgjakshëm sipër asfaltit.

Kur ato u tretën, ktheu sytë prapë nga i panjohuri. Ishte vetëm disa hapa përpëra tij, në trotuarin tjetër. Një çast, kur drita i ra anash fytyrës, iu duk se njoju shefin e Sigurimit të rrethit. Ah, ja si qenkësh puna, mendoi. Të lodhur nga puna shokët po ktheheshin në shtëpi. Nën shushurimën e shiut, si gjithë njerëzit me ndjenja të kësaj bote...

Secili në punë të yet, mendoi rishtaz. Ai, Shpend Guraziu, inxhinier ndërtimi, diplomuar në Universitetin e Tiranës, me përfundime të shkëlqyera, zotëruar i dy gjuhëve të huaja, dy herë përfaqësues i qytetit B. në kongresin kombëtar të përparimit teknik, anëtar i kolegjumit të revistës "Shkenca e ndërtimit", po shkonte në mbledhjen më të pabesueshme të ndoshta krejt kampit socialist, në një seancë spiritizmi.

Shpina e njeriut me pallto të zezë sa vinte zvogëlohej.

Kështu do të dilte ndoshta dalngadalë ngajeta e tij. Ai me gjithë dosjet e tij të fshehta, përgjimet, misteret e vockëla, si prej pupacësh: ç'dinin për të, çfarë nuk dinin, ç'dyshonin.

Po shkonte drejt njërsës prej mbledhjeve më të ndaluara në këtë botë. Kryepërgjuesi i qytetit lëvizte nëpër të njëjtën rrugë, e megjithatë drithërima në shpirt nuk i vinte prej tij.

Një valë dehjeje e kapulloi befas. Ai kishte ndërkaq, misterin e tij. Që lidhej me një botë të epërme, të parrokshme prej tyre. Fuqia e tyre mbaronte aty. Kështu i kishte ndodhur në rininë e hershme, kur në ëndërr shihte se fluturonte, ndërsa forca e keqe, që e ndiqte, mbetej poshtë. Të hutuar, ata do të ngeleshin te zgripi i humnerës.

Mirënjojha për Skënderin dhe Nikollën po ia zbutë parzmin. Kishin qenë të parët që e kishin afruar, kur një vit më parë, një ditë marsi kishte mbërritur në qytetin e mërzitshëm provincial, me çantën e udhëtimit në dorë, i hutuar si gjithë të ardhurit nga kryeqyteti për të qenë "midis baltës", plot dyshime nëse arsyaja e qarkullimit ishte vërtet ai parim qesharak i njohjes së popullit, apo një tjetër shkak i fshehtë dhe tinzar, që ai s'do ta mësonte kurrë. Kur kishin marrë vesh se s'kishte kurrkënd në këtë botë, ishin treguar edhe më të ngrohtë me të. Ftesat për darkë, loja me letra gjer në mesnatë, mahitet e të folurat me dy kuptime ishin bërë gëzimi i vetëm i mbrëmjeve të tij. Dhe, si të mos mjaftonin ato, befas fjalët e Skënderit "ti je i dashruar, domethënë i shenjtë", dhe pastaj kulmi, ftesa e jashtëzakonshme për "atje".

Unë shkoj në një seancë spiritizmi, përsëriste me vete, ngaqë i dukej se kuptimi i vërtetë i asaj që po bënte ende nuk kishte mbërritur i plotë në ndërgjegjen e tij. Në këtë jetë të tharë si një hithërishtë, plot mbledhje të mërzitshme, fjalime, duartrokite, parulla të zbrazëta: të shkojmë duarplot drejt kongresit të shtatë, drejt plenumit të katërt, drejt ditëlindjes, drejt së ardhmes, ai po shkonte në takimin me një shpirt.

E kishin humbur prej kohësh qielin e nuk ishin të

vetëdijshëm, mendoi. Çdo ditë po mësoheshin me shkretëtirën, gjersa të vinte një kohë që t'u dukej sejeta ishte veç ajo e tjetër s'kishte. Kurse fati ia kishte ruajtur atij një dalje shpëtimi, shtegun drejt qiellit. Mendimi se po e rifitonë zonën e tretur, e dehte përherë e më marramendshëm.

Shpendi i ngjiti dy e nga dy shkallët e ndriçuara dobët nga një llambë e katit të tretë. Qëndroi ca çaste te dera e apartamentit, shkoi dorën në flokë, shkundi hijezën, pastaj si u mbush me frymë, i ra ziles.

Ishin të gjithë atje: Skënderi, Nikolla, të zotët e shtëpisë, një grua tjetër me fytyrë të mekur, me rrudha nga ato që krijohen prej mërzisë luksoze, një burrë i panjohur. Shpendi tha "mirëmbërëma" dhe përshëndeti me krye, por nuk dinte në duhej t'i takonte një për një dhe të thoshte emrin. Për fat, Skënderi i bëri shenjë duke i treguar një ndenjëse përbri tij. Kur Shpendi u ul, tjetri mbylli sytë përgjysmë për t'i thënë: çdo gjë shkon mirë.

Dhoma ishte e zakonshme, ashtu si mijëra dhomat e ndenjes nëpër apartamente. Një nim, prodhim i hershëm i "Misto Mames", i pandryshuar prej dhjetë vjetësh, ndenjëse të buta, të së njëjtës ndërmarrje, biblioteka me flegra qelqi, në qendër të së cilës ishin katër vëllimet e para të veprave të plota të udhëheqësit. Napat në dritare, të bardha. Asnjë shenjë e asaj që pritej.

-Dëshironi të pini diçka? -pyeti gruaja që i hapi derën.

E folura, që siç duket, ishte ndërprerë pas ardhjes së tij, kishte rinisur. Por ajo ishte e rrallë dhe me zë të ulët, si në një ngushëllim. Si të dëgjonte shenjën e largët, ai kapi fjalën "zonjë", që burri i panjohur ia drejtoi njërsë prej grave.

-Po presim mediumin, -i pëshpëriti Skënderi. -Zakonisht vjen i fundit.

Shpendi nuk guxonë të pyeste për asgjë. Kishte vetëm një dëshirë, t'u thoshte faleminderit e njëkohësisht t'u kërkonte ndjesë të gjithëve. Dyshimi se mos mediumi nuk vinte i kalonte nëpër mend, por ai ishte i turbullt si

gjithçka tjetër në trurin e tij.

Kur zilja ra, nga mënyra si i tendosën qafat e tyre, Shpendi kuptoi se edhe ata kishin patur të njëjtin dyshim.

Mediumi bëri një përshëndetje me krye. Pastaj pa shikuar kërkënd tha: ç'murlan!

Një copë herë vazhdoi po ajo e folur, dy nga dy, që vazhdimisht i largohej qendrës së dhomës, për t'u strehuar anëve. Shpendi e kishte humbur përfthimin e kohës. Kishte çaste që i dukej se ata e kishin harruar përse ishin aty, ose dhe më keq, kishin kthyer mendjen e nuk do ta bënin seancën.

Kur e zonja e shtëpisë tërhoqi njérën nga perdet, (qelqet e dritareve plot rrëkeza uji nuk do t'i lejonin as përgjuesit më të zotë, madje të pajisur me tejqyrë, të dallonin ftyrat e tyre), pra kur napat u tërhoqën, e sidomos kur dy shandanë bronzi, me qirinj përsipër, u vendosën mbi tryezë, Shpendi, bashkë me ankthin që s'i ndahej, ndjeu prapë dehjen e njohur. Me shandanë, me qirinj, mendoi. Palltua e zezë e shefit të Sigurimit, lagej, ndoshta, ende në shi. Mbylli të gjitha shtigjet e kufirit, mendoi, përgjoi telefonat dhe zërat, atë nuk e kap dot.

Mediumi bëri një shenjë me krye nga llampa e ndriçimit. Tani, tha i zoti i shtëpisë. Natyrisht.

Ai theu disa fije shkrepëse, gjersa, me duart që i dridheshin, i ndezi qirinjtë. Tani do t'i prishim siguresat, për arsy që merren me mend, tha me zë të dobët, duke vështuar Shpendin, të vetmin, me sa dukej, që ishte rishtar. Me zë fare të ulët, Skënderi po i shpjegonte se prej kohësh i merrnin kështu të gjitha masat, që në rast shpërthimi të beftë të policisë, të përligjinin ndezjen e qirinjeve.

Errësira pllakosi vrazhdësisht, gati-gati si një goditje, gjersa diku në qendrën e saj, diçka nga drita e humbur u kthye përsëri. Por ajo ishte e huaj, e drojtur dhe krejtësisht tjetër farësh. S'kishte asgjë të përbashkët me ndriçimin e pakmëparshëm, atë që lëshonin bashkërisht hidrocentralet "Marks" dhe "Engels" të veriut, termocentrali i Fierit, centrali "Lenin" i kryeqytetit, dhjetëra centralet e tjera,

bashkë me mitingjet e përvimeve dhe anëtarët e qeverisë që pritnin shiritin, dhe lulet dhe zërin e mallëngjyer të gazetarit të TV.

Flakëza e qirinjve luhatej e zbehtë, si të trembej.
Ne nuk donim të fyenim dritën tuaj, zoti hetues, mendoi
Shpend Guraziu. Me dritën tonë të vjetër, të kryehershme,
ne kërkuam të zbutnim shpirrat tanë. Dhe kaq. Asgjë më shumë.

Rreth tij ai dëgjoi prapë të folurën e ulët, dhe fjalët "Zonja Greblleshi", "Zoti Rokaj". Po flisnin, me sa dukej, për shpirtin e atij që do të thërrisin, por Shpendi ishte kaq i tronditur saqë nuk përqendrohej dot. Kapi vetëm fjalët "dorëshkrimet e zhdukura", që ndoshta kishin lidhje me të vdekurin. Kuptoi gjithashtu se ishte hera e dytë që po e thërrisin, ngaqë në të parën s'kishin mësuar dot atë që donin.

-Jeni gati? -tha mediumi.

Zërin e kishte të ngrohtë, burrëror, të tillë që as i dëmtonte e as dëmtohej prej flokëve të dendura. -Dhe tani përqendrohuni sa më fort tek ai që duhet të vijë. Dhe gjithsesi, mos më ndërprisni.

Ai i uli sytë te flakëza e qirinjve dhe frymëmarrja iu rëndua. Të tjerët, me sa dukej, bënë të njëjtën gjë. Shpendit i vinte diçka e ngjashme me të qarët, por që nuk ishte ashtu. Ai u drodh kur dëgjoi zërin e mediumit. S'ngjante fare me të mëparshmin. Kishte një tretje në të, një si lëmim të frikshëm. Adrian, ti je aty. Folju të dashurve të tu. Ata të kërkojnë ndjesë që të shqetësojnë në një natë të tillë... Ata duan një shenjë prej teje... I kam dhënë shenjat... Mblidhuni, unë tani shoh mirë. Ç'të ndodhi në trembëdhjetë maj?... Mos më pyesni... Mos më pyesni sidomos për atë natë... Është gjithmonë herët, ose tepër vonë... Është tjetër gjë... Është ndryshe... E dorëshkrimet?... Oh, jo... Fjalë pa kuptim... Ka vetëm mbeturina... Të një dore... Asgjë më... E ndiej që shpejton. A s'mund të rrish dhe pak?...

-Iku.

Shpend Guraziu u drodh. Zëri i mediumit kishte ndryshuar prapë.

-Çfarë? -pyeti njëra nga gratë.

Mediumi vështroi ngultazi.

-Unë s'di asgjë. Ju, a nuk dëgjuat?

-Dëgjuam që e pyetët për natën e trembëdhjetë majit dhe përgjigjen e tij. Por ajo ishte e turbullt.

-Unë s'di asgjë, -përsëriti mediumi. -S'mbaj mend asgjë.

I lodhur, ai i vështroi rradhazi me vështrim qortues, që dukej sikur iu thoshte: sa herë duhet t'ua shpjegoj se ai që dëgjuat nuk ishte zëri im, por zëri i atij që foli nëpërmjet meje.

Shpendi e dinte ndërkaq. Ishte e para gjë që kishte mësuar për spiritizmin.

E zonja e shtëpisë shkoi në kuzhinë për të përgatitur kafetë. Sa mirë që askush nuk po kujtohej të rindreqte siguresat, mendoi Shpendi. Do të ishte i padurueshëm rikthimi i dritës së hidrocentraleve.

E zonja e shtëpisë i solli kafetë. Fytyra e mediumit ishte ende e zbehtë. Dora që mbante kupën i dridhej pak.

Biseda vazhdonte me zë të ulët, si më parë, nën dritën e qirinjeve. Shpendi dëgjoi disa herë fjalën "dorëshkrimet", që shoqërohej zakonisht nga një pshërëtimë e gjatë.

Ata dolën njëri pas tjetrit, ashtu siç, me sa dukej, kishin ardhur. Jashtë shqota ishte qetësuar. Frynte veç erë e acartë dhe Shpend Guraziu e ngriti prapë qafëzën e palltos.

Përpara teatrit ndali hapat. Tek vendi i afishevë s'kishte asgjë. Ngaqë afishet e shqitura kishin lënë rrupa e copëza, ai afroi fytyrën për të dalluar ndonjë emër aktori apo ndonjë orar. Në të vërtetë, si përherë kërkoi emrin e Suzanës. Por në atë përqartje të sajuar prej ngjitjeve e mbingjitjeve, s'kuptohej asgjë.

Një valë malli për të e përmbyti papritur. Veç ajo ishte e ndryshme nga herët e tjera. Kishte diçka më shumë, e njëkohësisht, diçka më pak. Takimi me shpirtin, mendoi. Ndoshta këndeje tutje gjithçka në jetë do të pësonte ndryshim për shkak të tij.

Dhoma ku banonte ishte e ftohtë. E ndezi ngrohësen elektrike që e kishte sajuar vetë, pastaj një copë herë qëndroi përpara copës së prerë të gazetës ngjitur në mur, sipër shtratit. Ishte fotografia e Suzanës, krejt e qeshur, nën shkronjat e mëdha: "Së shpejti "Pulëbardha" e Çehovit në qytetin tonë. Suzana Kraja në rolin kryesor. Intervistë me aktoren".

Vala e mallit, me atë gjësend të panjohur midis, e mbyti përsëri. Ishte si një mjegull tretëse, që kërkonte të fshinte diçka, atë vetë ndoshta, ose Suzanën, ose të dy.

Për të njëqindën, për të njëmijtën herë e përfytyroi hyrjen e saj në dhomën e ftohtë. Përqafimin e heshtur, pastaj fjalët që ai do të përpinqej të mos ia thoshte: përsë më dukesh si somnambul? Zhveshja, trupi i bardhë dhe flokët e saj sipër nënkesës, renditeshin gati njëkohësisht në mendjen e tij. Një zotërim i dytë, midis gjumit, që kishte pak gjasë të ndodhte për shkak të kohës së pamjaftueshme, e tërhiqte më fort. Kurse zotërimi i parë i ikte.

S'ishte vetëm ai që i shpëtonte. Qysh në fillim midis tyre kishte patur pérherë diçka që bëhej fir. S'je ti, i kishte thënë ajo, fill pas puthjes së parë, te shkallët e errëta të apartamentit. Kur ai e kishte pyetur ç'ishte kjo "s'je ti", ajo i kishte thënë "e kam vështirë ta shpjegoj". Ai e kishte puthur prapë dhe me zë të ëmbël ia kishte kërkuar shpjegimin. Ai ishte i turbullt. Më gjete në një çast dobësimi, kishte thënë ajo. Acarim me të shoqin? Oh, jo, përkundrazi.

Me shumë vështirësi ai kishte kapur diçka. Ishte drama e Çehovit që e kishte dehur krejt. Miratimi ishte dhënë me aq vështirësi. Ndaj ajo notonte si në erë. Dhe ai po përfitonë nga kjo. Ajo mund të fluturonte, madje

mund të vritej lehtë... Si pulëbardha, kishte menduar ai më pas.

Ndaj je kështu, e papërqendruar, sa që më vjen të të shkund për supesh, të të them, zgjohu, së paku ji e ndërgjegjshme se me kë po përqafohesh.

Ajo kishte qeshur. Dhe kur qeshte, era e mirë e flokëve i ndihej më fort. Por edhe ti se si më dukesh, i kishte thënë ajo. Si? Folë, të lutem. Po ja, me këtë emër, Shpend, që kujtoja se nuk vihej më. Kujtoja se ishte vetëm në romanet e viteve 30-të. Tani do të iki, u bë vonë. Më merr në telefon në teatër. Prit të të përqafoj edhe një herë, i kishte thënë ai. Kurse ajo: Po, u bë vonë, shpirt. Më kupto.

Sikur të mos ishte fjala "shpirt", si e nxjerrë nga histori të vjetra dashurie, nga ato që përfundonin zakonisht me ndarje të gjata, ose sëmundje turbekulozi, dhe me dy selvi të rritura më pas mbi varrin e secilit, e gjithë kjo atij do t'i ishte dukur më pas një trill aktoreje.

Në telefon, dy-tri herë që kishte arritur ta kapte, kishte po atë shpërqendrim që ai s'e duronte dot më. Gjer ditën, kur në vend të së qeshurës, kishte dëgjuar dënesën e saj të rëndë, të pashpresë. Ishte si një përmbytje pa anë e pa fund. Baltë dhe dëshpërimi i zi. Ai përpiquej ta ngushëllonte, kurse ajo veç përsëriste: jo, jo, mbaroi gjithçka.

Kurrë s'e kishte menduar se ai, inxhinier ndërtimi, do të përjetonte dhembjen e pezullimit të një drame më fort, ndoshta se njerëzit e teatrit.

U bë vonë, shpirt... Qelqet e dritares ishin të ftohtë. Ai u përpoq të vështronte qiellin. Mendja i shkoi prapë te Suzana, pastaj te duart e mediumit që dridheshin tek mbanin kupën e kafesë. Një grimë iu duk se flakëza e qirinjve dhe paqëndrueshmëria e gruas ishin të një fare. Dhe midis tyre dhe shpirtit që kishte ikur nëpër qiellin e zi, kishte pa dyshim një lidhje.

Atyre s'ke ç'u bën, tha me vete. Fjalët ia kishte drejtuar njeriut me pallto të zezë. Tokën mund ta bësh si të duash, socialiste, komuniste ndoshta. Po qellit s'keç'i bën.

6

Në mëngjesin e së premtes, porsa zbriti nga makina dhe kapërceu portën e hekurt, Arian Vogli e ndjeu se "vjetra" e parë kishte mbërritur. S'dinte as vetë ku e nuhati për herë të parë, te vendi i oficerit të rojës, nëpër shkallët ku u kryqëzua me dy- tre vartës apo te heshtja e veçantë e mesoreve. Ndërtesa krejt ngjante si e mbushur me shpirtra.

I ulur në ndenjësen pas tryezës e priti me një si buzëqeshje të largët, të ndryshme nga herët e tjera, ndihmësin e vet.

-Shoku shef, -tha ai me zë të ulët. -Sot, që pa gdhirë...

-E di, -e ndërpren Arian Vogli. -M'i sillni menjëherë.

Me mallëngjim, gati-gati me një ndjesi mëshire, i pa ato sende të vogla brenda të cilave ishin fijet e shiritave magnetikë me të cilët ishte mbështjellë këndeja e tutje fati i tij. E kishte përfytyruar disa herë trazimin shpirtëror të paraardhësit të vet katundar, kur dymbëdhjetë apo pesëmbëdhjetë vite më parë i kishin sjellë përgjimet e para, zërat njerëzorë

të huaj, të frikshëm, të mbështjellë si me maska.

Ndonëse i shkolluar e i njojur tashmë me kësi punësh, ndihej po aq i tronditur sa ai. Ushtria e re e veglave dëgjuese ngjante me gjerdallat e vjetra, aq sa mund të ngjasonin pushkët me strall në muzeun historik me armët moderne. Veshët e shtetit, të rinuar si pas një ndërhyrjeje kirurgjikale dëgjonin dhjetë herë, njëzetë herë më shumë se të moçmit. Dhe veç kësaj, e gjithë ajo veglëri ishte mbjelle e gjitha prej tij.

Ja ku ishin rresht ato të parahomës së zyrës së strehimit, të rradhës së qumështit, të sallës së provave të teatrit, të apartamenteve të lagjes Nr.3, të bërrarisë "Qendra", të barit "Liria", të zyrave të Arkës së Kursimit, ku ndaheshin pensionet. Dhe të mendoje se një pjesë ende nuk ishin vjelur. Se "princat", pjesa më e zgjedhur e kësaj aradheje, ende nuk ishin futur në veprim. Arian Vogli ndjeu valët e një përndezjeje që herë të ngrrohta, herë të akullta ia përmbytnin gjoksin.

Gjatë një dëgjimi të shkurtër, aty-këtu, sa për të parë cilësinë e regjistrimit, ndihmësi që i kishte sjellë, gati-gati ndihej fajtor për heshtjet e gjata që mbushnin pjesën më të madhe të shiritave. Zhurma qyteti, bori të largëta kamionësh, kërcitje dyersh dhe veç ca fraza të rralla pa kurrfarë interesni vinin njëra pas tjetrës. I qetë, gati buzëqeshës, Arian Vogli vërente padurimin e ndihmësit për të rënë në ndonjë "copë të mirë". Ishin përgatitur të mos zhgënjejeshin kurrsesi nga ajo lëndë e papërpunuar, që i ngjante një mase balte dhe gurësh prej sitjes të së cilave do të nxirrej minerali i çmuar. E ky i fundit do të sitej prapë e prapë gjersa të jepte një grusht smeraldesh. Ndryshe nga paraardhësit e tyre, i dinin të gjitha këto, megjithatë kjo s'e pengonte ndihmësin të shfrynte nëpër dhëmbë, gjersa shefi i bëri shenjë ta ndërpriste dëgjimin.

-Mjaft Naum. E di si është kjo? Si ai peshku apo rosa që, në restorantet e shtrenjtë, ia tregojnë darkëtarit përpëra se t'ia gatuajnë. Dhe tanë, o burra, shkonit ta përpunoni lëndën. Besoj, pas dy-tri orësh, do të dëgjojmë

diçka.

Pas daljes së tyre, Arian Vogli, në vend që të ulej në tryezë, nisi t'i bjerë zyrës poshtë e lart. Nuk përqendrohej dot. Në krejt ndërtesën e madhe trikatëshe zotëronte po ajo atmosferë e veçantë e mëngjesit. Në mesoret, njerëzit jo vetëm që flisnin me zë më të ulët, por në sytë e tyre dukej se diçka ishte zhvendosur. Arian Voglit iu duk se kështu duhej të ishin, ndoshta, të kremitet në kishat ku ata s'kishin qenë kurrë.

Pas dy orësh, kur ata erdhën prapë, në fytyrat e tyre ngazëllimi dhe hija e rëndë ishin përzier si rrallë herë. Në çastin kur aparati i dëgjimit u hap, dora e Arian Voglit e kërkoi paketën e cigareve me ngut. Të tjerët, gjithashtu, ndezën cigaret, thua se zhaurima njerëzore dëgjohej më mirë ashtu, midis tymtajës. Për një orë rresht qëndruan të heshtur, me sy gjysmë të myllur, duke u përpjekur të mos u shpëtonte asgjë. Ishte aty gjithë pëshpërima e zezë, të cilën ata e njihnin tashmë, veç shumë herë më e fuqishme. Sharje të hapura kundër shtetit, ankesa për skamjen, për ndalimin e fesë, prerjen e dritave, helm kundër Sigurimit, shfryrje nëpër dhëmbë, mahi, tallje të hidhura.

Fytyra e shefit sa vente zymtohej. Ishte aty gjithçka, grindje bashkëshortore, sëmundjet, muzika e vallëzimit në ditëlindjet, pëshpërima të ëmbla, korbi që aq shumë pritej të shfaqej...

Ishte hera e parë që shefi bëri shenjë të rikthehej shiriti për ta dëgjuar edhe një herë atë pjesë. E dëgjoi dy herë bisedën ku flitej pér një korb, ndërsa ata e vështronin me atë adhurim të veçantë që shfaqej sa herë ishte fjala pér gjëra të fshehta, që mund t'i dinte vetëm ai si shef.

Në të vërtetë pér punën e korbit s'dinte asgjë më shumë se ata. Kishte veç një udhëzim të veçantë: sa herë të binin në gjurmë të ndonjë bisedë, mahije, ose thjesht proverbi pér "korbin e verbër", të tregonin syçeltësinë më të madhe. Të fshehta të qendrës, mendoi. Asnjë qendër nuk mund të mendohej pa to.

Një rënkim femre ia mbajti frymën. Por nuk ishte

ajo... Ndihmësi, me pamje fajtori, bëhej gati të përgjiigjet për përzgjedhjen e atij rasti, por fytyra e shefit mbeti mospërfillëse. Kishte dhënë udhëzim të veçantë të mos bënин shpërdorime me shtretërit bashkëshortorë, siç kishte ndodhur shpesh në të kaluarën, kur gjurmët e masturbimit mbeteshin poshtë ndenjësve, gjatë seancave të dëgjimit.

Përgjuesi në apartamentin e Edlirës, ende nuk ishte vënë, por ai i kishte dhënë të kuptonte ndihmësit se do të merrej vetë me të. Një ndjenjë e ngrohtë, me një si thikë në mes, e mbështillte sa herë i shkonte mendja atje. Do të vij një natë, pëllumbeshë, përsëriti me vete fjalët e një këngë. Të të dëgjoj, të të puth e të shkoj...

-Ky është shiriti i fundit, -tha ndihmësi.

Sapo u dëgjuan fjalët e para, shefi e kuptoi se ajo pjesë ishte lënë në fund me qëllim. Balli iu vrugua nga rrudhat më fort se më parë. Ja, ky është përgjimi i vërtetë, mendoi. Ishin përgojimet e anëtarëve të Byrosë Politike dhe të vetë doktrinës. Më të hidhat e të gjithave. Më të rrezikshmet.

Sytë e shefit u takuan një grimë me ata të ndihmësit. Shprehja ngazëlluese e pakmëparshme në fytyrën e tij ia kishte lënë vendin një hutimi, krejt si njeriut që, papritur, bëhet i ndergjegjshëm për procën që ka kryer. Vështrimi i tij, bashkë me një kërkim ndjese, dukej se kishte shenjën e parë të kundërshtimit: a do të bëjmë përgjim të vërtetë, apo do të hiqemi sikur?

-Mjaft tani, -tha Arian Vogli dhe u ngrit në këmbë. Ajo "mjaft" nuk u kuptua përsë ishte: për shiritin që edhe pa të kishte mbaruar, për atë vështrim prej guaku të ndihmësit, apo për të dyja bashkë.

Tjetri ishte duke dalë kur, Arian Vogli, që i ishte afruar ndërkaq dritares, pa e kthyer kryet i tha:

-Dëgjo, krejt lënda të mbylljet në kasafortë. Dhe askush të mos dëgjojë asgjë.

-Si urdhëron, shef -u përgjigj tjetri.

Askush, përsëriti me vete Arian Vogli kur dera u mbylli. Askurrë dhe askund.

Befas, pati ndjesinë se ato fjalë me "as", duke e ndarë qenien e tij prej të tjerëve, e veshën aty për aty me luspa mbinatyrore plot rrrezik e mister.

Ai dëgjonte... Mendimi po i shfagej dalëngadalë me tërë peshën dhe lakuriqësinë e vet. Shfrynte nëpër mushkëritë dhe trurin e tij, bënte që tëmthat t'i buçisnin nga një dehje e re, shkumbëzuese, plot triumf dhe zi.

Dëgjonte... Më shumë se dëgjim ai ishte një zbritje në zonat e ndaluara të jetës. Që poshtë, nga kaosi, rropama e zezë njerëzore ngjitej gjer tek ai.

Unë dëgjoj, tha prapë me vete, si për ta thithur gjer në fund kuptimin e fshehtë të fjalës. Zérat e të rrëzuarve, ato që s'duhej të dëgjoheshin nga kurrkush, vinin që nga zgafellat e zeza drejt e tek ai. Ç'fuqi e ç'mister kishin pasur më shumë demonët e lashtë?

Dëgjonte të mosdëgjueshmen. Mallkime të vjetra që përdoreshin rrallë e më rrallë, i vinin nga vegjëlia bashkë me një frikë të turbullt. Mosqofsh...!

Mjaft, i tha vetes dhe, për ta detyruar mendjen të shkëputej prej tyre, nisi të hapte me vrull syzet e tryezës. Kur shënimet për mbledhjen e ardhshme me përgjuesit e pakënaqur të qytetit i dolën përpara, iu duk se po kërkonte pikërisht ato.

Që përgjuesit me vesh të qytetit (veshët e partisë, siç thuhej se i kishte cilësuar Udhëheqësi në një mbledhje të fshehtë), pas lajmit të mbërritjes së zëthave do të binin në të zeza, kjo ishte një gjë që pritej. Por që pezmatimi i tyre të merrte përmasat e një gjëme të pandreqshme, ishte me të vërtetë befasuese për Arian Voglin.

Kishte kujtuar se pakënaqësia nuk do të kapërcente kufijtë e brengave të njohura tashmë të veteranëve, kur iu dukej se nuk i nderonin më për shkak të oficerëve të rinj me shkollë, lidhur kjo me dyshimet dhe përfoljen kundër veglave të reja, edhe kjo e njohur tashmë, madje në fushat

e tjera të jetës, siç kishte qenë rasti i përdorimit të plehrave kimike, i prezervativëve, i ndërzimit artificial ose i gjithfarë mjeteve kundër të cilave mendja njerëzore kishte përherë një prirje armiqësore.

Ashtu si bubullima përpara stuhisë, trazimi i përgjuesve me vesh i kishte dhënë shenjat që larg. Në krye, shefin e Sigurimit e habit i vërshimi i paparë i lëndës. Raportet me biseda të përgjuara ishin fryrë si rrallëherë. Ndërsa po vriste mendjen për të gjetur arsyet e një mbushullie të tillë, buzëqeshja e lehtë s'i ndahej nga cepi i buzëve. Ose përgjuesit kishin punuar me zell të veçantë, pikërisht, dy javët e fundit, për të treguar se ç'ishin në gjendje të bënin ende ujquit e vjetër të përgjimit me vesh, në kundërshtim me atë mendim që prej kohësh i quante gërxho të dale jashtë kohe, ose vetë njerëzit, të gjendur përpara një ndryshimi të ndjeshëm në jetën e tyre, ndryshim i shkaktuar prej veglave që do të goditnin vdekshëm thashethemnajën njerëzore, shpejtonin të përfitonin nga koha e paktë që iu mbetet për të folur e pëshpëritur, e sharë e shfryrë, me fjalë të tjera, për të zbrazur edhe një herë barkun në prag të heshtimit.

Me po atë buzëqeshje shpotitëse, ai vazhdoi të shfletonte dosjen. Zelli i përgjuesve për të sjellë gjithë mllfin e pakënaqësinë e njerëzve kundër zëthave, binte në sy menjëherë. Ndihej shpresa e tyre e fundit se gjithë kjo pakënaqësi do të bënte, ndoshta, që vendimi për vendosjen e veglave të mallkuara, siç cilësosheshin aty-këtu, të shnjihej.

Një pjesë nuk ishin mëdyshur që, nëpërmjet gojës së gjindjes, të merrnin në mbrojtje veten dhe mjeshtërinë e tyre. Shumica e kishin bërë këtë në mënyrë të përkortë, por kishte raste, si ai i Met Rapallës, në kumtimin e të cilët dukej haptas se krejt dhimburia mallëngjyese, gati-gati dashurore e mbikqyrëses së muzeut historik të qytetit, Liliana K., ndaj përgjuesve me vesh, ishte, në pjesën më të madhe, sajim i atij vetë.

I shfrytëzuan sa i shfrytëzuan të gjorthit e tanë po i flaknin si limon i shtrydhur. Ndërsa të tjerët shkonin në

koncerте, театер apo нë mbrëmje vallëzimi, dëgjonin muzikë a fjalë dashurie: të dua, shpirt, jam jotja etj.etj. veshët e tyre mblidhnin veç vrer e helm. Por atyre s'u vinte keq për këtë, le të gjëzonin jetën të tjerët, le të këndelleshin e të fisnikëroheshin nga muzika, ata, përgjuesit me gjëzim e flijuan veten e tyre për hir të çështjes. Sepse jo vetëm veshët, por truri i tyre kishte nisur të helmohej nga gjithë ajo ndotje, u mësuan me të si ata që mësohen me nikotinën, me drogën, dhe e gjithë kjo në emër të çështjes. Veç, për pak mirënjoye kishin të drejtë edhe ata. Jo të përqmoheshin kështu për shkak të ca veglave të vdekura..

Shfryrjet kundër zëthave nuk mungonin pothuajse në asnje njoftim. Veç shprehjeve "vegla të pabesa", "shpikje e djallit", aty-këtu përgjuesit kishin sjellë përsiatje filozofike, që vështirë se mund të mendoheshin, pa le të shpreheshin me fjalë në këtë qytet. Ky përgjim sjell një përmasë të re në botë, thuhej në njëren prej tyre. Po a i duhet botës kjo përmasë e ligë? Të zbulosh atë është njëlloj si të heqësh napën që mbulon botën e poshtme. Njerëzimi mund të çmendet prej kësaj.

Në një tjetër njoftim flitej se, ndërsa aeroplanët e kishin parashestimin e tyre tek qiliimi fluturues, TV-ja në pasqyrën magjike të përrallave që mund të shihte çdo kënd të rruzullit e kështu me radhë, zëthat e neveritshëm s'mund ta kishin paraëndrrën e tyre veç në zërat e fantazmave e të hijeve, në okultizmin, magjinë e zezë, seancat e spiritizmit e në gjithfarë plehurinash të botës së vjetër.

Pa shih, pa shih, tha me vete Arian Vogli ndërsa nënvizonte me të kuqe shprehjet "limon i shtrydhur" dhe "vegla të vdekura". Pas pak, tek e para vuri një pikëpyetje të madhe, kurse përbri së dytës shkroi: "njeriu mbi të gjitha".

Megjithatë e ndjeu se për mbledhjen me përgjuesit do t'i duhej të përgatitej më seriozisht.

Mbledhja u bë të shtunën, në mbrëmje vonë. Përgjuesit hynin njëri pas tjetrit nga deriçka e prapme e oborrit, me qafëza të ngritura, një pjesë me syze të errëta për të mos u njojur. Ndonëse kjo nuk ishte fort e nevojshme, ngaqë shumica e të ftuarve ishin tashmë në pension, në lajmërim ishte theksuar pikërisht e kundërta, për të mos ua plagosur sedrën. Dy ditë më parë, duke shqyrtuar listën e tyre, ndihmësi i kishte thënë shefit se përfat të mirë ajka e përgjuesve, ata që edhe më shumë kishin bërë zhurmë kundër zëthave, ishin veteranë, kështu që mbledhja e tyre në një sallë, zakonisht e pakëshillueshme në kësi punësh, s'përbënte ndonjë shqetësim. Ishte aty vërtet lulja e tyre, njëri më i lavdishëm se tjetri, gjithkush me përgjime të bujshme, që ishin kthyer në legjendë. Në rreshtin e parë ishte Sulo Gabran, që ishte shurdhuar gjatë përgjimit të aviatorëve, aty ku ata e kishin ndjerë veten më të sigurtë, pranë avionit me motorr të ndezur. Përbri tij ishte Lulal Bella, ai që kishte pranuar të futej në gropë bashkë me viktimën e varrosur për së gjalli, për t'i shkëputur ndonjë të fshehtë në çastet e fundit të jetës. Vinin pastaj rresht pëshpëritësdëgjuesit me gjashtëdhjetë, tetëdhjetë, madje njëqind e dhjetë hapa larg, ata që zbërthenin murmurimën e belbanëve, të hundacëve, atë që bëhej pranë lëfytit të ujit, me furçën e dhëmbëve në gojë, midis ngulçit, me kokën e futur në mes të shalëve të gruas, të atyre që iu kishte rënë pika për të dytën herë e nga pëshpërima kundër shtetit s'hiqnin dorë etj. etj.

Me pak vonesë, ashtu siç ia donte edhe emri që kishte bërë, kishte ardhur e kishte zënë vend në krye fare Tur Ramabaja, krenaria e përgjuesve, jo vetëm të qytetit B., por të gjithë Shqipërisë, për të mos thënë krejt Lindjes, ai që ishte bërë i famshëm ngaqë kishte qenë i vetmi që me dashje kishte verhuar sytë për të mprehur shqisën e dëgjimit.

Sado që u përpoq ta mbante veten, Arian Vogli e ndjeu se si tronditja që ia çrregulloi disi të ecurën, ndërsa i afrohej foltores, i kaloi në zë, apo hapi gojën të fliste.

Ndërkaq ajo që ndodhi në sallë, ajo lëvizje kokash plot shqetësim, si e njerëzve që tranden nga një krismë apo ngritja e beftë e zërit të radios, e shtangu edhe më fort. Nuk u desh veç një grimë, që të kuptonte se për veshët e tyre të mësuar me përgjime pëshpërimash, zëri i tij ishte tepër i lartë.

E uli një herë, dy herë, gjersa iu duk se midis tij dhe sallës u vendos një farë harmonie. E filloi fjalën duke hyrë drejt e në thelb të çështjes: udhëheqja e Partisë, madje vetë kreu i saj, ishte në dijeni të pakënaqësisë së tyre lidhur me zëthat. E keni marrë këtë gjë si fyerje ndaj jush, vazhdoi, si nënvleftësim ose mosbesim ndaj aftësisë suaj dëgjuese. E pra, i porositur nga ministri ynë, i cili tejçon në këtë rast një porosi më të lartë, që ju e merrni me mend nga vjen, jam i ngarkuar t'ju them se ju, më tepër se kurrë i duheni sot Partisë.

Një copë herë ai foli se si ata e kishin mbrojtur Partinë në ditët e saj të vështira.

Ndërsa fliste, ai vuri re se shumica e tyre nuk e shikonin në sy. Edhe mënyra si e mbanin kryet, disi pjerrët, ndërsa vështrimi drejtohej jashtë, ishte e tjeterfartë. Duhet të jetë qëndrimi i zakonshëm gjatë përgjimit, mendoi, duke u përpjekur të mos e humbte fillin e mendimeve.

Pasi përmendi shkarazi traditën përgjuese shqiptare, vazhdimi i asaj ilire, (një film për Kaligulën, ku tregohej se si zgavrinat e shtatoreve përdoreshin për përgjim, ia kishte cytur këtë hamendje), Arian Vogli iu kthyesh prapë mendimit se kurrfarë krahasimi s'mund të bëhej midis veshëve të tyre besnikë dhe zëthave të pajetë. Ai foli për ta me përbuzje, gati me armiqësi, duke u habitur dhe vetë se ç'i shkrepit në kokë të pohonte se ata do të përdoreshin përkohësisht përpara se të flakeshin si limon i shtrydhur!

Fytyrat e dëgjuesve, që gjer atëherë ishin të zymta, u çelën për herë të parë. I ndezur, ai vazhdoi të shpjegonte se ato vegla të pashpirt do të vendoseshin atje ku partia asnjëherë nuk kishte lejuar të futeshin përgjuesit: në gropë plehrash, në WC-ra, në ruajna Zot ku. Pra, jo për t'ju fyer

ju, por përkundrazi, për të mbrojtur dinjitetin tuaj, Partia i kishte sjellë që nga fundi i botës. Duartrokitjet, që ai i priti pas kësaj fraze, shpërthyen një grimë më pas, kur ai thirri: u marrshin të keqen veshëve tuaj ato vegla!

Mori frymë i lehtësuar dhe vetëm atëherë e kuptoi se ballin e kishte të mbushur me djersë. Mbylljen e fjalimit e bëri me një farë nguti, duke u përpjekur të mbulonte zbrazëtinë e frazave me një zë bubullues: -Ju jeni krenaria e Partisë, thesari i pazëvendësueshëm i saj. Armiqtë, edhe atje ku janë, të rrëzuar në gropë, vazhdojnë të flasin. Po ju, edhe aty poshtë në gropë, i kapni zërat e tyre dhe na i sillni. Ju jeni themelet e këtij shteti.

-Fjalim i shkëlqyer, -i tha ndihmësi, që e priste te dera. -Simfoni, për besë. Kam edhe një lajm tjetër të mirë. Telefonuan nga kabineti i ministrit. Ajo puna e teatrit më duket se po rregullohet.

-Ah, ashtu? -ia bëri Arian Vogli dhe fytyra iu ndriçua krejt.

Kur u ul në tryezën e punës, e kishte ende në fytyrë buzëqeshjen. E mbështeti kryet në duar dhe mbylli sytë. Kohët e fundit ndjente përherë e më shpesh nevojën për një pushim të tillë. I përfytyroi afishet e teatrit tek ngjiteshin rresht në rrugën kryesore. Nuk dremiti më shumë se tri-katër minuta, por ajo kohë ishte e mjaftueshme që t'i dukej e natyrshme që fjala "korb" të kishte zëvendësuar "pulëbardhën" sipër afisheve. E shkundi kryet megjithatë dhe, ndonëse u përmend, frika prej ëndrrës nuk iu shqit. Korbi i verbër, përsëriti me vete. Mosditja e arsyes përse duheshin gjurmuar të gjitha shprehjet që lidheshin qoftë dhe tërthorazi me të, i dha prapë ankth.

Ndërsa shpejtonte të kapërcente sheshin e Republikës, Shpend Guraziut iu duk se pa një grumbull të pazakonshëm njerëzish përpara afisheve të teatrit. Përpara se të afrohej i mbylli një grimë sytë, si njeriu që dëshëron që ëndrra të vazhdojë edhe pak. Kur u avit edhe më, i dalloi që larg afishet e njohura, të kaltërta, me njollën e bardhë në mes. Fjalën "pulëbardhë" e pëshpëriti disa herë me vete plot frikë dhe drithërimë, si një lutje, gjersa ajo u shfaq vërtet në mesin e afishes, e dridhshme si një vegulli, e qartë si një shenjë hyjnore: PULËBARDHA.

Me hapa të gjatë si prej të dehuri, u afrua te afishet. Ishte vërtet ajo, me fjalën "premierë" poshtë saj, me emrat e regjisitorit, të aktorëve, së fundi me ditët e shfaqjes: e shtunë, e diel, e mërkurë, e enjte, ora 19.³⁰

Ktheu kryet majtas e djathtas dhe vuri re se sytë e të gjithëve kërkonin të kryqëzoheshin. Në të njëjtin çast pati dëshirën ta ndante gëzimin me të tjerët, të thoshte p.sh. ç'mrekulli, ë?, e po aty deshi të thërriste: shpërndahuni,

mos e tregoni haptas ngazëllimin tuaj.

U largua me hapa të vrullshëm, i sigurtë se një pérndezje e tepruar e turmës pérpara afisheve mund të prishte punë vërtet.

Veç të mos e ndalojnë prapë, o Zot, tha me vete. Nuk i durohej sa të mbërrinte në zyrë pér të çuar lajmin, por këmbët po e çonin te posta e qytetit, i vetmi vend ku kishte një kabinë telefonike. Me dorë të dredhur sajoi numrin e teatrit. A mund të flas me Suzanë Krajën? Eshtë në prova? Ah, natyrisht... Prisni, tha zëri në skajin tjetër të fillit. Jeni i afërmi i saj? Prisni, më duket se është duke marrë një kafe në bufe. Po e thërrës.

Zëri i saj ishte i shpërqendruar, gjithë frysme, thua se kishte vrapuar. Jam Shpendi, tha ai, inxhinjer Shpend Guraziu, apo pashë afishet, desha t'ju uroj. Më mban mend, besoj? Nuk më keni harruar?

Ah, po. Jeni ju, u përgjigj zëri i gruas. Një gjysmë e qeshur u përzie rrezikshëm me frysma marrjen e saj. Natyrisht që s'ju kam harruar. Por ka kaluar kaq kohë qysh atëherë.

Qysh nga dita kur juua ndaluan shfaqjen, tha ai, duke ndjerë një kllapë të hekurt në gjoks. Po ju atëherë më premtuat se sikur shfaqja të lejohej...

Ashtu? Juua paskam premtuar këtë? Keni të drejtë, me siguri që juua kam premtuar.

Shpendi u habit dhe vetë me shpikjen e tij. Dëshiroj aq shumë të shihemi, më ku toni, Suzanë? Qysh nga mbrëmja që jemi njojur unë nuk mendoj veç pér ju.

Përsëri e qeshura dhe frysma marrja e saj në një përzierje që atij iu duk qellore. Mendimi se roli i "pulëbardhës" do t'i jepte asaj përherë sipëranë mbi të, i shkaktoi një brengë të këndshme.

— Po ju do të vini, besoj, të takohemi, siç më keni premtuar, në një nga mbasditet, midis orës katër e gjashtë, pérpara provave.

Me gjak të ngrirë priti përgjigjen e saj.

— Dua të vij, tha gruaja në skajin tjetër. Por ju e dini

se përpara premierës ditët dhe orët e provave ndryshojnë vazhdimisht...

Atëherë unë do t'ju pres çdo ditë midis orës katër dhe gjashtë në apartamentin që jua kam treguar atëherë, në rrugën Vrana Konti. Më dëgjoni, Suzanë? Unë jam gati t'ju pres çdo ditë.

Ashtu? Zëri i gruas u bë më i ëmbël, ngaqë siç duket e preku kjo gjë.

Shpirt, tha ajo me zë fare të ulët, si të fliste me vete.

Shpend Guraziu deshi të thoshte një mijë fjalë dashurie, por në vend të tyre, me zë të mbytur, me një farë nguti, thua se druhej mos gruas i kthehej mendja, përsëriti numrin e ndërtesës dhe të shkallës ku gjendej apartamenti.

Rrugës, tek ecte si i ndërkryer, fjala "shpirt" e shqiptuar prej saj bashkë me një ëmbëlsi të paprovuar ndonjëherë, i dukej se po i jepte qysh tanë diçka të përafërt me ankthin. I ishte drejtuar pa dyshim atij, e megjithatë se si rrinte larg, thua se nuk i përkiste plotësisht.

Kur hapi derën e zyrës, nga fytyrat e tyre e kuptoi në çast se lajmi kishte marrë dhenë.

Ata jo vetëm që e dinin, por po merreshin me porositjen e biletave. Edlira thoshte se gjithë qyteti vlonë ndërkaq. Kishte një mbindijesë në ajër. Një shoqe e saj që punonte si grimiere në teatër, i kishte thënë se atje kishte plasur gazavaji.

-Njerëzit shohin në këtë lejim një shenjë të mirë, -tha Skënderi, kur Edlira doli për të çuar listën e biletave. Sidomos, pas asaj pëshpërimës së tmerrshme për zëhat.

Shpend Guraziu pohoi me krye, por duket që e kishte mendjen gjetkë.

-Skënder, porsa fola në telefon me Suzanën, domethënë "pulëbardhën".

-E mora me mend, -tha tjetri duke futur dorën në xhep. I nxori çelësat dhe i tringëlliti me një lëvizje teatrale. -Ja ku i ke, kur të duash.

Ai priti, me sa dukej, që Shpendi të buzëqeshte,

por fytyra e tij mori një shprehje fajtori.

-Puna është se ajo ma la ditën e takimit të papërcaktuar. Çështje oraresh, provash, e merr vetë me mend.

-S'ka gjë, -u përgjigj Skënderi. -Mund ta kesh apartamentin çdo mbasdite. Ti e di që në atë orë unë shkoj të loz bilardo.

Nga mirënjohnja, Shpendi e ndjeu dhe vetë se nisi të fliste më shumë se ç'duhej. Është e çuditshme, thoshte. Gjithçka tek ajo është e parrokshme, e ikshme, më kupton? Edhe një fjalë të ëmbël që më tha në telefon, "shpirt", tani sesi më ngjan. Sikur më drejtohej mua po aq sa asaj vetë, gjithë botës ndoshta. Edhe koha e takimit është në të njëjtin stil: e mjegullt.

-Mua më duket bukur, -e ndërpren Skënderi. -Kohë e mjegullt, pa data dhe orare. Krejt kohë eterne. Madje, do të thosha, si prej hyjnish.

Koha e vdekjes gjithashtu ishte e tillë, pa data dhe orare, mendoi Shpendi. Por përfytyrimi i flokëve të saj mbi nënkesën dhe qafa e ndehur me një dell të kaltër, të tejdukshëm në anët e saj, e dehu në çast.

Edlira e hapi derën gjithë vrull.

-I porosita biletat, -tha gjëzueshëm. -Shpend, të kërkojnë me ngut në zyrën e kuadrit.

-Mua, pse? -ia bëri ai dhe e mbylli grushtin, si të donte të fshihte çelësat.

-Nuk e di. Thanë vetëm se është me shumë ngut. Shpend Guraziu kafshoi buzën e poshtme dhe doli.

-Uh, ç'mrekulli, -tha Edlira, duke zënë vend në tryezë. -E di që ende s'më besohet? Kam një si frikë se mos vjen dikush e thotë: u gjëzuat para kohe, shfaqja u hoq përsëri.

-O, jo, -tha Skënderi.

-Nuk e di pse e mora me kaq zemër këtë shfagje. Ndoshët ngaqë përkoi me martesën time. Ishte mondaniteti i parë, si të thuash, në qytet. Mezi e prisnim ditën e premierës. Dhe ja, në vend të saj, fjala e tmerrshme; ndalim.

-Të kuptoj fare mirë, Edlirë, -tha Skënderi.

-Por tani ajo punë u kapërcye.

-Pikërisht ashtu më duket dhe mua, si një kalim. Një kapërcim i së pamundurës, s'di si ta them, diçka që i ngjan ngjalljes së të vdekurit.

-Në një farë mënyre, ashtu është, -tha Skënderi.

Ai i kishte sytë nga dera, si ta ndjente se ajo do të hapej.

-E? -thanë të dy një gojë, kur panë Shpendin.

Ai kishte një nga ato buzëqeshjet e gjera të cilat fytyra mezi i përmbledh.

-Një delegacion i Senatit francez mbërrin pasnesër në qytet, - tha duke mbyllur derën pas vetes. -Dhe, e merrni me mend? Shoqërues i tyre do të jem unë.

-Ah, pa shih, -tha Skënderi. -Një shfaqje që lejohet dhe një dërgatë nga Franca. Dy lajme të mira në të njëjtin mëngjes.

-Pse jo? -tha Edlira, duke e vështruar qortueshëm, ngaqë iu duk se tjetri po mahitej. -S'ka gjësend për t'u mahitur këtu.

-Unë nuk mahitem, Edlirë, -tha Skënderi me zë të ulët. -Do të isha një torollak, ose një shpirtkeq po ta bëja këtë. Përkundrazi unë gëzohem aq sa ti, ndoshta më shumë.

Sytë e tyre ngrinë një çast te njëri-tjetri, gjersa gruaja i uli e para.

-Sa për pakëz gjë ka nevojëjeta për ta marrë veten, -tha Skënderi, kur Edlira doli përsëri. -Në të vërtetë, është hera e parë që po besoj vërtet në një shenjë zbutjeje.

-Atë po mendoja edhe unë pak më parë, -tha Shpendi.

-Ka vite që s'ka shkelur delegacion perëndimor këtu. Është uluritëse ndjenja e vetmisë kur të duket se gjithë bota të ka harruar.

Në këmbë, pranë dritäres, Skënderi vështronte udhën. Që lart, kalimtarët ngjanin përherë të shtypur.

-Kemi dhe një gëzim të tretë, -tha me një buzëqeshje ngacmuese.

Shpend Guraziu preku pa dashur çelësat. E vështroi

me mirënjojje tjetrin, pastaj pa orën.

-Më duhet të shpejtoj në Komitetin Ekzekutiv për të marrë nuk e di ç'udhëzime, -tha dhe doli gjithë ngut.

Kur u kthyesh pas një ore, kishte po atë buzëqeshje që i kalonte tërë qenies së tij.

-E dini ç'kam këtu? -tha, duke i treguar një letër.

-Autorizim për blerje veshjesh në depon e veçantë të mallrave? -tha Skënderi, duke e vërejtur me kureshti shkresën. -Ende është në fuqi ky rregull i dikurshëm kur shoqëruesve, të veshur keq, ua jepte rrobat falas shteti?

-Ndryshimi është se tanë i blejmë vetë, -tha Shpendi.

Skënderi e lexoi me zë letrën: "Autorizohet shoku Shpend Guraziu të tërheqë nga ajo depo: tri këmishë të bardha, një palë këpucë, një kostum dhe një pallto të madhe ose xhup."

-Janë shumë, -tha Shpendi. -Duhen gati tri rroga për krejt listën.

-Nëse s'të duhet gjësend, është mëkat ta kthesh, -tha Skënderi.

Shpendi i hodhi një sy letrës.

-Pallton e madhe ose xhupin, nëse është i mirë do ta marr pa tjeter, -tha. -Ky që kam më është vjetëruar. Këpucët gjithashtu. Kurse për kostumin, s'kam nevojë. Po të duash merre.

-Të faleminderit, -tha Skënderi.

-E ty? -i tha Shpendi Edlirës.

Gruaja e re u skuq.

-Më fal, e kisha fjalën për tët shoq...

-O, jo, -tha gruaja dhe u skuq, edhe më.

-Të lutem, mos m'a merr për keq... Nuk di pse befas ndjeva dëshirë t'ju jap nga një kujtim të dyve.

-Ndoshta një nga këmishët, -tha Skënderi. -A do t'i marrësh të trija?

-S'e besoj. Do të marr vetëm dy.

-Para një javë ti kërkoje një këmishë të bardhë për ditëlindjen e tët shoqi, -i tha Skënderi Edlirës.

Ajo s'dinte ku t'i conte sytë.

-Në të vërtetë s'gjenden gjëkund, -tha duke mbuluar me dorë mollëzat që i ishin bërë shpuzë.

-E pra, mbaroi dhe kjo punë, -tha Shpendi. -Jam i lumtur t'ju jap një kënaqësi të vogël.

Rrugën gjer në depon e mallrave e bëri duke vërvshëllyer. Tëmthat i rrighnin me shpeshti, çka i ndodhët gjithmonë kur ato që mendonte ishin dehëse. Teshat e reja i kishin ardhur krejt në kohë, sidomos palltua ose xhupi, nëse ishte i bukur. Këmishën e bardhë aty për aty e përfytyroi me shenjën e të kuqit të buzëve të saj te qafëza. Kështu, te qafa, fill pas buzëve, të puthnin zakonisht femrat kur kishin mall për ty. Duhej ta merrte pa tjetër në telefon për t'i thënë se do të shoqëronte francezët. Do t'i rritej, me siguri, pesha në sytë e saj. Do të befasohej kur të merrte vesh se ishte diçka më tepër se një inxhinier i rëndomtë i komunales. Veç kësaj do të ngazëllehej, me siguri, kur ai t'i premtonte se do t'i sillte të huajt në shfaqje.

Hekurat e portës së jashtme të depos ia ftohën disi zjarrminë. Shufrat e lyera me ngjyrë vaji të gjelbërt, sipër të cilave ishte ngjitur një yll pesë cepash, gjithashtu metalik, i lyer me të kuq, ngjanin me ato të kazermave ose të zyrave të kuadrit. Do të besohej se pas tyre mund të gjeje gjithfarë gjérash, por kurrsesi rroba të bukura.

Mbikqyrësi i depos e priti me armiqësi pothuajse të hapët. E pa me kujdes autorizimin, e afroi te sytë, e largoi përsëri dhe gjatë gjithë kësaj kohe Shpendit iu duk se po murmuriste me vete. Një herë deshi ta pyeste: ka ndonjë gjë që s'shkon? Por pastaj i shkoi mendja se kështu, ndoshta, me një smirë të vetvetishme, i priste të gjithë ata që vinin të merrnin tesha atje, ku zakonisht pajiseshin sekretarët e komitetit të partisë dhe shefi i sigurimit.

-Ja ku i ke, -i tha më në fund, duke shtyrë një napë plastike, pas së cilës teshat, kryesisht kostume dhe pallto, ishin varur rresht. -Sa për këmishët, të bardha s'kam. Shih ngjyrat e tjera po të pëlqyen.

-As xhupa s'ka? Në autorizim është shkruar se mund

të zgjedh midis palltos dhe xhupit.

Tjetri ngriti supet.

-Kur s'ka, s'ka, -u përgjigj. -Unë s'mund të bëhem xhup.

Shpend Guraziu ndjeu t'i kërcente gjaku në krye.

-Dëgjo, ti, -i tha, -në qoftë se ti s'do të zbatosh këtë, - ngaqë s'dinte si ta quante, ia tundi letrën mu në hundë, -pra, nëse ti je kundër saj, thuaje haptaz. Unë s'kam ndër mend të të lutem, more vesh? Unë do të shoqëroj një delegacion francez dhe s'kam nevojë për këmishë rozë, more vesh?

Për habinë e tij, në vend të acarimit të mëtejshëm, Shpendi vuri re një ndryshim të befasishëm në sytë e tjetrit. Ligësisë së ftohtë po ia zinte vendin një ndriçim i sëmurë.

-Dale, dale, -tha. -Mos u nxeh. S'e dija se ishe ai i të huajve.

Shpend Guraziu deshi t'i shfrynte: po si kujtovë ti, me kokën time erdha këtu. Ose: më more për ndonjë nga ata servilët që i rregullojnë banjën shefit tënd dhe pastaj i kërkojnë shpërblimin?

-Mos u nxeh, -tha prapë mbikqyrësi. -Më fal që të fola ashtu, por dhe vetë e ke fajin që nuk e the që në krye se kush ishe. Ai i afroi kryet dhe uli zërin. -Ta dish ti, o vëlla, sa vijnë këtu, po nejse. Ty bravo të qoftë, je nga ata që e meritojnë dyfish. Mos u mërzit. Do të të gjejë vëllai edhe këmishë të mrekullueshme, edhe këpucë, edhe xhup të hatashëm.

Ai i bëri shenjë ta ndiqte në thellësi të depos.

Tarallaku, mendoi Shpendi. E kishte marrë me siguri për spiun të Sigurimit, siç duhej të ishin shumica e shoqëruesve. Mënyra si po i fliste ishte krejt e stilit: "jemi tanët, merremi vesh".

-Ja këmishët e bardha, ja kostumet dhe këpucët. Kurse xhupat, para një jave kanë mbërritur nga Austria. Kështu vëlla, zgjidh teshat më të mira që t'u tregosh atyre birbove francezë që edhe ne dimë të vishemi.

Ndriçimi i përqarë në sytë e tij sa vinte bëhej më i padurueshëm.

Ndërsa Shpendi provonte këpucët dhe rrobat mbikqyrësi vazhdonte të shfrynte kundër francezëve. Përpiqej ta ndihmonte, madje, një herë, Shpendit iu duk se do ta përkëdhelte te supet.

Shpendi shënoi çmimet, kurse tjetri e siguroi se pasi të paguante në seksionin e tregtisë në Komitetin Ekzekutiv, do t'i merrte teshat menjëherë.

Ndërsa largohej, Shpendit nuk i hiqej nga mendja shikimi i dergjur i magazinierit. Sikur të mos kishte qenë ftohtësia e fillimit, do ta merrte për afsh prej homoseksuali. U përpoq ta hiqte mendjen prej tij, megjithatë diçka nuk e linte. Ajo përndezja e mekur, si e njeriut që i lëshonte goja lëng përpara gostisë, ishte pa dyshim tjetër gjë.

Kur arriti në zyrë, Skënderi s'kishte ikur ende. Ia tregoi çmimin e kostumit, pastaj i tha se përgjegjësi i depos e kishte marrë, me sa dukej, për bashkëpunëtor të Sigurimit.

Sytë e tjetrit ishin të menduar. Ndihej që donte të thoshtë diçka, por priste, me sa dukej, të dilnin në rrugë.

Ashtu ishte vërtet. Zëri i tij u bë i rëndë, siç ndodhte sa herë bëhej gati t'i thoshte gjëra të rrezikshme. I tha se nuk habitej aspak që përgjegjësi i depos e kishte marrë për sigurims. Gjatë kohës që do të shoqëronte të huajt, njerëzit do ta shikonin atë me një ndjesi të veçantë: dyshim, frikë, adhurim, urrejtje, smirë, shpresë. Disa do të ndjenin tmerr prej tij e, të tjerët, drithërimë mistike, ashtu si ne gjatë seancës së spiritizmit. Dhe kjo ishte e kuptueshme. Ai do të përkitej me atë pjesë të botës, që për njerëzit ishte po aq e largët dhe e rrezikshme sa shpirtrat.

Shpendi dëgjonte i ngrysur. Mëndafshi i flokëve të Suzanës, vështrimi i lyrshëm i njeriut të depos dhe shiu i natës së spiritizmit i shtjelloheshin mundimshëm nëpër tru. Mendimi se njerëzit do të prisnin diçka prej tij, zotëronte një grimë mbi gjithçka.

Skënderi, sikur të ishte në mendjen e tij, ia tha pothuajse haptas: ishte një rast i rrallë që një dërgatë e një senati perëndimor zbriste në këtë gropë. Do të përsëritez ndoshta kjo pas tre, pas trembehjetë vitesh, ndoshta askurrë. Ndaj ishte mëkatë ...

-Po çfarë? -e ndërpreu Shpendi me zë të mbetur.
-Ç'duhet bërë? Të kam mik, të kam vëlla, më thuaj pa droje ç'farë të bëj?

-Ajo varet nga ndërgjegjja jote, Shpend. -As unë s'e kam të qartë ç'mund të bëhet. Një kumt ndoshta. Një ofshamë së paku, që ata të marrin vesh se ky vend pret diçka nga ajo botë.

Një copë rrugë e bënë të heshtur.

-S'dua të të shtyj në aventurë, -tha Skënderi. - Madje po e përsëris, është e rrezikshme, tejet e rrezikshme. Ndaj mendoje gjakftohtësish. Dhe ki kujdes. Asnjëherë në vend të mbyllur, në hotel ose në makinë. Dhe, natyrisht, nëqoftëse bindesh se kumti mund të kalojë...

-Natyrisht, -tha Shpendi, duke u përpjekur të mbyste një psherëtimë.

8

Te hyrja e teatrit kishte një gjallëri që e kapërcente dukshëm pështjellimin e zakonshëm që krijohej në raste premierash. Arian Vogli me ndihmësin, të maskuar të dy si horra, pinin cigare në një kënd, pa ia ndarë sytë turmës. Përveç atyre që kërkonin me britma ndonjë biletë të rastit, si dhe të tjerëve që prisnin shokët për të hyrë bashkarisht, kishte, me sa dukej, shumë njerëz që kishin ndaluar për të kundruar ngjarjen më të bujshme të stinës.

-Ja mjekja e syve,-i pëshpëriti ndihmësi. -Ajo me pallto të zezë. Ja dhe frati Nik Prela. Ohu, gjahu po mblidhet, për besë.

-Je i sigurtë se çunat do t'i njohin?

-Mos kini asnje dyshim. Kam zgjedhur fizionomistët më të mirë.

Shefit të Sigurimit i shkoi prapë mendja te proverbi i korbit të verbër, për shkak të të cilit do të përgjohej mjekja dhe mosditja e arsyes e shpoi prapë si thikë.

Një djalosh me pamje gjysmë horri edhe ai, u afroa

duke u lëkundur mbi këmbët e gjata.

-Shoko, mos keni ndonjë biletë tepër?

-Jo, - u përgjigj Arian Vogli, në kohën që ndihmësi ia plasi gazit. -Simon, sa bukur e luajtke rolin e halabakut, -i pëshpëriti.

-Ah, qenke ti Simon? -tha shefi. -Bukur, bukur, s'ke ç'i thua.

Djaloshi qeshi, pastaj u ngërdhesh prapë.

-Më dërgoi Xhemali t'ju them se prifti e dorëzoi, më në fund, zhgunin te rrobaroja.

-Ah, më në fund, -ia bëri ndihmësi. -Kujtoja se as në gjumë nuk e hiqte atë rreckë.

-E detyruam te hyrja e sallës, -tregoi Simoni. - Urdhër i prerë, i thamë, s'lejohet me kurrfarë veshje të trashë. Teatri është, veç të tjerash, dhe kulturë jetese. Ja kështu.

Arian Vogli qeshi.

-Shumë bukur, -i tha. -Përgëzoje Xhemalin nga ana ime. Tjetri iku duke çapëlyer shalët e gjata më fort se më parë.

-Janë si të përndezur edhe çunat tanë, -tha shefi. - Kjo lojë, siç duket, i zbavit.

-Mendoj se të gjithë zbavitemi nga pak, apo jo? - u përgjigj ndihmësi.

Arian Vogli deshi të thoshte diçka, por në atë çast midis turmës i zunë sytë Edlirën. E kishte zënë për krahu të shoqin në atë mënyrë të veçantë, sikur donte të varej pas tij. Atij iu kujtua se kështu i ishte varur në sup atë natë vere të largët, fill pas dorëzimit.

Te shkallët, ndërsa ngjiteshin, ndriçimi i neonit ia bëri edhe më të bardhë e më të huaj fytyrën. Dhimbja e gjervishti Arian Voglin më egërsisht se kurrë. Ndihmësi diçka pëshpëriste, por ai s'dëgjonte asgjë. Sytë e tij e ndoqën qafëzën e peliqes së saj ngjyrë kafe, gjersa u zhduk pas portës. Vetëm atëhere iu kthyte ndihmësit.

-Besoj se nuk ke harruar për inxhinier Gjikondin.

-Pikërisht atë doja t'ju thoshja. -Apartamenti i tyre

është ndër të parët që do të pajisen sonte. -Ndihmësi pa orën. -Çunat që punojnë me banesat e kanë marrë urdhrin e prerë, pikërisht tani në ora 19.³⁰, kur porta e teatrit mbyllët ata nisin nga puna.

-M'u kujtua se i pashë tek po hynin. Grua e bukur, apo jo?

-E bukur, s'ke ç'i thua, -pohoi ndihmësi.

Arian Vogli mezi e mbajti një psherëtimë.

-Sa shpejt që kalon koha, -tha. -E kam njohur atë grua kur ka qenë vajzë, studente në ekonomi. Më kujtohet një verë...

Me bisht të syrit ai ndiqte mospërfilljen me të cilën tjetri dëgjonte fjalët e tij. Kasketa gjithë zhul prej halabaku e bënte edhe më të papërshtatshme gjithçka. Arian Voglit i erdhi keq për veten. Ndjeu një dëshirë të egër ta kapte për mëngë e t'i zbrazej: pa dëgjo një grimë, o njeri. Midis gjithë kësaj krusme, edhe ne kemi nevojë për çlodhje, për pakëz nostalqji.

Po ndihmësi, krejt si bisha që i shpeshohet frymëmarrja prej pranisë së gjahut, nuk e fshihte se s'dëgjonte asgjë.

-Francezët, -pëshpëriti ultazi, si të fliste me vete.

Arian Vogli mbylli sytë si i këputur. Kur i hapi, grupi i vogël i të huajve po kalonte përmes turmës nën shikimet plot kërshëri të njerëzve.

-Ja dhe shoqëruesi, -vazhdoi ndihmësi me një buzëqeshje tinzare. Inxhinier Guraziu, hm... E paska zgjedhur të bukur xhupin e ri.

-Besoj se çunat do të kenë kujdes të mos ia dëmtojnë, -tha Arian Vogli me zë të lodhur.

Tjetri ia dha një të qeshure ngazëlliyese.

-S'ka nevojë që çunat të ndërhyjnë, shef... Ai e ka ndërkaq.

-Si?

-Ai e ka, për besë, -përsëriti ndihmësi përmes së qeshurës. -Harruat që në depon e mallrave kemi njeriu tonë? E pra i mora masat që ajo punë të bëhej përpëra se pullumbthi të vinte ta tërhiqtë. Punë e pastër, ë?



-Ti je i hatashëm, -tha Arian Vogli. -Domethënë "princi" i parë i qenka vënë inxhinjerit. E paska përruar domethënë ai këtë histori. E po, e mbajtë me shëndet.

Qeshën të dy një copë herë, pastaj Arian Vogli e kapi për bërryli.

-Dëgjo, e ke fshirë ndërkaq nga lista? Është aq tundonjës ai xhup, saqë ka rrezik që çunat të mos e përmbarjnë dot nepsin për t'i futur një vegël të dytë.

-Në të vërtetë këmbëngulja për përgjimin e francezëve ka qenë e tillë saqë nuk e fsheh, më shkoi mendja se dy "princa", nuk do t'i bënin keq.

-Sonte qenke në humor të mirë.

Fill pas hyrjes së francezëve, ra zilja e dytë paralajmëruese e fillimit të shfaqjes. Te hyrja u bë një pështjellim i fundit, pas të cilit portat u mbyllën. Njerëzit e mbetur te sheshi nisën të shpërndaheshin pa ngut.

Ata u tërhoqën mënjanë te hijet e gështenjave, përbri Galerisë së Arteve, për të mos rënë në sy. Bënin ç'bënin e kthenin kryet nga ndërtesa e teatrit. Prej heshtjes ajo ngjante më e zymtë.

Arian Vogli kishte një zbrazëtirë në shpirt. Ankthi, që përherë e më shpesh provonte ditët e fundit, përpinqej ta kapullonte. I ktheu shpinën teatrit dhe ndezi një tjetër cigare. Ankthi vinte me siguri që andej. Rrobaqepësит janë aty, mendoi ngrirazi. Bashkë me listat dhe me "princat". Të gjithë me pilat brenda ndërkaq, si me një shpirt. Të gatshëm për jetën e tyre të parë dyqindorëshe, ose një mijëorëshe. Gjersa t'u fikej ajo për të nisur jetën e dytë, të tretë. I njejti trup, që mbushej e zbrazej herë pas here me fjalë e frymëmarrje të ndryshme. Një metempsikozë e vërtetë.

Sa koka njerëzish do të hanin vallë?

I përfytyroi shikuesit në sallën e mbushur plot, tek ndiqnin me sy të mallëngjyer fatin e pulëbardhës. Ju jeni vetë për t'u mëshiruar, thirri me vete. Kishin ardhur me veshjet e tyre më të mira. Me palltot, me peliqet e parfumuara. Pa iu shkuar mendja se, kur të dilnin, do të kishin me

vete një shtojcë të vogël...

Një pezm i çuditshëm për mendjelehtësinë e tyre e kapte valë-valë. Kishin ardhur rresht, për të vajtuar një femër të plagosur, pa e ditur se ishin rrëzuar vetë ndërkaq.

Ndërtesa e teatrit, me ndonjë dritare të ndriçuar zbehtë diku në mesoret e katit të epërm, i ngjante ogurzezë. Një dyteatërsh, ja ç'ishte, mendoi. Përbindësh dykrerësh me dy skena, njëren në krye, tjetrën, kryesoren, në shpinë, te garderoba.

Atje gëershëret e rrobaqepësve kullonin, tani, gjak.

Zëri i ndihmësit e shkëputi nga mendimet. S'i durohej të shihte një herë se ç'bëhej brenda. E kishte lehtë të hynte nga porta e mbrapme. Kishin njeriun e tyre aty.

-Shko, -i tha ai. -Po të pres këtu.

Që larg ndiqte me sy njerëzit e rrallë që, si gjithë kalimtarët e natës, afronin kryet më shumë se ç'duhej te afishet për të lexuar me ca sy hutaqë, ç'ishte shkruar atje.

Ndihmësi nuk vonoi.

-Mrekulli, -tha duke fërkuar duart. -Njëmbëdhjetë vendosje qysh në premierë. Më shumë se gjysma janë kryer. Pjesa tjeter pas pushimit.

-Mrekulli vërtet, -u përgjigj shefi. -Tre- katër shfaqje të tilla dhe kjo punë merr fund... Pastaj dihet ç'do të ndodhë.

Ai mendoi zhurmën që do të bënte ndalimi i shfaqjes. Mbledhjet sfilitëse gjer në mesnatë. Dënimin e regjisitorit e të kryetarit të këshillit artistik. Fajësimet për liberalizëm, zhbirimet në biografi, rikujtimet e mëkateve të vjetra të kohës kur ishin studentë, e ndoshta më thellë, të gjimnazit.

Midis lodhjes, shumë njerëz do të bënin pyetjen: po pse? Pse? Kur kishin ndër mend ta ndalonin, përsë e lejuan? S'kishte qenë e papritur kjo punë. Mëdyshja për ta ndaluar ose jo kishte vazhduar me javë të tëra. Vetë sigurimsat, ata që për gjithçka ishin më të repte, kishin qenë dashamirës. Atëhere, përsë? Ç'kishte ndodhur?

Arian Voglit iu duk se kishte kohë që buzëqeshte. Ditë e netë rresht, javë të tëra e ndoshta vite, ata do ta

torturonin veten me këto pyetje. Do të bënин gjithfarë hamendjesh të marra, por të vërtetës nuk do t'i afrohej kurrë, askush.

Duartrokitjet që u dëgjuan mbyturazi që brenda, e shkëputën nga mendimet. Dritat që ishin fikur përgjysmë, u ndezën prapë te hyrja e teatrit. Kur njerëzit e parë nisën të dilnin, ata të dy u afruan qetazi. Turma te hyrja u bë prapë e ngjeshur si para shfaqjes. Shumica nuk iknin. Prisnin të njohurit për të këmbyer përshtypjet ose vinin veshin për ç'thuhej përreth. Dëgjoheshin ngado fjalët: "e mrekullueshme!", "e përsosur". Ti paske qarë?, pyeste dikush. Ndoshta, përgjigjej tjetri. Nuk e fsheh, u trondita si rrallë herë në jetë.

Me bisht të syrit, Arian Vogli vërente herë pas here fytyrën e ndihmësit. Në tërë qenien e tij ndihet prapë tendosja e bishës. Murmuriste me vete, gati-gati rënkonte, sa herë që midis turmës dallonte viktimat.

Dolën me radhë frati Nik Prela, mjekja e syve, francezët bashkë me shoqëruesin, një oficer i artilerisë, Edlira e varur pas të shoqit më fort se më parë, një mbikqyrës finance,...

Fikja e dritave te hyrja bëri që turma, e cila dukej se nuk do të shqitej që andej, të shpërndahej.

Arian Vogli ndjeu befas një lodhje kapitëse. Ndihmësi, më i këputur ndoshta se ai, ndizte cigare pas cigareje. Në heshtje ndiqnin me sy shpinat e njerëzve që po largoheshin.

Ecnin për krahu, qeshnin, shtrëngoheshin e çuçurisnin fjalë të ëmbla, mendoi Arian Vogli. E ndërkaq nuk e dinin se s'ishin më ata që kishin qenë dy orë më parë... Ajo shtojca e vogël, sa një kopsë, do t'ua ndryshonte krejt jetën... Do t'i ndiqte hap pas hapi, më e palodhur se një tumor, gjersa t'ua hante kokën.

-Mbaroi për sonte, -i tha ndihmësit. -Ti, besoj, do të takosh pakëz çunat. Unë po shkoj. Vdiqa për gjumë. Natën e mirë.

-Natën e mirë, shef, -u përgjigj tjetri.

10

Autobusi ndërqytetas Tiranë-B. mbërriti, si zakonisht në B. në orën dhjetë e gjysmë të mëngjesit. Skënderi bëri disa hapa sa pér të çmpirë këmbët, pa orën dhe pasi u mëdysh një grimë: të shkonte drejt e në punë apo të kthehej sa pér të lënë çantën në shtëpi, vendosi aty pér aty pér të dytën. Kur autobusi vonohej, as që bëhej fjalë pér këtë. Por këtë herë, përveç që kishte kohë, e tërhiqte edhe kureshtja.

Sapo e hapi derën, e ndjeu se ajo që i kishte shkuar ndër mend disa herë gjatë udhëtimit, ishte kryer. Lavdi Zotit, tha me vete, ndërsa flegrat e hundës vazhdonin të kapnin një erë të mbetur parfumi, përzier me atë të cigareve. Sytë i shkuan te shtrati i ndrequr përgjysmë me ngut, pastaj te hirnorja e mbushur plot me bishta cigaresh, një pjesë e të cilave i kishin filtrat me shenja të kuqi buzësh, dhe krejt i sigurtë këtë herë tha prapë, lavdi Zotit.

Jo vetëm kishte dashur me gjithë shpirt që shokut të tij t'i plotësohej, më në fund, ajo ëndërr, por ngaqë

gjithçka kishte qenë lidhur me apartamentin e tij, i qe dukur se në një farë mënyre ai ishte përzier në të.

Hyri në banjë dhe, si të kërkonte shenja të tjera siguruese vuri re dorezën e dushit të lënë në një skajim të pazakonshëm, siç ndodhët përherë me një dorë të huaj. Së paku, të ketë patur ujë të ngrohtë, mendoi.

Kundër dëshirës dhe me një ndjesi fare të lehtë faji, e përfytyroi gruan e re tek shpëlante prej trupit të saj shenjat e dashurisë. Nuk do t'i ndodhët ndoshta kjo, sikur ajo të mos ishte aktore, dhe jo vetëm kaq, por aktorja që lozta "pulëbardhën".

Pa dyshim, tha me vete, duke u përkulur mbi nënkesën.

Parfumi i femrës atje, ndjehej më mirë se kudo. Ajo grua kishte ditë që po trazonte përfytyrimin e një qyteti të tërë dhe ai, sado i ndershëm të ishte në marrëdhëniet me Shpend Guraziun, nuk mund t'i lejonte vetes luksin, siç thuhej, të humbte rastin për të përkitur shenjat e lumturisë së saj.

Ç'bëj kështu? mendoi, kur e gjeti veten me nënkesën të shtrënguar pas faqes. Era e mirë i jepte prehje. E rraste sa më fort pas fytyrës, si të donte që dehja të mos i dilte.

Sa herë që mbërrinte të shtunave në Tiranë, ndiente ankth. Përherë i dukej se diçka e keqe mund të kishte ndodhur gjatë mungesës së tij. Kurse këtu, përkundrazi, e priste paqja.

Me zemër u lut që ajo të vazhdonte. Dhe nuk ishte pjellë e trurit të tij. Ajo nënkesë, me atë erë të mirë gruaje, e jepte më rrokshëm se gjithçka prehjen dhe paqen e përkohshme. Shfaqja vazhdonte. "Pulëbardha" ishte prore në qytet. Gjithçka, tani për tani, shkonte mirë. Ai mori frymë thellë dhe u lut përsëri.

Në ndërtesën e Komunales kishte gjallëri të pazakontë. Në mesoren e gjatë, nga të dy anët e së cilës delnin dyert e zyrave, desh u përplas me Edlirën. Përpara se ai ta pyeste se ç'ishin ato gota konjaku që mbante sipër një pjatance, ajo tha:

-Delegacioni francez.

-Vërtet? Ka ardhur këtu për vizitë?

-Pritet nga çasti në çast.

Ai priti kthimin e saj, në këmbë, pranë dritäres.

-Në drejtori janë bërë të gjithë si të marrë, -tha ajo.- Dy herë i kanë ndërruar gotat dhe konjakun.

-S'kanë faj, -tha Skënderi. -Është hera e parë që presin një dërgatë perëndimore.

-Natyrisht. Me kinezët dhe kubanët është e lehtë. Ca buzëqeshje, ca lule dhe fjalë për miqësinë e përjetshme dhe çdo gjë kalon për mrekulli.

Skënderi vente e vinte nëpër zyrë.

-S'kanë faj, -tha prapë. -Ja, e shikon? As mua s'më punohet. Në të vërtetë, një tjetër klimë ka këtu. Mbrëmë në Tiranë një shoku im, kur i tregova për shfaqjen e Çehovit, teatrin e meremetuar me këtë rast, krejt atmosferën e krijuar, tundi kryet i habitur. More, po ju sikur jetoni në tjetër botë, më tha.

Edlira e vështronte ngultazi.

-E atje në Tiranë, si është klima?

Skënderi ngriti supet.

-Ç'të them? Mbledhje kudo. Pritet një valë e re spastrimesh në dy ministritë kryesore: të mbrojtjes dhe të ekonomisë.

-Ah, ashtu?

-Po, nejse. Ne s'kemi pse të mërzitemi. Dihet që kryeqyteti çdo gjë e ka me tepri: edhe gëzimet edhe mërzitë. Do të kalojë, me siguri, dhe kjo si gjithë të tjerat.

Skënderi u ul më në fund në tryezën e punës.

Edlira u ngrit pas pak.

-Të shkoj të shkoj një herë q'bëhet, -tha.

Kur u kthyesh dukej e shpërqendruar.

-Delegacioni po vonon, -tha.

Skënderi pa orën.

Një copë herë të gjatë qëndruan pa folur, secili në tryezën e vet. Një rabeckë që u ul dy herë në parvazin e jashtëm të dritäres, bëri që gruaja ta ngrinte kryet.

-Sa shumë që vonuan, -tha ajo.

Skënderi vështroi prapë orën. Në mesore u dëgjua një trokitje e shpeshtë takash. Edlira u ngrit nga vendi.

-Me sa duket, po vijnë, -tha Skënderi.

Dera u hap me vrull. Te pragu, me sy të ndezur që përpinin gjithçka, ishte ndihmësshefja e kuadrit.

-E morët vesh? -tha, pa e hequr dorën nga doreza e derës. -Shfaqja teatrale u ndalua.

-Si? -ia bëri Edlira. Ajo nuk arriti të nxirrte asnje fjalë tjetër.

-Po hiqen afishet kudo, -shtoi gruaja, duke tërhequr derën pas vetes.

-O, jo, -tha Edlira dhe zuri kryet me duar.

Ngaqë gishtat s'i bindeshin, Skënderi po e shqyente paketën e cigareve.

-Gjithmonë lajme të këqija sjell kjo grua, -murmuriti nëpër dhëmbë.

Telefoni kishte një copë herë që po binte, por ai e ngriti dhe e mbylli dorezën pa folur.

Edlira dëneste në heshtje.

Skënderit nuk i kujtohej qartë një ëndërr e keqe që kishte parë ndaj të gdhirë. Gypa ujrash të turbullta që shpërthenin. E kishte qetësuar veten, ngaqë i qe dukur se lidhej me kokëçarjet e tyre të përditshme.

-Ndihesha kaq e lumtur saqë kisha filluar të kem frikë, -tha Edlira, përmes dënesës.

Skënderi s'dinte si ta qetësonte.

-E di, vallë, Shpendi? -tha me zë të ulët, sikur pyetjen, më shumë se asaj t'ia drejtonte vetvetes.

Telefoni vazhdonte të binte, por asnjeri nuk e prekte dorezën.

-Vërtet, ç'do të bëhet me delegacionin? -tha ajo, si të përmendej për diçka krejtësisht të jashtëzakonshme.

Ai ngriti supet. Mendimi se vonesa e dërgatës mund të kishte lidhje me ndalimin e shfaqjes, flatronte diku, mushkonjë e bezdissħme, bashkë me proverbin e vjetër, të tmerrshém: kur vijnë të ligat hapiu derën, rrotull vetëdijes së tij.

-Na çmendi dhe ky telefon, -tha Edlira dhe u ngrit të merrete dorezën. -Alo, -thirri gati me zemërim. -Nuk është këtu Shpend Guraziu. Është me shërbim. Çfarë? Doni adresën e tij? Të familjes? Po pse? - Ajo vështroi nga Skënderi, duke vënë pëllëmbën e dorës mbi dëgjonjësen. -Një i luajtur kërkon adresën e familjes së Shpendit.

Skënderi i bëri shenjë t'ia jepte telefonin.

Nga skaji tjetër i fillit u përsërit, me sa dukej, e njëjta pyetje.

-Nuk ka familje Shpend Guraziu, -u përgjigj Skënderi.
-Po pse pyesni?

Përpara se Skënderi të lëshonte britmën "jo", Edlira ia kishte ngulur sytë e shtangur krejt.

-O, jo, -klithi për herë të dytë Skënderi. -Përplasje e makinës? Sot në mesditë? Vdekur?

-Ç'tmerr! -ia bëri Edlira.

Skënderi e kishte lëshuar telefonin dhe kishte mbuluar fytyrën me duar.

Edlira qante në heshtje.

Dikush nga jashtë e shtyu derën si të donte ta shkallmonte.

-E morët vesh? Shpend Guraziu... -fjala i mbeti në gojë. -Ah, e ditkeni.

Skënderi, si të përmendej, u sul përjashta.

Oh, rënkoj me vete Edlira. O ditë e zezë!

Dikush tjetër e shtyu derën po aq furishëm, por e tërhoqi prapë pa thënë asgjë.

Telefoni nisi të binte përsëri.

Skënderi u kthye pas pak.

-Ka ndodhur një orë më parë, -tha, si të fliste me vete. Është prerë më dysh nga një buldozer...

Ajo, me mollëzat e nxira nga rrjedhat e rimelit, nuk përqëndrohej dot për të dëgjuar hollësitë. Në mesditë ishte shkëputur një çast nga delegacioni për të telefonuar. Në kthim tek makina, si të ishte i verbër, nuk e ka vënë re një buldozer që zhvendosej përbri. I është futur në dhëmbëza, krejt si ata që bëjnë vetëvrasje dhe është copëtuar

prej tij.

Po kjo është e pamundur, klithte së brendshmi Edlira. As vetë s'e dinte ç'ishte e pamundur, vdekja e tij apo shtypja nga një buldozer.

Ajo priti që Skënderi të thoshte të njëjtën gjë, por ai ia kishte ngulur vështrimin qelqeve të dritares, sikur e vërteta të shfaqej në lëmimin dhe tejdukshmërinë e tyre të pabesë.

Tani i dukej se pothuajse e dinte të vërtetë. Ashtu siç ia kishte dhënë kumtin proverbi i pamëshirshëm për të ligat që s'vinin currë vetëm, gjithçka kishte pasur lidhje me shfaqjen e mallkuar. Shpend Guraziu ka qenë shkëputur nga delegacioni për të marrë në telefon të dashurën. Dhe aktorja, që porsa kishte mësuar lajmin e zi, ia kishte thënë atë përmes qarjeve. Ose edhe më keq: i ka thënë se s'donte t'ia dëgjonte zërin. Ose: si guxonte ai, në një ditë të tillë të zezë, t'i kërkonte takim. Ose... Zoti mund ta dinte ç'mund t'i ketë thënë. Dhe ai, pasi ka lënë dorezën e telefonit, krejt i çmeritur, duke shkelur pa kujdes përbri gropave të rrugës që meremtohej, është futur verbtazi në dhëmbët e buldozerit.

Edlira vazhdonte të qante me kryet e futur në pëllëmbët e duarve. Vetëm një herë, kur u duk se e mblodhi veten, deshi t'i kujtonte Skënderit ditën kur Shpendi, si ta parandjente ndarjen me ta, kishte dashur t'u linte secilit nga një kujtim, veshjet e tij.

Fjalët e saj, të mbytura nga ngashërimi, nuk dhanë veçse një pjesë të vogël të asaj që donte të thoshte, por ajo ishte e mjaftueshme që Skënderi të kthehej prapë nga dritarja për të fshehur lotët.

Nën erën që dukej se u ftoh edhe më pasdite, po hiqnin kudo afishet e mbeturat të "Pulëbardhës". Vetëm atëherë u kuptua se për të ishin ngjitur më shumë afishe se për tërë stinën teatrale. Copëza të tyre, që iu shpëtonin

duarve të shqitësve, zvarriteshin prej erës, gjersa binin aty-këtu në hullitë ndanë rrugës.

Një "GAZ" i Degës së Brendshme ecte me shpejtësi udhës kryesore. Që brenda tij, Arian Vogli, ndiqte me sy heqësit e afisheve. As grumbuj njerëzish, as kureshtarë asgjékund.

Në të gjitha katet e ndërtesës së Komunales kishte një ecejake të pazakonshme. Varrimi i Shpend Guraziut do të bëhej po atë mbasdite. Trupi kishte qenë i copëtuar aq keq, saqë s'kishte qenë e mundur as ta çvishnin. E kishin skajuar njëfarsoj në arkëmort, pastaj e kishin mbyllur shpejt e shpejt mbulesën, duke menduar se kishte raste, si ky i këtij të gjori, kur më mirë të ishte qyq mbi dhë, kështu që kërkush, as nënë e as motër, s'kërkonin ta shihnin për herë të fundit.

Varrimtarët hypën në autobusë rreth orës katër.

"GAZI" i Degës së Brendshme u ndesh me ta në të dalë të sheshit të Republikës. Arian Voglit iu kujtua se një njeri ishte copëtuar nga një buldozer atë mëngjes.

-Kalo nga teatri, -i tha shoferit.

Përpara ndërtesës së teatrit ishte po ajo shkreti e mesditës. Vetëm një kureshtar, duke vënë dorën si streth sipër ballit, për të parë më mirë brenda, lëvizte kryet herë majtas, herë djathtas te qelqnaja e portës.

Në varrezë, përbri gropës së porsahapur, njerëzit po mblidheshin në trajtë gjysmë rrethi për të dëgjuar më mirë fjalën e rastit që ende s'dihej kush do ta mbante.

Arian Vogli shtyu portën e hekurt të oborrit të Degës së Brendshme dhe hyri. Zyra mbante erë tym cigareje dhe ai hapi të dy flegrat e dritäres.

Era e ftohtë të priste. Dritaret e ndërtesave përballë ngjanin si të vëngëra.

Te tryesa ishte njoftimi i ngjarjeve të ditës. I vrari paskësh qenë inxhinier në Komunale. Emrin e tij, Shpend Guraziu, ai e lexoi pothuajse me zë. Se ku e kishte dëgjuar atë emër. Shpend Guraziu, tha prapë, por në atë çast iu kujtua se Edlira punonte në të njëjtën ndërmarrje dhe

mendja i shkoi tek ajo.

Edlira, duke u dredhur nga e ftohta, vështron te arkëmortin e veshur me mëndafsh të kuq përbri gropës. Sado që s'donte kurrsesi, përfytyrimi i trupit të të vrarit brenda arkës së myllur s'i shqitej dot. E gjëzofsh, e grissh me shëndet, e kishin uruar të gjithë për xhupin e porsablerë. Tani e kishte me vete nën dhé, plot shqyerje dhe gjak prej dhëmbëve të buldozerit.

Në zyrën e tij, Arian Vogli e pyeti ndihmësin a kishin arritur të përpunonin diçka nga regjistrimi i bashkëshortëve Gjikondi. Ndihmësi u kthyte pas pak me rrotullën e magnetofonit. Është ashtu siç e kishit parashikuar ju, tepër tepër kureshtare, i tha duke ia zgjatur. Ashtu? ia bëri kinse mospërfillës shefi. Është regjistruar natën e parë fill pas premierës së teatrit. Ah, atëherë qenka vërtet ashtu. Tani dëgjo, ti mund të shkosh. Kam dëshirë ta dëgjoj vetëm.

Përbri varrit, pas fjalës së shkurtër të shefit të kuadrit, Skënderit iu duk se të gjithë prisnin që ai, si miku më i afërt i të ndjerit, të thoshte diçka. Arriti ta mbante veten dhe foli vërtet diçka, ndërsa sytë i kërkonin me padurim midis grumbullit të varrimtarëve, aktoren e "Pulëbardhës".

Në zyrën e tij Arian Vogli kishte myllur sytë përgjysmë përpëra magnetofonit. Sa e bukur që je bëre sonte, thoshte i shoqi i Edlirës. Vërtet? përgjigjej ajo. Ndoshta nga shfaqja. Më ka përndezur të gjithën... Dëgjoheshin ecejaket në dhomën e gjumit. Zëri i tij: ke shumë dëshirë sonte? Ajo: shumë, si asnjëherë... Ai: eja pra. Një fëshfërimë e fundit. Ndoshta heqja e të brendshmeve. Pastaj zhurma e puthjeve dhe rënkim i parë i gruas.

Arkëmortin e kishin zbritur ndërkaq në gropë. Ashtu si të tjerët, Edlira u përkul te grumbulli i dheut për të hedhur një grusht balte mbi të. U tërhoq për t'u lënë vendin të tjerëve dhe, pa i shkuar mendja se i kishte duart me dhé, fshiu mollëzat. Dridhej krejt si të ishte e zhveshur përballë acarit.

Pa i hapur sytë, me dhimbje në fytyrë, Arian Vogli

dëgjonte zërin e gruas përmes fryshtëmarrjes që sa vinte shpeshtohej... Ishte një mrekulli vërtet ... teatri i ngrohur për herë të parë... Njerëzit të veshur bukur... Pas kaq kohësh, për herë të parë... Ah, ashtu... ashtu... ç'mrekulli... edhe pak... o Zot... Ah ...

Me thonjtë e ngulur në shputat e duarve ai dëgjoi rënkin e fundit, pastaj shkrehjen. Me sa dukej për shkak të lëvizjes në shtrat, ose të kërcitjes së ndezëses së cigares, fjalët e pastajme qenë të mbytura.

Sipër grumbullit të dheut të freskët po vinin kurorat. Të gjithë me bisht të syrit përpinqeshin të lexonin fjalët e shkruara mbi kuroren e dërgatës franceze: "Paix à son âme".

Më jep edhe mua një cigare, u dëgjua zëri i saj i qartësuar përsëri. Ndihem kaq e lumtur sonte. Ai: më kujtohet pasditja kur pate orgazmën e parë. Ishte ja, kështu si sonte... Ajo: sonte ishte dhe më e bukur. Ai: s'të kam pyetur ndonjë herë hollësira për njeriun e parë në jetën tënde. Ajo: oh, s'kam dëshirë ta kujtoj, sidomos sonte. Ai: po pse? Ajo: s'e di as vetë... Më beso, s'e kam për arsy me skine, që të tregoj se ti je i vetmi etj. etj. Por vërtet s'kam dëshirë ta kujtoj. Ai: ke qenë në vitin e parë të fakultetit, në mos gaboj? Ajo: po... kurse ai ishte sekretar i komitetit të rinisë së qytetit. Një lloj ylli, stari, siç thuhej, për gjithë vajzat e reja. Ai: ishe e virgjër? Ajo: natyrisht... Po të lutem mos më pyet më... Më duket se gjithçka ka ndodhur në një planet tjeter.

Nëpër rruginat e varrezës njerëzit ecnin drejt daljes, duke lexuar kalimthi pllakat prej guri e merméri. Edlira ndjeu befas këputje në gjunjët. Ankthi, që gjer atëherë ia kishte zgavruar lukthin, po i shpërndahet në krejt trupin. Kërkoi me sy Skënderin ngaqë iu duk se po të mos mbështetej në krahun e dikujt, do të binte.

Kështu pra, Edlirë. As të më kujtosh nuk ke më dëshirë, tha me vete Arian Vogli. E ktheu mbrapsht fillin, ridëgjoi copëza të tij, pastaj qëndroi një copë herë kryevarur si mbi një humnerë.

Ndjente se si një zemërim i shurdhër, që më shumë se me gruan e re kishte lidhje me krejt botën, po e pushtonte. Mllefë i verbër, bashkë me hidhësinë i shkaktonte një farë kënaqësie. I kishte dhënë një ëndërr këtij qyteti dhe ia kishte marrë përsëri. I kishte nxitur të harboheshin e tani do t'i kundronte kur të vyshkeshin krejt. Tani s'kishte kurrfarë dyshimi se, me atë aradhë të tmerrshme shkurtabiqësh, zëthat e tij, ai ishte edhe më i fuqishëm se ç'e kishte ditur. Do të depërtonte me ta atje ku s'zbriste dot askush. Në të gjitha zgavrat, madje gjer në seksin e saj. Të hetonte ç'ndodhët në atë terr të lagësht ku, verbtazi, kishte rrjedhur dikur fara e tij.

Jashtë po binte mbrëmja. Nën varrin e porsambuluar, trupi i pajetë i Shpend Guraziut dergjej si gjithë kufomat, në heshtje dhe në terr.

10

Ashtu si në mëngjeset e tjera, kohët e fundit, atij iu duk se ndriçimi i zyrës ishte i pamjaftueshëm. I hoqi sytë nga dosja që po lexonte, i fërkoi, pastaj i mbajti një copë herë mbyllur. Përpara se të riniste leximin hapi abazhurin tjetër sipër tryezës, madje dritat anësore, ato që i ndiznin veç në raste mbledhjesh, dhe prapë zyra iu duk e ndriçuar zbehtë.

Kryma duhet të ketë rënë, mendoi.

Jashtë, dita ishte e zymtë. Shiu çuçuriste i palodhshëm qysh nga mesnata, por ai e dinte se shqetësimi i tij, duke përfshirë edhe atë të syve, nuk kishte të bënte me zymtinë e ditës.

Kishte disa ditë që përpiquej t'i përmbahej këshillës së një miku të vet për të mos e filluar ditën e punës me dëgjinin e zëthave. Mirëpo s'e kishte të lehtë. Bënte ç'bënte; mendja i rrinte aty. Vëmendja i shpërqendrohej, i dukej se ishin folur ndërkaq gjëra të tmerrshme dhe ai kishte vonuar në dëgjim. Ndihmësi e kishte sigruar disa herë se po të

kishte gjësend të atillë, që lypte ngut, si puna e fratit françeskan, ai do ta njoftonte në çast.

Frati ishte pushkatuar dy ditë më parë, në orën katër të mëngjesit, te zallishtja buzë lumit. Ishte morti i parë i shkaktuar prej "princave". Goditja kishte qenë e rrufeshme. Goditje princash, jo shaka, siç kishte thënë ndihmësi.

Ditën që e kishin sjellë "princip" e porrsahequr nga zhguni i françeskanit, si ta ndjente se diçka e pazakontë ishte ndryrë brenda tij, ndihmësi e kishte pritur vetë dëgjimin. Fill pas tij, me fytyrë të prishur, ishte shfaqur te dera e zyrës së Arian Voglit. Ejani dëgjoni, kishte thënë me zë të ulët, si të kishte frikë. Një gjë e tmerrshme. Çfarë? kishte pyetur Arian Vogli, i habitur përse në fytyrën e tjetrit nuk ishte ngazëllimi i zakonshëm në kësi rastesh, kur sa më e frikshme ishte e folura, aq më ngadhënjenyese quhej kapja e saj. Një tmerr i vërtetë, ishte përgjigjur ndihmësi. Kundër "atij"? kishte pyetur Arian Vogli, duke ngritur gishtin lart, siç bënte sa herë ishte fjala për shefin e madh. Ndihmësi kishte bërë 'jo' me krye. Ishte tjetër gjë, ndoshta më e frikshme.

Dhe ashtu kishte qenë vërtet, diçka e pazakonshme, një pagëzim.

Një pagëzim, përsërishte me vete Arian Vogli, ndërsa zbrisnin të dy në katin e poshtëm, atje ku bëheshin dëgjimet e ngutshme.

Jo vetëm ata të dy, por edhe teknikët që kishin bërë gati magnetofonin, flisnin me zë të ulët, si në një tempull.

Zëri i regjistruar i priftit ishte i tingullt, me një jehonë të largët, thua se kulmorja e kishës ku kishte bërë meshë dikur, kishte mundur t'ia ngjiste përjetë atij zëri jehun e saj. "Un të pagëzont n'emën t'atit, birit e të spirtit sent".

Formula e Pagëzimit, tha me vete Arian Vogli. Vëtëtimthi iu renditen në kujtesë zërat e mësuesve në gjimnaz, më pas ato të profesorëve në fakultet, në emisionet e kulturës

në radio, në gjithfarë konkursesh në TV: Fraza e parë e shkruar e gjuhës shqipe është një formulë pagëzimi, që gjendet midis një qarkoreje të hartuar në latinisht prej peshkopit të Durrësit Pal Engjelli në shekullin 15.

-Fraza e parë e shkruar e shqipes, -tha Arian Vogli, pas dëgjimit të përsëritur. -Fillimi krejt, -shtoi duke kërkuar të ndeshte sytë e tyre. Por ata ende vështronin ngultazi magnetofonin dhe, kur Naumi, i pari, ktheu shikimin drejt tij, Arian Voglit iu duk se ai shikim po i thoshte: e çë pastaj?

Asgjë, u përgjigj me mend shefi. Kurse me gojë tha:

-Lajmëroni në çast qendrën.

Udhëzimi nga lart ishte i prerë. Ushtrimi i fshehtë i riteve fetare të kumtohej me po atë ngut që jepej zbulimi i një përbetimi.

Tre ditë më pas, kur fill pas urdhërit të arrestimit qendra kishte kërkuar dënimin me vdekje të pagëzuesit, Arian Vogli e kuptoi se ai shikim i tij dhe fjalët e thëna hutueshëm: "fraza e parë e shqipes", nuk kishin qenë veç një mëdyshje, e parë dhe e fundit në punën e tij, për të anashkaluar një urdhër.

Të tjerëve nuk u kishte vënë faj që nuk e kishin kapur thirrjen e tij të humbët. Ishte i vetmi që kishte mbaruar studimet për gjuhë-letërsi shqipe dhe, me sa dukej, ajo mëdyshje kishte qenë detyrimi i tij i fundit ndaj rinisë së tij prej studenti. `

Më pas, sa herë që ishte përpjekur të shqitej prej zymtisë, duke thënë me vete se ç'rëndësi kishte nëse kishte dhënë mort fraza e parë apo e njëmiliontë e shqipes, diçka e pengonte. Ishte themeli, sidoqoftë, thoshte me vete, kundër vullnetit të tij. Së paku, ai të mos ishte përgjakur. Mendimi se ishte kapërcyer një prag që s'duhej, i jepte një parandjenjë të keqe.

Te zallishta, në orën katër të mëngjesit, ishte pothuajse errësirë, kur e pushkatuan françeskanin. Shefi nuk ia ndante sytë zhgunit të vjetër, një cep i të cilit kishte mbartur dy

javë rresht veglën e vdekjes. Prifti shkelte lehtë, me këmbët e dopta sipër guralecëve. Qëndro aty, i thirrën dhe ai u bind. Fjala e tij e fundit "mëshirë", që ai e shqiptoi me sytë drejt qiellit, nuk ishte për veten, siç ndodhët shpesh, por për të gjithë.

Në kthim, ndihmësi, me të cilin ishin futur bashkë në "GAZIN 69" e pyeste se si duhej ta jepnin fjalën e fundit të viktimës në kumtesën për lart, si pendim apo si thirrje armiqësore. Jepe siç ishte, ishte përgjigjur shefi, "mëshirë". Ndrysht, prej fjalëve të tilla s'ke veçse ngatërruesë.

Kur mbërritën në Degën e Brendshme po gdhinte. Ndihmësi përgatiti një kafe të fortë. Arian Vogli kërkoi të shihte "princat" që, pas tërheqjes prej veshjeve të njerëzve, po i përgatisnin për shërbimin e ri.

-Ku është ai i priftit? -pyeti shefi.

Ndimësi ia tregoi. Rezëllinte i ftohtë, krejt si të tjerët, në arkëzën me kadife të kuqe. E kishte pjellë i pari vdekjen dhe tanë ishte në pritje për t'u mbushur prapë me fillin magnetik.

Disa ditë rresht Arian Vogli nuk u mor me dëgjimet. Më pas etja për to iu rikthye më e fortë se më parë. Pa mbërritur mirë në zyrë, bashkë me kafenë e mëngjesit i sillnin aparatin. Në krye dëgjonte i ulur në ndenjëse, pastaj ngrivej, vente e vinte nëpër zyrë, shfrynte me vete, egërsohej. Gjuhustra të pandreqshëm, murmuriste nëpër dhëmbë. Pastaj ankoheni përsë ju godasin.

Nuk e dinte as vetë nëse donte që ajo murmurimë e pambarim kundër shtetit të mehej apo të gjëmonte edhe më. Në këtë pikë as dëshirat e qendrës nuk kuptoheshin. Nganjëherë dukej se dëshirohej fikja e tyre, e pas c'atitësh, vinte vërejtja se kapja e zëravë kishte qenë e dobët.

Ai vetë kishte kujtuar se do të mësohej me të, por po i ndodhët e kundërtë, sa vinte acarohej më keq. Kur mikut të tij, atij që i kishte dhënë këshillën të mos e niste ditën me dëgjimin e zëthave, i kishte thënë: po s'kam ç'bëj, jam mësuar ndërkaq me to si me një drogë, tjetri i

ishte përgjigjur: pikërisht se kjo gjë i ngjan drogës, sa vete bëhet edhe më e rrezikshme.

Me vullnet të hekurt kishte arritur më në fund ta shtynte orën e dëgjimit. Së paku, ta çoj gjer në mesditë, thoshte me vete. Ndryshe dosjet e tjera do t'i merrte lumi.

Lëri dredhitë, mendoi kur e gjeti veten duke hetuar prapë ndriçimin e pamjaftueshëm. Po kërkonte, me sa dukej, vegjë për të lënë leximin e për t'u hedhur në dëgjim.

Lëri dredhitë, tha gati me zë dhe, duke fërkuar duart, si për t'u nxehur hapi dosjen e ditës. Ishin aty ngjarjet e natës së shkuar si dhe ç'kishte ndodhur në mëngjes herët. Kufoma e një të panjohuri ishte gjetur në një plevicë bari në të dalë të qytetit. Këshilltari i ambasadës greke, që kishte fjetur në hotel "Turizmi", kishte hapur e mbyllur shumë herë dritat në dhomën e tij, me një shpeshti të dyshimitë, sipas njoftimit të agjentit që merrej me përgjimin me sy të hotelit nga ndërtesa përballë. Një zjarr me zanafillë ende të pashpjeguar në ngrohtoren e fabrikës së lëkurëve, një grindje të dehurish në mesnatë, në bar "Liria", ku ishte përdorur shprehja "ik, mor kalec i ndyrë", nisja që pa gdhirë për një kryeqytet me një taksi të porositur një natë më parë e aktores Suzana K., si dhe përdhunimi i një gjimnazisteje, ishin ndodhitë kryesore.

Asgjë e jashtëzakonshme, mendoi Arian Vogli. Nata, ashtu si krejt ajo javë, kishte qenë e qetë. Në teatër vazhdonin mbledhjet e pambarim. Ishin shkarkuar drejtori bashkë me sekretarin e Partisë, regjisori-i "Pulëbardhës" ishte çuar për riedukim në një kooperativë bujqëshore, por këto masa ishin gjykuar të pamjaftueshme. Kërkohet gjetja e shkaqeve që kishte çuar në parapëlqimin e dramës, pastaj rrënjet e tyre, pas të cilave vinin prapë shkaqet, këtë herë të rrënjeve, pas të cilave përherë kishte diçka që dilte me vonesë, atëherë kur s'pritej.

Trysnia ishte rritur, sidomos, pas mospranimit të Suzanë K. për të luajtur e dyzuar Cucën te "Cuca e maleve", si një shlyerje faji për joshjen e saj prej "Pulëbardhës". Ishte marrë në krye si një trill, ndikuar nga "yjet" e

Perëndimit, gjersa një nga aktorët, i porsazgjedhur sekretar partie, kishte thirrur: çfarë trilli more, kjo është kundërvënie e hapët.

I ishin sulur pastaj Suzanë K. me të gjitha llojet e fajësimeve (e po, doemos, parapëlqen "pulëbardhat" dhe "zonjushat" ndaj cuave tona heroike), në kohën që ajo ngulte këmbë se mospranimi i saj s'kishte lidhje me kurrfarë kundërvënie, por me një brengë vetiakë. Kishte mjaftuar kjo që dikush të thoshte fjalët: i dimë ne edhe ato brengat e tua vetiakë, pas të cilave e fajësuan haptaz për moral jo të shëndoshë. Midis dënesës, për habinë e të gjithëve, ajo kishte pranuar se lidhja e saj e shkurtër me një inxhinier që s'jetonte më tanë, mund të kishte qenë vërtet ndikim i gënjimit hollivudian, pohim që i kishte lënë një mbresë të mirë të dërguarit të Komitetit të Partisë, i cili s'mungoi ta përmendte në një nga ndërhyrjet e tij si shëmbull të një shpjegimi marksist të ndjenjave më të fshehta njerëzore.

Eh, moj Suzanë K. tha me vete Arian Vogli, tek rilexonte, këtë herë pa ngut, ndodhitë e teatrit. Pranon se ke bërë dashuri me inxhinierin orëlig, pastaj nisesh në orën katër të mëngjesit me taksi për në Tiranë. Ai tundi kryet si njeriu kur shikon se tjetri e ka marrë, ndërkaq, rrökullimën.

Në kumtesën për teatrin, ndihmësi kishte nënvizuar me të kuqe gjithsaherë përmendej Dega e Brendshme. Ata që kishin qenë tepër të zellshëm për vënien e "Pulëbardhës", përpinqeshin të përligjin e tyre me dashamirësinë e organeve të diktaturës që, ndonëse e dinin për ç'dramë bëhej fjalë, jo vetëm nuk kishin shfaqur kurrfarë mëdyshje, por përkundrazi... Lërini mënjanë organet e diktaturës, ua ndërprisin fjallën të tjerët. Pastaj edhe në qoftë ashtu, kur është fjalë për parimet, ne dëgjojmë vetëm Partinë.

Arian Vogli buzëqeshi. Në vegjelinë e tij, në oborrin e shtëpisë, i pëlqente të hetonte me orë të tërë ecejaken e thneglave rrotull folesë. Venin e vinin duke bartur nga një fije kashte ose dromcë, rendnin, kthehesin, rropateshin, pa e ndjerë se një sy i përgjonte, ndërkaq, që lart. Pastaj,

the
best
is
now

kur mërzitej nga kjo, ai ua prishte befas gjithçka. U hidhte ujë dhe baltë përsipër, për të ndjekur pastaj, me një të qeshur të ngrirë, çoroditjen e tyre.

Arian Vogli pa orën. Po afronte mesdita, ora e dëgjimit. Ndihmësi do të vinte bashkë me aparatin dhe kupat e kafesë, për të dëgjuar së bashku gjithçka.

Ashtu ndodhi vërtet.

Ndezën nga një cigare të dytë pas dëgjimit dhe, ndihmësi, si për t'u shfajësuar tha: gjëra të rëndomta edhe sot.

Shefi ngriti kryet si për t'i thënë: ç't'i bësh.

Tre javë pas ndalimit të shfaqjes, qyteti vazhdonte të ishte si i goditur nga pika. Ne të gjithë jemi pulëbardha të plagosura, përsëriti me vete Arian Vogli fjalët e një infermieri.

-S'ma merrte mendja kurrë se një shfaqje do ta pikëllonte kaq shumë një qytet të tërë, -tha mendueshëm.

-Duket e pabesueshme, vërtet, -u përgjigj ndihmësi.

-Edhe kometë po të ishte, më pak besoj se do të ndihej.

-Kometë, hm, -qeshi shefi. -Ku të vete mendja... E pra, s'ishte veç një pulëbardhë.

-Kurse unë e kam hallin gjetkë tani, -tha ndihmësi.

-Mirë herën e parë e zgjidhëm për mrekulli vendosjen e "princave", po herën e dytë e të tretë, ç'do të bëjmë?

-Mos u mërzit, Naum. Do të mendojmë diçka tjetër.

Një koncert ndoshta, ose një balet...

Ndihmësi nuk e fshihte se këto çaste bisedash të çlirëta me shefin ishin ndër më të lumturat e tij.

-E dini si kanë nisur t'i quajnë tanë "zëthat"? "Veshët e vdekjes".

-Ah, ashtu? Në të vërtetë, s'e kanë gjetur keq.

S'e kanë gjetur keq, mendoi. Ndër mend, për të kushëdisajtën herë, iu përhi trupi i fratit, rënë mbi zhur, me njëren këmbë të dobët si shkarpë, që i dilte poshtë zhgunit.

-Gjuha bën mort, -tha duke ndezur cigaren, që e mbante prej kohësh midis gishtave. -E thoni në anët tuaja

këtë fjalë?

-Po... po-, u përgjigj ndihmësi me një farë mëdyshjeje.

-Këtë dhe shumë të tjera. Megjithatë, vetëm tani që merrem me këtë punë e kam kuptuar se sa shumë gjuha ka lidhje me shtetin...

-Një gjësенд e vogël, e butë, që po na çmend të gjithëve. Me siguri, kështu ke thënë me vete, Naum?

-Pak a shumë.

Një copëz e butë ngjyrë trëndafili që e kishte krijuar dhe e mbante gjallë gjithë këtë tmerr. Në fakultet, në leksionet e para për zanafillën e gjuhëve, kështu i që përfytyruar gjithësia e gjuhëve. Diçka midis oqeanit dhe rrrokovajit botëror.

-Nuk është e rastit që një nga mallkimet më të rënda është: t'u thaftë gjuha, -tha me zë të menduar.

Balli i ndihmësit u vrugua.

-Nuk e fsheh, përherë e më shpesh më shpëton kjo nëmë gjatë dëgjimit, -tha.

-T'u thaftë gjuha, -përsëriti Arian Vogli, duke picërruar sytë, sa herë që rrekej të depërtonte brenda zhguallit të ndonjë shprehjeje të moçme. Ishte i sigurtë se ai mallkim ishte thënë, ndërkaq, kundër tij.

-Desh harrova diçka, -tha Naumi. -Lidhur me proverbin për korbin, më duket se i kam rënë më të përse është fjala.

-Ah, ashtu?

Ndihmësi mori frymë thellë.

-Armiqtë, me sa duket, kanë hapur fjalë se Udhëheqësit tonë sytë i janë dobësuar.

-Ah, ashtu? -ia bëri prapë Arian Vogli.

-Një nga njerëzit tanë më solli njoftimin.

-Hm, -ia bëri shefi, duke iu shmangur shikimit të ndihmësit.

-Kur e dëgjova, u tërbova, -tha Naumi. -Vend i poshtër, thashë me vete, popull mosmirënjos. Si ua nxë goja fjalë të tilla? Ka të drejtë Ai, i madhi, të zemërohet përjetë me këtë vend. Zjarrin t'i vejë. E di që s'kam të

drejtë të ngatërroj armiqtë me krejt popullin, por aq shumë u nxeha, sa e humba. Mallkova gjithçka, njerëzit, shtëpitë, shpirtrat e tyre. Dhe prapë tani, kur e kujtoj, mendja më errësohet. Iu thaftë gjuha, them, dhe kjo më ngjan pak. Në pjelltë të tillë helm, u thaftë më mirë krejt gjuha shqipe.

Mos ki dyshim, atë jemi duke bërë, u përgjigj pa zë Arian Vogli.

Hodhi pakëz kafe të ftohtë në kupën e tij dhe e gjerbi ngadalë.

Gjuha bën mort, tha me vete, duke hetuar se si pezmi po sprapsej me vështirësi nga fytyra e ndihmësit. Veshët gjithashtu, shtoi pas pak, duke ndjerë një drithërimë në trup.

11

Tre vjet më pas dukej se ishte i njëjti fillim dimri, me po ato re dhe me të njëjtin ujë që derdhej qiejsh.

Sa shpejt shkon koha, thoshin njerëzit, duke marrë kafen e mëngjesit. E thoshin këtë gati të gjithë, madje dhe ata që mendonin të kundërtën, se koha ecte shumë ngadalë.

Në të vërtetë askush nuk kishte një mendim të përcaktuar nëse koha kishte rrjedhur më ngutshëm ose më ngeshëm, qysh nga ajo vjeshtë..., nga ajo vjeshtë... kur ...

Prej kohësh, askush nuk i përmendte me zë zëthat. Por edhe në mendimet e njerëzve ato kishin qenë të pranishme një farë kohe, aq fort e në mënyrë aq të ethshme, saqë tani, pas rënies së zjarrmisë, rrinin të skajuara qetësisht, disi mënjanë, si orendentë.

Te shumica e njerëzve ashtu përftoheshin, diçka e ndërmjetme, midis veglës së vdekur dhe gjallesës. Përherë të vockla, si insektet, pa trajtë, pa gjini, madje qysh në krye kur i përmendnin njerëzit, herë përdornin përemrin "ata" e herë "ato".

Krahasimi me kandrat kishte qenë më i lehti përkëdo. Grenzat, mizat, mushkonjat ishin më të përdorshmet në fillim, për shkak të zukamës së lehtë, dridhjes, rrrotullimit rrreth veshit dhe, padyshim, pickimit në fund. Më pas, për shkaqe jo fort të shpjegueshme, (ardhja e dimrit ndoshta, kur insektet zhdukeshin e zëthat jo), ana e veglës nisi të ndihej më tepër. U ranë krahëzat, iu mek zukatja, dhe pavarësisht se nuk u kthyen krejtësisht në vegla, ato u bënë më në fund zëtha.

Një nga fjalët më të moçme të shqipes, si e krijuar enkas për veglën e tmerrshme, dukej se e kishte pritur atë emërtim qysh prej një mijë vjetësh.

Njerëzit e kishin mbledhur më në fund mendjen se do ta ngrysnin jetën me to. Ishte shtuar në jetë diçka që herë përftohej në mënyrë të thjeshtë, si çdo gjë që lidhej me shtypjen dhe kërcënimin e shtetit, e herë-herë, në çastet e rralla kur mendja kapércente kufijtë e lejuar të saj, ngjante si një zezonë kozmike.

Ishte shtuar në botë një vegël-insekt. Që të dëgjonte ç'thoshje qoftë edhe me zë të ulët. Që si korrier qiellor e çonte zërin tënd atje lart, në majën e shtetit. Dhe kjo kandër, ndryshe nga të tjerat, që u ishin dashur dhjetëra miliona vjet për t'u krijuar, ishte shfaqur brenda disa ditësh. Të tjerat, të gjitha më të vjetra se raca njerëzore, ishin krijuar jashtë kohës së njeriut, kurse kjo ...

Pavarësisht se i mendonin a nuk i mendonin këto, njerëzit vendosnin një marrdhënie të caktuar me zëthat. Një pjesë ishin mospërfillës: s'kam gjë me shtetin, as ai me mua, kështu që me zëha a pa zëha, jeta më duket po ajo. Të tjerë vazhdonin të ishin si të mpirë. Vërtiteshin nëpër shtëpi duke bërë "shët", sa herë që dikush hapte bisedë të rrezikshme, përsëritnin proverbin "heshtja është flori", pshëretinin orë e pa kohë. Të tjerë i dëgjonin me përcëmim. Jo vetëm bënин të kundërtën, por shfrynin mllefin kundër petkave, mbi të cilat dyshonin se ishin vënë ose mund të viheshin veglat e pabesa. I futnin në makinën larëse me temperaturë të lartë, i hekurosnin pastaj egërsisht,

duke përfytyruar se si nën hekurin e përvëluar zëthat, duke u shtypur, do të kërcisin si morrat. Qeshnin ha, ha, ha, të kënaqur prej kësaj shfryrjeje, pastaj ndjenin nevojën për të qarë.

Shumë njerëz ishin thyer ndërkaq. Jo vetëm ishin mësuar me zëthat, si me ca kafshëza të zbutura, por herëherë përulja ndaj "insekteve të shtetit", siç i kishte quajtur një zoolog, shfaqeji në një si valë mallëngjimi. Flisnin përto me ëmbëlsi, me plot prapashtesa zvogëluese, i quanin, kushedi pse, "të gjorthit", kishin përherë frikë se mos i dëmtonin, ishin gati t'i ndihnin, si shenjtorët e dikurshëm që i ngrinin nga toka krymbat e rënë, e i vinin prapë mbi plagët e tyre që të ushqeheshin.

Nuk e fshihnin se jo vetëm s'bezdiseshin nga prania e tyre në trup, por ndiheshin më mirë. Le ta dinte shteti se s'kishin kurrgjë kundër tij, i gjorthi, i vogëlthi shteti shqiptar.

Kur e hiqnin pallton ose peliqen, ku ishin të bindur se e kishin zëthin, shketësoheshin përnjëmend. Iu vinte të shkonin drejt e në zyrat e Sigurimit: e hoqëm pallton jo me ndonjë prapamendim, a për t'i mërzitur shokët, por thjesht ngaqë kohëza papritur u ngroh.

Kështu, me gjithfarë trazimesh e si pakuptuar, kishin kaluar ato tre vjet.

Edlira u kthye nga zyra e shefes së kuadrit me fytyrë të prishur. Skënderi priti sa të dilte Nikolla, që kishte ardhur si zakonisht për të ndërruar të rejat e mëngjesit, që ta pyeste se ç'kishte.

Gruaja e re mezi e mbajti dënesën.

-Më kanë thirrur në Degën e Brendshme.

Tjetri u kthye si ta kishin goditur.

-Ah, pa shih, -ia bëri, duke u përpjekur të mbante gjakftohtësinë. -Po përsë, a dhanë ndonjë arsyë?

Ngaqë e ndjeu dhe vetë se pyetja ishte e pakuptimtë,

deshi ta ndërtonte ndryshe.

Edlira e vështronë me sytë e rrëmbushur, si të kërkonte ndihmë.

-Si mendon ti, ç'të jetë?

Këtë herë ishte ajo që tha pak a shumë atë që duhej të thoshte ai.

Skënderi ngriti supet.

-S'di ç'të them. Zakonisht të thérresin gjithmonë pér atë që të shkon mendja më pak. Megjithatë s'duhet të shqetësohesh. Thirrjet në Degën e Brendshme janë një gjë e zakonshme sot.

-Nuk e di në duhet t'ia them tim shoqi.

Ai kafshoi cigaren që e mbante në cep të buzëve.

-Mendoj se s'ke pse të ngutesh. Kur duhet të paraqitesh dhe te kush?

-Në orën një të drekës. Kurse zyrën ose zyrtarin nuk e di. Do ta marrësh vesh atje, më tha shefja.

-Ora sidooqoftë më duket paqësore, -tha ai, duke u përpjekur të buzëqeshte.

Tek hetonte me bisht të syrit fytyrën e bukur të gruas, iu duk se, bashkë me ankthin spikati në të një farë pezmi, nga ata që shfaqen në trajtë pérndritjeje lodruese.

Në të vërtetë përzier me frikën, Edlira ndjente herë pas here një farë zemërimi që, pér habinë e saj, e gjallëronte.

Guxoi më në fund, thoshte me vete. Kaq vite kishte pritur shfaqjen e kthetrave të Arian Voglit, madje kishte menduar se në ç'mënyrë do t'ia tregonte vendin. Mos çaj kryet pér të, i kishte thënë i shoqi. Në kësi rastesh, si me ty, "ata" sa ç'dukan të fuqishëm, aq dhe janë të lëndueshëm.

Mirëpo kishte kaluar kaq kohë dhe mënjanimi i tij prej jetës së saj kishte qenë i tillë, saqë ajo herë pas here kishte provuar një ndjenjë mirënjoheje.

Dhe ja, ujku më në fund ishte hedhur. Pér të zezën e vet ndoshta, i dha zemër vetes gruaja.

Ndër mend i vinin turbull gjithfarë dënimësh që kishin pësuar zyrtarët pér shpërdorim posti lidhur me femrat. Në këtë pikë, pér habinë e të gjithëve, shteti shqiptar

tregohej çuditërisht i paanshëm. Asnjë mëshirë për kuadrot, madje sa më të larta t'i kishin postet dhe sa më të lavdishme të kaluarën, aq më lemerishëm goditeshin. S'besoj se të ka marrë erë koka gjer në atë shkallë sa të guxosh, tha me vete për të dhjetën herë, dhe befas iu duk se ndjeu një ngërç midis zemrës dhe lukthit. E sikur të ishte tjetër gjë?

Guximi e la aty për aty dhe ankthi e kapulloj prapë të gjithën. E sikur të ishte vërtet tjetër gjë?

E çmendur, i tha vetes pas pak. I kishte shkrepur në kokë se ishte thirrur nga ish-i dashuri i saj për t'u ngacmuar dhe, në vend që ta merrte këtë gjë qetësisht, madje zbavitshëm, kishte bërë ojna, e kishte kthyer në diçka kinse tragjike, ishte fyter, pezmatuar, tërbuar, pa i shkuar mendja se ai ngacmim do të ishte lule në krahasim me gjëmat e tjera, që të kallnin datën.

-Ç'mund të jetë vallë? -pyeti Skënderin për të tretën herë.

Bënte sikur i dëgjonte fjalët e tij, por mendjen e kishte gjetkë. Tani do të ishte e lumtur sikur dikush ta siguronte se shefi i Sigurimit të qytetit e thërriste për t'i kërkuar të flinte me të. Veç të shpëtonte nga ankthi i së panjohurës. Madje edhe fjalët e ashpra të fillimit: si guxon ti, që duke përfituar nga posti që ke të më bësh përshtypje apo të më frikësosh?, ishin zëvendësuar në mendjen e saj me fjalë më të buta: dëgjo, Arian, ti e di mirë, po aq sa unë, se ajo histori ka vdekur tani.

Edlira vuri re se Skënderi e shihte orën po aq shpesh sa ajo. Në dymbëdhjetë e pak ajo nxori pasqyrën nga çanta, ripërtériu të kuqin e buzëve dhe pudrën në mollëza dhe u ngrit.

-Merre qetësisht, -i tha Skënderi, duke e përcjellë gjer te dera. -S'kam kurrfarë parandjenje të keqe.

Sytë e të dyve shkuan, kushedi pse, te tryzeza ende e zbrazët e Shpend Guraziut dhe në mendjen e Edlirës, i ngrirë, i shkëputur nga gjithçka, kaloi mendimi se krejt si pa kuptuar kishin ikur ndërkaq tre vjet nga vdekja e tij.

Skënderi e puthi te flokët, pastaj, që pas derës

dëgjoi ca çaste trokitjen e takave të saj që largoreshin.

Te hyrja, ajo u pa edhe njëherë në pasqyrë dhe pyetja a do t'i dukej atij e bukur, pyetje që në një rast tjetër do ta quante të përbuzshme, iu duk krejt e natyrshme.

Gjatë rrugës kishte në mendje të njëjtin pështjellim si në zyrë. Dyshimi se mos e thërrisin për ta bëre bashkëpunëtore të fshehtë, i përzihej me shqetësimin për të shoqin, e të dyja bashkë ndërpriteshin nga mëdyshja se si duhej t'i drejtohej atij, shoku Arian apo thjesht Arian, si dikur.

Ndërtesa e Degës së Brendshme i doli përpara gati befasisht. E habitur vuri re se kishte ardhur shumë kohë përpara. S'është e mundur, tha dy-tri herë me vete. Dukej sikur ndërtesa me tulla të kuqe e kishte thithur dhe ajo nuk kishte ecur por flutuar drejt saj.

Po kthehej në rrugën anësore për të kaluar pesëmbëdhjetë minutat që i mbeteshin gjer në orën e takimit, kur te porta e hekurt, sytë i kapën aktoren Suzanë K., që po delte në atë çast nga ndërtesa.

Përpara se t'i kthjellohej diçka në mendje, ndjeu zjarrminë në faqet dhe dyshimin se mos vallë edhe atë po e thërrisin për të njëjtën arsy që mund të kishin thirrur aktoren e "Pulëbardhës", iu përzie aty për aty me Shpend Guraziun, të cilin po e kujtonte për herë të dytë atë mëngjes, dhe me pëshpërimat për lidhjen e shkurtër midis tij dhe aktore, në prag të vdekjes së tij dhe me klithmën e brendshme: sa turp! Sa turp që iu kishte shkuar mendja se, meqenëse ajo, Edlira, kishte punuar në një zyrë me Shpend Guraziun, rrjedhimisht duhej të kishte pasur lidhje dashurie me të.

Ktheu dhe një herë kryet, për t'u bindur se ishte ajo dhe, një copë herë, e ndoqi me sy tek largohej me kryet e mbështjellë me shall dhe me syzet e errëta, ashtu siç mund të përfytyroshin më lehtë gratë mëkatare.

Përse nuk e lënë të qetë edhe tani pas vdekjes, tha me vete për Shpend Guraziun. Vera e parë e kaluar në plazhin e Durrësit shumë vite më parë, ca zogj britmarakë

mbi det, që nuk i kishte parë kurrë dhe fjalët e ungjit Lazër: besohet se pulëbardhat janë shpirrat e detarëve të mbytur, rrinin pezull në trurin e saj, pa krijuar asnje mendim.

Koha mezi ecte.

Në zyrën e tij Arian Vogli pa orën. Fytyra e ndihmësit e nderur drejt mangetofonit jepte gjithë mundimin, gati-gati vuajtjen e shkaktuar prej moskupimit të fjalëve.

-Ç'dreq shqipeje qenka kjo, -tha për të dhjetën herë. -S'mora vesh asgjë.

-S'ka nevojë ta vesh prapë, -tha ndihmësi. -Edhe njëqind herë ta dëgjojmë, s'kemi për të marrë vesh gjësend.

Ajo që kishte pritur jo pa një farë ankthi prej kohësh, përcudnimi i gjuhës, po ndodhët muajt e fundit me shpejtësi. Shenjat e para i kishte dhënë gati tre vjet të shkuara, fill pas vendosjes së zëthave kinezë, por ato ishin ende të pavërejtshme. Si sëmundja që mahisej së brendshmi ngadalë, për të shpërthyer befas, lëngata e gjuhës pikasej tanë menjëherë.

Të parët e kishin kapur përgjuesit e gjallë. Ankoheshin pérherë e më shpesh, veshët i kishin në rregull, thoshnin, porsa kaluam kontrollin mjekësor, megjithatë qëllon që s'marrim vesh asgjë.

Ato që kapnin veshët e tyre ose s'kishin kurrrfarë kuptimi, ose mund t'u jepje gjithfarë kuptimesh, shpesh herë çoroditëse. Të njëjtën ankesë bënин zbardhësit e shiritave magnetikë. Regjistrimi ishte i shkëlqyer, fjalët e gjuhës ishin po ato, veç diçka ishte prishur në gërshtetimin e tyre. Shprehje të panjohura më parë, nofka, idioma befasuese, aq sa do të besoje se kishe përpara një murmurimë të marrësh.

Si ishte vallë e mundur që do të mjaftonin tre vjet për të trullo sur një gjuhë që thuhej se gjëllonte ç'prej tre mijëvjeçarësh, mendonte shpesh Arian Vogli. Ç'nuk i kishte

shkuar ndër mend atë ditë të lagësht, kur arkat me zëtha kishin mbërritur më në fund në B.

Tani ajo ditë i ngjante si e një tjetër shekulli, kurse ngjarjet e paharrueshme disa javë më pas, herë i dukeshin të largëta edhe ato, e herë sikur kishin ndodhur dje.

Pas "zëthianës", siç e kishin quajtur disa trandjen e shkaktuar prej zëthave, qyteti, ashtu siç pritej, ngjante si t'i kishte rënë pika. Bisedat njerëzore ishin rralluar, gjuha ishte rënduar e trashur, si e njerëzve që u bie pika.

Herë-herë atij i dukej se kështu do të vazhdonte blla-bllaja e tij gjersa qyteti të kthehej në belban të pashërueshëm.

Por në të dalë të dimrit, për habinë e tij, e folura ishte rikthyer, veç këtë herë me një ndryshim të lehtë. Ishte e qartë se ai që atij iu duk si një shtrajtim i parë i saj, s'ishte veçse kundërveprimi i njerëzve për t'u mbrojtur prej përgjimit.

Gjer atëherë sa herë që dëgjonte të flitej për ndarjen e gjuhës shqipe në dy dialekte: veriorin dhe jugorin, i vinte të buzëqeshte. Ndarja e vërtetë, ajo që sa vente shquhej si një humnerë ishte midis shqipes së sipërme, asaj që zotëronte në jetën e përditshme, dhe së poshtmes, të nëndheshmes. Sipas armiqve të shtetit, ndryshe nga gjuha e epërme, që po sëmurej e po thahej prej komunizmit, ishte e poshtmja ajo, që thellë në qilare mbetej e vetmja gjuhë njerëzore.

Dhe ja, nën trysninë e zëthave, kryeneçja e poshtme kishte dhënë krismën e parë. Për herë të parë pas kaq vitesh ishte dukur një prirje afrimi midis të dyjave. Dukej sikur shqipja e epërme kishte gjetur, më në fund, rrugët e fshehta për të depërtuar e pikuar dalngadalë në qilaret plot terr. Ndërkaq simotra e saj e poshtme, ajo që për dyzet vite rresht ishte tallur me shemrën e saj, për herë të parë po bëhej dradharkë dhe po vinte maskat e tjetrës.

E gjithë kjo çudi ishte shkaktuar prej atyre djajve të vegjël me emrin "zëtha". Arian Vogli gjithë kureshti,

pothuajse i mahnitur, e ndiqte gjithçka. Pas shkrirjes së shqipes veriore me atë jugore, njëjësimi po kryhej tani në rrafshin ku armiqësia ishte dukur e përjetshme.

Mirëpo gëzimi kishte qenë i përkohshëm. Si të përmendej nga një makth, shqipja e poshtme i kishte hedhur prapë dredhitë dhe maskat, për t'u mbrojtur me një mënyrë të re, duke u mbrapështuar. Po lindte kështu një shqipe e tretë, e cila për herë e më fort në ndërgjegjen e Arian Voglit po merrte trajtat e një shtrige, prej së cilës ai do të sfilitej gjatë. Nganjëherë i dukej se e kishte krijuar ai vetë atë përbindësh ndaj dhe vetë, në një dyluftim të pafund, do ta mposhtte ose do të mposhtej prej tij.

-S'ke ç'i bën, Naum, -tha ai duke shikuar orën. -E shoqja e inxhinier Gjikondit duhet të ketë ardhur ndërkaq. Do të flas vetëm për vetëm me të.

-Si urdhëron, -tha ndihmësi dhe u ngrit.

Ajo iu duk më e bukur nga ç'e kishte menduar. Kishte atë lloj largësie që mund ta merrje për pikëllim pa shkak, stoli tepër e rrallë e grave të reja, në vitet e para pas martesës. Kështu do ta merrte edhe ai, sikur të mos dinte diçka më shumë.

-Uluni, Edlira, -i tha me zë të qetë. -Duke ardhur këtu, mendja ju ka shkuar, me siguri, për gjëra jo të këndshme dhe ndoshta keni shfryrë kundër meje.

Ajo buzëqeshi idhtaz.

-Nuk e fsheh që po, -tha.

-E pra, po uå them qysh në fillim se, në qoftë se nuk do t'ia lejoja vetes me askënd të shpërdoroja postin tim, me ju nuk do ta bëja në jetë të jetëve.

Gruaja kafshoi buzën e poshtme. Deshi t'i thoshte "faleminderit", por fjala iu duk tepër e varfër.

-Në qoftë se ju thirra vetë, këtë e bëra pikërisht për t'ju paralajmëruar që të mos shqetësoheni.

-Të shqetësohem? Po pse?

Ai u mendua një hop.

-Edlira, më dëgjoni me kujdes. Porsa të dilni nga zyra ime, në zyrën përbri, nga një oficerja jonë ju do të pyeteni për diçka. Por ju nuk duhet të shqetësoheni aspak. Është një hetim rutinë, tepër i shpeshtë në punën tonë.

Balli i gruas së re ishte rrrolur.

-Nuk kuptoj, tha me zë të prerë. -Përse duhet të pyetem? Domethënë, a mund ta di?

-Natyrisht, -u përgjigj ai, duke tërhequr një letër nga dosja. -Ju do të pyeteni për një hollësi në dukje tepër të rëndomtë, që ka lidhje me dikë që s'jeton më dhe pikërisht me inxhinier... ah, po, inxhinier Shpend Guraziun.

O Zot, tha me vete dhe ndjeu se po skuqeji. Qenkësh dyshimi i pakmëparshëm kur kishte parë Suzanë K. të dilte që këndeji.

-E ç'na qenkësh kjo? -pyeti duke u përpjekur ta mbante veten.

Ai buzëqeshi me pamje të shkujdesur.

-Siç ua thashë, është diçka fare e rëndomtë, madje mund t'ju duket qesharake. Oficerja jonë do t'jua shpjegojë, por unë po ju them thelbin: është fjala për një hetim tërësor post mortum, lidhur me të ndjerin. Dhe në një hetim tërësor, siç mund ta merrni me mend, përfshihet gjithçka. Që t'i bije shkurt, ju dhe me siguri, dikush tjetër, do të pyeteni lidhur me veshjet e tij. -Domethënë... -ai e ngriti prapë fletën për të lexuar diçka në të, pastaj me po atë zë të shkujdesur vazhdoi, -domethënë me petkat që ai ka tërhequr nga ajo depua e veçantë, fill pas caktimit si shoqërues i një delegacioni francez.

-O Zot, -i shpëtoi Edlirës. -Si është e mundur?

-Çfarë?

-E keni fjalën për një këmishë të bardhë që unë ia bleva për ditëlindjen e tim shoqi? Vërtet ju ka shqetësuar ajo këmishë?

-Edlira, unë ua thashë, është një hetim rutinë.

-Ky është turp, -gati sa nuk klithi ajo. -Vërtet ju besoni se është krim të blesh një këmishë të bardhë nga

një shok i zyrës? Vërtet ju shikoni në këtë gjë një veprimtari kundër shtetit? Më thoni ju lutem Arian, e besoni vërtet këtë?

Arian, përsëriti ai me vete dhe në çast e kuptoi se nga takimi me të s'kishte pritur ndoshta më tepër.

-Edlira, prisni, -tha ai. -S'është fjala për atë këmishë. Më dëgjoni një herë.

-S'kam ç'ju dëgjoj. Të gjesh një këmishë për ditëlindje dhe tre vjet më pas të të thérresin në zyrat e Sigurimit të shtetit për të dhënë llogari për këtë... Nuk e kuptoni ju se kjo është e tmerrshme... e trishtueshme... Merreni atë këmishë. Kurrë mos u veshtë, kurrë mos u gristë, po shkoj t'ua sjell që tanë.

E ndjeu dhe vetë që s'dinte ç'fliste dhe fill pas kësaj nuk e mbajti dot dënesën.

Tri herë Arian Vogli u ngrit nga vendi, iu afrua, e përqafoi me dëshërim, pastaj lëndimthi ia puthi mollëzat e lagëta dhe flokët e gështenjtë, por vetëm me mendje, sepse trupi, më i rëndë se plumbi, nuk iu bind.

I mbërthyer si me kllapa hekuri sipër ndenjëses, e ndiqte gulçin e saj, ndërsa me vete thoshte: e ftohta, e gjymtuara ime...

Tre vjet më parë, kur kishte kërkuar ta dëgjonte përséri ofshamën e saj të dashurisë, këtë herë fill pas ndalimit të premierës, ishte befasuar. E kishte pritur rënien e saj, por jo gjer në atë shkallë. Ishte një fikje e vërtetë. Nuk mundem, oh, nuk mundem Bardh, i thoshte të shoqit. I kërkonte falje, e merrte me të mirë, dhe prapë me zë të prerë, gati me dënesë i thoshte "jo".

Arian Vogli e kishte ndjerë veten ngadhënjyes. Ëndrra e tij e gjimnazit për t'i ngjarë demonit të Lermontovit ishte njëmendësuar më në fund. Si demoni i Kaukazit kishte zbritur nëpër terr në shtratin e femrës së dëshëruar, për t'ia dëgjuar pshërëtimën. Dhe jo vetëm kaq: ia kishte nxitur epshin me anën e një shfaqjeje dhe ashtu, siç e kishte parashikuar, po me atë shfaqje, ia kishte shuar pastaj. I ftohtë do të ishte sekzi i saj gjer në pranverë,

ndoshta më tej.

Disa javë më pas, kur i kishte thënë ndihmësit t'i sillte një regjistrim të ri, ai i ishte përgjigjur: s'ka asgjë të re te Gjikondët, puna po vete keq e më keq. Dhe pas pak kishte shtuar: si zakonisht pas ngjarjesh të tilla ka ftohje të përgjithshme, sidomos te gratë.

Edlira nuk ishte ngrohur as atë pranverë e as tjetrën. Midis saj dhe te shoqit flitej haptaz për "frigiditet", madje vizitë tek mjeku. Por ngadhënjimi i tij gjithashtu ishte i ftohtë.

E la një copë herë të dëneste, përpara se t'i thoshte prapë të njëjtat fjalë qetësuese.

-Edhe ne kemi burokracinë tonë, Edlirë, -vazhdoi me një zë që asaj iu duk i ndryshëm nga ai i mëparshmi. -Dhe natyrisht kokëçarjet tona... -shtoi me po atë zë të lodhur. -Na kërkohen shpesh gjëra të pamundura.

Ajo nuk e rrokte dot kuptimin e fjalëve të tij. Ajo që kapi disi, por fare turbull ishte tjetër gjë. Më shumë se mirëkuptim, iu duk se ai kërkonte prej saj diçka të ngjashme me dhimburinë.

Kur e kuptoi se duhej të ikte, ajo u ngrit nga ndenjësja, rregulloi me dorë flokët që, kushedi pse, kishte ndjesinë se i kishte të shprishur dhe doli.

Me sy të mbyllur ai ndoqi zhurmën e takave të saj, gjersa e kuptoi se e kishte gjetur derën që duhej.

E plagosura ime, tha prapë me vete. E donte, me sa dukej, si më parë, madje tanë, të ndryshuar, të ftohtë, e donte ndoshta më fort.

Fashat e bardha, që në ndërgjegjen e tij kishin shoqëruar pa dashur përftimin e plagosjes, -fashat e bardha në ballë heronjsh në filmat sovjetikë, kaluan befas tek ai, ashtu si përkëdhelja e pakmëparshme, që tanë e mendonte si të sajën...

Trokitja në derën e zyrës iu duk barbare.

-Jam i zënë, -gati sa s'thirri, pa e marrë vesh mirë se kush e kërkonte. Por ndihmësi nguli këmbë për t'ia shpjeguar. Ishte Xhelo Vranishti, veterani i përkëdhelur i

luftës, prej të cilit nuk vinin veç kokëçarje.

-Thotë se ka një punë me ty dhe me askënd tjetër, -vazhdoi Naumi duke ngritur supet.

-Ç'idiot, -murmuriti shefi. U ngërdhesh disa herë, si ta provonte nëse ftyra e tij ishte ende e aftë të buzëqeshte, pastaj bëri "po" me krye.

-Po ç'të solli xha Xhelo? Ç'u mundove gjer këtu? -tha me atë zë të lartë, që iu drejtohej zakonisht pleqve.

-Eh, mezi më lanë të vij tek ty, -tha veterani. -E di se nuk e kanë qejf Xhelon, sidomos ca bythecë të rinj. Na i solli në majë të hundës thonë, me siguri. Sa të thyejë qafën, thonë. Por mos u mërzitni, do të iki një ditë edhe unë. Do t'ju lë të qetë.

Zëri i plakut u thye nga mallëngjimi.

-Ç'është ajo fjalë, xha Xhelo, -ndërhyri Arian Vogli.

-Ne mezi të kemi. Ne të nderojmë.

Plaku fshiu hundët me një rizë.

-Tani dëgjo, o bir. Kam një kërkesë, por e dua prej teje e veç prej teje këtë.

-Folë xha Xhelo, dhe po të jetë në dorën time ja ku të premtoj që s'ta bëj fjalën dy. Do një armë të re? Revole çeka të tipit të fundit apo italiane? Me siguri të ka shkuar mendja për një italiane.

-Jo, jo, -ia bëri plaku.

Prite kur të më kërkojë ndonjë kallahnikov, mendoi tjetri. Por edhe atë ishte gati t'ia jepte, veç ta hiqte qafe.

-Nuk dua armë, jo, -tha plaku. -Boll i kam edhe ato që kam. Dua tjetër gjë. -U ngrit nga ndenjësja, picërroi sytë dhe ia afroi ftyrën si t'i thoshte një të fshehtë. - Dua një nga ato veglat e tua, një nga ato djallushet e vegjël, zëtha, siç i thoni.

-Si? Si?

Arian Vogli në fillim qeshi. Pastaj, sikur e qeshura të shpërtente një pengesë, e pushtoi krejt, e bëri të ngrihej, të lëvizte krahët, të kthehej gati në ulërimë. "Si? Si?" arrinte të thoshte midis saj, pa mundur të fliste dot. -Oh,-tha më në fund,-s'kam qeshur ndonjëherë kaq.

-S'ka ndonjë gjë për të qeshur, -tha veterani i ngrysur në fytyrë.

-Më fal, xha Xhelo. Më fal. Natyrisht që s'ka ndonjë gjë për të qeshur, megjithatë desha të di ç'të duhet ty ajo vegla?

-Ajo është puna ime. Ti më thuaj vetëm një gjë, ma jep apo s'ma jep.

-Dëgjo, xha Xhelo, po të kesh ndonjë dyshim për diçka, ta zemë se në filan shtëpi, apo mjedis fliten gjëra që duhen dëgjuar, ti na thuaj dhe ne do të vemi në çast ta vemë atë veglën.

Plaku tundi kryet me përcëmim.

-Ato gjëra kërkoi nga spiunët e tu. S'merret Xhelo Vranishti me asi punësh.

-Po atëherë më thuaj, ç'e do? -tha Arian Vogli me zë të butë, për ta marrë me të mirë.

-E dua për qejfin tim, -u përgjigj plaku me zë të prerë. -Ja kështu i shkrepri Xhelo Vranishtit: të ketë një zëth për qejf të vet. Plak jam unë, sot jam nesër s'jam. S'kérkoj pallate, një copë vegël kérkoj, sa një kopsë.

-Po, më kupto, xha Xhelo. Ajo vegël sa një kopsë, që thua ti, hyn në të fshehtat e shtetit. Askush s'ka të drejtë...

-Një Xhelo Vranishti ka Partia, -e ndërpren tjetri.

-Ma plotësoni këtë maraz të fundit. Të iki i qetë nga kjo botë.

Ndërsa fliste, Arian Vogli nuk ia ndante sytë. Kishte në zërin e tjetrit një brengë që gjer atëherë i kishte shpëtar. Dhe befas iu duk se e zbuloi arsyen e kërkësës së çuditshme. Një çështje nderi, me siguri. Ose më mirë dyshimi për ndonjë tradhti bashkëshortore të ndonjërs prej nuseve të djemve ose të nipave. Dy vjet më parë, në një mbledhje vjetore në shkallë republike ishte përmendur një rast kur zëthat ishin përdorur për çështje vetiakë.

Nuk e pati vështirë ta merrte me të mirë plakun për t'ia shkulur arsyen. Ajo që kishte dëgjuar prej tij e kishte lënë me gojë hapur: Xhelo Vranishti nuk e kërkonte zëthin

për çështje nderi e as për zbulim kusarie. Ai donte t'ia vinte përgjuesin shemrit të vet, veteranit Arif Dukës, me të cilin kishin qenë bashkë në luftë në të njëjtin batalion, njëri komandant e tjetri komisar. Prej kohësh Xhelua dyshonte se tjetri, gjatë darkave të tij, pasi merrte vrull nga rakia, s'linte rast pa ngritur veten e pa ulur meritat e Xhelos në luftë. Ja kjo po ia helmonte ditët e fundit Xhelo Vranishtit. Më keq se dhimbja e kockave, më keq se përdhesi. Dhe nuk donte të ikte nga kjo botë pa e zënë me presh në duar shemrin e vet...

Pas ikjes së veteranit Arian Voglit nuk i qeshej më. Ishte e mundur vallë që për një kohë kaq të shkurtër zëthat të ishin futur në themel e jetës? Do të besohej se që nga veshjet kishin depërtuar në lëkurë dhe që andej, dalngadalë, duke gërryer mishin dhe ashtin, zbrisnin përherë e më thellë.

Që të ndjenin trazim prej tyre brezat e rinj, kjo ishte e kuptueshme. Por të përgjërohej për ta një dinozaur i luftës si Xhelo Vranishti, kjo nuk pritej. Tani s'mbetet gjë tjeter veç të thureshin për to balada epike, si ato të moçmet, me orë dhe me zana.

S'është çudi, tha me vete. S'ishte vërtet ndonjë çudi. Në këngët e vjetra, sidomos ato të veriut, heronjtë merrnin fuqi të mbinatyryshme, duke bashkëpunuar me orët, ose duke pirë qumësht nga një sisë zane. Xhelo Vranishti kishte kërkuar pothuajse këtë gjë, fuqinë e mbinatyryshme të zëthave, për të mposhtur shemrin e vet.

E pabesueshme, tha me vete.

Orët, zanat, zëthat. Fjala renditej natyrshëm krahas simotrave të vjetra. Pa dashur, në mendjen e tij nisën të sajoheshin vargje sipas gjedheve të hershme. Fluturoi një zëth i zi. Ose: zëthi i zi solli mandatën.

Ai u ngrit dhe nisi të vejevinte nëpër zyrë. Donte ta conte mendjen në të tjera gjëra, te Edlira, sidomos te butësia e syve të saj në çastin e fundit, por një tufë ndërhyrjesh nuk e linin. Telefonimi nga qendra për çështjen e Shpend Guraziut, një letër padorase kundër një zyrtari

të lartë, dy vrasje të pazbuluara, vetë zëthat që pasi kishin venitur seksin e grave, e pasi kishin përcudnuar gjuhën, tani kërkonin të bënин pjesë në familjen e hyjnive të vogla shqiptare.

Djallushë të vegjël, ç'do të kërkoni vallë më pas, tha me vete, gjysmë me të qeshur, gjysmë me mallëngjim. Ishin përherë ushtria e tij besnikë dhe ai duhej të ndihej vërtet i mbinatyrrshëm me ta. Arian Vogli dhe tridhjetë e nëntë zëthat e tij. Hm!

Buzëqeshi me vete ndërsa ndjeu nevojën të dremiste qoftë dhe disa çaste. U ul prapë në ndenjëse dhe mbështeti ballin mbi shputat e duarve. Midis dremkës, vargani i zëthave herë i përfytyrohej si grumbull rojesh, herë si tufë qensh, me zilkat e vogla që tringëllinin ultas.

Ishin të tijtë, sidoqoftë, dhe në orën e ligë do ta mbronin me siguri gjatë dyluftimit.

U përmend shpejt dhe gati i trembur pyeti veten: dyluftim me kë? Kokën e kishte të turbullt dhe zgjati dorën te zilja për të porositur një kafe. Dyluftim me qytetin, pa dyshim. Dhe me njerëzit në përgjithësi. Por prej tyre ai nuk kishte frikë. Ishte një tjetër forcë që e akullonte. Por ajo ndodhej përtej të dyjave, madje përtej shtetit.

Ai i ra ziles, por në vend të kafesë porositi t'ia sillnin përsëri dosjen e plotë të çështjes "Guraziu".

Edlira e kaloi mesoren pothuajse duke rendur, por në zyrë s'gjeti askend. Nikolla, në zyrën fqinjë gjithashtu nuk ishte. Do të jenë diku bashkë, tha me vete.

Trazoi një copë herë shkresat mbi tryezë, pastaj i la ato dhe hapi çantën për të nxjerrë pasqyrëzën, thua se midis dosjeve kishte kërkuar atë.

Me siguri ai kishte ndjerë dëshirën ta puthte. Ndryshtë s'kishte si të shpjegohej ndjesia e saj se të kuqtë e buzëve i ishte fshirë.

Skënderi që hyri pas pak nuk e fshehu habinë kur e gjeti me pasqyrëz në duar.

-E? -ia bëri. -S'ishte aq e tmerrshme, apo jo?

-Një gjë e kotë, -u përgjigj ajo. -Një marrëzi do të thoshja. Së paku mua kështu m'u duk.

Gjithë vëmendje, ai e dëgjoi pa e ndërprerë asnje herë. Dy vratat e vogla mbi ballë nuk i lëvizën edhe kur ajo i tha se atë, gjithashtu, do ta thërrisin.

-Hetim për petkat e dikujt që ka tre vjet nën dhë, -tha më në fund i menduar. -E çuditshme, madje është pak ta quash kështu.

Ajo nuk ia ndante sytë kostumit të tij të zi.

-Mua m'u duk një trill maniakësh, -tha pas një heshtje. -Ndryshtë s'mund ta besoj kurrë që lufta kundër shpërdorimeve në këtë vend ka shkuar aq larg saqë u bëkan hetime edhe për një gjë kaq të thjeshtë.

-O, jo, -tha ai. -Këtu me siguri ka tjetër gjë.

-Çfarë? -ia bëri ajo me zërin që iu dobësua papritur.

-Këtu ka tjetër gjë, -përsëriti Skënderi. -Nikolla më tregoi se dje janë thirrur në Degë dy njerëzit që janë marrë me vendosjen e trupit të viktimit në arkëmort.

-Ah, ashtu?

-Ndërkaq ti më thua se ke parë duke dalë nga Dega aktoren me të cilën, dihet tashmë, ai ka pasur një lidhje dashurie. Me një fjalë, kërkohen dëshmi të shumëanshme.

-Po ç'lidhje mund të ketë midis vendosjes së trupit në arkëmort dhe aktore, ose petkave që ai na i dha ne?

-Atë po vrash mendjen edhe unë, -tha tjetri. -Që këtu ka një enigmë, kjo s'do shumë mend për ta kapur.

Ndonëse ai ishte kthyer nga dritarja, edhe pas shpinës ajo ia ndjente trazimin.

-Ti thua se këmbëngulën të dinin se ç'veshje kishte atë natë kur shoqëronte francezët në teatër, -vazhdoi ai me zë të zvargur. -Me siguri, ata që u morën me arkëmortin janë pyetur për të njëjtën gjë. Buldozeristi si dhe ata që u ndodhën aty pranë, do të jenë pyetur gjithashtu. Shkurt një hetim tipik nga ata që quhen "njojje e trupit të viktimit".

Ai u kthye befas, me fytyrën që asaj iu duk krejt e zbehtë. -Askush nuk e ka parë trupin e Shpend Guraziut. E sikur të ketë një dyshim se është gjallë!?

-Shpendi, gjallë!? Ku të paska shkuar mendja, -tha ajo.

Ai ishte kthyer prapë nga dritarja si të donte që ajo tē mos ia shihte fytyrën. Në tē vërtetë, i turbull siç qe, kishte thënë diçka pa kuptim, për tē fshehur dyshimin tjetër, atë tē njëmendtin: e sikur ta kishin vrarë?

Qindra herë, gjatë atyre tre vjetëve kishte vrarë mendjen nëse Shpend Guraziu kishte arritur vallë t'u kalonte një kumt senatorëve francezë. Netë tē tëra kishte dëgjuar "France inter"-in, për tē kapur ndonjë shenjë, ndonjë përgjigje tē largët, tē tërthortë, tē humbët. E dinte dhe vetë se kjo ishte një shpresë e kotë, më e pamundur se kërkimi i një zogu tē veçantë midis tufave tē shpendëve që fluturonin mbi oqean. E megjithatë ai kishte vazhduar tē shpresonte. Dhe ja, ishte dashur ky mëngjes që dyshimi i tmerrshëm ta shponte si thikë. E sikur tē ishte treguar i pakujdeshëm dhe Sigurimi t'ia kishte kapur kumtin? Ose senatorëve në hotel t'u kishte shpëtuar një fjalëz? E sikur pastaj, i tmerruar nga kjo, i tmerruar, sidomos, nga një përgjigje e mundshme. Sigurimi, pa e menduar gjatë, me ngut, i çmeritur nga paniku se mos kumti francez kalonte, krejt si banditët që gjëja e parë që bëjnë në rast rrezikimi është këputja e fillit ndërlidhës, Sigurimi, pra, e preu atë fill, domethënë jetën e Shpend Guraziut?

O, jo e kundërshtoi aty për aty vetveten. Sado tmerr tē kishte shteti shqiptar nga kalimi i kumteve, ai kishte kaq përvojë sa ta përbante veten dhe t'i rripte shtatë pashë lëkurë Shpend Guraziut për tē zbuluar tē vërtetën. Veç kësaj, në qoftë se e kishin vrarë vetë, përsë do ta bënin këtë rihetim pas tre vjetësh?

Jo, një mijë herë jo, tha me vete.

Atëherë ç'ishte kjo, gati sa nuk uluriti.

Dyshime tē tjera, njëri më i çartur se tjetri ia përshkonin si vetëtimë trurin. E sikur ta kishin arrestuar

Shpend Guraziun në çastin kur kishte dalë nga makina për të telefonuar dhe aty për aty kishin sajuar kinse vdekjen e tij, domethënë shtypjen nga një buldozer të ndonjë njeriu tjetër, ose të ndonjë kukulle të veshur si ai, në mënyrë që në heshtje të plotë të kryenin hetimin dhe torturimin e tij?! Dhe pastaj, pas tre vjetësh në ferr, ai ishte thyer, më në fund dhe kishte nisur të fliste.

O, jo, rënroi prapë me vete dhe aty për aty i kërkoi ndjesë të vdekurit, që po e trazonte në paqën e tij.

- Jo, - tha më zë të lartë duke u kthyer nga ajo.

- Duhet të jetë diçka që, ose ne nuk jemi në gjendje ta kapim, ose është vërtet e pakapshme.

Sytë e tij ngjanin të zbrazët krejt. Ndërsa me vete thoshte: një seancë spiritizmi... Ja çfarë kishte qenë e nevojshme më shumë se kurrë.

I përfytyroi flakëzat e qirinjve dhe zërin e mediumit që i lutej Shpend Guraziut t'u jepte një shenjë shokëve të vet.

Drithëtira në shpirt sa vente i shtohej.

Kështu, me sa duket, do ta kërkonin njëri-tjetrin me radhë, herë pas here, nëpër terr e moskund.

Në zyrën e tij, Arian Vogli po i hidhte një sy të fundit dosjes "Shpend Guraziu", që do ta niste me ngut për në qendër.

Përfshihej në të proces-verbalit i vjetër, mbajtur para tre vjetësh kur, pas rënies në sy se "princi" me numër 017B mungonte, ishin kryer të gjitha hetimet e mundshme në kësi rastesh. E para, pas vërtetimit se "i princëzuari" kishte vdekur gjatë kohës kur e kishte me vete sendin, ishte kryer bastisja e apartamentit për gjetjen e veshjes, (një xhup i prodhimit perëndimor), në të cilin, sipas dëshmise së teknikut të sigurimit V.M. si dhe përgjegjësit të depos së mallrave, ishte vendosur "princi".

E dyta, katër dëshmitarë të tjerë: buldozeristi që

shkaktoi padashur vdekjen e viktims, shoferi i makinës së delegacionit francez si dhe dy punëtorë të ndërmarrjes së mirëmbajtjes së rrugës, që u ndodhën në vend, kanë pohuar se njeriu në çastin e vrasjes ka patur të veshur xhupin në fjalë, (xhup i markës së huaj, ngjyrë kafe, sipas buldozeristit, xhup "austriak" sipas shoferit, xhup i huaj ngjyrë kafe të mbyllur, sipas dy punëtorëve rrugorë).

E treta, dy punonjës të komunales, që ishin marrë me vendosjen e trupit në arkëmort, kanë pohuar pa kurrfarë ngurimi se në pamundësi për ta shqitur trupin e copëtar nga veshja, e kishin kallur ashtu siç qe, bashkë me xhupin e gjithçka tjetër, në arkë. Pas mbylljes, arkëmorti nuk ishte hapur më, rrjedhimisht, viktima ishte varrosur bashkë me veshjet dhe "princip" 017B.

E katërtë, meqenëse të gjitha këto hetime u bënë në kohën e "vjetes së parë të princave", domethënë tre javë pas vdekjes dhe varrosjes së viktims, çështja e humbjes së "principit" 017B "për shkaqe e rrethana të jashtëzakonshme" u quajt e mbyllur.

Lënda tjetër e dosjes, proces-verbal i dytë i sapo hartuar, ishte edhe më i hollësishëm se i pari. Përveç dëshmive të vjetra që ishin ripërtëritur, ishin shtuar dëshmitë e rrobaruajtësve të teatrit, të aktorez Suzanë K., me të cilën viktima kishte patur një lidhje të shkurtër dashurie, pikërisht, në kohën e ndodhise, si dhe pritej shtesa e dëshmive të dy shokëve të zyrës, të cilëve viktima u kishte shitur teshat që, pasi i kishte tërhequr nga tregtia speciale, i ishin dukur të panevojshme për të.

E qartë sa s'ka ku të vejë më, tha me vete Arian Vogli, pasi lexoi edhe një herë frazën përmbyllëse ku theksohej se groposja e "principit bashkë me viktimin ishte diçka e vërtetuar katërcipërisht".

E qartë, madje më fort se ç'duhet, mendoi. Madje një mendje e zgjuar do ta kapte që atje tej se hetimi për kostumin dhe këmishën e shitur kishin qenë të panevojshme dhe ishin bërë vetëm për të dhënë mendimin se kjo punë ishte zhbiruar me kulm e me themel.

E mbylli dosjen dhe lëshoi një psherëtimë. Tre vjet kishin mjaftuar për t'i çmendur të gjithë, mendoi pas pak. Duke përfshirë edhe ata lart, në qendër.

Nganjëherë i dukej se qendra, që e dinte dhe e drejtonte gjithçka, s'kishte kurrfarë arsyё të çmeritej. Por kishte ditë kur i dukej se pikërisht nga që atje grumbullohej gjithë ai helm, ajo mund ta humbiste e para fillin.

Tre vjet, tha me vete, sikur të ndërmendohej për gjënë më të pabesueshme. "Princat" ishin mbjellë e vjelur shumë herë, (ishin mbarsur e kishin pjellë, siç thoshte ndihmësi), kishin çuar në burgje e internime dhjetëra njerëz, disa herë familje të tëra, e kishin bërë një qytet të tërë të fliste si në makth, e megjithatë atje lart ishin përherë të pakënaqur. Gjithmonë gjenin një shkak për të prishur buzët. Ja, tani i ishin qepur këtij qyqari, nesër kushedi ç'mufka do të nxirrin.

I vinte prapë gjumë. Ktheu kryet nga dritarja dhe e kuptoi se shiu që sapo kishte nisur përashta, ia sillte atë fikje. Ishte një shi i pjerrët, i shtrembët, që mjegulla që e mbështillte dukej sikur e merrte me të mirë, për t'ia zbutur furinë.

Ai kundroi një copë herë pullazet e lagët. Fjollat e zeza, që kërlesheshin sipër tymtarëve të qytetit, iu duk se e jepnin më mirë se gjithçka egërsimin e tij.

Po afronte ditëlindja e Udhëheqësit. Ashtu si çdo vit, pritej shtimi i murmurimës së zezë. Si ullukët që grumbullonin shiun, zëthat e tij do të mblidhnin gërgamën njerëzore. Ditë e natë, parreshtur kurrë. Nganjëherë i dukej se dhe në gjumë ndjente rrotullimin e shiritave të tyre.

I tirnin fijet e fatit, si fatet e moçme.

Nganjëherë, i egërsuar edhe vetë më keq se qyteti, i vinte të ulurinte: mbylleni atë gojë!

Një çast dremiti dhe vetja iu duk si një murg i rreckosur në krye të një aradheje që herë ishin zëthat e tij e herë kryqëzata e fëmijëve, që e cte drejt varrit të Krishtit.

C'makthe pa kuptim, mendoi duke tundur kryet.

E thirri ndihmësin dhe, duke i dhënë dosjen, i tha:

-Plotësoje me dy dëshmitë e fundit dhe nise me ngut në qendër.


-Si urdhëron shef, -tha tjetri.

Te dera mbajti këmbët, ngaqë e dintë se ishte çasti kur shefi jepte zakonisht ndonjë udhëzim të fundit.

Dhe nuk gaboi.

-Dëgjo, Naum, -tha Arian Vogli. -Gjersa qendra të qetësohet lidhur me këtë çështje, për çdo rast, veri në "përpunim" të gjithë ata që kanë patur lidhje me viktimën. Ditë e natë, -shtoi pas pak.

Ndihmësi bëri "po" me krye.



Zhurma e mbytur, që vinte valë-valë nga lart, bënte që kalimtarët të mbanin një grimë hapat e të ngrinin kryet. Në të dy kafenetë e qendrës njerëzit afroheshin te qelqnaja si për t'u sigruar se ai, që pak më parë u ishte dukur si gjëmim moti, ishte tjetër gjë.

Qielli ishte i mbyllur dhe përveç oshëtimës nuk jepte asgjë tjetër. Në tryezat njerëzit përpinqeshin të kujtonin, ndërkaq, se sa kohë kishte kaluar që në qytetin B. nuk ishte ulur ndonjë helikopter. Disa këmbëngulnin për tre vjet e të tjerë nuk ishin të sigurtë.

Një pjesë mezi e fshihnin turbullimin. Kérkonin me sy kamerierin për të paguar kafenë e për të ikur me ngut drejt shtëpisë. Të tjerë, sidomos, ata që prej kohësh prisnin përgjigje për ankesat e tyre ose për kallëzimet që kishin çuar me shkrim drejt e në Komitetin Qendror, porosisnin nga një kafe të dytë, e gjerbnin me sy të dergjur, ashtu siç kishin bërë sa herë që ishte hapur fjala se nga qendra kishte mbërritur diçka e rëndësishme.

Skënder Morina iu afrua dritares dhe e kërkoi më kot në quell makinën fluturuese. Fjalët "ç'është ky helikopter", që kushedi pse priste të dëgjonte nga Edlira, i shkaktonin ndërkaq ankth.

Më në fund, ajo i tha dhe ai ngriti supet.

-Ka dhjetë minuta që vërtitet dhe ende s'po ulet, - tha me zë të ulët. -Siç duket për shkak të motit të keq.

Qyshse e kishin thirrur në Degën e Brendshme, një parandjenjë e keqe nuk i ndahej. Dhe ashtu, si qindra të tjerëve, turbull i dukej se ai helikopter po vinte për të.

Një tjetër njeri kishte lënë tryezën e punës për të hetuar me sy të ngrirë qielin, Arian Vogli. Ishte i vetmi që e dinte përsë po vinte helikopteri në B. Frika e mjegullt prej tij, i përzihej më një ndjenjë hakërrimi, për t'u ndeshur sa më parë me njerëzit që ishin brenda tij, e të dyja bashkë, me dëshirën e fshehtë që helikopteri të rrëzohej.

Pas marrjes së dosjes së Guraziut, qendra, në vend që të qetësohej, siç kishte shpresuar ai, ishte hakërryer më keq. Pas disa telefonimeve të vrazhda dy orë më parë, e kishin lajmëruar se një grup hetimor po vinte për të parë çështjen në vend.

Grup hetimor për humbjen e një zëthi të tipit "princ", përsëriti me vete. Edhe një princ trashëgimtar të kishte humbur, s'do të bëhej kaq zhurmë, i kishte thënë ndihmësit. Ndërkaq e kishte ndjerë se mahia ishte e atillë që në vend që të lehtësonte, të helmonte më keq.

Për të dhjetën herë kishte shfletuar kopjen e dosjes, por për habinë e tij, ato pjesë që pak më parë e ngushëllonin dhe i krijonin besim, si p.sh.: "pasi u arrit në përfundim se sendi ishte varrosur bashkë me kufomën, njëzëri u hoq dorë nga gjetja e tij, madje u përdor shprehja: nuk do të hapim varret si hijenat..."; një çast më pas i dukeshin të pabesa.

Uturima e helikopterit u ndie një farë kohe aq fort, saqë u duk se prej shtypjes së saj po dridheshin qelqet. Kërkoni të më trullojni, tha me vete Arian Vogli. Por shihni se mos thyeni kokën.

Tani, fare haptas, e dëshironte përmbysjen e tyre. Qielli, krejt i zymtë, dukej se ishte me të. Madje, një herë, kur gjëmimi i fluturuesit u fashit, gati sa s'thirri: Thyeni qafën andej nga keni ardhur. I dukej se mjaftonte që ai helikopter i nëmur të ikte, e gjithçka do të merrte udhën që duhej.

Por oshëtima, më kërcënuese se më parë, ia behu përsëri. I lodhur, ai u ul te tryeza, mbështeti kryet mbi duar dhe priti.

Mbërritën pas gjysmë ore, më të zymtë dhe më hijerëndë se ç'i kishte menduar. Siç duket, moti i keq përmes të cilit kishin udhëtuar për shkak të tij, ua kishte cingërisur nervat.

Fjalët që thanë s'ishin më pak të hidhura. Qendra kishte pritur një qëndrim më serioz të tij lidhur me dosjen e "principit" 017B. S'ishte fjala për një përgjim të rëndomtë, por për një kumt që tre vjet më parë armiqtë e brendshëm arritën, me sa dukej, t'ia kalonin, nëpërmjet senatorëve francezë, NATO-s, krejt Perëndimit. Ka të dhëna për kalimin e kumtit dhe ndoshta të përgjigjes, por ne nuk dimë asgjë, as për njérën, as për tjetrën. Dhe e gjithë kjo për shkak të syleshtësisë tuaj. Sepse fillin që do të na conte te burimi i së keqes, ju e humbët. Dhe në vend që të shqetësoheshit thellë për të, na dërgoni raporte pas raportesh për të përligjur atë humbje, për ta nënveftësuar, duke përdorur madje dhe shprehje zonjushash intelektualiste si ajo e hijenave etj.

Një farë ngrirje e qafës, që i jepte fytyrës së Arian Voglit shprehjen e kryeneçesisë, ishte e para që u lëshua, përpara se ai vetë të ligështohej. Befas e ndjeu veten fajtor. Krejt ngrefosja e mëparshme, bashkë me padurimin për t'ua thënë gjithçka në sy, ç'kërkoni prej meje, kam tre vjet që rrropatemi si qen midis urrejtjes dhe helmit, për t'i shërbyer çështjes, dhe në vend të një fjale të mirë s'më vjen veç ky pezmatim, dhe përse, për një farë zëthi, një vegle të vockël sa një kopsë; pra gjithë shfryrjet me të cilat i kishte dhënë zemër vetvetes ato ditë, u tretën aty

për aty.

-Jam fajtor, -tha me zë të ngadaltë. -E ndiej veten dyfish fajtor, për atë që ka ndodhur dhe për moskuptimin e rëndësisë së saj. Jam gati të bëj çmos për ta shlyer fajin, -shtoi pas pak, pasi priti më kot që ata të thoshin diçka. -Më thoni, ç'duhet të bëj.

Ata shikuan njëri tjetrin.

-Asgjë, -tha njëri prej tyre. -Tani është tepër vonë. Arian Vogli ndjeu zbrazëtirë në lukth.

-Nuk kuptoj, -tha me zë të këputur.

E mori me mend se si ata u vështruan prapë në sy, por nuk e ngriti kokën t'i shihte.

-Desha të them se për zëthin e humbur, pra për gjithçka që lidhet me të, është tepër vonë tani.

Natyrisht, mendoi. Ishte vonë. Inxhinier i vdekur, ç'bën tre vjet pa tretur... Princi i vogël kishte tre vjet nën dhé...

Të gjitha çka u thanë i erdhën e i rierdhën ndërmend, ndërsa lart në qiell ndihej gjëmimi i helikopterit që, sa vinte largohej.

-Po ikën, -tha Edlira, duke u zgjatur te dritarja, me sytë drejt qiellit.

Njerëzit kishin ndalur prapë ndanë udhës ose ishin afruar te dritaret për të gjetur drejtimin nga po ikte. Gjithsesi nuk gjenin dot, nëse ishte mirë që po largohej kaq shpejt, apo përkundrazi.

-Një ngut i tillë, -tha Skënder Morina pa lëvizur nga vendi.

Arian Vogli në zyrën e tij kërciste gishtat. Uturima e helikopterit para se të tretej dha një hungërimë të fundit, aq sa iu duk se i dhembën veshët. Veshët gjithashtu bënин mort, mendoingrirazi.

Një copë herë qëndroi ashtu, fare i zbrazët, si i varur mbi një humnerë. Pastaj i tha vetes: idiot!

Ishte treguar vërtet idiot i pandreqshëm kur dyshimin se shteti nuk i donte kurrë ata që ia mësonin të fshehtat, e kishte lidhur përherë me të tjerët e rrallë me veten e vet.

I zbrazur nga oshëtimi e helikopterit, qëlli ngjante edhe më i rënduar.

Te dera e tij, ndihmësi po trokiste për të dytën a ndoshta të tretën herë.

E vështronte në sy, pa dëgjuar asgjë nga ato që i thoshte. Më në fund, si i përmendur nga gjumi, tha:

-S'ma merrte mendja se ajo gjë e vockël do të ma hante kokën.

Naumi e vështronte me ca sy të shqyer. Më në fund i tha:

-Është shpejt të flitet për ngrënie koke.

-Ashtu mendon ti?

Ndihmësi vazhdoi të rikujtonte ditën kur ishin marrë me atë që, tre vjet më parë iu ishte dukur një ndodhi më se e përligjur, humbjen e një zëthi, qoftë ky edhe "princ". Madje, njeri nga oficerët ashtu edhe kishte thënë: po ai është "princ", dhe ishte pikërisht Naumi që i ishte përgjigjur: princ ose joprinc, s'kemi ç'bëjmë, le ta marrë me vete në atë botë. Kurse dikush tjetër kishte shtuar atë frazën përijenat.

Arian Vogli trokiste gishtat në tryezë, si të përpinqej të mbante ritmin e një këngë. Në të vërtetë fjalët "Inxhinieri i vdekur, ç'bën tre vjet pa tretur" ashtu i përsëriteshin në mendje, në trajtën e një këngë, ku fjala "inxhinier" herë zëvendësohej me emrin Guraziu e herë me Shpend i Zi.

-Dëgjo, -e ndërpren më në fund tjetrin. -Më gjej të dhënat teknike të "princëve" dhe m'i sill menjëherë. Disa çaste më pas ndërsa e shfletonte fletoren shkroftëtinte me vete.

Le ta marrë me vete në atë botë, kishte thënë një nga oficerët. Tani nuk mund ta mendonte gjithçka veçse ashtu, pa kurrrfarë shprese: të vdekurin që ikte nëpër kaos, me atë zëthin e vockël në trup, ndërsa ata të gjithë e

ndiqnin pas, si shtjellë e zezë.

Si në ethe, gishtat e tij shfletonin fletët. Princat ishin të paprishshëm prej dëborës, shiut, goditjeve të gjithfarëshme. Ata i përballonin temperaturat e larta gjë më gjashtëdhjetë gradë mbi zero dhe po aq nën zero.

Atje, ku je ti, është ftohtë, shumë ftohtë, tha me vete Arian Vogli dhe befas i erdhi të klithte: s'ke për të më shpëtuar dot.

S'kishte për t'i shpëtuar sado thellë të ishte struktur. Qiell e dhë do të përbyste gjersa ta kapte. Hienë e më keq do të bëhej.

Ngrehu demon, i tha vetes, shfaqu!

Tani besonte vërtet se gjatë tridhjetë e dy vitesh, trajta e tij njerëzore me vështirësi ia kishte fshehur thelbin tjetër. S'kishte qenë e rastit që, qysh nga mosha katërmëdhjetëvjeçare s'kishte èndërruar veç vetminë madhështore të demonit lemontovian.

I mpirë, ndihmësi po rrekej të kapte ç'ndodhë me shefin.

Arian Vogli ngriti kryet dhe tha diçka të pabesueshme. Pastaj diçka tjetër po aq të çartur, pas së cilës ndihmësi e vështroi me atë frikë e adhurim, me të cilën s'mund të kundrohej veç djalli.

Ajo që ndodhi pastaj ishte e tillë që, as atë natë e as më pas, nuk mund të riprodhohej kurrsesi në mënyrë të qartë. Ngaqë në trurin e secilit pjesëmarrës në ngjarje pati ngrirje të herëpashershme, koha e humbi rrjedhën e gjithunjishme, çka solli që në secilin tru të kishte ngecje në vend, përshpejtime ose lëvizje mbrapsh të saj.

E gjithë kjo çkurdisje ndikoi pastaj në krejt përftimin e ngjarjes, e cila, e mjegullt dhe e copëzuar, notonte si copëra akujsh, e ngjashme më fort me një makth se me një ndodhi të njëmendtë.

Urdhri i Arian Voglit për të gjetur e për të thirrur

me ngut përgjegjësin e varrezës së qytetit bashkë me dy varrmihës, rendja e makinave të Degës drejt varrezës, rrithimi prej tyre i varrit të Shpend Guraziut, (emra të tjerë të vdekurish, të gdhendur mbi rrasha mermeri shfaqeshin anash si turmë kureshtarësh nën atë ndriçim të mundimshëm projektorësh), të gjitha këto të shoqëruara nga lehje të shumta qensh të katundit fqinj me varrezën, me kujtime të ndjekjes se diversantëve, ose të gjahut të zyrtarëve të lartë, të mjegulluara gjithash tu nga mosdija e saktë, ose dija e pjesshme e arsyes së asaj rendjeje të marrë; të gjitha këto ndikuan që te disa nga pjesëmarrësit në ngjarje të krijohej mendimi se po merrnin pjesë në një ndjekje, ku i ndjekuri mund të ishte njëkohësisht keqbërës, bishë ose fantazmë.

Kaq i fortë ishte ky përftim i parë, saqë edhe kur u kuptua se përse ndodheshin atje, madje kur u duk qartë se ajo çka u rrithua prej dritave verbuese të makinave, nuk ishte as armik i plagosur e as bishë, por një-varr, ai përftim fillestar vazhdoi të mbetej zotërues.

Përbri varrit po shtronin, ndërkaq, një napë plastike, nga ato të serrave. Përgjegjësi i varrezës, me fenerin ende të ndezur në dorë, iu thoshte diçka varrmihësve, të tjerët duke u dridhur nga e ftohta vështronin varrin. Pritej shefi.

Gjithmonë për shkak të ngrirjes së kohës, Arian Voglit iu duk se "GAZI 69" i tij e bëri rrugën gjer në varrezë jo nëpër rrugën automobilistike, por nëpër re. Dhe jo vetëm atij. Një nga varrëmihësit, vite më pas, vazhdonte të ngulte këmbë se ai ia kishte behur nga lart, si xhebrahili.

Nën urdhrat e tij nisi hapja e varrit. Dëgjohej zhurma e mihësve, e shoqëruar nga pëshpërima, që nganjëherë ngjanin si lutje. "Kujdes", thoshte dikush me zë të hollë. Mihësit kishin ndeshur në dërrasat e arkëmortit. Ai vetë, nën trysninë e dheut, ishte krejt i vithisur. Është e pamundur të nxirret arkëmorti, thoshte dikush, që kishte zbritur në gropë. Është bërë njësh me dheun, edhe eshtrat. Arian Vogli u përmend nga mpirja. Atëherë merreni krejt dheun bashkë me eshtrat.

Ai e dëgjoi urdhrin e tij të përmendej dy-tri herë dhe ashtu jashtë tij iu duk i çuditshëm. Merreni krejt dheun, bashkë me eshtrat, ja ku e keni plastmasën.

Grumbulli i baltës së zezë sipër plasmasës, sa vente rritej. Eshtrat mezi dalloheshin midis saj. Toka paskësh qenë e lagësht, mendonte Arian Vogli. E mirë për të tretur trupin. Por jo për zëthin. Princ i vogël, pshëritiu me vete. Princ i vogëlibë i vdekur.

Kur menduan se gërmuan mjافت baltë, e ngritën, duke e mbajtur për cepash plastmasën dhe me vështirësi e ngarkuan mbi një kamion.

Rrugës së kthimit, qentë e katundit nisën prapë lehjen.

Në laboratorin e Degës së Brendshme, teknikët, me dorashkat prej gome të ngjeshura gjer në bërryla, prisnin të heshtur.

U deshën gjashtë vetë për ta zbritur plasmasën e rëndë dhe për ta çuar gjer atje. Sitja e baltës dhe e eshtrave nisi menjëherë.

Në këmbë, me krahët të kryqëzuara mbi gjoks, Arian Vogli ndiqte me sy duart e kërkuesve që lëviznin si në ethe. Sado që t'i shtrëngosh nofullat, do të ta nxjerr të fshehtën, tha me vete kur pa kafkën.

Herë pas here ndjente të dridhura në trup. E ftohta i ishte futur gjer në palcë atje, në varrezë.

Fill pas mesnatës, njëri nga kërkuesit gjeti kopsën e parë të xhupit, që u dha zemër të gjithëve. Gjysmë ore më pas, "princi" u gjet.

Me sy të shqyer, Arian Vogli e vështronte gjësendif e vockël, pa e ditur përsë nuk gëzohej dot. Të tjerët përreth pshëritinin nga lodhja, vështronin duart, pastaj njëri-tjetrin. Vetëm atëhere e vunë re se gjithçka përreth, fundshtroja e laboratorit, tryezat, ata vetë, ishin krejt të përbaltur. Por askush nuk çante kryet për këtë. Të verdhë

në fytyrë, gati të palëvizur, rrinin rrith e rrotull magnetofonit, në pritje.

Kur "principit" iu hoq balta, Arian Vogli provoi prapë ndjenjën e fajit, po këtë herë më mundimshëm. "Princi" i vogël, i treturi, i dëbuari, i harruari nën tokë kaq vite, dukej se ishte rikthyer për të kërkuar shpagim.

Ai shkundi kryet si për të dëbuar lodhjen dhe mendimet e mbrapshta, por ato nuk i shqiteshin. Ndjesia e fajit, përzier me një parandjenjë të keqe, ishte aq e fortë sa një herë i erdhi të thoshte: falmë, imzot e princ!

Të tjerët, gjithashtu, ishin si në kllapi. Teknikut, që merrej me aparatin, i dridheshin duart. Lëvizte pa pushim sustat, afronte veshin që të kapte ndonjë zë, pastaj prapë e çonte fillin përpëra, duke kapërcyer, me sa dukej, zbrazëtitë.

Një herë e humbën shpresën. Pastaj befas, midis gërvimave ndeshën zërat e parë. Ishin të zvargur, të mbytur, krejt zëra të përtejmë.

Arian Vogli rrudhi ballin, pastaj vjetveti kërkoi me sy kafkën e të vdekurit, si njeriu që, për shkak të paqartësisë të së folurës, përpinqet ta marrë vesh tjetrin prej lëvizjes së buzëve.

Por kafka e hedhur pa kujdes në tokë i kishte dhëmbët e shtrënguar.

-Shiriti ka marrë, siç duket, lagështirë, -murmuriti njëri nga teknikët.

-Kaq kohë nën tokë, është e kuptueshme, -tha Naumi.

Arian Vogli u bëri shenjë të heshtnin. Vazhdonin po ata zëra veshtullorë, të mbështjella si me hije. Fjalët nuk dallohen, kuptohej vetëm që biseda bëhej në dy gjuhë.

Të gjithë u panë në sy gjithë shpresë. Së paku diçka kishte në atë humnerë. Diçka do të dilte pa tjetër nga ai kaos.

Një gërvimë e gjatë, që ngjante si cen i regjistrimit, shkaktonte vuajtje dhe shtesë rudhash në fytyrat e tyre.

-Është ecje e makinës, -shpjegoi tekniku.

-Kapërceje, -tha Arian Vogli.

Pas pak ndeshën prapë në bisedë, por këtë herë zëri tjetër ishte femëror.

-Më duket se është ajo kuçka, aktorja,-tha njëri nga oficerët.

Shefi i bëri shenjë të heshtte. U dëgjua një si ofshamë. Pastaj prapë zëri i gruas, i zvargur dhe ai si të tjerët.

-Ec më tutje, -tha shefi.

Një si zhurmë breshëri, me ca britma të largëta midis, vazhdoi tepër gjatë.

-Duartrokitje, -tha tekniku me zë shpërfillës. -Me sa duket është shfaqja e "Pulëbardhës".

Arian Vogli mbylli sytë, ngaqë iu duk se vetëm ashtu mund ta sillte ndër mend atë mbrëmje. Të largët, si të pahitur me dëborë të tjetër epoke, iu përhinë njerëzit. As hynin e as dilnin nga teatri, vetëm vërtiteshin si shtjellë nëpër gjysmë terr.

Me një shenjë të tij, tekniku kapërcente zbrazëtitë. Fjalët ndesheshin të rralla krejt dhe atij iu kujtua vuajtja e dikurshme, kur përpinqej të përfytyronte zgavrat e gjithësisë, ku trupat qiellorë mezi shfaqeshin një këtu, një aty.

-Nata, -tha tekniku, duke vështruar në mënyrë pyetëse shefin.

Kapërcimi i natës ishte më i gjati i të gjithëve. Biseda që vinte pas, ajo e mëngjesit, dëgjohej më shkoqur, ose ashtu iu duk ngaqë po mësoheshin me atë veshtulli. E folura ishte prapë dygjuhëshe dhe, nga ajo pak frëngjishte që kishte mësuar në fakultet, Arian Voglit iu duk se kapi fjalët "aidez nous".

-Ktheje mbrapsh, -thirri me zë të egër. -Ngrije zërin.

Të gjithë u tendosën dhe afruan kryet te aparati.

Ingritur, zëri i të vdekurit e jepte edhe më shkretueshëm gropën prej nga vinte. Arian Vogli vuri re se edhe të tjerët bënin ç'bënин, vështronin vjedhurazi kafkën gjithë baltë.

I kalbur më zi se trupi, zëri u bë prapë i zvargur,

si i njeriut me gjuhë të dëmtuar. Arian Vogli nuk ishte më i sigurt se kishte dëgjuar fjalët "aidez nous". I kishte marrë ndoshta vetë me mend ato fjalë, aq sa një herë iu duk se i kapi edhe shqip. Madje në trajtën shqipe "ndihmë", ato i tingëlluan edhe më vdekshëm.

Ndihmë, përsëriti me vete. S'e kishte vënë re ndonjëherë se fjala "ndih", ndoshta për shkak të ngjashmërisë me "mih", dukej si e pjellë nga balta.

Më mihi, tha prapë. Mihmë! Tani i dukej se i vdekuri e kishte thirrur që poshtë dheut dhe ai ia kishte plotësuar dëshirën, e kishte gërmuar...

Në aparat u ndie prapë zhurma e makinës në ecje. Pastaj përplasja e dyerive të saj dhe zëri i të vdekurit, këtë herë si britmë, që thoshte "alo, alo!".

Një zhurmë e mbytur, pas së cilës pasoi një si rrënim dhe klithma "Oh"-i midis, u ndien fare qartë.

-Çasti i vrasjes prej buldozerit,-tha tekniku.

E kthyen mbrapsht atë pjesë dhe çdo herë "Oh"-i të vdekurit ngjante më i thekshëm.

Më pas dëgjuan zërat e njerëzve rrotull trupit të viktimës dhe sirenat e makinës së ambulancës a të policisë.

Të gjitha si të asaj bote, mendoi ngrirazi Arian Vogli. Edhe mjekët, edhe policët.

E kapërcyen një pjesë të madhe për të mbërritur te varrimi. Ngaqë regjistruesi ishte tani në arkëmort, gjithçka dëgjohej edhe më shurdhër: hapat e njerëzve në varrezë, fjalimi i dikujt, së fundi zbritja në gropë. Pas zhurmës së dheut që binte mbi dërrasat e arkëmortit, heshtja sa vinte bëhej më e thellë. Perëndi, mendoi Arian Vogli. Ishte heshtja e varrit, siç i thoshnin.

I ngrirë, e dëgjoi gjer në fund atë asgjësi. Ishte me siguri i pari njeri në këtë planet që kishte në duar heshtjen e vdekjes. Tani mund të thoshte se kishte zbritur vërtet në zonën e hijes.

Ora prej bronzi në mur, lajmëroi dy pas mesnate. Kishte gdhirë dita e 13 tetorit.

Të gjithë rrotull tij ishin të ngrysur. Ai hapi gojën

të thoshte diçka, por gjuhën e ndjeu të rëndë, thua se i vdekuri i kishte ngjitur zvargien e tij. Në vegjeli, i kujtohej, një shoku i tyre bëlban ua shkaktonte shpesh marrjen e gojës.

Llajmërooni qeellindrëen, tha me vete përpara se ta shqiptonte frazën me zë. E tha pak a shumë, siç dukej, me përjashtim të fjalës "qendër", që pati përshtypjen se e shqiptoi midis "qendrës" dhe "qiellit".

13

Dëborë në mes të tectorit? Kryetari i komisionit të dhuratave për ditëlindjen e Udhëheqësit fërkoi sytë. Pastaj iu afroa dritares dhe buzëqeshi hutueshëm. Ishte e dyta herë brenda asaj mbasditeje që po i mizonin sytë.

Nxorri paketën e cigareve, por iu kujtua se gruaja e Udhëheqësit mund të çastiste befas dhe e futi prapë në xhep.

Marramendja dhe veshja e syve, që e kishin shqetësuar disa ditë më parë, tani po i dukeshin më e pakta gjë që mund t'i ndodhte pas asaj jave të çmendur.

Dhuratat mbërrinin çdo ditë nga krejt skajet e vendit.

Udhëzimi ishte i prerë: të pranoheshin të gjitha, të dërguara nga kushdo qoftë: organizata partie, njerëz vetiakë, zyra, pionierë, gra fatpadala, nëndetëse, azile pleqsh, kulla vrojtimi, ish-priftërinj, lavire të penduara, të burgosur. Ishte hera e parë që ishin pranuar dhurata nga çmendinat. Thuhej se mjeku H., shok i vegjelisë së Udhëheqësit, ia kishte mbushur mendjen. Sa për dërgesat pa emër, siç

ishin zakonisht ato të kundërshtarëve (një dhemb ose një copëz teli me gjëmba ishin prej vitesh më të shpeshtat), ato çoheshin, si përherë, drejt e në laboratoret e Ministrisë së Brendshme, për zbulim gjurmësh.

Kryetari i komisionit mori fryshtëm thellë. Dy javë më parë, kur ia kishin ngarkuar atë kryesim, s'kishte mbetur njeri pa e uruar: lart e më lart! Ai vetë, ndonëse s'ia kishte thënë kujt, kishte menduar se rruga drejt postit të zëvendëskryetarit të Akademisë së Shkencave, ëndrrës së tij shumëvjeçare, ishte hapur më në fund.

Tani e shikonte se sa ishte ngutur. Nën ndriçimin e marrtë të pasdites, moria e dhuratave i ngjante gati armiqësore. Të ftohta, me një hirnosje shpotitëse, i dukeshin jo vetëm portretet, e sidomos shtatoret e skulptorëve, por edhe qendizmat, armët e vjetra prej argjendi, lahitat, fyejt dyjare. Madje edhe ato që gjer dje i ngjanin si dhuratat klasike e më të sigurta, si vjershat dhe dramat e poetëve vendas, ose botimet në gjuhë të huaja të veprave të tij, tani i zgjonin dyshim.

As të tjerat, ndonëse ishin të një natyre krejt të ndryshme, s'po i dukeshin më qetësuese. Vedra e parë e naftës, nxjerrë nga pusi i porsahapur, për nder të ditëlindjes së tij, një copë gizë nga derdhja e parë e një shkritoreje, buka e parë e bërë nga një arë malore, lingota e parë e arit... Mund të thoshte: mjaft me këto, ka dyzet vjet që më kanë ardhur në majë të hundës, s'gjetët gjë tjetër? Kurse për lingotën e arit puna mund të shkonte edhe më keq. Ç'është kjo lingotë ari këtu? Bankier jam unë, që të më bëjë përshtypje floriri? Pastaj... i kini dëgjuar ju pëshpërimat dashakeqëse të armiqve lidhur me...?

Kryetarit të komisionit iu bë një komb në grykë. Në të vërtetë pas një nate pa gjumë, lingotën e arit deshi ta hiqte, mirëpo dyshimet e kishin përfshirë në çast. E sikur ta pyesnin: përsë e hoqe floririn? Apo mos ke dëgjuar ato murmurimat e ndyra? Në mos je dhe ti vetë një ndër ata që i hapin?

E kishte lënë lingotën në vend dhe, ndonëse përpinqej

të mos e kthente kryet andej, përndritja e saj dukej se e përqeshte që larg.

Tani ishte i bindur se rreziku ishte ndehur kudo: mbi shtatoret e vogla të porsanxjerra nga amfiteatri i Durrësit, mbi qilimat, mbi dashin me brinjë të spërdredhur, e vëtmja qënie e gjallë midis asaj sendërije, mbi librin e shpuar me plumb, gërsheetat, mollët, bakllavanë me 140 petë të një plake gjirokastrite, mbi mullinjtë e kafesë, dëftesat me të gjitha notat dhjeta të nxënësve, aparatin e parë telefonik prodhuar në vend, pipat, vjershat e të verbërve.

E ndjente veten të humbur. Edhe sikur Atij të mos i shkonte mendja për keq, ishin të tjerët që do ta ngucnin. Me letra padorase, me pëshpërima.

Kishte bërë shumë armiq ato ditë. Ministritë grindeshin me njëra-tjetren kush të çonte më shumë dhurata. Ajo e Mbrojtjes ankohej si gjithmonë kundër asaj të Kulturës, kjo e fundit kundër të Ekonomisë, e të dyja bashkë kundër të Jashtmes. Smira kishte përfshirë Komitetet e Partisë së rretheve, shoqatat e veteranëve, Komitetin Qendror të Rinisë, minoritarët grekë. Dhe gjithë pezmi do të shkarkohej mbi të. Do të kërkonin të zhvlerësonin dhuratat e pranuara, për të ngritur të tyret. Do të zhbironin e do të vrissin mendjen për të gjetur kuptime të dyshimta në gjithçka, te pipat prej shqope, te plumbi i nxjerrë pas dyzet vjetësh prej shpatullës së një veterani, te dreqi e di ku.

Sytë i shkuan te dhuratat e çmendinave. Befasuese, të pabesueshme, të tilla që kishin aftësinë të të bënин te shqyeheshe gazit mu midis tmerrit, ose e kundërtë, ato ishin skajuar veç, si në strukë, në këndin më të largët. Dhurata e falltares plakë Hançe Hajdije, Pezë e Madhe, një pasqyrë e hukatur, ishte bashkuar me to. Së paku prej tyre jam i qetë, tha me vete. Doktor H., ai që kishte këmbëngulur për to, le të përgjigjej.

Psherëtiu prapë më thellë se më parë. Gjithkush mund ta pësonte në Shqipëri, veç doktorit. Ishte i vetmi, të cilët shefi i madh i besonte gjithçka kohët e fundit. Thoshin se mbylleshin me orë të tëra në një kthinë të

mënjanuar të shtëpisë. Dhe askush s'e dintë përse. Disa pëshpëritnin se doktori i lexonte me zë vjersha frëngjisht. Të tjerët se i hidhte fall.

Sa të kalonte dhe kjo mbasdite e pambarimtë. Pas dy orësh, e shumta tri, pak përpara fillimit të darkës zyrtare, kur atij t'i ishin njoftuar dhuratat kryesore, ndoshta dhe kryedhurata, në qoftë se do të kishte të tillë, gjithçka do të merrej vesh.

Këmbora e dashit tringëllinte vetmueshëm herë pas here. Ai e vështroi gati me dhëmbshuri kafshën. Pastaj pa orën. Gruaja po vononte. Nga dritaret e larta dukej një pjesë e Bulevardit të madh. Ndonëse muzgu ende s'kishte rënë, dritat ishin ndezur ndërkaq. Ishte thënë që festë të bujshme nuk do të kishte, megjithatë ajo ndihej. Madje kështu, e pashfaqur, me shijen e rrezikut midis, ajo rrezatonte një përdëllim të veçantë gjithkah.

U ul në njëren nga ndenjëset, duke u përpjekur të mos mendonte asgjë. Nuk e kuptoi as vetë ç'e përmendi nga dremitja, një zhurmë pas dere apo këmbora e dashit. Megjithatë ishte në këmbë, kur gruaja hyri.

E sjellshme si përherë, ajo i tha se kishte fare pak kohë. Ju kuptoj, iu përgjigj ai. Në një ditë të tillë...

Ajo eci ngadalë përpara stivës së dhuratave. Ndërsa ai jepte shpjegime të shkurtëra për secilën, ajo heshtte, veç herë pas here shfaqte ndonjë mendim. Sot mund të zgjidhni disa nga dhuratat, ato më kryesoret. Të tjerat do t'ia paraqitim më vonë. Natyrish, përgjigjej ai. Ky portret më duket i mirë. Për tjetër pikture s'ka nevojë. Ndoshta edhe një shtatore? Jo, jo. Më vonë i shohim shtatoret. Këto dy mollë, për shembull, duken të thjeshta, por ai preket shumë nga dhurata të tilla. Tufa e karafilave, gjithashtu. Aq më tepër që vjen nga shqiptarët e diasporës. Po ky dash, ç'do këtu? Ai u përpoq t'ia shpjegonte, por e ndjente se po e humbte sigurinë. Kishte qenë dëshira për dhurata vetanake, që të mos përsëriteshin vazhdimisht ato tradicionalet. Vetë ministri i bujqësisë dhe blegtorisë e kishte për zemër atë dhuratë, kryesisht për shkak të brirëve. Siç mund të

vërehej lehtë, brirët e dashit kishin trajtën e "E" dhe "H", domethënë shkronjat e para të emrit të Udhëheqësit.

Përpara se t'ia bënte pyetjen me gojë, ajo ia kaloi me sy: ç'kuptim kishte kjo?

Ai hapi krahët. Në të vërtetë kuptimi s'mund të ishte veçse tepër i tërthortë... si të thuash poetik... Dash i mallkuar, tha me vete. Tani iu duk se po dallonte qartë te njëri nga brirët shenjat e ngjitjes për të sajuar përdhumshëm shkronjën "H". Po, lavdi Zotit, ajo s'po e vinte re. Nga çdo anë që ta shikosh s'më duket se ka ndonjë kuptim, tha gruaja.

Tani edhe atij po i dukej se jo vetëm s'kishte kuptim, por po të doje mund t'i jepje një domethënie fare të mbrapshtë, misticizëm, lidhur me gjenetikën e dënuar si shkencë dekadente... Ministër mendjefyçkë, shfryu me vete.

-Keni të drejtë, -tha i vendosor. -Asnjë kuptim s'mund t'i japësh.

Ajo kishte ndalur, ndërkaq, përpara bakllavasë dhe po lexonte fletën shoqëruese.

-Ja një dhuratë që atij do t'i pëlgente veçanërisht, -tha ajo. -Gjithmonë preket nga dhuratat e plakave, ngaqë i kujtojnë nënën. Aq më tepër, që kjo plakë është nga shtëpia e vjetër e Hankonatëve, që ndodhet jo larg shtëpisë së tij. Bukur, shumë bukur, veçse... ajo u mëdysh një grimë përpara se të vazhdonte. -Veç sikur të hiqet shpjegimi se kjo është, me sa duket, bakllavaja e fundit e gruas së moçme.

-Keni të drejtë, -tha kryetari i komisionit, duke e shënuar vërejtjen e saj në fletorkën e vogël, që e nxirrte herë pas here.

Nuk arriti ta shijonte ngazëllimin, ngaqë balli i saj ishte ngrysur prapë.

-Ç'do kjo lingotë ari këtu? Ç'janë këto marrëzira?

Ai e pati vështirë t'ia shpjegonte arsyen, ngaqë gruaja s'donte të dëgjonte... S'ishte fjala për dhuratë të drejtpërdrejtë. Ishte më tepër simbolike, që ai të gëzohej që punëtorët e shkrirëses së bakrit të Rubikut, kishin

arritur për herë të parë të nxirrnin edhe ar...

Gruaja nuk e fshihte zemërimin. Për shkak të lingotës së arit, po e pësonte dhurata e Ministrisë së Brendshme, libri i Udhëheqësit, i shpuar nga plumbi i shkelësit të kufirit në gjoksin e një ushtari.

-Kjo është përsëritje e librit të shpuar gjatë luftës në gjoksin e një partizani, -tha me zë të ftohtë. -Të gjithë nxënësit e shkollave e dinë këtë.

Kryetarit të komisionit iu duk e kotë t'i sqaronte se në rastin e partizanit ishte fjala për Historinë e P.K. të Bashkimit Sovjetik. Hajde merru vesh tani me ministrin e Brendshëm, tha me vete. Kishte qenë aq i ngazëllyer nga dhurata e vet, saqë ishte i bindur se pikërisht ajo do të zgjidhej si kryedhuratë e këtij viti.

U desh një farë kohe gjersa gruas t'i dilte zemërimi. Nisi të zbutej kur po kalonte përpëra dhuratave të pionierëve, por u zbut përfundimisht prej dërgesave të sizmologëve, të artistëve të Operas e të Baletit, sidomos të një turme arixinjsh, që i premtonin Udhëheqësit se për hir të shtatëdhjetë e pesë vjetorit të ditëlindjes së tij do të nguliteshin në një qytezë e do të pranonin të pajiseshin me pashaporta.

Ajo dha mendime për një varg dërgesash të tjera: mineral kromi i pasuruar tetë përqind, një pentagramë muzike, pipa të gdhendura, qendizma, naftë, por ndihej që nuk ishte e përqëndruar. Ngutej, shikonte orën vazhdimisht.

-Me dhuratat e të burgosurve nuk po merrem, -tha. -Që të jem e sinqertë, të ishte përmua, nuk do t'i pranoja. Por ai, ngaqë është i mëshirshëm, ka thënë: le t'i dërgojnë.

-Ju kuptoju, -tha kryetari i komisionit. -E ka bërë për t'u dhënë atyre një gëzim.

Ndodheshin në fund të sallës, te çmendinat.

-Sa për këto këtu, le të merret doktori me to, -tha gruaja, pa fshehur acarimin. -Ai thotë se prej tyre mund të nxirren kuptime të fshehta. Ashtu qoftë.

Përpëra se të ikte, ajo shfaqi mendimin që kryedhuratë të mos kishte. Midis dhuratave kryesore, që do t'ia jepnin atë mbrëmje, mendonte të futej bakllavaja, që ishte diçka

që përfshinte, si të thuash, krejt popullin, tufa e karafilëve, që përfaqësonte diasporën dhe botimi në Brazil i veprës së tij. Sa për librin e shpuar nga plumbi, ajo do të fliste vetë me ministrin e Brendshëm.

-Po nga ekonomia? - pyeti ai me drojtje.

-Hm. Keni të drejtë. Por ju zgjidheni vetë. Të them të drejtën, ajo vedra me naftë, sado që e mbyllur në enë plastike, nuk m'a mbush mendjen.

Ai buzëqeshi.

-Ju e dini, kur doli naftë nga pusi 103, shoku ministër, nga gjëzimi piu ca gllënjkë prej saj.

-Dhe u shtrua pastaj një javë në klinikë, duke u hequr si martir, -tha ajo gjithë hidhësi.

Ai e ndoqi me sy kur gruaja, pasi u nda me të, me hapa të vegjël doli.

I lehtësuar disi u kthye dhe një copë herë vështroi sallën mbi të cilën po ndehej tisi i parë i muzgut.

Sytë i kaluan me radhë mbi vargun e pafund të sendeve. Dashi, që për habinë e tij, kishte qëndruar gjatë gjithë kohës i qetë, e tundi prapë këmborën. Me sy të lodhur ai vështroi qilimat, librin e shpuar, dramat, lingotën e arit, që s'kishte arritur megjithatë të shkaktonte fatkeqësi, dhe prapë psherëtiu. Vedra e naftës, gati e zezë, iu lidh me përfytyrimin e ministrit tek po e pinte dhe me fatin e tij të ardhshëm. I çmendur, mendoi për të. Ç'do të bëhej sikur të vinin të gjithë ashtu, dikush duke përtypur mineral, tjetri duke pirë dreqi e dinte çfarë... Kundër vullnetit të tij, e përfytyroi ministrin e Brendshëm me një vedër gjaku... në duar.

E shkundi kryet, thua se ashtu do ta shkulte më lehtë prej trurit atë pamje makabre, por ajo s'e pengoi që të fshinte buzët me tërbim.

Gruaja, ndërkaq, po ecte në rrugë e ndjekur nga makina dhe roja i saj. Banesa nuk ishte as dyqind hapa

larg ndërtesës së Komitetit Qëndror, dhe ajo, pavarësisht nga lagështira, kishte dashur ta bënte atë copë rrugë më këmbë.

Ndonëse ndriçuesit në trajtë shandani të katit të parë ishin ndezur përgjysmë, në shtëpinë e madhe ndihej fryma e festës. Në thellësi, nga njëri prej apartamenteve të nuseve dëgjohej muzikë. Kryeroja, që ishte ulur në një nga ndenjëset anësore, u ngrit në këmbë. Pyetjes së saj me sy, se ku ndodhej i shoqi, iu përgjigj me zë të ulët:

-Është myllur me doktorin.

Prapë, ia bëri ajo me vete. E pa përsëri orën, pastaj pyeti për "Zalon", siç e quanin midis tyre, për një arsy që tashmë qe harruar, dytsin.

Kryeroja tregoi me krye njëren nga dyert.

Gruaja e hapi pa trokitur. Përpara një pasqyre dy grimierë diçka po i bënin te flokët njeriut që ndoshta do të zëvendësonte, gjatë darkës, burrin e saj.

Ende s'ishte vendosur përfundimisht, megjithatë ajo ishte tërë ankth. Ishte herë e parë që dytsi, siç e quanin tashmë sosinë, mund të provohej në një darkë zyrtare.

Qysh prej katër vjetësh ishte përdorur pothuajse në të gjitha zhvendosjet me veturë brenda dhe jashtë kryeqytetit. Në shëtitjet me këmbë në muzg, në breg të detit, ishte provuar gjithashtu shpesh, sidomos verën e fundit. Por, me përjashtim të një mitingu me minoritarët grekë në fshatrat e jugut, ende s'kishin guxuar ta nxirrin përpara publikut të gjerë. Kurse për darkën e sotme, ajo s'kishte dashur kurrsesi. Një ndjesi bestyte, e ringjallur kohët e fundit, e bënte t'i druhej sidomos zëvendësimit në ditëlindje. I dukej prapësi, dhe gati-gati e përfytyronte nënën plakë që, po të ishte gjallë, do t'i thoshte: veç në ditëlindje mos e bëni këtë. Nuk thirret hija në tryezë në një darkë të tillë.

Në pasqyrë ajo kapi sytë e dytsit: të topitur, pyetës, me një ndjenjë faji të ngrirë në ninëza.

Qysh nga vera e fundit në Durrës, sa herë që sytë e tyre ndesheshin, ndodhët një shkarkim i ftohtë, i mbrapshtë,

që s'kishte emër në asnjë gjuhë të botës. Pa qenë armiqësore ishte kundërta e shikimit joshës. Një farë antivështrimi, që të kujtonte, ndonëse turbull, antilëndën ose antikrishtin.

— E gjithë kjo bezdi në jetën e saj kishte nisur ditën që i shoqi, duke qeshur i kishte thënë: nisu në Durrës të më tradhtosh me hijen time.

Kishin dy javë që pushonin në Shqipërinë lindore buzë liqenit të Ohrit, në kohën që, siç bëhej zakonisht kohët e fundit, shërbimi vetiak i sigurimit të tij kishte hapur fjalën se ai gjendej në bregdetin e Durrësit. Dritat ndizeshin çdo mbrëmje në të gjitha dhomat e vilës së tij, ndalonin makinat e shërbimit, hynin e dilnin korrierët. E për ta bërë gjithçka të besueshme, me rënien e muzgut, shëmbëllimi i tij, dytsi, shëtiste ngadalshëm buzë detit.

Në mbarim të javës së dytë, një murmurimë e hapur në plazhin e ndaluar kishte bërë që ministri i Brëndshëm të vinte vetë te lijeni midis maleve. Kiske rënë në sy vëtmia e shefit të madh. Ishte hera e parë që ai pushonte vetëm, pa gruan... Ngutshëm duhej bërë diçka... Dhe kështu ajo ishte nisur për në Durrës, për të luftuar thashethem...

Me rënien e muzgut, kishte dalë, për herë të parë në jetën e saj, krah për krah me një burrë të huaj, buzë detit.

Ndjesia ishte më se e pazakontë. Kiske ftohtë, përbuzje, e më së shumti tmerr. Nganjëherë i dukej se mbante përkrahu lëvozhgën e burrit të vet e, aty për aty, i vinte edhe të qeshte, edhe të qante.

Kiske qenë besnikë gjithë jetën, për ta kinsetradhtuar me një pupac.

Gjithçka vazhdonte të ishte e mosnatyrshme, si pas një pasqyre. Pas mëngës së palltos së zezë, ajo ndiente dridhjen e njeriut hije. Mendimi se një ditë mund të ishte gruaja e kësaj trajte të zbrazët, i vërtitej tinëzisht, si një mizë e bezdissħme. Kiske qenë nëna e saj që i kiske thënë e para se ndoshta do të ishte më mirë që vdekja e burrit të saj, kur Zoti ta sillte, të mbahej e fshehtë. Ajo kiske shkumbëzuar nga zemërimi, kiske thënë: mama,

ç'janë këto marrëzira, por plaka kishte ngulur këmbë. S'ishte vetëm për të mirën e saj e të fëmijëve, por të krejt shtetit. Të tjerët, gjithashtu, e kishin bërë.

Më pas kishte nuhatur se mendimi, pa guxuar të shfaqej haptaz, notonte aty-këtu. Të tjerët e kishin bërë vërtet. Jo vetëm në kohët e vjetra, por edhe më vonë. Komunistët japonezë e kishin mbajtur fshehtë vdekjen e sekretarit të parë të Partisë, Tokudës, për gati njëzet vjet. Për Maon ende s'dihej mirë nëse kishte jetuar vërtet gjë ditën që vdiq. Nganjëherë, sidomos në çaste përgjumjeje, asaj i vinte të besonte se një pjesë e udhëheqësve komunistë treteshin ndërkaq nën dhë, të zëvendësuar tashmë nga dytsat e tyre. Madje mund të ndodhë që disa të ishin dytsat e dytsave, e kështu me radhë, si në një makth. Ndryshe s'mund të shpjegohej ky zvetënim i shpejtë, i ngjashëm me zvetënimin biologjik, të kuadrove komunistë vitet e fundit.

Gruaja vuri re papritur se grimierët e kishin ndërprerë punën, për të pritur, siç duket, ndonjë vërejtje të saj.

Pa thënë asgjë ajo e mylli derën.

Dytsi ishte i pari që lëshoi një pshërëtimë. Duart e grimierëve gjithashtu, pësuam një çngrirje. Prej gjithë atyre që mund t'i qortonin për punën e tyre, asaj ia kishin më tepër frikën. Ishte përherë e pakënaqur, herë i dukej se "ai" dilte më i vjetër, e herë më i ri.

Ai vetë s'dinte ç'sprehje të mbante në fytyrë. Të theksonte mirënjojen që i kishin besuar atë rol, kishte rrezik të dukej i përvuajtur, të shprehte të kundërtën, krenarinë, prapë mund të keqkuptohej. Do të thoshnin se i ishte rritur mendja, se po ngrefosej për gjëra që s'i meritonte etj. E kishte vënë re se rojet e Tjetrit, haptas e shprehnin nervozizmin e tyre ndaj tij, kur detyroheshin t'i shërbën. Madje një herë i ishte dukur se gati-gati e kishin shtyrë në veturë me vrazhdësi. Një ditë kishte dëgjuar pëshpërimën e njërit prej tyre: "ky lolo, kujton se qenqësh bërë vërtet shef". Kurse një herë tjetër ishte tronditur edhe më fort. Zëvendësi i kryerojës i thoshte me zë të ulët

një shokut të vet: nganjëherë më vjen t'i fus thonjtë në fyt. Dhe, si të mos mjaftonte kjo kishte vazhduar: për nder, në qoftë se i ndodh ndonjë gjë shefit të madh, të parit njeri që do t'i sulem do të jetë ky. Kam për ta ngrënë me gjithë lecka.

Ai deshi të kthehej e të pyeste: pérse? Më shumë se frikë kishte, ndjerë trishtim. Pastaj frika e kishte kaplluar krejt. E sikur, vërtet, të nxitur nga një shtysë bestyde, ata ta flijonin atë, pér të mashtruar, si të thuash vdekjen, siç bënин fiset parakë?

— Shpesh i qëllonte të zemërohej: a nuk mjaftonte që në rast atentati ai do të mbante peshën kryesore, do të thithë vdekjen? Ata gjithashtu do të rrëzoheshin, por vdekja do të kërkonte kryesisht atë.

Pas vrullit zemërak ky përfytyrim i shkaktonte zakonisht një zbutje mallëngjyese. E mendonte veten të shtrirë nga plumbat, me vdekjen e Tjetrit në trup. Së paku, atëherë do t'i thoshin faleminderit!

Kurse vdekjen do t'ia mbanin fshehtë. Shumë-shumë do të thoshnin se Udhëheqësi u godit prej armiqve, por nuk pësoi asgjë!

Dhe pér ca ditë rolet do të ktheheshin përmbyss. Do të ishte Udhëheqësi që do të bëhej dytsi i tij. Së paku pér aq kohë sa të gjendej një dyts i ri ...

Duart e grimierëve iu dukën prapë se e prekën pa butësi dhe ai gati sa s'klithi së brendshmi: mjerë unë.

Kujt t'i ankohej? Kryeroja e vështronte po aq ftohtëtisht si të tjerët, kurse gruaja e shefit, qysh pas shëtitjeve në breg të detit, kishte përshtypjen se e urrente.

Ato shëtitje kishin qenë krusma më e madhe në jetën e tij. Gjunjët kishin nisur t'i dridhen kur ajo i kishte vënë pér herë të parë krahun. Në krye, një lloj ngazëllimi ia kishte zbutur krejt krahërorin. Dielli sapo kishte perënduar, por mbi det kishte mbetur ende një tymnajë e trëndafiltë. Vetvetishëm, pa e menduar, ai nisi të fliste. Ishin fjalë të thjeshta, që kishin lidhje me mbrëmjen dhe detin, por përgjigjet e gruas ishin aq të ftohta, saqë e folura iu meh

aty për aty. Ç'po bëj? gati sa s'klithi me vete. Po i fliste me siguri gjëra krejt të rëndomta asaj, që ishte mësuar të dëgjonte mendime të madhërishme. Më falni, i kishte thënë me zë të ulët dhe gruaja e kishte pyetur: pse?

Ajo i kishte thënë "pse?" për herë të dytë dhe ai ishte hutuar më keq. Kryet e kishte të turbullt, mendimet të shkapërderdhura. Deshi t'i thoshte, ndër të tjera, se nnderimi i tij për të ishte aq i madh, sa që... sa që... qysh nga koha që ishte bërë dyts, as me gruan e vet nuk flinte dot më... E dinte se kjo ishte e pathënëshme, madje edhe mendimi i dukej mëkatar. Aq më tepër që e vërteta kishte qenë ndryshe për gruan e tij. Asaj, me të marrë vesh punën e re, i kishte hypur një ndezulli e pazakontë. Kushedi ç'i pillte mendja e saj prej gruaje. Kurse ai përkundrazi, sa vente ftohej. Ajo zemërohej, nganjëherë e fyente: mos të duket vetja vërtet udhëheqës, mor marrok? Pastaj e merrte me të mirë: ç'ke kështu, i thoshte, eja në vete, zbrit nga retë. Ai përpiquej t'ia shpjegonte: s'ishte punë mendjemadhësie, ose ngrefosjeje, por ja që s'mundej. Ndoshta edhe mosha po bënte të vetën. Ajo kundërshtonte: mosha nuk i sillte kurrë befasisht këto gjëra. Pastaj prapë nxehje e shfrynte gjithë pezm: mos të dukem e padenjë tani, a? Mos të vete mendja të flesh me shoqet e Byrosë Politike? Apo dhe më lart, me gruan e tij? Folë, mor qyq, te ajo të paska shkuar mendja?

Disa javë kishte vazhduar kështu, gjersa të dy e kishin kuptuar se ajo histori ishte mbyllur përgjithmonë.

Krahas pikëllimit, ai kishte ndjerë një kënaqësi të qetë, por të gjerë. Ajo që kishte ndodhur tregonte se ai nuk ishte thjesht një maskë e zbrazët e Udhëheqësit, por kishte ndërkaq një lidhje të brendshme me të. Një lidhje që, duke qenë e fshehtë, i ngjante edhe më e shtrenjtë.

Të gjitha këto i kishin shkuar ndërmend tek shëtiste buzë Adriatikut me të shoqen e Tjetrit.

-Fol diçka, -i kishte thënë gruaja. -Ndryshe do të kujtojnë se jemi të zemëruar.

Kishte të drejtë. Nga tremet e vilave qeveritare,

me dhjetëra sy e ndiqnin, me siguri, shëtitjen e tyre. Në mos me sy të zhveshur, me tejqyrë mund të dallohej heshtja e tyre.

Kishte të drejtë, pa dyshim. Megjithatë gjetja e fjalëve atij i dukej po aq e rëndë sa nxjerrja e perlave nga deti. Veç në goftë se bënte sikur fliste, duke lëvizur buzët. Krejt si hijet ...

Grimierët po mbaronin punë me të. Atij iu duk se, nga çasti në çast, dera do të hapej dhe gruaja do të shfaqej prapë në prag.

Gruaja gjendej disa kthina më larg, në dhomën e saj. Ora ishte gjashtë dhe Ai ndodhej ende me doktorin. Nga apartamentet e nuseve vinin herë pas here zhurma të lehta. Ajo i përfytyronte të dyja përpara pasqyrave, me sy të ndezura nga smira për njëra-tjetërën, duke vënë stolitë.

Si përherë, në pragje kremitimesh e darkash zyrtare mendja, duke iu bërë më e ethshme, i shpërqendrohej. Gati-gati njëkohshëm i fqinjëronin në tru acarimi ndaj nuseve dhe doktorit H., diadema e Geraldinës, mbretëreshës së rrëzuar, që ia shtonte me siguri bukurinë gjatë pritjeve, gjysmë shekulli më parë, mitralozët rrëth shtëpisë së Koçi Xoces, ngjyra e kostumit të qepur enkas për këtë përvjetor, e që tani i dukej jo fort e përshtatshme, e lidhur, kushedi pse, me një tërheqje vëmendjeje të Drejtorisë së shtypit, për përmendjen kohët e fundit në disa vjersha të emrit të Ledit Makbeth.

Përse ato nuk i përgojonte askush, tha me vete ankueshëm për të dy mbretëreshat e Shqipërisë. Për të parën, Sophie Schonemberg, ishte e kuptueshme, largësia e kohës, viti 1913, mbretërimi fare i shkurtër. Por e dyta ishte gruaja e Zogut, ndaj të cilit s'ishte lënë mënxyrë pa u thënë. Që kur shqiptarët na qenkëshin bërë kaq xhentelmenë me të huajt? E kursenin gjermanen, e kursenin dhe hungarezen, veç kundër saj s'pushonin së shfryri ditë e natë.

Ju meritonit Çian Çinin, tha me vete, duke futur në atë "ju" edhe rrobaqepsin e saj. Pastaj mendimi se Geraldina, dyzetepesë vjet pas regjimit ishte ende gjallë, i shkaktoi, si përherë, habi.

Ju të katrok... Kështu i kishte thënë vite më parë një shoqe e shkollës. Në krye s'e kishte kuptuar përsë flitej. Pastaj, kur e kishte marrë vesh se ishte fjala përkatër gratë e sunduesve të Shqipërisë, ishte mvrejtur. Ti e di, se unë s'jam mbretëreshë, i kishte thënë gjithë vrer. Por tjetra ishte përgjigjur: Donikë Kastrioti, gruaja e Skënderbeut gjithashtu nuk kishte qenë mbretëreshë, por ajo ishte mbi të tjerat.

Ajo pa orën. Doktori H. duhet të ishte me të vërtet i çmendur, mendoi. Kishte kohë që dyshonte, por sonte po bindej përfundimisht. Mbetej edhe një orë nga fillimi i darkës dhe ai s'kujtohej të dilte.

U përpoq të qetësohej duke e hequr mendjen prej tij. Në të vërtetë i shoqi i saj gjithçka e kishte bërë të përsosur. Skënderbeu, duke qenë nga veriu i Shqipërisë e kishte marrë gruan nga jugu, kurse burri i saj jugor kishte zgjedhur një veriore. Në pasqyrë, sytë e dytsit i qenë dukur të frikësuar. Mos parandjente ndonjë gjë të keqe? Shko të më tradhtosh me hijen time, i kishte thënë burri në verë. Mund ta fajësonin për çdo gjë, por, së paku, që kishte qenë e virtytshme, s'mund t'ia mohonin.

Mitrolozat në oborrin e Koçi Xoxes janë kthyer me tytat drejt shtëpisë... Tridhjetë e shtatë vjet kishin kaluar, megjithatë fraza i dukej si e dëgjuar përpëra një ore. Ende nuk kishte gdhirë dhe ajo nuk ia kishte parë fytyrën njeriut që kishte folur. Kishte dëgjuar vetëm përgjigjen e rojës tjetër: ç'të duhet ty?

Për një kohë të gjatë tytat e mitralozëve i ishin kthyer në një ankth të vërtetë. Në ëndërr i ishte dukur shpesh se ato nisin të kthehen vetë andej nga nuk duhej.

Sidomos, kjo ndodhte në "netët e ndërmjetme". Kështu ishin emërtuar në ndërgjegjen e saj netët përpëra vetvrasjeve.

Nesër do të dëgjojmë autokritikën e tij, kishte thënë gati dyzet vjet më parë i shoqi, i kthyer vonë nga mbledhja e Byrosë Politike, ku ishte goditur Nako Spiru. Të shohim çdo të bëjë sonte...

Qysh atëherë vazhdonte i njëjtë rit. Kishte përherë një natë ndarëse. Midis mbledhjes së Byrosë Politike, të lënë përgjysmë për arsy se bëhej tepër vonë, dhe mëngjesit kur do të dëgjohej auokritika.

Vetvrasja kryhej zakonisht ndaj të gdhirë.

Uf, ia bëri ajo e zemëruar me veten, që po sillte ndërmend gjëra të hidhura.

U ngrit, u afrua te pasqyra dhe mendimi se Geraldina s'kishte arritur të jepte asnjë pritje në Pallat të Brigadave, kështu që diadema e saj nuk do të mund të jepte qoftë dhe një vezullim të zbehtë në pasqyrat e atjeshme, iu duk qetësues.

Një trokitje në derë e bëri t'i khente shpinën pasqyrës, si e zënë në faj.

-Ministri i Brendshëm në telefon.

Zëri i ministrit iu duk si i mytur nga frymëmarrja.

-Më falni që po ju shqetësoj në një ditë të tillë, por...

-S'ka gjë, -e ndërpree ajo. -Në të vërtetë duhej të tē merrja vetë, por s'pata kohë. Tani dëgjo, për atë punën e librit të shpuar isha unë që thashë se ishte përsëritje.

-Oh, jo, -tha ai. -Nuk mora për tē. Ose më mirë, për atë gjë, mora në një kuptim të kundërt. Domethënë që unë vetë mendova ta zëvendësonin dhuratën me një gjësend tjetër. Me diçka tepër të rrallë, të jashtëzakonshme, oh, nuk gjej fjalë ta shpreh.

-Më bëre kureshtare, -tha ajo.

-Atij do t'i pëlqejë shumë, -vazhdoi ministri. -Do çmendet nga gëzimi.

-Je i sigurtë?

-Më tepër se i sigurtë... Dëgjoni, kemi zbuluar rrënjet e një komploti. Ndoshta më të tmerrshmit gjer më sot. Me një thirrje drejtar Perëndimit.

-Ah, ashtu?

-Dhe provën themelore e kemi në duar. Domethënë thirrjen për ndihmë. Një helikopter është duke fluturuar pikërisht tani, që unë po flas me ju, për ta sjellë në Tiranë. Nga çasti në çast mund të mbërrije.

-Prit, e ndërpree ajo. -Ti the se mund të zëvendësojë dhuratën. Apo ndoshta e kishe fjalën për anën simbolike, domethënë që një lajm i mirë është në të vërtetë një dhuratë?

-Jo vetëm kaq, -u përgjigj tjetri. -Ajo që po sjell helikopteri është gjësend i rrokshëm... Por prisni t'ua shpjegoj... Në të vërtetë një i vdekur na erdhi në ndihmë. Desha të them, kemi zërin e tij, që e kemi nxjerrë nga fundi i dheut, domethënë nga varri.

-Më ngjethe mishtë, -tha ajo, kurse me vete shtoi: është mirë nga mendja ky njeri?

-Me fjalë të tjera e kemi në dorë thirrjen drejtar Perëndimit, -vazhdoi ministri. -Të tejçuar prej të vdekurit tre vjet më parë.

-Por...

-Por ai s'është veç një i vdekur, do të thoni ju. - Në telefon u dëgjua e qeshura e ministrit. -Ndërkaq ne kemi zbuluar shokët e tij, krejt grupin, që nga çasti në çast presim t'i arrestojmë.

-E kuptoj.

Një copë herë ministri i dha hollësira të asaj që kishte ndodhur, dhe pas çdo fraze të tij, ajo përsërise "ah, ashtu?".

-Kështu që pas pak ne do të kemi në duar atë zë, -vazhdoi ministri. -Do të kemi, si të thuash, një shpirt të zënë si zokth në kurth.

-Ke të drejtë, ai do të gëzohet shumë, -tha ajo. - Tani ndodhet i myllur me doktorin, por unë do të përpinqem t'ia them sa më shpejt.

Ndërsa vendoste dëgjonjësen, ajo përfytyroi helikopterin që fluturonte ndërkaq midis natës që sapo kishte rënë, për të sjellë atë që ministri e kishte quajtur "një shpirt".

Me hapa tē vegjël u nis drejt dhomës ku ishte i shoqi, por te mesorja e dytë e ngadalësoi ecjen. E sikur tē priste edhe pak?

Pa u menduar hapi derën ku ndodhej dytsi, pér tē parë ç'bëhej me tē. Njeriu ishte vetëm. Grimierët, siç duket, kishin mbaruar punë me tē. Sytë i kishte tē trishtuar e gjithë faj, si tē njeriut që ka drojë se mos midis festës, bëhet i bezdiss'hëm.

Deshi t'i thoshte një fjalë, por iu duk se ishte vështirë tē gjendeshin tē tilla pér tē. Në fund tē fundit pér tē folur me një trajtë, gjithashtu, duhej një farë ushtrimi.

Sikur ta ndiente mendimin e gruas, kur ajo e mbylli derën, njeriu psherëtiu.

Kishte mjaft kohë që e kishin lënë aty, pa i thënë kurgjë. Nganjëherë as në çastin e fundit nuk ia tregonin çdo tē bënte. E çonin drejt e te vetura dhe pastaj udhës diçka i shpjegonin. Edhe me një qen do tē silleshin më mirë, tha me vete, por pa kurrfarë pezmi.

Kishte mundësi që edhe sonte ashtu do tē bënin. Do ta hypnin në veturën e madhe tē zezë gjer në Pallat tē Brigadave. Pastaj atje do ta çonin në ndonjë skutë, gjer në mbarim tē darkës zyrtare... Veç në qoftë se papritur, Ai, zoti i tij, do tē ndihej keq dhe do tē kërkonte tē zevendësohej gjatë darkës. Ndonëse e kishin stërvitur gjatë pér një gjë tē tillë, kishte frikë. Ushqimi, me siguri, do t'i ngecej në fyt. Gota do t'i dridhej në dorë. Jo, njëqind herë më mirë në skutën e pasme, ashtu si vitin që shkoi, sesa në tryezën rrezelluese, i rrethuar nga drita, muzika dhe anëtarët e Byrosë Politike. Në një kënd tē veçuar, me një pjatë tē thjeshtë pérpara, një mbeturinë ndoshta, krejt si qentë...

Keqardhja pér veten ia rrëmbushi sytë. Por e mbajti veten ngaqë u kujtua se lotët mund t'i dëmtonin grimin. Në fund tē fundit, s'kishte tē drejtë tē lëshonte as lotët e

vet mbi fytyrën që më shumë se e tij, ishte tanë e atij Tjetrit.

Ngashërimi, i mbajtur vështirshëm, ia lëkundi supet. Do t'u vinte keq ndoshta për të veç në qoftë se e kryente një ditë rolin e paracaktuar. Si përherë, mendimi i vrasjes së tij të mundshme, krahas brengës, i jepte një lloj ngazëllimi dehës e bashkë me të shijen e parë të rebelimit. Do t'u vinte keq për të, por atëherë do të ishte vonë. Do t'u kujtohej si e kishin lënë vetëm, kur vetë dëfrenin, si e kishin shpërfillur, fyer. Ai vetë, zoti i tij, do të vinte ndoshta në varrimin e tij të fshehtë. Do të përlotej ndoshta dhe, për herë të parë do t'i shikonte me sy të mvrejtur anëtarët e Byrosë: cili nga ju ma bëri mua një shërbim të tillë?

Ngashërimi e mbyti përsëri. Ishte thënë që në jetën e tij të thjeshtë prej nëpunësi të Bashkimeve Profesionale, në moshën gjashtëdhjetëepesëvjeçare, pas pensionit, pasuria më e madhe t'i bëhej vdekja. Vdekja e dhunshme e Tjetrit, që ai, dytsi, në çastin fatal, duhej t'i ndërronte drejtim. Ta joshte, ta thithje, si rrufepritëse vetëtimën, për t'u shembur vetë prej saj.

Mendimi nuk i shqitej nga anëtarët e Byrosë Politike. Në darkën e përfytyruar i dukej se ata do ta zbulonin një ditë dhe do ta përqeshnin. Por edhe ai, po të ishte nevoja, mu aty në tryezën e darkës, do t'u tregonte vendin. Së paku, për dy orë mund të hakmerrej me ta, të lozta si macja me miun: Ti atje, ç'ke që zgërdhihesh ashtu, po ti tjetri, s'ke mësuar ende të mbash thikën?

Ndonëse çastet e rebelimit ishin të shkurtra, shija e hidhur ndaj anëtarëve të Byrosë i mbetej gjatë. Ata mund t'i jepnin Atij, kryezotit të tyre, mendime të çmuara, mund t'i ndërtonin uzina e t'i zbulonin komplotë, por punën e tij si vdekjethithës, nuk e bënte dot askush.

Mjaftonte ky mendim që të ndihej krenar. S'ishte punë e lehtë të mbaje mbi supe atë gunë të rëndë, vdekjen e Udhëheqësit.

Nganjëherë mendimi, duke u përpjekur të ngjitej

lart, i mjegullohej. Ishte morti i Tjetrit që do të shkarkohej mbi të, një mort i madh, i fundbotshëm, që një komb i tërë mezi do ta duronte. Kurse ai do ta përballonte i vetëm, në trupin e tij të rëndomtë.

Do të vinte, si të thuash, ai stërmort për t'ia marrë hua trupin... Kurse shpirtin ...

Këtu mendimi i shkapërderdhej krejt. Kishte dëgjuar se filozofia ishte ajo që merrej, veç të tjerash, me marrëdhëniet midis shpirtit dhe trupit, por ai, me ato pak vite shkollë që kishte bërë, s'kishte patur rast të lexonte libra të ndërlikuar.

Një mesnatë gruaja ishte zgjuar befas e trembur, për ta pyetur: e sikur, Zoti mos e dhëntë, Ai të vdesë, ç'do të bëhet me ty?

Gjer në mëngjes nuk i kishte zënë gjumi të dy. Pas pyetjes së gruas, mendimi i parë që i kishte ardhur në kokë kishte qenë proverbi: lisi bije bashkë me hijen e tij. Por gruaja kishte thirrur: pse? S'është e drejtë kjo, është mëkatë nga Zoti. Dhe ia kishte plasur vajit.

Ai përpiquej ta qetësonte, fliste si i dehur, por e ndiente që mendja e tij e thjeshtë përsëri nuk e ngrinte dot mendimin në lartësi. Kacavirrej gjer në një farë pike dhe aty rrëshqiste. Një herë thoshte se kështu qenkësh e thënë kjo punë, madje shtonte se në ngjashmëri me Kanunin e moçëm, që e përcaktonte se shtëpia e shqiptarit ishte e mikut dhe e Zotit, edhe trupi i tij, përpara se të ishte i tij, ishte i atij, Tjetrit.

Këtu ngatërhohej përsëri. Thoshte se marrëveshja ishte bërë veç për vdekjen e dhunshme dhe kurrsesi për natyralen. Por gruaja ngulmonte të dinte se ç'mund të bëhej pikërisht në rastin e fundit. Ai ngrinte supet, thoshte: mos më mundo me kësi pyetjesh. Pastaj vetë niste ta mundonte veten. Ishin dy mundësi, vazhdonte. E para dhe më e dëshirueshmja do t'ishte që të mbeteshin gjallë të dy për një kohë të gjatë. E dyta, që tjetri të vdiste nga pleqeria. Në këtë rast s'dihej ç'mund të ndodhë. Më e mira do të ishte që dytsi, me mbarimin e rolit të kthehej prapë në jetën e zakonshme, të pinte kafenë me shokët e

vet pensionistë e në kafenë "Ora", (qysh tani po e merrte malli për atë kohë). Por mund të ndodhte të mos e linin ta gëzonte atë copëz jete që i mbetej, ta mbytnin qetësish, kot, si për mllef, ose që të mbulohej e fshehta. Kurse në një rast tjetër mund të vendosej që vdekja e Tjetrit të mbahej e fshehtë dhe ai të vazhdonte ta mishëronte. Ky do të ishte dhe motërzimi më i ndërlikuar, plot rreziqe dhe befasi. Atëherë puna do të bëhet lëmsh, thoshte ai, më keq se te ai teatri... ajo drama e atij... Edipit mbret. Ç'e përmend atë turpëri, i thoshte ajo. Ç'hyn ajo këtu? Desha të them se puna do të bëhet lëmsh si në atë bordello, ku s'merrej vesh kush ishte i ati e kush i biri, e kush nëna e kush gruaja.

Uf, ia bënte e shoqja, tek ngrihej të merrte një qetësues. Ai vazhdonte të fliste për mundësinë e fundit, atë që përbënte dhe thelbin e rolit të tij, vrasjen prej armiqve. Në të vërtetë për atë po e përgatisnin, njëlloj siç rritnin kafshët prej lëkurës së të cilave bëheshin pelicet e shtrenjta. Kur ora të vinte, ashtu do t'i rripnin vdekjen e tij... Hesht, i thoshte gruaja, mos fol gjëra ngjethëse. Por edhe kur e mbante gjuhën, trurin s'e ndalonte dot. Si do të merreshin vesh të dy vdekjet, e rëndomta vdekja e tij, me vdekjen e Tjetrit, atë zonjën e madhe që do të vinte nga kushedi ç'drejtim? Përbuzshëm do ta shtynte tjetrën, as do ta vinte re fare ndoshta, ndërsa do ta mbështillte shpirtin e tij për ta çuar larg. Dhe fill pas kësaj, gjatë endjes nëpër qiell, do ta vinte re, ndoshta, se kishte gabuar. Atëherë do t'i zemërohej. Ah, unë kujtova se paskësha mbajtur një shqiponjë, e ti s'paske qenë veçse një qyq...!

Ca hapa të lehta e shkëputën nga mendimet. Hapat ndaluan para derës, por ajo nuk u hap.

Një orë e madhe në mur tregonte se darka po afronte. Një uturimë e mbytur, si gjëmim avioni, u ndie për herë të dytë, larg.

Gruaja mbajti këmbët përpara derës së myllur. Tallet me Maon që ishte myllur në shpellë, kurse vetë bën të njëjtën gjë me doktorin, mendoi. Ishte nga rastet e rralla kur shfrynte me vete kundër tij.

Ajo vuri veshin, por nga brenda s'dëgjohej asgjë. Veç në qoftë se ka vendosur të mos vijë në darkë, mendoi. Kujtimi i dytsit, me ata sy të ngrirë si të peshkut te pasqyra, e qetësoi disi.

Diktatori, nga ana tjetër e derës, ktheu kryet nga dera, pa thënë asgjë.

Në tryezën përbri tyre ishte grumbulli i radiografive dhe fletëanalizave mjekësore te hedhura pa kujdes.

Në cepin e secilës, mbi një copëz letër të ngjitur ishte emri i njeriut që i përkiste. Ishin gati gjysma e Byrosë Politike dhe disa nga ministrat kryesorë.

-Domethënë, sipas teje, dhuratat e të çmendurve kanë kuptim të veçantë, -tha diktatori pas një heshtjeje të gjatë.

-Pa dyshim, -u përgjigj mjeku H. -Ashtu si vizatimet e tyre, ashtu si ëndrrat. Kohët e fundit vëmendja ndaj tyre është rritur mjaft.

Fytyra e tjetrit, pas gazmendit të pakmëparshëm dukej dyfish më e ngrysur tani.

-Shqipëri mosmirënlohëse, -tha, me zë fare të ulët. -Dërgon dhurata, por nga helmi nuk heq dorë.

Gjithë mbasditen kishte dëgjuar regjistrimin kundër atij vetë. E kishte detyruar ministrin e Brendshëm t'ia dërgonte ashtu siç ishte, një mal me baltë të zezë, pa i përzgjedhur më parë me gruan. Tani ishte penduar.

Ajo, Shqipëria, gjithashtu do të pendohej, për gjithë atë vrer, por do të ishte vonë.

Pendimi i saj i përhihej në tru në trajtë të një qarjeje të përgjithshme. Atë rrökavaj do ta shkaktonte ai vetë, ose duke e vënë në një krusmë të re, nga ato që e bënin foshnjën të dridhej në bark të nënës, siç thoshte fjala, ose duke ikur vetë nga kjo botë. Nganjëherë kjo e dyta i dukej më ngushëlluese. Ta bënte, të shkulte flokët

e të gjerricte faqet, ashtu si gratë e dikurshme, Shqipërigruan, dyvejushën e tij.

-Gjithë ai vrer, - murmuriti.

Doktori e vështronte mendueshëm. Afroi kupën e kafesë te buzët, e gjerbi pak, pastaj tha:

-Ç'e çan kryet.

Ai tundi kokën një copë herë.

-Megjithatë, them se ka ardhur koha t'u vemë dërmën atyre që janë marrë me këtë helm...

-Atyre që kanë dëgjuar, do të thuash, -tha mjeku. Sigurisht, kjo ishte një gjë që dihej. Me sa di unë, dy javë më parë ti i ke dhënë një udhëzim Drejtorisë së Përgjithshme.

-Ah, e paskam dhënë ndërkaq.

Doktori qeshi.

-Më thuaj një gjë që nuk e ke bërë në kohën e duhur, -tha. -Tani, me sa di unë, po kërkohen vjegat.

-Se kisha fjalën vetëm për zyrtarët e rëndomtë.

-Natyrisht.

-E kisha fjalën për të lartët. Duke nisur që nga ministri.

-Natyrisht, -tha prapë mjeku.

Ai kishte zgjatur dorën ndërkaq te tryeza ku ishin radiografitë. I verbri i vuri veshin zhurmës së shkaktuar prej trazimit të tyre.

-Ia gjete?

-Po.

-Askush s'më kupton më mirë se ty, -tha me zë të ulët.

Ca çaste u ndie kërcitja e lehtë e radiografisë në duart e mjekut.

-Hm, s'e ka mirë, -tha me zë të rëndë.

Diktatori u gjallërua, siç i ndodhë zakonisht në kësi rastesh.

-A shkaktohet kanceri nga ankthi? -pyeti pas pak.

-Po nga pabesia?

Mjeku përgjigjej me zë të shkujdesur, pa e ndërprerë hetimin e radiografisë.

-Sikur ta gjeje prej grafisë kush e ka ndërgjegjen të pastër e kush jo, ti do të ishe mjeku më i madh në botë.

-Edhe ajo do të gjendet, -u përgjigj tjetri.

I verbri zgjati duart për t'ia prekur fytyrën.

-Ty të kam vetëm në këtë botë, -tha me zë gati të shuar. - Veç ti më ke mbetur. Tu comprend? Toi seul...

I pavëmendshëm, mjeku vazhdonte shqyrtimin e radiografisë. E afronte te drita e llambës, pastaj e largonte pakëz për të shquar, me sa dukej, diçka të pavërejtshme.

Një copë here biseda e tyre e rralluar vazhdoi herë në shqip herë në frëngjisht.

-Ajo është te dera, -tha befas i verbri, duke kthyer kryet andej. Vërtitet si macja kur kërkon të hyjë. Hapja derën.

I ngrysur mjeku e la mbi tryezë grafinë dhe u ngrit.

Gruaja ishte vërtet pas derës. Një shkrepëtimë në sytë e saj e dha edhe zemërimin, edhe qortimin për atë që po ndodhë.

-Darka fillon pas një ore, -i murmuriti doktorit. - Besoj se e dini.

Mjeku nuk u përgjigj. Mendimi se ishte, me sa dukej, i vetmi që s'çante kryet për të, e shpoi gruan si thikë.

-Ministri i Brendshëm ka një orë që do të flasë me ty, -iu drejtua të shoqit, por unë i thashë se je i zënë.

-Ashtu jam vërtet, - u përgjigj diktatori. -Ka ndonjë gjë të ngutshme?

Përpara se ajo të përgjigjej i bëri shenjë të heshtte.

-Prit, është e dyta herë që më ngjan se po dëgjoj një si zhurmë avioni. S'besoj se më bëjnë veshët.

-Pikërisht, -tha gruaja, duke ngritur gishtin drejt qiellit. -Telefonimi ka lidhje me të.

Me fjalë të përgatitura qysh më parë (si përherë,

ishin pikërisht ato që i pështjelloheshin më keq në gojë), u përpoq t'ia shpjegonte sa më shkurt. Një përbetim apo ishte zbuluar. Dëshminë kryesore po e sillnin me helikopter. Donin t'ia bënин dhuratë për ditëlindje. E kishin nxjerrë nga fundi i dheut. Dhe kjo s'ishte shprehje gjuhësore, por e kishin nxjerrë vërtet nga balta, nga një varr.

-Prit, -ndërpree ai. -Na e bëre mendjen dhallë. C'qenka kjo dëshmi e nxjerrë nga dheu që dashkeni të ma bënі dhuratë? Pasi më keni ngopur me naftë e me krom, tani do të nisni të më sillni baltë?

Ajo i kërkoi ndjesë që nga ngutja ia kishte thënë keq. Dhe nisi t'ia shpjegonte nga e para. Kryesorja ishte zbulimi i përbetimit. Më i madhi ndoshta gjer më sot. Kurse dëshmia përbante thirrjen drejtar Perëndimit për ndihmë. Thirrje e drejtpërdrejtë. E bërë gojarisht. E regjistruar nga një zëth. Nxjerrë nga fundi i një varri. Për arsy se njëri nga përbetarët...

Sytë e tij xixëllonin sikur do të merrnin flakë.

-Një përbetim, -tha me zë të ulët, kurse me vete shtoi: më në fund, tani e kuptoj përsë shokët donin të ma bënі dhuratë.

E lehtësuar, gruaja buzëqeshi. Mjeku gjithashtu kishte një buzëqeshje në fytyrë, por tepër të largët.

Midis heshtjes u dëgjua prapë gjëmimi i helikopterit.

-Siç duket ka vështirësi për t'u ulur, -tha gruaja.

-Jashtë bën mot i keq.

Sa herë që helikopteri lëkundej fort, Arian Vogli prekte pa dashur çantën e zezë, brenda së cilës ishte kaseta. "Çfarë?", thërriste piloti në radio. "Nuk dëgjoj mirë. Ka shkarkime. Si? T'i largohem malit? Në aeroportin tjetër? Po ai s'më pranon... Aha... Si urdhëron".

Nga dritarja e vogël u dukën prapë dritëzat e kryeqytetit, këtë herë më xixëllueshëm. Arian Vogli nuk i hiqte sytë nga ajo prushitje e largët. Ishte i ftuari i fundit që po

mbërrinte në darkën e festës. S'e kishte menduar kurrë që ky fluturim, i cili zakonisht ishte më pak se një orë, të zgjatej kaq. Nata i kishte zënë befas në udhë, si e rrëzuar nga qielli dhe, si të mos mjaftonte kjo, asnjë nga aeroportet e vegjël ushtarakë nuk po i pranonte.

Helikopteri u vithis prapë disa metra dhe ai preku çantën, si ta merrte me të mirë. Po shqetësohesh, tha me vete. Herë-herë i dukej se lëkundjet e makinës fluturuese nuk ishin veç ravgimet e shpirtit të të vdekurit.

Përndezja e pakmëparshme, kur më në fund i ishte dukur vetja demon i vërtetë që fluturonë midis shtjellës së zezë të reve, me robin në duar, po ia linte vendin një zbrazëtie kërcënuese.

Rrëzëllima e dritëzave të kryqytetit s'po i dukej mikpritëse. E kishte nxjerrë pré-në nga balta e, pasi e kishte vërtitur nëpër qiell, po ua sillte ta dëgjonin, e ata prapë ishin të pakënaqur. Si pérherë, mendoi me pezm.

Pak kohë më parë, kur ende fluturonin sipër maleve kishte provuar një frikë të akullt. Helikopteri kishte nisur të lëkundej aq fort saqë atij i ishte dukur se do të rrëzoheshin. Me padurim kishte pritur të shfaqeshin dritat e Tiranës dhe kur i kishte ajgëtuar që larg, kishte marrë frymë i lehtësuar.

Mbërritëm, o shpirt, kishte thënë me vete.

Rrugës, herë pas here kishte bërë bisedë me të vdekurin. Shpesh fjalët që i thoshte nuk ishin veç përsëritje të fjalëve të të tjerëve, kryesisht të një gruaje, të regjistruara prej "principit", por kjo i dukej tanë e natyrshme.

Mbërritëm, kishte përsëritur. Të ka marrë malli për Tiranën, besoj. Me siguri, kur ishe atje poshtë nën baltë as që të kishte shkuar mendja se do të vije prapë. Dhe në ç'menyrë se! Me helikopter, drejt e në darkën zyrtare.

Por Tirana i kishte pritur ftohtë. Aeroportet e vegjël ushtarakë i kthenin njëri pas tjetrit. Dyshimi se mos u kishte ndërruar mendja e kishte kapur befas. Një frikë bestyde ndoshta..., i vdekuri në ditëlindje... ose një tjetër shkak i errët... Vetë të thirrën e tanë kanë frikë prej teje,

kishte thënë me vete.

Tani nuk e mendonte më se po e sillte të pranguar, siç çoheshin zakonisht të arrestuarit, por gati-gati si një bashkëvuajtës. Ishin dy shtegtarë të humbur, që nuk po i pranonin te porta e pallatit të madh...

E folura e pilotit në radio e shkëputi nga përhumbja. "Është lajmëruar vetë Udhëheqësi, kupton? Si? Atëherë pse më sjell rrötull në qoftë se e di. Si? E di? Për të mirën time? Të kuptoj. Por sidoqoftë kam dy orë në qiell".

Arian Vogli nuk u besoi syve kur pa ca si dritëza të kaltërtë. Ishte aeroporti i vogël, pothuajse i braktisur, i kohës së mbretërisë, në një rrëthinë të Tiranës.

Më në fund, thirri me vete. Ishte një lëkundje e fundit e helikopterit apo iu morën mendtë? Gojën e kishte të tharë, veshët i dhimbnin. Vetëm tani e ndjeu sa shumë ishte dërmuar. Tri netë pa gjumë. Ndrekje ditë e natë e komplotistëve. Përgjim telefonash. Hamendje, dyshime, prapë hamendje.

Tani gjithçka kishte kaluar. Dritëzat e vogla, të kaltërtë, afroheshin si në ethe. Po mbërrimjë, shpirt, tha me zë.

I veshur gati për darkë, diktatori ishte ulur në kanape përballë vatrës. Doktori, në anën tjetër, vështronte herë zjarrin, herë dorën e ndehur të tjetrit, me unazën që i vezullonte shqetësueshëm. Dorën tjetër, atë pa unazë, e afronte herë pas here te sytë.

-Pastaj thonë se jam unë vetë që i shpikkam komplotet, -tha me zë të thellë.

-Nuk do ta thonë më.

I kishte lodhur, siç duket, ajo mbasdite e gjatë dhe fjalët u ishin rralluar.

-A thua se do ta dëgjojmë vërtet zërin?

-Pa asnje dyshim, -u përgjigj doktori. -Pak më parë fola vetë me ministrin. Më siguroi se zëri, ndonëse i

dëmtuar nga qëndrimi i gjatë në tokë, dëgjohet qartë.

-Pra qenka si zë i përtejmë...

-Natyrisht. Tre vjet nën dhé.

Diktatori mendoi një çast vargun e makinave që po niseshin rresht në darkë, dhe dytsin që kishte zënë vend, ndërkaq, në veturën kryesore, përbri gruas së tij.

-Ka një të thënë më të vjetër që thotë: ç'merr lumi e gjen në det, ç'merr zjarri e gjen në tym, ç'merr vdekja e gjen në varr, -tha doktori.

-Për vdekjen ka shumë proverba, -u përgjigj tjetri. Ime më, ndjesë pastë, m'i thoshte shpesh.

Tani nuk i kujtoheshin, veç njërsës: Vetëm mortja merr e nuk jep.

Mezi ç'i pritej ta dëgjonte atë zë. Nëse ishte vërtet një zë i nxjerrë nga varri, atëherë mund të thuhej se ishte herë e parë që vdekja jepte diçka. Një shenjë të dobët...

Si zakonisht, kohët e fundit, biseda për vdekjen ia trazoi trurin. I pëlqente që kjo punë lidhej me dëgjimin. Veç kësaj, nëse vdekja kishte dhënë vërtet një kumt, pas tij pritej të jepte ndoshta diçka tjetër.

Trokitja e lehtë në derë e bëri të kthente kryet andej.

Ishte kryeroja që e lajmëronte se duhej të niseshin.

Ndriçuesit në trajtë tulipani në të dy anët e udhës që conte në pallat, i jepnin gjithçkaje një qetësi ëndrrre. Pas zhurmës së motorrit dhe krahëve të helikopterit, Arian Voglit i dukej se kishte rënë në shurdhëri. Qysh nga zbritja, gjunjët vazhdonte t'i kishte të mpirë dhe kjo ia shtonte ndjesinë se nuk ecte, por notonte sipër dheut.

Çantën vazhdonte ta shtrëngonte fort pas trupit.

Po të çoj në festë, tha me vete... Në pallatin e madh plot dritë e ngazëllim, që nuk e ke parë as në ëndërr... Vetë Udhëheqësi atje të pret...

-Darka do të ketë filluar, -i tha njeriut që po e

shoqëronte dhe në çast vuri dorën në fyt. Ç'ishte ai zë i pazakonshëm, krejt i shkatërruar që i dukej se po i dilte prej goje e prej veshëve njëherësh, sikur ato të bashkoheshin prej një zgavrine?

-S'ka gjë, - u përgjigj shoqëruesi. -Ata e dinë pengesën.

Arian Vogli bëri pyetjen "çfarë?", që fare pak ngjante me atë çka kujtonte. Atij iu duk se dëgjoi të njëjtën përgjigje, por të ndryshuar pakëz në fund: s'ka gjë, shpirt...

S'jam mirë, mendoi. Shqetësimi se si do të delte kështu përpara tyre, i rraskapitur, i përbaltur dhe me atë zë si këmborë e prishur, iu davarit, megjithatë, shumë shpejt.

Ishë rrezatimi fikës, si prej hëne, i ndriçuesve që e lëmonte gjithçka. Veturat e mëdha zyrtare nxinin njëra pas tjetrës. Rojet dukeshin të ngrysur nën zhgunet e lagur.

Ta prisha gjumin atje ku dergjeshe, i tha prapë Shpend Guraziut. Gjyshja më thoshte shpesh: s'ka mëkatë më të madhe se të trazosh varret. Gjatë fluturimit me helikopter kujtova se do të hakmerreshe. Madje një herë isha i sigurtë se do të rrokulliseshim bashkë ne humnerë... Po ti, siç duket e dije, se do ta mbaja fjalën për të të sjellë në pallat... Ju e keni këtë sipëranë: dini përherë diçka më shumë se ne, të gjallët.

Hyrja e pallatit, ndonëse ende nuk dukej, ndihej që ishte pranë.

Sidoqoftë mërzi duhet të ishte atje nën dhë, i tha hijes.

S'jam mirë, tha prapë me vete.

Tëmthat i gjëmonin dhe disa nga pamjet i dyzoheshin. Kurse çizmet i kishte gjithë baltë nga ecja nëpër aeroportin e braktisur.

Hyrja u shfaq, më në fund, gjithë mermer dhe drithë. Përmes qelqeve të saj dallohej një pjesë e mesores së zbrazur.

-Darka ka filluar, -tha gjithë shqetësim, me po atë zë, si të nxjerrë nga zgavrina.

-S'ka gjë, -përsëriti shoqëruesi.

S'ka gjë, shpirt.

Shqetësimi se do të shkelte me çizmet e tij mbi qilimat madhështorë, ia behu e u tret aty pér aty.

Hyrja po afrohej por iu duk se gjithçka duhej t'i falej.

Kishte pak kohë që darka kishte nisur. Tringëllinin gotat dhe enët, por gjithë të ftuarit e dinin se, si zakonisht, fillimi i vërtetë do të ishte pas pak, fill pas fjalës së shkurtër që do të mbahej dhe ngritjes së dollisë.

Në sallën e ambasadorëve pritja dhe kureshtja ndiheshin fare zhveshur. Ai që do të mbante fjalimin do të quhej i shpallur tashmë haptas si zëvendës i shefit të madh pas... Policia shqiptare e kishte shpërndarë ndërkaq pëshpërimën me mënyrat që i dinte ajo.

Mbi fytyrën e atij që mendohej se mund të ishte zëvendësi, kishte rënë, ndërkaq, një farë zbardhjeje e veçantë, një si djersitje ngazëllyeze e përzier me hutim prej dhëndri e ndjenjë faji njëkohësisht.

Të tjerë sy hetonin kujdeshëm gruan dhe vajzën e tij, te tryeza e familjarëve të udhëheqësve. Prej tyre, gjithashtu, diçka mund të kuptohej, sidomos prej vajzës. Ajo dukej tepër e menduar. Ndryshe nga herët e tjera, kishte një veshje krejt të përbajtur dhe, një krehër rrezellues që e mbante përherë në flokë, nuk e kishte më.

-Për mua kjo është shenja më e sigurtë, -i pëshpëriti ambasadori brazilian fqinjitet të vet. -Qysh prej historisë së Agamemnonit, vajzat janë zakonisht të parat, prej të cilave tiranët e rinj e kërkojnë një flijim...

-Nuk të kuptoj mirë, -tha fqinji.

-Është e thjeshtë, -vazhdoi braziliani. -Shefi grek e mbyti vajzën e vet përpara se të niste fushatën. Ky këtu, -ai tregoi në krye nga zëvendësi, -po e bën të njëjtën gjë përpara ngritjes në post.

Fqinji buzëqeshi.

-A thua se heqja e ca stolive është baraz me humbjen e jetës?

-Për ju dhe për mua jo, -vazhdoi ambasadori, -por për një vajzë të re, sidomos një vajzë të përkëdhelur të nomenklaturës, të jeni i sigurtë se është ashtu.

Ndërsa ecte pas shoqëruesit, Arian Vogli pati shtysën të kthente kryet pas për të parë nëse thembrat e tij linin gjurma mbi qilim. Por pamja që hapej pas qelqnjajës nga e djathta e mesores e, sidomos, zëri që vinte që andej ia kishin shtangur vështrimin. Në tryezat e gjata të gostisë, qindra të ftuarit, me sy të kthyer nga kreu i sallës po dëgjonin fjalimin kremit.

Zëri në fortafolës pushoi një frymë dhe atij iu duk se darkëtarët, të ciluar prej tij, do të kthenin sytë për të parë, si ecte përbri sallave të festës i ftuari i vonuar, me çizmet që linin pllanga të zeza pas. Ky njeri po na sjell baltën në Pallat.

Shoqëruesi hapi me kujdes një derë anësore, duke i bërë shenjë ta ndiqte pas. Ecën nëpër një mesore të ngushtë, pastaj në një tjeter. Shoqëruesi hapi një derë dhe e futi në një kthinë.

-Prisni këtu, -i tha me zë të sjellshëm, duke i treguar një ndenjëse. -Do të lajmëroj ministrin.

Arian Vogli u ul. Çantën e vuri sipër gjunjëve, pastaj vështroi çizmet. Tani iu kujtua se qysh nga vajtja në varreza nuk i kishte pastruar.

Fortafolësi dëgjohej fare mbytur. Në veshë i rivinte herë pas here zhurma e helikopetrit. Ishte ngrohtë. I flihej.

Dy-tri herë e kapi veten tek po dremiste. Pastaj pa orën. Kishte vetëm disa minuta që ndodhej aty.

Dera më në fund u hap, po gruaja që hyri as që e ktheu kryet drejt tij. Mbante në duar dy pjata dhe një shishe vere.

Me sy të hutuar ai e ndoqi ecjen e saj mespërmes

kthinës, drejt një dere të mbyllur, që po e vinte re për herë të parë.

Nga që duart i kishte të zëna, gruaja e lëvizi dorezën e dorës me bërryl. Pas hyrjes, njëra nga flegrat mbeti e hapur përgjysmë. Arian Vogli padashur vështroi andej.

Ajo që pa e bëri t'i mbyllte sytë aty për aty. Fjalët: s'jam mirë, jam në ëndërr, jam çmendur, i ranë të pleksura së bashku në tru, të mbështjella nga një shije tmerri.

S'ishte mirë, pa dyshim. Tri netët pa gjumë, në këtë kthinë te ngrohur jashtë mase, pas një endjeje të marrë nëpër qiell, po i jepnin më në fund pasojat.

Ngadalë, me zemër të ngrirë, i hapi qepallat. Flegra e derës vazhdonte të ishte e hapur. Dhe... në thellësi të saj, pas një tryze, i vetëm krejt, gati-gati i pikëlluar, rrinte Udhëheqësi...

Arian Vogli nuk i mbylli më sytë. Ai pa se si gruaja, pasi i afroi pjatën e gjellës, i hodhi verë në gotë pastaj u drejtua nga dera.

Ashtu si pak më parë, ajo i kaloi përpara pa kthyer sytë ndaj tij.

S'është e mundur, thirri ai me vete. Ose unë jam i çmendur, ose... ose... Nuk guxonë të mendonte se Pallati ishte i magjepsur.

Që larg, e mbytur, erdhi një zhurmë duartrokitjesh.

Ai fërkoi tëmthat, preku me dorë çantën, pastaj vështroi derën, që tashmë ishte mbyllur.

Kishte qenë pa dyshim një vegulli... Ndryshe kurrsesi s'mund të shpjegohej... Veç në qoftë se për arsy sigurimi... Jo..., as ashtu nuk ishte e mundur... I vetëm fare, pa asnjë roje... Dhe ajo pjatë e thjeshtë... të thuash një mbeturinë nga tryze e gostisë...

I Damun, tha me vete.

Dera tjetër, ajo nga kishte hyrë, u hap befas dhe nëpër të hyri ministri.

Arian Vogli brofi në këmbë. Më në fund, mendoi. Ky makth po mbaronte.

-Shoku Arian, mirëmbërëma.

-Mirëmbërëma, shoku ministër.

Gjithçka ishte bërë prapë e rrokshme, jetësore. Dhe ministri ishte vërtet ai, me fytyrën pakëz të përndezur, si gjithë zyrtarët gjatë darkave, madje iu duk se po përtypej ende.

Buzëqeshte, disi i shpërqëndruar, ndërsa sytë i gacullonin.

-E pate të vështirë zbritjen. E di, e di. Madje nuk e fsheh, pata një farë shqetësimi. Por tani kaloi.

Sytë e tij i ishin ngulur çantës, që Arian Vogli e kishte lënë mbi ndenjëse.

-E paske sjellë, më në fund. Të lumtë!

U zgjat ta merrte dhe, kur çanta u gjend në duart e tij, Arian Voglit i erdhi të lutej: mos m'a merrni... veç ajo më ka mbetur...

-Tani dëgjo, -tha ministri, duke vështruar mbi qilim.

-Në shenjë mirënjojjeje, ty do të të presë vetë Udhëheqësi... Ndoshta do të hani darkë bashkë ...

Filloi prapë, tha me vete Arian Vogli. Nuk i kishin mjaftuar vegullitë, tani po dëgjonte zëra të rremë.

Ai tregoi me sy çizmet me baltë, por ministri bëri një shenjë shkujdesjeje me duar, si për t'i thënë: mos u shqetëso!

Arian Vogli digjej nga kureshtja t'i tregonte ç'kishte parë përtej derës së mbyllur misterioze, por për tmerrin e tij, pasi i kishtë thënë "eja pas meje", ministri ishte drejtuar pikërisht nga ajo derë.

Jo, klithi me vete kur dera u hap. Gjithë trupi i tij deshi të kthehej mbrapsht. Veç këmbët nuk iu bindën.

Pas tryezës ishte vërtet Udhëheqësi. Përpara pjatës me gjellë, ashtu siç e kishte parë pak më parë. Ministri iu afrua, i pëshpëriti diçka, duke iu përkulur te supi dhe tjetri bëri "po" me krye. Pastaj me një vështrim shpërfillës i bëri shenjë Arian Voglit të ulej përballë tij. Në ndenjësen që ishte vënë enkas për të.

Ky është kulmi, mendoi Arian Vogli. Megjithatë s'ndjente asnjë gjëzim. Përse nuk ngazëllehem, gati sa s'thirri.

Gjithçka ishte e ftohtë, si në botën e hijeve. Përfundimisht po bindej se ishte në ëndërr. Madje nga kjo ndjeu një farë qetësimi.

Ministri u mat të dilte. Ndërsa mbyllte derën, iu duk se midis tij dhe Udhëheqësit u ndërrua një shikim i shpejtë.

Tani kishin mbetur vetëm përballë njëri-tjetrit. Udhëheqësi e vështroi një grimë. Pastaj i bëri shenjë nga pjata dhe nga shishja e verës.

Vetëm tani e kuptoi se pjata, që kishte sjellë gruaja pak më parë, paskësh qenë për të.

Dora e mpirë i kërkoi vetveti çantën por aty për aty u kujtua që ia kishin marrë.

Ku je shpirt, mendoi. E humbëm njëri tjetrin në këtë pallat.

Jam keq, tha prapë. Ç'ishte kjo darkë kështu, pa fjalë, pa gjëzim? Jo vetëm kur endeshin nëpër qiell, por qyshse e kishin lajmëruar se do ta conte vetë kasetën, gjëzimi nuk i ngjizej. Sikur ta dija, mendoi.

Tjetri vazhdonte të hante në heshtje. E dinte vallë përse po ia bënte atë nder?

Si njeriu që pickon veten për të kuptuar nëse ndodhet në ëndërr a në zhgjëndër, Arian Vogli foli i pari. Me zë të ulët, si të trembej mos zgjonte dikënd, foli diçka për nderin e madh që i ishte bërë, pastaj për përbetimin që pikërisht në këtë çast, vazhdonte të zbërthehej.

Udhëheqësi bëri "po" me krye por syri i mbeti i fjetur.

Arian Vogli ndjente të ftohtën t'i shpërndahej nga shpina nëpër gjymtyrë. Zot i madh, tha më në fund... Me sa dukej, Ai s'dinte asgjë.

E ftohta po ia akullonte shpirtin. Gjithçka po bëhej e parrokshme, me një ndriçim të rremë.

Dyshimi se mos nuk ishte ai, i shkrepëtiu në tru ftohtësisht, si gjithçka tjetër. Dhe fill pas tij, dyshimi tjetër, më i rëndë: mos kishte vdekur dhe e kishin zëvendësuar me këtë pupac?

Prit, i tha vetes. Mos u ngut. Po të ishte ashtu, do të ishte atje, në sallën e festës, ku do të kishin nevojë për të dhe jo këtu, si qyq!?

U përpoq ta gëlltiste atë çka kishte futur në gojë, por gjithsesi s'mundej. Tani e kapi përse tjetri nuk fliste. Me një zë të rremë mund të mashtronin gjithkënd, por jo atë, Arian Voglin që kishte tre vjet që merrej me përgjime zërash.

Për herë të parë e vështroi drejt gati-gati pa frikë. Për besë, do të mendoje se ishte ai, mendoi.

Tjetri, që e ndjeu vështrimin, ngriti gotën e verës.
-Gëzuar! -tha qetësisht.

Arian Vogli shtangu. Maska më në fund ishte flakur. Nuk ishte zëri i tij.

E ngriti dhe ai gotën dhe ndjeu dëshirën t'i fliste, kishte tre ditë e tre netë pa gjumë. Ç'ishte nevoja për një farsë të tillë?

Do t'ia thoshte ndoshta ato fjalë, por një tjetër dyshim, më i zi dhe më i zhveshur, po i ngrihej ndërkaq nga thellësitë, përse po silleshin ashtu me të... Arian Voglin. Ata që kishin kaq kujdes të mos u dilnin të fshehtat..., përse nuk druheshin më prej tij... Mos vallë...

E afroi gotën te buza, ndërsa ndiente se si diçka zbutëj e shkërmiqej me shpejtësi brenda tij.

Veç mos më helmojnë mu përpara tij, rënkoj me vete.

Koka po i varej, megjithatë pati aq kujdes sa të mënjanonte pakëz pjatën e gjellës, që së paku të mos i binte në të.

Në darkën zyrtare kishte mbërritur ora më e këndshme, ajo e marrjes së kafesë.

Nga të gjitha dyert e sallave njerëzit vërshonin grumbuj drejt mesores qendrore.

Si në çdo darkë ku ishte i pranishëm diktatori,

pjesën kryesore të kureshtjes e thithte ai vetë. Fijet e padukshme e asnjëherë të shpjegueshme plotësisht që lidhnin çdo lëvizje të tij me darkëtarët ishin në ndehje e ndjeshmëri të plotë. Sytë e tij, si t'i bindeshin asaj ndërlidhjeje të ndërsjelltë, të përpunuar gjatë dyzetë e ca viteve, herë xixëllinin panatyrrshëm e herë shuheshin krejt.

Një valë tjetër ndërkaq, e errët, misterioze se si lëvizte bashkë me kostumet e zeza të darkëtarëve. Qarkullonte nga sallat e ndryshme drejt mesores së madhe, për t'u rikthyer prapë në to, e ndryshuar, e ngarkuar edhe më shumë me drithërim. Me zë të fikur, të ftuarit pyesnin njëri-tjetrin se a e kishin marrë vesh ndodhinë. Policia e fshehtë shqiptare kishte kryer diçka të pazakonshme, gati-gati të mbinatyrrshme. Ishte dëgjuar edhe në sallën "D" madje edhe në "F", por njerëzve u ishte dukur më tepër si përrallë. Një si punë shpirti, vazhdonte dikush e tjetri ngrinte supet ngaqë dyshonte se mund të quhej ashtu. Diçka e ngashme, pa dyshim. Një zë i përtejmë...

Ca çaste më pas, kur dukej se kthjellohej, pëshpërima ngrysej edhe më.

Ata që s'kishin besuar iu pohonin të tjerëve se paskëshin patur ndoshta të drejtë. S'qenkësh edhe aq përrallë, siç mund të ishte dukur në krye. Qenkësh fjala për një thirrje komplotistësh drejtuar Perëndimit. Madje ishte përmendur emri i Francës. Dhe e gjitha kjo lidhej me një zë të përtejmë, një farë fantazme apo hije... të kapur.

Ndërsa flitnin për të me gjysmë zëri, pëshpëritësit e huaj e ndjenin se asnjëra nga fjalët e gjuhëve të tyre nuk e jepet dot atë që mendonin. Ishte ambasadori argjentinas që kishte përdorur i pari fjalën latine "spiritus". Mos shikoni veshjen legjendare, kishte shtuar pas pak. Pëshpërima duhet të ketë një bazë.

Ambasadori francez, ndaj të cilit drejtoheshin tërthorazi vështrimet e kureshtarëve, ndihej i shqetësuar. S'ishte vetëm përmendja e emrit të Francës, së cilës i qenë drejtuar për ndihmë komplotistët, as "përgjigjja" e saj, për të cilën nuk sqarohej asgjë, por diçka tjetër, përsë Sigurimi shqiptar

e kishte lejuar hapjen e pëshpërimës.

-Kjo pëshpërimë s'më pëlqen, -i tha me zë të ulët kolegut të vet italian, ndërsa merrnin kafenë e dytë. Më e pakta gjë që ajo parandjell është një acarim i ri me Francën, për të mos thënë me krejt Perëndimin.

Tjetri buzëqeshi.

-Po të jetë puna për acarim, këtu duhet gjetur një fjalë tjetër, mik i dashur. Shqipëria ka dyzet vjet në acarim të palodhshëm me gjithë botën.

-E keqja s'ka fund, -tha i menduar francezi.

Turma e të ftuarve lëvizte vazhdimitdh dhe atyre iu duk se midis zhurmërisë së shtruar kapën prapë fjalën "spiritus".

-Sidoqoftë, një shpirt vërtitet nëpër pallat, -tha italiano, që kishte nisur të mësonte pakëz shqip.

Francezi tundi kryet pikëllueshëm. S'ishte herë e parë që në këtë pallat ndodhnin ngjarje të pashpjegueshme.

Pjesa e tretë

ÇMËRSI

Grupi i huaj, që për disa javë rresht ishte marrë me një hulumtim të errët, u largua nga qyteti B. krejt papritur, një mëngjes fundvjeshte.

U duk se asnjeri nuk e vuri re ikjen e tij, ashtu siç nuk kishte vënë re ardhjen, e aq më pak atë që kishte bërë gjatë atij muaji të ftohtë e plot mërzi.

Për dy ditë rresht, qyteti ra në një shurdhëri të pazakontë, për t'u zgjuar të tretën ditë, krejt i ndërkryer.

Njerëzit vërshuan në rrugë në mënyrë të beftë, i mbushën së pari kafenetë dhe udhëkryqet e qendrës, pastaj ato më të largëtat, e fill pas kësaj nisën të vërtiteshin parandonjë synim në trajtë gjeratoreje.

Në mesditë, në vend që të fashitej disi, trazimi po shtohej. Një drithërim i tillë s'mbahej mend qysh nga koha e errët kur një psikopat kryeqytetas, shumë vite më parë, në kohën e regjimit të vjetër, kishte mbytur një shkabë në kopshtin zoologjik.

Grumbuj njerëzish drejtoheshin nga varreza e qytetit, për t'u kthyer pastaj me këpucët gjithë baltë.

Lajmi i vetvrasjes së dikujt në mbasdite vonë, e

shtoi trysninë. Një shtatore ishte rrëzuar në lagjen e sipërme dhe makina e policisë po rendte nëpër udhën kryesore për të shmangur, me sa dukej, ndonjë shkatërrim.

'Në prag të muzgut, qyteti ngjante si i shkalafitur. Një uragan nuk do të kishte lënë më pak gjurmë gjatë kalimit mbi të. ,

Megjithatë njerëzit dukeshin më të çliruar. Me sa dukej, furtuna që e kishin ndryrë brenda vetes gjatë atyre dy ditëve të shurdhëta, kishte qenë më e padurueshme se ai shpërthim.

Të nesërmen, ndonëse më i shtruar, trazimi vazhdonte. Te dyert e "Albturizmit", pavarësisht se afishet që njoftonin se hotelet e bregdetit ishin mbyllur, ishin përherë me shkronja më të mëdha e me ngjyra më të forta, njerëzit zinin radhën me shpresë se mos hotelet e Durrësit ose ato të Sarandës ishin hapur, madje ishin gati të shkonin edhe më larg, veç t'iknin këndeje, në Shën Gjin përshembull, në veri, atje ku me siguri binte dëborë. Te varreza e qytetit gjithashtu kishte ecejake. Pas gazetarëve të ardhur nga kryeqyteti, kur varrin e Shpend Guraziut erdhën ta vizitonin dy grupe eskursionistësh, mbikqyrësi i varrezës u shqetësua dhe kërkoi një polic për çdo rast.

Të nesërmen, kur një grup arkeologësh që gërmonte në një qytezë ilire në krahinën fqinjë, duke përfituar nga mjeshteria, kërkuan të hapnin rrasën e mermertë, mbikqyrësi, pasi ua hodhi poshtë kërkuesën, e rrethoi varrin me një thurimë të thjeshtë hekuri, duke kërkuar prej cilitdo që kërkonte t'i afrohej, kartën e gazetarit ose të policisë.

Ndërkaq gazetarët, pasi kishin dërguar lajmet dhe reportazhet e para me titujt e bujshëm "Një shpirt i kapur", "Në kërkim të shpirtit të humbur", "Shpirtkurthi" etj. vërtiteshin në qytet për të bërë zhbirime të reja për ngjarjen. Ata lëshonin britma, gati shkullnin flokët nga marazi, kur merrnin vesh se grupi i të huajve, ai që e kishte nxjerrë nga dheu këtë ndodhi, ishte larguar nga Shqipëria, pa lënë as gjurmë e as drejtim.

Ishte kjo mungesë që, me sa dukej ushqente, ashtu

siç ishin në gjendje të ushqenin vetëm mungesat, ndezullinë shpirtërore të njerëzve. Në mbrëmje vonë te bar "Liria" a në barin e hotelit, gazetarëve, pasi ishin rrekur më kot të merrnin vesh emrat e të huajve dhe vendin ku e kishin qendrën, New-York, Romë, a Dublin, s'u mbetej veç të ëndërronin ndihmën e fatit për një takim me ta.

U desh të kalonte fare pak kohë për të bërë një zbulim më se tronditës. S'paskësh qenë i nevojshëm takimi me grupin e të huajve për të zbuluar misterin. Në një trajtë ose në tjetrën, ngjarjen e dinin, ose, më përpiktaz, e kishin ditur pothuajse të gjithë, qyshkur.

I ishinshmangur prej vitesh, e kishin lënë të kullonte në thellësi të qënies së tyre, gjersa iu ishte krijuar përshtypja se e kishin harruar, për të mos thënë se nuk e kishin ditur kurrë.

Askush nuk ishte në gjendje të shpjegonte këtë marrëveshje të heshtur. Vinte, ndoshta, që nga muzgje të dikurshëm, atëherë kur njerëzit, të shtangur përpara ngjarjeve të kohës, vetvetishëm e nuhatnin cilat prej tyre duhej të mbuloheshin nga harresa e cilat të këndoheshin në balada zymtore.

Kështu ishin gjendur, me sa dukej, edhe përpara kësaj ndodhie, me mëdyshjen e hershme, e cila, si çdo gjë e vjetër, e rishfaqur jashtë kohës së vet, po i torturonte tashmë.

Në sytë e çmeritur pikasej po ajo pyetje: ishte më mirë të tretej, apo të ringjallej ngjarja? E ndjenin se as njëra as tjetra nuk ishte në dorën e tyre. Ta mybynin s'kishin fuqi, por edhe ngjallja dukej e përcudur. Shumë-shumë mund të ringjallej pas një vdekjeje, pra, me lejen e saj.

Mirëpo ngjarja nuk kishte arritur, me sa dukej, të vdiste plotësisht, për të shpresuar ngjalljen e saj. Kishte qenë midis të dyjave, e vdekur e pakallur, siç thuhej, ndaj dhe ishte e patrajtueshme prej mendjes së njerëzve.

\ Dalngadalë po bëhej e qartë se grupi i kërkuesve të huaj, me zbulimin e saj, nuk kishte bërë gjë tjetër

veçse kishte ndërprerë një zhdrivillim, proces, të domosdoshëm. Para kohe e kishte nxjerrë nga dheu atë, që ishte dashur të dergjej edhe mjaft kohë atje. E trandur, kështu, nga ky zgjim i përdhunshëm, e dëmtuar, e përbaltur, me pjesë të thyera, me një pikëllim çnjerëzor sipër saj, ajo ishte e padurueshme. Të vriste sytë dhe veshët dhe gjumin e dëbonte larg.

Kështu u shpjegua ato ditë ai trazim e ajo ecejake e pafund, një pjesë e së cilës nuk ishte veçse përsëritje si në ëndërr e gjithçkaje që kishte ndodhur vite më parë. Të përgjuarit e dikurshëm prej mikrofonave ngarendnin prapë si atëherë, pa gjetur qetësi, i vishnin e i hiqnin me tërbim veshjet ku dyshonin se kishin zëthat, krejt si ata që kërkojnë të shpëtojnë prej zekthit. Të tjerë, ashtu si dikur kur rrekeshin të delnin jashtë valëve të përgjimit, vazhdonin të kërkonin hotele sa më të largët e me çfarëdo çmimi.

Vetëdehja shkoi aq larg, saqë pati raste kur ishpërgjues të vjetër, të rigjallëruar befas, i lanë flokët e i pastruan veshët si dikur e, ashtu qetë-qetë, shkuan në vendet e dikurshme ku kishin përgjuar e kishin qenë të lumtur.

Tani u kuptua se ngjarja, ashtu e gjymtuar e shtatanike, siç po dilte nga harresa, ishte më e tmerrshme se ç'do të ishte po të ishte e plotë. Duhej bërë diçka pér të shpëtuar prej saj, thuhej andej-këndej. Dhe sërisht vinin mëdyshjet: të mbulohej prapë ishte vonë, të ngjallej ishte herët.

"Po përse?" pyesnin gazetarët e ardhur vendësit, përse veç kjo ngjarje paskësh qenë e tillë, vetanake, sa pér të trandur si tërmët një qytet të tërë? Me sy shpërfillës, siç dëgjohet ai që flet gjëra pa kuptim, vendësit vështronin të ardhurit.

Të shkurajuar, gazetarët vazhdonin, megjithatë, zhbirimet e tyre. Në këtë qytet kishin ndodhur tronditje të tjera: përmbyssja e diktaturës komuniste, shmangia pér një fije e luftës civile, rrëzimi i shtatores së diktatorit dhe zvarrisja tri herë rresht rrëth kështjellës së vjetër ilire. Përse asnjëra prej tyre, ndonëse të gjitha përkujtoheshin nëpër gazeta e

në TV, nuk kishte shkaktuar furtuna të tilla.

Ata që duhej të jepnin arsyet, tundnin kryet. Haptaz e tregonin se ishte e lodhshme, e ndoshta, e pamumndur të përgjigjeshin. Dhe kur gazetarët, për të nxitur mendimin, thoshnin se, ndoshta, kjo vinte ngaqë në qytet ende ishin gjallë një pjesë e spiunëve, e hetuesve, dëshmitarëve të rremë, e zëthavënësve, e zëthaheqësve, e torturuesve, e gjyqtarëve, e natyrishët ishin gjallë gjithashtu një pjesë e viktimateve, vendësit prapë mbeteshin po aq të kursyer në përgjigje.

Ishte e vërtetë që të dy palët ishin ende gjallë, por kishte kohë që midis tyre nuk ndodhët asgjë. Thua jse të dy palët, ndonëse jetonin në të njëjtën hapësirë, ishin të verbër e nuk e rroknin me sy njëri-tjetrin.

"Atëherë përsë?", kishte uluritur mu në mes të bar "Lirisë" një gazetar i radios që vinte për të katërtën herë në B., "Për ç'dreq arsyet veç kjo ngjarje po na çmend të gjithëve?".

"Mos bërtit, djalosh", i ishte përgjigjur një burrë i vjetër nga tryeza fqinje. Fliste me zë fare te ulët, nga ata që janë të aftë megjithatë të vendosin heshtjen përreth. "Ti pyet përsë". "Do të ta them unë".

Ai vazhdoi të fliste me zërin e tij të ulët, gurgullues, pa u kujdesur nëse të tjerët e ndiqnin. Në të vërtetë njerëzit përreth sa vinte shtrëngoheshin për të mos u shpëtuar asgjë. Ngjarja, sipas njeriut që fliste, ishte tronditëse ngaqë ishte e shënuar. Jo e shënuar, siç përdorej për të kremitet e festat, por e shenjuar. Ishte me hierore, aureolë, sipas tij. Si hierorja e ikonave. Veç kësaj ishte e rrallë, tepër e rrallë, nga ato që, si kometat, shfaqeshin një herë në shtatëdhjetë, ndoshta njëqind e shtatëdhjetë vjet, e ndoshta edhe më rrallë.

Kishte gjasë që kishte ardhur gabimisht nga të tjera botë, ku sundohin ligje të tjera. Kishte humbur udhën, ndoshta, nëpër hullitë e gjithnjës, dhe ashtu e hutuar, kishte bujtur pa dashur në botën tonë.

Ndaj dhe ishte e huaj për botën, për të mos thënë

armiqësore, ashtu siç ishte bota për të, njerkë. Kështu që ishte e natyrshme që edhe ne e tillë të na dukej, përherë e dyzuar, aty e rrokshme e aty jo, e hijedritshme, si ta thuash, e trupshpirtshme, gjysmë hyjnore, gjysmë tokësore, baltë dhe qiell përzier, bijë e vërtetë e kaosit...

Njeriu e ndërprenë të folurën për të porositur një kafe.

E piu kafenë midis heshtjes, që nuk guxonte ta prishte njeri. Veç dikush, kushedi pse, pas një psherëtime të thellë murmuriti: ne kemi marrë fund.

Kur pas gazetarëve në qytetin e vogël buisen kineastët e pastaj dramaturgët, e fill pas tyre një princeshë angleze e shoqëruar nga kryetari i Shoqatës Botërore të Mediumëve, u kuptua se kjo histori nuk do të mbyllej shpejt.

Qyteti, ndërkaq, si rrallë herë në jetën e tij të gjatë dymijë e ca vjeçare, po merrte pjesë gjerësisht në ngjarjen, si zbulues ose mbulues i saj. Dalngadalë po bëhej e rrokshme se qysh nga ndërtimi i kështjellës ilire, i hapjes prej romakëve të Via Egnatias, që kishte kaluar përbri, i vrasjes së një shkabe prej një të çmenduri gjatë diktaturës komuniste dhe fillimit dhe lënies përgjysmë të një autostrade, në vitet paskomuniste, kjo ishte ngjarja që mund të quhej edhe ndërtimi më i bujshëm në këtë krahinë të vendit.

Tisi i shkaktuar prej saj, pluhuriza, gropat dhe rreziqet ishin aq të pranishme kudo, saqë kishte ditë kur dukej se e vetmja mënyrë që një qytet balkanas t'u shëmbellente qyteteve ngjyrë hiri barok të Evropës Qendrore, ishte zëvendësimi i pirgjeve dhe katedraleve që i mungonin, me krime e frikëra të moçme.

Ai dukej tani vërtet i madh, i mistershëm, sidomos në prag të muzgut.

Ishin pikërisht këto fjalë që shkrimtari Skënder Bermema, i cili porsa ishte kthyer në Tiranë, ia tha të shoqes.

Ajo e dëgjonte, pa e ndërprerë krehjen përpara pasqyrës, madje i tha se ai gjithashtu duhej të bëhej gati për në pritje.

Ndihej i lodhur. Gjithë rrugës e kishte lënë veten të trullojë prej atyre ç'kishte dëgjuar në B. Çdokush që do të mësonte se Skënder Bermema, ai që e kishte përshkruar këtë ngjarje shumë vite më parë në një nga romanet e tij, duke e paraqitur si ndodhi kineze, ishte përsëri krejt i përpjekë prej saj, do të mbetej gojëhapur.

Atje në B. adhuruesit e tij, pasi kishin pritur më kot, që ai, në një farë mënyre, të krenohej që mu në mesnatën e robërisë kishte guxuar të shkruante atë tmerr, gati-gati ishin zemëruar me të. Së paku mos u tmerro e as mos u mrekullo prej saj, i kishin thënë. S'të shkon as njëra, as tjetra.

Por ai, pa e çarë kokën për ta, kishte vazhduar edhe të mrekullohej edhe të ngjethet, madje më fort se të tjerët. E kishin të vështirëta kuptonin tani, ashtu siç nuk e kishin kuptuar vite më parë, kur kishin kujtuar se arsyeva e vetme që e kishte kinezizuar atë histori, kishte qenë çenzura komuniste. Si mund t'uash shpjegonte se përvèç asaj, kishte qenë dhe një tjetër arsyë, po aq e fortë, përtë mos thënë vendimtare, nevoja përtë ta çuar ngjarjen larg, tepër larg, si e vëtmja mënyrë përtë ta zotëruar.

E kishte ndjerë qysh atëherë se ajo histori ishte e veçantë, e ydekjejetshme, në mund të përdorej një fjalë e tillë. Kishte përshkruar shëmbëlltyrën e saj të turbullt e të përkorë, si pasqyrimi i drizëzës në fundin e një pusi, i sigurtë se ngjarja do të varrosej përtjetë. Kurse ajo, befas, ishte rikthyer. Tani ishte i sigurtë se më fort se kushdo ai kishte një lidhje me të. E kishte njojur fare të brishtë, pëshpërimë që e merrte era lëndimthi, kurse tani kreshpërohej

e shtillej si re e zezë, u prishte gjumin botës, duke kërkuar s'dihej çfare, trazim të mëtejshëm apo qetësi.

Skënder Bermemës i ngjante se kishte një detyrim ndaj saj, e aty për aty, ndihej krenar ose fajtor. Kishte ditë që i dukej se për të shtruar furinë e saj do ta thërrisin pikërisht atë, thua se vetëm ai ia dinte huqet.

Rrugës, ndërsa muzgu dendësohej, dy-tri herë kishte pyetur "ç'ke?".

Ndihej që edhe ajo kërkonte diçka prej tij. Është vonë, kishte thënë me vete. Letërsia e kishte lodhur qyshkur. Përherë dhe më vështirshëm i duronte qoftë gjëzimet, qoftë hidhërimet e saj.

Megjithatë kishte ditë që ajo histori s'e linte të qetë. S'i ndahej as në èndrra, madje dukej sikur që andej, nga zona e gjumit e kishte nisur ngacmimin. Ishë joshëse e aty për aty zymtohej kërcënueshëm, thua se do t'i fajësonë se e kishte shpërdoruar dikur, atëherë kur kishtë qenë e re dhe e përkorë, e tanë që koha dhe përgojimi njerëzor e kishin pocaqisur, i shmangej.

E sikur... mendonte herë pas here duke e lënë veten të miklohej, përpara se të shkundej e të thoshte prapë "jo".

Kështu e kishte shtyrë prej vitesh tundimin për të shkruar atë që në ndërgjegjen e tij e quante "tregim të pamundur". Kishte çaste që i dukej i njëmendshëm, por ato ishin të shkurtra. E ngushëllonte veten me mendimin se ky duhej të kishte qenë tundimi i shumicës së shkrimtarëve të kësaj bote. Një vepër e pazakontë, gjithsesi. Jo vetëm për nga tharmi, por nga gjithçka: nga brumi, mënyra e ngjizjes, ndërtimi. Një vepër ku ngjarjet të rridhnin në drejtime të kundërtta, për shembull, si gjaku në venat dhe në arteriet, njëri i ngarkuar me oksigjen e tjetri i mbushur me gaz karbonik, domethënë me vdekjen. Një vepër me një pjesë të ngrirë midis, në pritje të një klime tjetër... Ose me mikrob në pjesën e parë, që të mund të jepte ethe ose vegulli më pas...

-Unë jam gati, -tha e shoqja. -Ti ç'bën?

E dinte se ia kishte ënda ta kundronte kur stolisej te pasqyra, ndaj zëri i saj ishte i butë.

Ai u vesh me ngut. Rrugës për në pritje mendimi, bënte ç'bënte, i kthehej te shënimet që kishte mbajtur dikur, në një çast dehje mendore në kafe "Flora", një mbasdite dimri. Ishin shestime për tipe të ndryshme krijimesh. Roman me shtojcë, mekanizëm në trajtë brezi shpëtimi, në rast murtaje në botë, ose rrezikimi të ri të kombit shqiptar nga i njehti drejtum si në shekujt VII ose VIII, ose lëvizje akullnajash a zhvendosje e lehtë e boshtit tokësor. Ç'pjessë, madje ç'fjalë do të zëvendësoheshin a të ngrinin nga egërsimi. Këtu mund të hynte shtojca e re në çdo shfaqje të kometës Halley, si një pasqyrëz përballë saj, një farë nderimi, përhëndetje a zbutje.

-Dukesh i lodhur, -i tha e shoqja tek po hynin në ambasadën e Bashkimit Evropian. Vazhdimin e mendimit, të përpinqej të ishte pak më i vëmendshëm me njerëzit, ajo ia kaloi me një shtrëngim të lehtë të krahut. Mirënjohës, ai ndjeu dëshirën ta puthte te tëmthat, ndërsa e ndihmonte të hiqte pallton.

Pëshpërima e vjetër se ajo çka ishte përfthuar si dhundi e pazakonshme, nuk ishte veç një çrregullim i herëpashershëm i trurit (për të mos thënë çmenduri e tij), ishte rihapur prapë kohët e fundit.

Ti je i çmendur. Kishin kaluar kaq vite që Ana Krasniqi ja kishte thënë e para ato fjalë, dhe qysh atëherë, sikur ajo t'ua kishte lënë porosi, gratë që kishte njohur, herët ose vonë, mbërrinte një çast që ia përsërisnin.

Të dy salonet e ambasadës ishin plot. Pritjet në selinë e Bashkimit Evropian ishin nga më të gjëzueshmet kohët e fundit. Ai mori një wiski dhe u tërhoq në një kënd pranë qelqnajës që dilte në kopsht. Pranë ftohtësisë që vinte nga jashtë, iu duk se e kishte më lehtë ta conte mendjen te romani i tij i pamundur. Tani përpinqej të kapte një zgavrinë në fund të tij, një farë vrime të zezë, që mund të shërbente si mjet asgjësimi, në rast vetëvrasjeje të veprës. Ajo lidhej me një tjetër pamje të shkretë: shkronjat

e gjuhës, mijëra a-të, xh-të e y-të e saj, të ndërruara në pluhur, pas prishjes së gjuhës shqipe, e të shpërndara në qiel në pritje të ringjalljes së saj.

Si përherë, pas gjerbjes së parë, pija i dha një kthjellësi të padurueshme në tru. Gjithçka iu duk e lehtë: hija që duhej të shoqëronte romanin në tokë, lodrimi i tij në qiel, pastaj ethet, kllapia, së fundi çmenduria e tij.

Të gjitha ishin aty, o Zot, mendoi. Veç ai duhej t'i nxirrte nga ai pus. Pa le ta quanin si të donin. Të çmendur e të stërcmendur.

Kërkoi prapë wiski dhe me vete tha: veç atë ta shkruaj, pa dhe bota të përmbyset.

Sytë e një vajze të re kërkonin këmbëngulshëm të ndeshesheshin me të tijtë. Vetvetiu, sipas një frenimi të krijuar gjatë viteve të shumtë të njohjes publike, ai iu shmang. E afroi gotën e wiskit te buzët dhe me vete tha: ç'është kjo vajzë që i ngjet Anës? Varri i saj, me mermérin ngjyrë qumshti, i vetoi ndërmend, siç i ndodhte sa herë që diçka ia kujtonte të vdekurën.

E vështroi vjedhurazi, dhe iu duk prapë ashtu. Dhe duhej të kishte të njejtën moshë që kishte pasur Ana kur ishin njohur bashkë: njëzet e dy-njëzet e tre vjeçe.

E çoi mendjen prapë te romani, por nuk e kishte më tejdukjen e parë. Kujtimi i njohjes së parë me Anën, në një darkë ditëlindjeje, mozaikë e përkorë, gjysmë e shuar nga koha, kishte ende fuqi të tërhiqte mendjen e tij.

Mund të jetë mbesë nga Krasniqët, mendoi dhe aty për aty iu drejtua njeriut që kishte përbri, një nëpunësi të Ministrisë së Jashtme, me të cilin s'kishte veçse një përshëndetje.

-Shqiptare është ajo grua e re që bisedon me ambasadorin italian?

Tjetri bëri "po" me krye, pastaj shtoi: -Në mos gaboj është e fejuara e një anëtari të Presidencës.

Aha, paskan arritur kaq shpejt, tha me vete, pa e ditur as vetë se ç'kishte qenë shpejt.

-Ah, ashtu? -ia bëri. -Është e bukur.

Vajza, sikur ta ndjente që flisnin për të, vështroi me një buzëqeshje ngazëlluese.

Idiot, i tha vetes Skënder Bermema dhe ktheu kryet nga kopshti dimëror, që ndriçuesit e rrallë e bënин të dukej edhe më i ftohtë.

Që ishte i çmendur, kishte nisur të dyshonte dhe vetë. Madje nuk i ishte dukur ndonjë zbulim kushedi se çfarë. Zbulimi kishte qenë tjetërkund: gjatë shumë viteve paskësh qenë, me sa dukej ashtu, dhe ishte pikërisht kjo që e kishte shpëtuar. Ashtu si somnambulët që sëmundja i ruante gjatë ecjes natën sipër pullazeve të pjerrët, ashtu çmenduria e kishte mbrojtur nëpër terr të kohës.

Tani po vinte me sa dukej në vete... Por ai nuk donte. Kjo kohë gjithashtu nuk po i pëlqente. Ndoshta ishte vonë për të. Asnjë kohë s'mund t'i pëlqente më pas atij tmerri. Vazhdo dhe pak mosmendja ime, tha me vete dhe, aty për aty, buzëqeshi. S'ishte dhe aq i pamëshirshëm me veten përderisa e kishte zëvendësuar fjalën "çmendje" me një tjetër, që ndoshta s'gjendej në gjuhën shqipe.

Midis të ftuarve i zunë sytë psikiatrin Y.V. Do të donte t'i thoshte: njerëzit të kërkojnë zakonisht t'i shpëtosh prej çmendjes. Po në rast të kundërt, kur s'druhen prej saj por prej rrezikut të kthjellimit, ç'bëhet?

Të gjithë kishin dashur të fajësonin njeri-tjetrin për atë që e kishin vetë, kohë e çmendur, popull i çmendur. Popull i çmendur bashkë me zyrtarët e vet, mendoi, ndërsa veshët i kapnin ca dromca bisedash përbri.

U kthyte për të dëgjuar më mirë dhe vështrimi iu ndesh prapë me sytë e gruas së re. Bisendonte gjëzueshëm midis një grupi të ftuarish me gotën e shampanjës në dorë dhe fustani i gjatë i kuq i shkonte mrekullisht.

Ishte vonë për të hequr sytë, kurse në të sajtë ndriçimi u dendësua aq fort sa që një nga biseduesit ktheu kryet për të ndjekur, siç dukej, kahun për ku po rridhte ai ngazëllim.

Skënder Bermema e shkëputi vështrimin dhe afroi

gotën te buzët, ndonëse nuk i pihej. Rri me ambasadorët, iu drejtua me vete së panjohurës. Asgjë të mirë s'do të kesh prej meje.

Iu afrua qelqnajës, si të kërkonte mbështetje dhe një copë herë kundroi drurët e akulluar në kopsht.

Nuk ishte më i ri për lidhje të tilla. Aq më tepër për një femër që në ndërgjegjen e tij më tepër se grua e re përfytyrohej si vajzë.

Asgjë të mirë s'mund të kishte prej tij. Veç mërzisë prej murgu dhe zymtimit manastiror.

Përbri, veshët i kapën fjalën "spiritus" dhe e kuptoi se po flitej pikërisht për atë që ai kishte pasur frikë.

-Sinqerisht ende nuk di asgjë, -thoshte ambasadori francez. -Natyrisht kam kërkuar të marr vesh diçka, i shtyrë, veç të tjerash, edhe nga kureshtja, por asgjë, më besoni, gjer tani asgjë.

Tani mund t'i ktuhehesin të pyesnin atë, për shkak të shkrimit të tij të hershëm. Që fantazma e inxhinierit do të mbërrinte gjer në pritjet diplomatike, s'ishte ndonjë gjë e papritur. S'kishte qenë e rastit që, me sa kishte zhbiruar ai, pikërisht në një pritje zyrtare, në Pallatin e Brigadave, ajo kishte marrë shtysën e parë. Kishte qenë, me sa dukej, vetë diktatori, që në darkën e fundit të tij, ashtu i verbër siç qe, e kishte ngjizur i pari.

Tirani dergjej prej vitesh nën dhé, dhe sa herë që "spiritus" të rishfaqej ashtu si sonte, s'kishte pse të habitej po t'i drejtoheshin atij. Ta thërrisin siç thirreshin magët e dikurshëm për ta vënë në fre, ose si ekzorcistët.

Ai deshi të klithte: lermëni të qetë! Mjaft e kishte mbajtur në kokë, në kohën që trutë e tyre flinin.

Kishte nevojë vërtet për pushim. Ta linin të qetë në mosmendjen e tij. Veç ashtu do ta rishkruante, ndoshta, historinë e fantazmës.

Dhe po ashtu..., vetëm ashtu..., si somnambul, mund ta përfytyronte veten duke u çlodhur prej mëndafshit të flokëve të... gruavajzës.

Një grimë e mendoi vërtet ashtu, me flokët e shprishur,

ndërsa buzët e saj të bukura, tek hapeshin për të thënë "të dua", si t'i bindeshin një porosie të largët, i pëshpëritnin ëmbëlsisht: "i çmendur".

Në qytetin B. dimri s'lodhej së hedhuri rreshje e mjegull si rrallëkund. Megjithatë autobuzët ndërqytetas, e sidomos ata të Tiranës, nuk e pezulluan rrugën asnijëherë.

Kureshtarët e mëdhenj, ata që pasi e kishin dëgjuar ngjarjen misterioze, vinin më në fund këtu, në krye ngeleshin të zhgënjer. As vetë s'e kishin të qartë se çfarë nuk gjenin nga ajo që kishin shpresuar, megjithatë kishin përshtypjen se diçka mungonte.

Veç varrit të Shpend Guraziut, tek i cili rendnin pa përjashtim, dhe për të cilin, ashtu siç pritej, ishte hapur fjala se i kishin lëvizur gurët përsëri, nuk gjenin gjurma të dukshme të trazimit.

Ç'prej disa javësh varri ruhej, sidomos natën dhe, siç kishte shkruar një gazetar, ky qenkish varri i dytë në Shqipëri, në këtë gjysmë shekulli, që kishte pasur këtë fat. Pas zhvarrosjes së diktatorit vite më parë, trupi i Shpend Guraziut kishte mbetur i vetmi që kishte roje.

Kureshtarët, pasi i binin kryq e tërthor qytetit, turbull e kapnin se kjo ngjarje ishte e tillë që, ashtu si shkarkimet e motit, mund ta jepte bubullimën larg. Dalëngadalë ata po e kuptonin se ajo jo vetëm nuk kishte qendër, por kishte prirjen të mos kishte as truall e as kohë.

Tek dilte nga kaosi, trajtat i ndryshoheshin vazhdimi, megjithatë diçka e ruante të paprishur. Ndonëse kishte dalë mbi dhë e mbante ftohtësinë e nëntokës, ku kishte kaluar aq vite. Dhe kështu, dyjetëshe, vazhdonte të shqetësonë gjithkënd.

Ndërkaq po jepte shenja të tjera se ishte e një race të veçantë. Pjesa e rrokshme e saj përzihet përherë me makthe, të cilat binin më pas. Por nganjëherë qëllonte që, në vend që të binin makthet, rrëzoheshin pjesë të trungut

të njëmendtë dhe makthet ktheheshin në trung.

Ndryshime të tjera të saj, shterrje a tharje të një pjese, qëllonte që jepnin fryrje e pezmatim te pjesa tjetër. Po ashtu, prirja për t'u rreshkur ndihej qartë. Kërkonte të krijonte një farë guacke ku të mbyllej e aty për aty e çante zhguallin, për të kriuar një tjetër.

Shenjat epike iu shfaqën haptaz kur ajo dha motërzimet e para. S'kishte kaluar asnjë stinë, kur dolën, ndërkaq, tre Arian Vogla. Ishin të tre me gjuhë dhe me duar të thara prej mallkimit, ashtu siç ngulte këmbë legjenda, kështu që nuk jepnin dot asnjë shpjegim. Veç secili pohonte me sy se ishte ai që kishte qenë Arian Vogli, domethënë "demoni" i vërtetë.

Shokët e burgjeve e të kampeve, që kishin qenë me secilin prej tyre qoftë në Spaç, qoftë në Burrel a Fushëbar mbronin secili Arian Voglin e vet, pa sjellë ndërkaq ndonjë vërtetim bindës për të përjashtuar të tjerët.

Motërzime pati jo vetëm për personazhet e tjerë, por edhe për disa nga nyjet e ndodhisë. Ndërkaq të tjera shenja, si tkurrja e ngjarjeve të disa stinëve brenda një kohëzgjatjeje prej disa orësh ose e kundërtë, fryrja e një ndodhie fare të shkurtër, për të mbushur me të vite të tëra, tregonin fare dukshëm se ngjarja shpejtonte të kthehej në baladë. Madje për këtë të fundit, fryrjen, një shkencëtar i ri kishte rikujtuar fjalën "mufatje", të përdorur gati një shekull më parë prej studiuesve gjermanë të epikës ballkanase.

Një nga "mufatjet" më të pastra kishte ndodhur me ngjarjet e natës së paharrueshme të Arian Voglit në Pallatin e Brigadave, në darkën e ditëlindjes së diktatorit.

Ja historia e Arian Voglit, të mbiquajturit "demon", sipas njërit prej motërzimeve "të mufatur".

E varrosur prej kohësh, ajo doli së bashku me krejt ngjarjen, fill pas pëshpërimës së parë. Me të dëgjuar ringjalljen e historisë së kapjes së një fantazme prej Sigurimit shqiptar,

histori në të cilën kapësi, merret me mend, zinte një vend qendror, e sidomos, kur u pohua njëzëri se kapësi pas nderimeve të para, rritje në gradë, dekorim me Urdhrin e Flamerit, etj., një vit më pas u godit nga mallkimi dhe u dënuar dyfish prej shtetit dhe prej qilliit, domethënë me burg dhe me gjyntim trupor, me t'u përhapur, pra, pëshpërima e vjetër, aty për aty disa ish-të burgosur u kujtuan se e kishin takuar të gjymtuarin në burg ose në kamp.

Ah, një burrë i ri, pothuajse djalosh, me shtat mesatar, me sy ngjyrë hiri prej joshësi, që jo vetëm të dy duart por edhe gjuhën e kishte të tharë? Po unë kam qenë dy vjet me të në kampin e Torovicës, madje në të njëjtën barakë. Një plakë nga Lezha, thuhej, e kishte mallkuar.

Diçka të ngjashme thoshnin veteranët e Burrelit e të Spaçit e, sidomos, ata të kampit të Fushëbarit. Përkonte pak a shumë përshkrimi trupor dhe sidomos gjyntimi, si dhe ajo që njeriu kishte qenë i mallkuar. Për këtë të fundit, ndonëse hollësitë jepeshin të ndryshme, (disa ngulnin këmbë se ishte mallkimi i plakës katolike që e kishte shituar e të tjera, mallkimi i vetë fantazmës), kjo ishte dhe e vëtmja pikë ku rrëfenjësit i lëshonin udhë njëritjetrit.

Që burgjet dhe kampet ishin vendet ku jo vetëm të gjymtuarit mund t'i takoje si kudo, po ku cenet trupore kishin prirjen të binin në sy më fort, kjo merrej me mend. Megjithatë, askush nuk u kap pas kësaj për të kundërshtuar rrëfenjësit. Përgjithësisht ata vetë kishin prirjen të mos tregoheshin grykës. Pranonin që edhe të tjera mund të kishin jetuar pranë "demonit", madje shfaqjen e tij në burgje a kampe të ndryshme e përligjin me qarkullimin e të burgosurve nga një vend në tjetrin. Me sa dukej, në krejt këtë histori, pjesëmarrësit, si të shtyrë nga një këshillues i përbashkët, i shmangeshin vëtmisë. Ashtu si edhe më parë, ajo dukej e papërballueshme jo-vetëm për një njeri, por për një grup të tërë njerëzish, për të mos thënë një brez të tërë.

"T'u thaftë gjuha ty që deshe të përgjosh gjuhën e

të vdekurit!". Kështu thuhej se ishte formuluar mallkimi i plakës nga Lezha kundër tij.

Dhe mallkimi e kishte ndjekur njeriun hap më hap, stinë pas stine e vit pas viti. Në krye, gjuha nisi t'i trashej, e folura sa vente i ngadalësohej, e fill pas gjuhës, tejzat e duarve nisën t'i ngrinin.

Ndonëse kishte ndërruar disa herë burg e kamp, e keqja s'i ndahej, gjersa e kishte kuptuar dhe vetë se nuk ishte as pikëtira e maleve të veriut, as lagështia e fushës që e dëmtonte, por tjetër gjë.

Herët a vonë, mallkimi e arrinte kudo. Duart s'i lëvizte dot fare dhe gjuha i ishte rënduar aq keq saqë e folura e tij, sipas pohimit të atij vetë, ishte bërë e njëjtë me atë të vdekurit, ashtu siç e kishte nxjerrë nga balta atë natë të paharuar tetori.

Ky kishte qenë edhe rrëfimi i fundit i tij në këtë botë, përpara se Zoti t'ia merrte gojën krejt.

Në krye ishte besuar se synimi i mallkimit kishte qenë pikërisht njëjësimi i të folurës së tij me të folurën veshtullore të fantazmës, por pastaj u kuptua se fati s'kishte patur mëshirë për të, duke e çuar ndëshkimin më tej.

Kështu, duarcung e gjuhëtarë vërtitej nëpër kamp a në oborrin e burgut, nën vështrimin hetues të të burgosurve. Tani, që e dinin se nuk përgjigjej dot, ia bënин edhe më të shpeshta pyetjet: trego, si e bëre atë gjëmë që nxorre nga varri të vdekurin? Si e detyrove të fliste, pastaj e vërtite nëpër qìll, kapur pas zverku, për ta çuar në darkën e tiranit? S'pate frikë nga qìlli, o djall?

Me sy të shqyer ai e përballonë vështrimin e tyre. Nuk tutej, as kërkonte të ikte a të zgjonte mëshirë. E vëtmja vuajtje që i shfaqej në fytyrë ishte ajo e mosfoljes. Dhe pothuajse gjithë rrëfyesit pohonin se vinte një çast që në hirnosjen e syve të tij pikasnin vetëtimthi diçka të tjetërbotshme.

Historia e "mufatur" e Arian Voglit, ajo që mendohej se kishte ndodhur në një kohë prej gjashtë-shtatë vjetësh, në të vërtetë nuk kishte zgjatur veçse disa orë.

Kur në darkën e famshme me dytsin e tiranit Arian Vogli u përmend, kryet e kishte ende mbi tryezë. E para gjë që i kaloi vetëtimthi në tru ishte se nuk e kishin helmuar. Fill pas kësaj i erdhi të qeshte me vete: kush do ta helmonte dhe pse?

Ende nuk e kuptonte ku ndodhej. Pastaj sytë i shkuan të ndenjësja e zbrazët përballë tij dhe fërkoi ballin me dorë. Me siguri kam parë ëndërr, tha me vete dhe u ngrit. Bëri disa hapa drejt derës, vështroi dhe një herë muret e dhomës dhe prapë e çoi dorën te balli. Hija e udhëheqësit ishte zhdukur, por dhoma dhe tryeza dhe ndjenjëset ishin po ato, të ëndrrës.

E hapi derën ngadalë dhe doli në mesore. Turbull i kujtohej se kishte hyrë pikërisht këndeje. Eci më tutje dhe doli në një mesore tjeter më të gjatë. Pastaj në një tjeter, nga qelqnaja e së cilës dukej këndi i një salle, me tryezat e gjata, mbi të cilat dukeshin ende gjurmat e gostisë: gota pijesh të lëna përgjysmë, napëza të hedhura pa kujdes, enë të pahequra.

Darka zyrtare paskësh mbaruar, tha me vete. Dritat po shuheshin njëra pas tjetrës në pallatin e madh. Shandanët gjithashtu.

Nuk arriti të mendonte se ç'do të bëhej me të, kur dy njerëz të panjohur se nga mbinë përbri tij. U çlodhe pakëz? tha njëri. Tani do të shkojmë.

Arian Vogli deshi të thoshte "ku?", por pyetja iu duk pa kuptim. Duhej të ishte i kënaqur që, midis tërë kokëçarjeve të darkës, nuk e kishin harruar.

Ndërsa ecnin përmes mesores së madhe, një grimë iu duk se poshtë setrës së njërit prej shoqëruesve të tij dalloi një bluzë të bardhë. Pastaj vuri re çantën në njëren dorë të tij. Ç'kam? e pyeti me zë të ulët. Më ka rënë të fikët gjatë darkës? Kam bërë ndonjë proçkë? Asgjë me rëndësi, u përgjigj njeriu. Një çrregullim i vogël, me

siguri nga lodhja.

Tjetri ishte ndërkaq te hyrja dhe po iu bënte shenjë ta ndiqnin.

Makina i priste përjashta. U futën të tre në ndenjësen e pasme, duke e vënë Arian Voglin në mes.

Iu duk se ata të dy po e shtrëngonin pak si tepër. Në mendje i vinin pështjellueshëm nisja me ngut nga B., fluturimi nëpër quell dhe darka me dytsin e Udhëheqësit. Ishin shumë për një natë. E aq më tepër që e kishin gjetur të lodhur për vdekje.

Ku po shkojmë? pyeti pas pak. Në hotel?

Iu duk se ata u mëdyshën për t'u përgjigjur.

Në mos në hotel, në një shtëpi pritjeje, iu përgjigj ai vvetves. A nuk i kishin thënë se një jetë tjetër niste tani për të?

Ndriçuesit e rrugës sa vente bëheshin më të rrallë. Pastaj u tretën krejt. Shqetësimi iu davarit aty për aty, kur mendoi se shtëpitë e pritjes ishin zakonisht jashtë qyteteve. Madje ato më të fshehtat, ishin përherë tepër larg.

U përpoq të dremiste pak, por nuk mundi. Një herë iu duk se pas qelqeve të makinës, nën një ndriçim të zbehtë hëne, që se nga mbiu befas, dalloj malet me mjegull. S'kishte ndonjë gjë për t'u habitur nëse e çonin drejt e në B. Atje krejt Sigurimi po merrej ditë e natë me zbulimin e komplotit. Dhe ai, shefi i tij, duhej të ndodhej në vend.

Mendimi për hotelin ose shtëpinë e pritjes iu dukën befas qesharake. Ai ishte njeriu që po merrej me zbulimin e përbetimit më të madh kundër vendit në këto dhjetë vitet e fundit. Ai s'mund të humbte asnjë ditë, asnjë orë, askund. Të mbërrinte sa më parë në B., per t'i kallur datën qytetit që, qysh prej katër ditësh, gdhihej e ngrysej në ankth.

Kështu mendonte, po kjo s'e ndihte aspak të çlirohej prej ankthit të vet. Makina po ngadalësonte shpejtësinë dhe ai u habit së tepërmë kur ndaloi krejt. Shoqërueshit e tij zbritën të parët.

Në terr shquhej një banesë e ulët, e ngjashme me hotelin e gjuetisë në Lezhë.

Mbërritëm, tha njëri prej shoqëruesve, duke i bërë shenjë ta ndiqte. Të pushojmë pakëz këtu.

Dikush nga brenda hapi derën dhe ata hynë të tre. Ftohtësia e mesoreve të fuste drithmën në shpirt. Një fener i zbehtë në fundin e njërsës prej tyre mezi i ndriçonte dyert.

Hynë në njëren nga dhomat. Në fillim njëri nga shoqëruesit, pastaj ai vetë, së fundi njeriu tjetër, ai me bluzë të bardhë nën setër. Arian Vogli u kthye të pyeste përse nuk po i jepnin asnje shpjegim. Ç'ishte kjo banesë dhe përse duhej të kalonin natën këtu?

Hapi gojën të fliste po shkëlqimi si teh thike i syve të tyre e shtangu. Ashtu, i ngurosur, i ndoqi krejt veprimet e tyre, si të ndodhnin mbi një trup tjetër: hedhjen e beftë sipër tij, rrëzimin në shtrat, prangimin e duarve pas shpinës. Klithmat: ç'bëni kështu, ju jeni të çmendur, kush jeni ju? Nuk arriti t'i nxirrte asnjëherë. Lëshoi vec një "oh" të gjatë e të dhimbshëm dhe mendimi se sado e çmendur t'i dukej kjo, në të vërtetë ai e kishte pritur, e piku në shpirt.

Që poshtë, ata i dukeshin edhe më të frikshëm. Njëri prej tyre, ai me bluzë të bardhë, kishte çantën që tani dukej haptas se ishte një çantë infermieri dhe diçka po nxirrte prej saj. Deshi t'i thoshte: s'ka nevojë të më bëni gjëlpërë, siç e shihni nuk po ju kundërshtoj, por aty për aty mendoi se një qetësues nuk do t'i bënte keq.

I qetë, ndoqi me sy lëvizjet e njeriut, mbushjen e gjëlpërës, fërkimin me alkool të krahut, përkuljen sipër tij. Shpimi ishte i dhimbshëm, por edhe më i keq ishte rrjedha e lëngut brenda trupit.

E kishte ende ndërgjegjen kur ia gërvishtën krahun e djathtë, pastaj të majtin, si t'i bënин një vaksinë. Pastaj, pas një ngërçi të shkurtër, e humbi.

Ata të dy nuk priten shumë. Bluzëbardhi ia hapi nofullat me forcë dhe provoi t'i nxirrte gjuhën. Një copë herë u mor me përgatitjen e gjilpërës tjetër. Pastaj, duke

ia mbajtur gjuhën me njërën dorë, me tjetrën ia nguli majën.

-Tani mund t'ia heqësh prangat, -i tha tjetrit. -S'do të ketë më kurrë nevojë për to.

Disa orë më pas, në mëngjes, mendimi i parë që i erdhi Arian Voglit pas përmendjes, ishte pikërisht për prangat. S'mi paskan hequr prangat, tha me vete.

U kthyte djathtas, pastaj i mëshoi supit të djathtë për t'u ngritur, siç bënин gjithë të lidhurit. Kur arriti, më në fund, të çohet, krejt i befasuar kuptoi se në duar s'kishte kurrfarë prangash. Habia po i shndërrrohet ndërkaq në tmerr. Ç'më keni bërë kështu?, klithi me vete. Pastaj u mbush me frymë për të uluritur sa kishte në kokë: ç'më keni bërë kështu?

Dhe ashtu bëri, uluriti sa kishte në kokë, por në çast ra përbys, si i goditur nga rrufeja. Kurrfarë fjalësh nuk i dolën, veç një klithmë e egër çnjerëzore, diçka midis bulurimës së një kau dhe britmës së shpendit vetmitar.

Në mëngjes ata erdhën prapë. Dukeshin të clodhur, madje buzëqeshës.

I thanë "mirëmëngjes", madje njëri prej tyre, bluzëbardhi, shtoi: s'është mirë të mos përgjigjesh kur të thonë mirëmëngjes.

Nejse, s'po ta marrim për keq, tha pasi zuri vend në një ndenjëse. Ne kemi nevojë të ngutshme për disa të dhëna. Gjithmonë lidhur me komplotin që ti nise të zbulosh. Ti ke punuar vetë në organet dhe e di se sa e kotë është në kësi rastesh kokëfortësia. Prandaj, të lutem, t'u përgjigjesh pyetjeve.

Ç'është kjo komedi, tha, ose kujtoi se tha Arian Vogli. Ju e dini se unë nuk flas dot. Ju...

Nga e folura, gjuha i ngjau e rëndë plumb. Vetëm atëherë ai vuri re magnetofonin e vogël që tjetri mbante në njérën dorë.

-Vazhdo, -tha ai me një shprehje të butë, gati mirënlohëse

në fytyrë. -Vazhdo, Arian.

Si shkrepëtimë iu zbulua në tru arsyjeja e regjistrimit në magnetofon. Ajo lidhej me gjilpërën. Dhe gjithçka lidhej me dyshimin e vjetër se ata që dinin shumë, s'duhej të flisnin. Ata po ia thanin gjuhën për t'i hequr mundësinë e të folurit. Këtë ai e dinte qysh prej një mijë vjetësh. Dhe kur hëngri darkë me dytsin, e dinte gjithashtu. Kishte patur frikë nga helmimi dhe kjo që po i bënин tanë, s'ishte veç një motërzim i helmimit. Dhe tanë po i bënин provën. Madje ngaqë e quanin njeri të mbaruar, s'kishin as kujdesin më të vogël që ta fshihnin qëllimin. Ashtu si gjatë darkës me dytsin.

-Vazhdo, Arian, -tha bluzëbardhi, me po atë zë të ngrohtë.

Truri i Arian Voglit punonte si në ethe. Ndryshe nga çasti i klithmës, kur kishte kujtuar se e kishte humbur krejtësisht të folurën, tanë iu duk se diçka i kishte mbetur. Ndoshëta duhej ta fshihte këtë. Të hiqej krejtësisht gojëcung, për t'i vënë në gjumë. Përndryshe do t'i bënин një gjëlpërë tjetër. Për ta heshtur përfundimisht.

Ashtu vendosi; ta trashte sa më fort gjuhën, që ta linin të qetë. Të bindeshin se me atë gjuhë të ngurosur ai s'mund të rrëfente asgjë nga ato që s'duheshin rrëfyer.

Befas u drodh së brendshmi: që po ia thanin gjuhën, kjo tregonte se kishin vendosur ta linin gjallë. Përndryshe mund të kishin zgjedhur rrugën më të shkurtër. Jo, nuk duhej të bënte dredhi. Herët ose vonë, do ta merrnin vesh.

-Ç'...do...ni...tëë...di...iii...n...iii...

-Ju e dini vetë, -tha bluzëbardhi. -Tregoni gjithçka.

Arian Vogli nisi të fliste. Tjetri tundte herë pas here kryet. Me siguri që as që i bëhej vonë ç'thoshte i pyeturi. Mund të tregonte mërzinë e kohëve të fundit, dashurinë e tij të parë, varrimin e nënës.

E duart?, deshi të pyeste. Mirë gjuhën ma prishët, po ç'patët me duart? Përgjigja nuk vonoi t'i vinte vetvetiu, që të mos dëshmonte me anën e shkrimit.

Kjo ishte dhe asgjë tjetër. Gjithçka kishte qenë më

se e logjikshme. Duart duhej të ndiqnin fatin e gjuhës. Veç në qoftë se shkrimi nuk do të ishte në këtë botë ndoshta, do t'i kurseheshin. Por shkrimi ishte.

Mendimi se ai ishte ndoshta njeriu që më rëndshëm se kushdo në këtë njerëzi po e paguante taskën për shpikjen e shkrimit, e pikëlloi qetësisht.

Pas dy ditësh e çuan në spitalin e burgut të Tiranës, në një dhomë të veçantë. Ishin të tjerë njerëz që merreshin tanimë me të. Ia hetonin belbëzimin dy herë në javë duke biseduar pa kurrfarë kujdesi në sytë e tij. Nganjëherë mu përpara tij e ridëgjonin "kuvendimin" e regjistruar në magnetofon, thoshnin "bukur", ose "ktheje dhe një herë mbrapsht", madje një mëngjes, njeri prej tyre, ai që dukej si shef kishte thënë: "s'besoj se ka nevojë për ndërhyrje tjetër".

Merrej me mend se nuk e quanin veçse një kufomë. Arian Vogli i vështroi me mirënjojje, por kur ata dolën, qau një copë herë në heshtje.

Gjuha po i çenjtej ngadalë, por belbëzimi, ndonëse ndryshonte, nuk qartësohej. E kishin kuptuar se nuk bënte dredhi, ndaj nuk e fshihnin se ishin të kënaqur me të.

Pas dy muajsh, në hetimin e fundit të së folurës, atij iu duk se ajo i ngjasonte asaj të të vdekurit, tre vjet e ca më parë, atë natë të paharrueshme të 13 tetorit, kur e kishte nxjerrë nga balta.

Ishte hera e parë që besoi se e kishin mallkuar vërtet.

Ndonëse shumë herë u hap fjala se do të arrestohej, Arian Vogli nuk ra në burg asnjëherë. Farefisnia e tij e gjerë, një pjesë e së cilës punonte në Komitete Partie dhe në Degët e Brendshme u bë shkak, me sa dukej, që të kursehej. Gjymtimi i tij u quajt përherë si rrjedhojë e një

helmimi në një darkë të dyshimtë, ku pjesëmarrja e tij as u shpërmiratua e as u quajt si çështje detyre. Edhe në shkresën zyrtare, ku i njoftohej dalja e parakohshme në pension për arsy shëndetësore, nuk iu bë asnë nënvizim gjymtimit të tij.

Ishte, me sa dukej, kjo gjendje e tymtë, e sidomos zhdukja e tij nga sytë e njerëzve, që nxiti përhapjen e legjendës së tij nëpër kampe dhe burgje.

Ai s'kishte më gojë, por meqenëse për ngjizjen e një legjende gojët e të tjerëve ishin përherë më të përshtatshme, ajo nuk rreshti për vite me radhë.

Shumë gjëra u pëshpëritën ndërkaq. Në një takim me të, thuhej se shkrimtari Skënder Bermema, duke u përpjekur t'ia zbërthente belbëzimin, e sidomos duke e përfshuar atë ravgim e ankth kaotik, si dëndësim të tejskajshëm të censurës, të pengesave të gjuhës e të pamundësisë së shprehjes, prej të cilave torturohej nëpër mijëvjeçarë njeriu, u rrek të bënte një sprovë letrare: me atë grusht të rrallë belbëzimesh, të dala aq mundimshëm prej zgrofit të zi të mosfoljes, të ngjizte një roman të tërë.

I ngjeshur si lëndë yjesh të bardhë, i përbërë veç prej nëntë ose dy mbëdhjetë rreshtash, i cilësuar andej-këndej nëpër bisedat si "roman i pamundur" ose "kundërrroman", i pagëzuar madje me titullin "I Damun", fjalë e vjetër e shqipes prej së cilës thuhej se rriddhe fjala Demon, ai roman nuk ishte botuar kurrë.

Ndryshe nga historia e Arian Voglit, ngjarja e zymtë e zbulimit dhe e dënimit të grupit që bënte seanca spiritizmi, pësoi një dukuri të kundërt. Ajo çka kishte ndodhur gjatë pesë-gjashtë muajve u ngjesh e u mbështoll në fillim në një kohëzgjatje pesë-gjashtë orësh, për të përfunduar më pas në pesë-gjashtë minuta.

Ja historia e tkurrur e seancës së spiritizmit: Fill pas hapjes së varrit të Shpend Guraziut dhe dëgjimit të

zërit të tij, Arian Vogli me njerëzit e vet, ashtu të llangosur siç ishin, rendën drejt e në apartamentin ku po zhvillohej ndërkaq seanca. I zbardhur në fytyrë, mediumi ishte duke u ankuar se s'hynte dot në lidhje me "spiritus"-in. Ka shkarkime në ajër, thoshte, ka një tjetër pengesë misterioze. Ishte duke shqiptuar fjalën e fundit, kur dera e apartamentit u shkallmua që jashtë dhe Arian Vogli me të vetët, të zez e të përbaltur, shpërthyen brenda. Ka pengesa, natyrisht, uluriti. Pastaj qeshi si djalli vetë duke treguar me njérën dorë kasetën e magnetofonit. Shpirtin, që po e prisni në takim, e kam zënë unë. E kam kam këtu, ha-ha-ha, përpëlitet, dridhet si zokth në grushtin tim... Dhe tani, zgjatni duart t'ju hedh hekurat...

E vërteta e njëmendtë ishte ndërkaq tepër larg. Rrjedha e ngjarjeve, personazhet që morën pjesë në të, e sidomos kohëzgjatja e saj ishin fare të ndryshme. Kjo e fundit për shembull ishte gati dyzetë mijë herë më e gjatë se koha e legjendës. Kurse kapësi i shpirtit, Arian Vogli, qeshja "ha, ha, ha" e të cilit ishte, me sa duket, dhe shenja e parë e kthimit në demon, as që mori pjesë në arrestimin e grupit e aq më pak në zbulimin e përbetimit. Ai dergjët në një dhomë veçimi me gjuhën ende plagë, ndërsa oficerë të shumtë të ardhur nga kryeqyteti, po merreshin ditë e natë me "shpleksjen e fijeve të komplotit".

Përgjimi vazhdoi tepër gjatë, më shumë se gjysmë viti. Thuhej se vetë diktatori e ndiqte hap pas hapi zhdrivillimin e hetimeve. Siç ua kishte pohuar të afërmve, nuk donte të ikte nga kjo botë pa e marrë vesh edhe këtë përbetim të fundit, me sa dukej, më të tmerrshmin kundër tij dhe Shqipërisë.

I pari u arrestua Skënder Morina dhe, një ditë më pas, mediumi. Brenda javës ranë në burg të zotët e apartamentit, pastaj Nikolla, zonja Greblleshi dhe gjithë të tjerët.

Skënder Morina nuk e fshehu se kishte dashur t'i conte një thirrje Perëndimit për ndihmë, madje ishte ai vetë që e kishte nxitur Shpend Guraziun t'u drejtohej senatorëve francezë. Për përzierjen e të tjerëve në përbetim,

nuk pranoi asnjëherë. E torturuan egërsisht dhe atë mëngjes herët kur e çuan për ta vdekur, ata që e kishin parë, dëshmuant se një krah dhe një sy e kishte të shkulur. E hodhën gjysmë të gjallë në një pus të braktisur qymyrguri, larg qytetit.

Mediumi vdiq nën torturë. Nikolla, ndonëse pranoi të nënshkruante çdo pohim, nuk pati tjetër fat. Të tjerët gjithashtu. Hetuesit kishin dyshim se të fshehtën kryesore, rrugën nëpërmjet të cilës Perëndimi do të kthente përgjigje, e mbanin të fshehtë.

Ndërkaq dosja e përbetimit sa vente fryhej. Njeri pas tjetrit ranë në burg dy zyrtarë të lartë të Sigurimit, komandanti i bazës ushtarake të Pasha Limanit, ish-ambasadori shqiptar në Paris. U pëshpërit se dyshimi ngjitej më lart, çka ishte e logjikshme për një përbetim të përmasave të tillë. Kur i erdhë radha ministrit të Brendshëm, të gjithë e ndjenë se ky nuk ishte një cak, por fillimi i një shkallëzimi. Të gjitha shenjat ishin se rrufeja do të binte në Byronë Politike. Dhe ashtu ndodhi vërtet.

Ndërkaq në qytetin e vogël B. njerëzit, të mpirë krejt, dëgjonin lajmet e mbrëmjes, pa u mësuar dot me mendimin se tërmeti që po dridhte krejt vendin e kishte patur zanafillën te varreza e pikëlluar e qytetit të tyre provincial. Që andej kishte dalë zëri që, më lemerishëm se briri i apokalipsit, do të ngjethët gjithkënd.

Të gjitha këto u rikujtuan turbull e pështjellueshëm në atë të dalë dimri. E rishfaqur ngjarja ishte ende e e rrezikshme. Ishte ende midisëse, e dynatyryshme. Mishin e kishte të kohës së re, por luspat e forta të mitit i kishin mbirë ndërkaq sipër. Ndihej se njëra natyrë e saj kërkonte të flakte tjetrën.

Njerëzit, pasi ishin përpjekur ta harronin, turbull e kishin kuptuar se e vetmja mënyrë për t'u ndarë prej saj ishte të merreshin me të. Ta ndihmonin të vetëbalsamosej.

Ndryshe, ashtu do t'u mbetej nëpër këmbë. As e gjallë, as e vdekur.

Ajo mpakej e rreshkej vërtet çdo ditë. Por, shi kur dukej se po shkonte drejt tkurrjes së skajshme, për t'u kthyer më në fund në një bërthamë, kreshpërohej befas me një furi të re. Kështu, në të hyrë të marsit, si në një furtunë të papritur, motërzimet u pëshqelluan e u ndeshën keq, në një përpjekje të fundit për ta mbytur njëra-tjetrën.

Shtampa e gjedhe epesh të moçme, vegla që sa më të vjetra aq më frytdhënëse ishin në kësi rastesh, u përdorën gjerësisht. Darka zyrtare në Pallatin e Brigadave, ajo që në vështrim të parë mund të dukej aq larg botës epike, u tret e u përpunua e para për t'u rishfaqur me trajtë të re. Shtampa e moçme e "darkës me të vdekurin" ishte vendimtare për tjetersimin e saj. Ftesa për darkë e të vdekurit, premtimi për ta çuar të vdekurin në një darkë, mbërritja e të dyve, Arian Voglit dhe Shpend Gurazut - Demonit dhe Spiritusit në pallatin e Brigadave (të verdhë të dy, njëri nga që kishte qenë tre vjet nën tokë, tjetri ngaqë kishte zbritur për ta marrë), të gjitha këto ushqyen njerin nga dy motërzimet kryesore të darkës. Tjetri, i bazuar kryesisht mbi takimin e Arian Voglit me Dytsin, pati prirje shkëputjeje e dalje më vete. Meqenëse Dytsi kishte qenë shëmbëllim i diktatorit, pra një farë shfaqje në pasqyrë a fantazmë e tij, ishte krejt i natyrshëm tharmëtimi epik, për të dhënë baladën e "Darkës me tiranin e vdekur".

Pjesa më e patretshme e ngjarjes dukej ajo që kishte llidhje me gjeopolitikën. Veçimi i vullnetshëm i Shqipërisë, harrimi i saj prej botës, dërgata e senatorëve francezë si dhe përpjekja për t'i tejçuar një kumt Perëndimit dhe NATO-s, ngjanin gjithsesi të huaja për legjendën. I kishte enët dhe lëngjet tretëse edhe për to, por më të reja, rrjedhimisht jo aq të përkryera sa veglat dhe magjen e moçme, ku mbrunte, për shembull, brumin e vdekjes. Shprehi të vjetra

poetike si "Evropa shkruajnë e thonë" ose "Në atë të zezën Spanjë" të përziera me lajme gazetash bashkëkohore, madje me grindje partish politike në shtyp, lidhur për shembull me arin e diktatorit të skajuar në bankat e Zvicrës, (midis diamanteve thuhej se ishte dhe kaseta me zërin e "Spiritusit"), e sidomos me polemikën: a ishte veç Shqipëria fajtore për veçimin e saj, apo edhe bota të kishte pjesën e vet në këtë tmerri, të gjitha këto, duke iu afruar legjendës, dukej se do të mbeteshin gjithsesi jashtë saj. Por, ishin pikërisht ato që, për habi, dhanë njërin prej dy motërzimeve përfundimtare, atë të baltës që foli, Shqipëria e braktisur, pa gojë, e padëgjuar nga kurrikush, kaq të fortë e pati ahtin që donte të nxirrte, saqë një natë tetori ai aht e bëri baltën të fliste si të kishte shpirt.

U ndie në atë fund dimri se sado që të dendësohej ngjarja, tkurrja nuk mund të shkonte më tej, kështu që "balta që kishte folur" dhe "kapja e shpirtit" do të mbeteshin që të dyja bërthamat e saj.

Të pleksur me njëri-tjetrin, dy motivet kryesore, edhe kur dukej se ndaheshin, afroheshin më fort. I lidhnin jo vetëm personazhet e njejtë, Demoni me Spiritusin, por edhe dhjetëra fije të tjera. Do të mjaftonte vetëm njëra prej tyre, tortura e pengesës dhe përpjekja për ta kapërcyer atë, që t'i bënte binjakë për jetë. Ajo ndihej kudo: pengesa për t'i cuar një kumt botës, pengesa e mediumit për t'u lidhur me Spiritusin, e këtij të fundit për t'u folur shokëve, pengesa e helikopterit për t'u ulur, e radarëve që mezi lidheshin me pilotin, mjegulla ndarëse midis Arian Voglit dhe hijes së tiranit, pengesa në gjuhën e Demonit, ajo që e bënte të endej nëper botë me ate bila-billane e tij të frikshme, së fundi pengesa dhe kapërcimi i së pamundurës prej baltës, që arriti të nxirrte ahtin e Shqipërisë.

Në pranverë, ende pa mbërritur krillat e para, ndodhën të tjera ndryshime, më të përkora. Ashtu si dy selvi që për shkak të afërsisë së madhe qëllon që ngjiten me njëratjetrën, u bashkuan e u kthyen në një personazh dy gratë e bukurë të asaj historie të trishtë: Edlira Gjikondi dhe Suzanë K.

Si rrjedhojë e kësaj, armiqësimi midis Demonit dhe Spiritusit u pasurua edhe me një shkak tjetër, këtë herë të përjetshëm, xhelozinë për një grua. Ndesheshin pra, veç të tjerash, edhe për të. Ndiqeshin të dy nëpër qiej, klithnin "është imja" e rënkim iu ndihej larg, nëpër mot të keq.

Ndonëse dukej se s'mund të mpakej më, historia vazhdoi të tkurrej gjatë gjithë pranverës. I binin me shpejtësi si gjethet copëza të tëra, vyshkeshin si në katastrofë bisqet e reja, një dëshirë e përgjithshme harrese bënte atë që do të duheshin ta bënин vite të tërë. Kështu ra historiza e ushtarit-aktor, që e përdornin në kufirin detar për të ngallur terror, e mjekes së syve që u arrestua për shkak të proverbit të korbit plak e të verbër, etj.

Thuhej se shkrimtari Skënder Bermema, që ishte përpjekur të ndiqte fatin e legjendës, pasi e kishte fryrë veprën e vet prej dymbëdhjetë rradhësh në një dorëshkrim një mijë faqesh, tanë po e ngjishte prapë për ta dhënë këtë herë në shtatë radhë!

Pëshpërima për çmendurinë e tij nuk kishte qenë kurrë aq e fortë.

Aty nga mesi i prillit, historia tashmë e moçme e Spiritusit dhe Demonit përmendej ende, por fare ndryshe nga pak kohë më parë. Flitej për të gjakftohtësisht, me një lodhje sipërane, siç flitet zakonisht për yjtë ose gjërat

tepër të largëta.

Guacka brenda së cilës ishte ndryrë, jo vetëm e mbronte nga ndërhyrjet, me atë fortësi dhe lëmim prej kuarci që kish, por pengonte rrezatimin e saj tronditës.

Një kaltërsi dehëse, gati e padurueshme dukej se ndihmonte gjithçka atë pranverë.

Dalja në skenë e birit të Spiritusit, (atë ditë kur djali i Suzanë K. kishte mbushur njëzetënë vjeç, aktorja nuk e kishte fshehur se kishte mbetur shtatzënë në takimin e parë dhe të fundit me fëndjerin), shfaqja pra e të birit që, siç pritej, nisi të kërkonte të atin, jo vetëm nuk e kishte cënuar baladën, por i kishte dhënë tkurrjen e fundit. Për këtë kishte ndihmuar, natyrisht, trinia e krishtërimit "ati, biri dhe shpirti i shenjtë", formulë për shkak të së cilës kishte rënë nën goditjen e "princave" frati Nik Prela.

Përherë dyberthameshe, balada vazhdonte të ishte po aq e njohur në motërzimin e dytë, atë të "baltës që kishte folur". Një formulë edhe më e lashtë, ajo e Biblës që e jepte krijimin e njeriut prej Zotit si përzierje të baltës dhe të frymës, ishte mbështetëse e saj. Tre vjet e ca nën tokë, Spiritusi, i përzier me baltën, kishte arritur më në fund t'ia kalonte asaj, ashtu siç thoshte Bibla, zërin e vet njerëzor.

Kështu, dyfarëshe, balada u përdor prej dy agjensive kryesore turistike shqiptare "Albturist" dhe "Shqipëriaturist".

Si e krijuar enkas për dy agjensi shemra, ajo u shërbente njëlloj të dyjave. Shigjetat e njerës e jepnin vendin e "shpirtkurthit" në një rrafshnaltë veriore, afër bujtinës së vjetër të Rrashtit të Buallit, të blerë prej saj e të kthyer në motel për turistët. Kurse shenjat e tjetrës tregonin se vendi i "Fushavajës" (baltës që kishte folur ose kishte dënesur) ndodhej në Shqipërinë Qendrore, jo larg qytetit B. Ashtu si agjensia e parë, ajo kishte riparuar një bujtinë mesjetare, duke i rivënë emrin e vjetër "Bujtina

e Dy Robertëve" të hequr prej komunistëve.

Në reklamat e të dy agjensive, krahas orareve dhe çmimeve për stinët e ndryshme turistike, të dhëna përveç lekut shqiptar, në dollarë dhe marka gjermane, ishte shtypur një pjesë e baladës.



Tiranë-Paris
1995-1996

* Për të gjithë ju që e lexoni këtë libër të mretullueshëm kam një pyetje:
— Përse fjalë S.P.I.R.I.T.U.S është shkruar me pikë nëpër të? (Është vërtet domethë-nëse.)